

**KOMBET E  
BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen  
Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje  
të Rënda të së Drejtës Humanitare  
Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-  
Jugosllavisë prej Vitit 1991

Lënda Nr.. IT-04-84-A  
Data: 19 korrik 2010  
Origjinali: anglisht

**NË DHOMËN E APELIT**

**Para:** Gjykatësit Patrick Robinson, Kryegjykatës  
Gjykatësit Fausto Pocar  
Gjykatësit Liu Daqun  
Gjykatësit Andréia Vaz  
Gjykatësit Theodor Meron

**Sekretari:** Z. John Hocking

**Aktgjykim:** 19 korrik 2010

**PROKURORI**

**kundër**

**RAMUSH HARADINAJT  
IDRIZ BALAJT  
LAHI BRAHIMAJT**

***PUBLIK***

**AKTGJYKIM**

**Zyrës së Prokurorit:**

Z. Peter Kremer  
Z. Marwan Dalal  
Zj. Elena Martin Salgado

**Avokatëve të Ramush Haradinajt:**

Z. Ben Emmerson  
Z. Rodney Dixon

**Avokatëve të Idriz Balajt:**

Z. Gregor Guy-Smith  
Zj. Colleen Rohan

**Avokatëve të Lahi Brahimajt:**

Z. Richard Harvey  
Z. Paul Troop

**PASQYRA E LËNDËS**

<b>I. HYRJE</b> .....	<b>5</b>
A. RRETHANAT .....	5
B. APELI I PROKURORISË.....	7
C. APELI I BRAHIMAJT .....	7
D. SEANCA E APELIT.....	8
<b>II. STANDARDI I RISHIKIMIT</b> .....	<b>9</b>
<b>III. APELI I PROKURORISË</b> .....	<b>13</b>
A. PRETENDIM PËR SHKELJE TË TË DREJTËS SË PROKURORISË PËR GJYKIM TË DREJTË.....	13
(PIKA 1).....	13
1. Hyrje.....	13
2. Vendimet e Dhomës Gjyqësore që pretendohet ta kenë privuar Prokurorinë prej të drejtës për gjykim të drejtë.....	15
(a) Vendimi i 31 tetorit 2007 dhe Urdhri për Caktim Date i 30 nëntorit 2007.....	16
(b) Vendimi i 15 nëntorit 2007.....	18
(c) Vendimi i 20 nëntorit 2007.....	19
(d) Vendimi i 26 nëntorit 2007 lidhur me Kabashin.....	20
(e) Vendimi i 26 nëntorit 2006 lidhur me dëshmitarin tjetër.....	21
(f) Vendim i 5 dhjetorit 2007.....	22
(g) Vendim i 21 dhjetorit 2007.....	23
3. Analizë.....	24
4. Përfundim.....	33
B. PRETENDIMET PËR GABIME LIDHUR ME VRASJET E MOTRËS “S”, TË NËNËS SË DËSHMITARIT 4, DHE MOTRËS “M” (PIKA 2).....	34
C. PRETENDIME PËR GABIME LIDHUR ME PËRDHUNIMIN, TORTURIMIN DHE TRAJTIMIN MIZOR TË DËSHMITARES 61 DHE TRAJTIMIN MIZOR TË DËSHMITARIT 1 (PIKA 3).....	39
1. Pretendimet për përdhunim, torturim dhe trajtim mizor të Dëshmitares 61 nga Idriz Balaj.....	40
(a) A gaboi Dhoma Gjyqësore kur konkludoi se ekzistonte dyshim i arsyeshëm që Idriz Balaj (i njohur si “Toger”) ishte përgjegjës për përdhunimin, torturimin dhe trajtimin mizor të Dëshmitares 61.....	40
(b) A gaboi Dhoma Gjyqësore kur nuk u mbështet në prova të tjera identifikuese.....	42
(c) A gaboi Dhoma Gjyqësore kur nuk u mbështet në prova të dorës së dytë.....	44
2. Pretendimi për përgjegjësinë e Idriz Balajt në trajtimin mizor të Dëshmitarit 1.....	47
(a) A gaboi Dhoma Gjyqësore kur konkludoi se trajtimi i Dëshmitarit 1 nuk përmbushi standardin e veprës penale të trajtimit mizor sipas Nenit 3.....	49
(b) A është Idriz Balaj përgjegjës për trajtimin mizor të Dëshmitarit 1.....	50
<b>IV. APELI I LAHI BRAHIMAJT</b> .....	<b>53</b>
A. PRETENDIME PËR GABIME LIDHUR ME BESUESHMËRINË E DËSHMITARIT 6 (PIKA 1).....	53
1. Pretendimi për shkelje të Rregullës 68 nga ana e Prokurorisë.....	54
2. Pretendim për pabesueshmërinë e dëshmisë së Dëshmitarit 6 lidhur me kontaktin e tij me Sretë Camoviqin.....	57
3. A gaboi Dhoma Gjyqësore kur nuk shqyrtoi konkretisht pretendimin për mosdhënien e një shpjegimi të besueshëm prej Dëshmitarit 6 lidhur me ndryshimin e kushteve të burgimit të tij.....	58
4. A gaboi Dhoma Gjyqësore kur nuk shqyrtoi konkretisht pretendimet për mospërputhje.....	59
5. A gaboi Dhoma Gjyqësore kur nuk shqyrtoi konkretisht motivin.....	67
6. Pretendime për gabime lidhur me identifikimin.....	70

7. Përfundim.....	76
B. PRETENDIME PËR GABIME LIDHUR ME TORTURIMIN E DËSHMITARIT 6 (PIKA 2) .....	76
1. Pretendim për gabim lidhur me akuzën se Lahi Brahimaj ka vepruar me synim .....	76
2. Pretendim për gabim lidhur me arsyen për keqtrajtimin e Dëshmitarit 6 (arsye politike) .....	78
3. Pretendim për gabim lidhur me arsyen për keqtrajtimin e Dëshmitarit 6 (bashkëpunim i pretenduar me serbët) .....	79
4. Pretendime për gabime të tjera lidhur me arsyen për keqtrajtimin e Dëshmitarit 6 .....	80
5. Pretendim për gabim lidhur me arsyen për keqtrajtimin e Dëshmitarit 6 (armëmbajtje) .....	82
6. Përfundim.....	83
C. PRETENDIME PËR GABIME NË LIDHJE ME TORTURIMIN DHE TRAJTIMIN MIZOR TË DËSHMITARIT 3 (PIKAT 3-6).....	84
1. Pretendime për gabime në lidhje me vlerësimin nga Dhoma Gjyqësore të dëshmisë së Dëshmitarit 6 për torturimin e Dëshmitarit 3 (Pikat 3 dhe 5.1) .....	84
(a) A “hamendësoi” Dhoma Gjyqësore se Dëshmitari 3 ishte rrahur.....	87
(b) A gaboi Dhoma Gjyqësore në konkluzionin se Dëshmitari 6 nuk hyri në dhomën ku mbahej Dëshmitari 3 .....	88
(c) A gaboi Dhoma Gjyqësore në konkluzionin se Dëshmitari 6 nuk e pa Dëshmitarin 3 kur ai u arratis nga dhoma.....	90
(d) A gaboi Dhoma Gjyqësore në rrëzimin e arsyeve të dhëna nga Dëshmitari 6 se përse Dëshmitari 3 nuk ishte rrahur .....	91
(e) A gaboi Dhoma Gjyqësore kur pranoi dëshminë e Dëshmitarit 3 duke marrë parasysh se kjo dëshmi nuk u konfirmua, por përkundrazi binte ndesh me dëshminë e Dëshmitarit 6 (Pika 5.1) .....	92
(f) A e shkeli Dhoma Gjyqësore parimin <i>in dubio pro reo</i> .....	93
(g) Përfundim.....	94
2. Pretendime për gabime në vlerësimin e Dhomës Gjyqësore të dëshmisë për kohëzgjatjen e qëndrimit të Dëshmitarit 3 në oborrin me ndërtesa të UÇK-së në Jabllanicë (Pika 4) .....	94
3. Pretendime për gabime në vlerësimin nga Dhoma Gjyqësore të besueshmërisë së Dëshmitarit 3 (Pika 5) .....	97
(a) Pretendim për kundërshti midis dëshmisë së Dëshmitarit 3 dhe dëshmisë të Fadil Fazliut (Pika 5.2) .....	98
(b) Pretendim për motiv të Dëshmitarit 3 për sajim dëshmie (Pika 5.3).....	100
(c) Mospërputhje të tjera (Pika 5.4).....	103
(d) Përfundim.....	108
4. Pretendime për gabime në lidhje me dëshminë e Dëshmitarit 3 për kthimin e tij në Jabllanicë (Pika 6).....	108
D. PRETENDIME PËR GABIME NË LIDHJE ME RRAHJEN E PARË TË DËSHMITARIT 3 (PIKAT 7 DHE 8).....	111
1. Pretendim për mosnxjerrje përfundimesh mbi rrahjen e parë (Pika 7) .....	111
2. Pretendim për gabim në lidhje me përgjegjësinë e Lahi Brahimajt për rrahjen e parë (Pika 8) .....	114
E. PRETENDIME PËR GABIME NË LIDHJE ME MOTIVET E LAHI BRAHIMAJT PËR TORTURIMIN E DËSHMITARIT 3 (PIKA 9) .....	116
1. A arriti Prokuroria të provonte një apo më shumë elemente të torturimit .....	117
2. A gaboi Dhoma Gjyqësore në konkluzionin se Lahi Brahimaj synonte ta diskriminonte Dëshmitarin 3 për shkak se mendohej që ai kishte lidhje me serbët.....	119
3. A shpërfilli Dhoma Gjyqësore prova që lidhen me pushkën Kallashnikov .....	122
4. A pati Lahi Brahimaj njoftim të duhur për “bazën alternative” të fajësisë së tij.....	124
5. Përfundim.....	126

F. APELIMI I DËNIMIT (PIKAT 10-19) .....	127
1. Standardi i rishikimit .....	128
2. Pretendim për gabim në konkluzionin se posti i mëparshëm ishte faktor rëndues (Pika 10) .....	129
3. Pretendim për gabim në konkluzionin se posti i Lahi Brahimajt në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së ishte post i lartë në UÇK dhe si rrjedhojë rrethanë rënduese (Pika 11) .....	131
4. Pretendim për gabim në konkluzionin se posti i mëparshëm i Lahi Brahimajt si Zëvendëskomandant i Zonës së Dukagjinit ishte post i lartë në UÇK dhe rrjedhimisht rrethanë rënduese (Pika 12) .....	134
5. Pretendim për gabim në konkluzionin se Lahi Brahimaj i inkurajoi ushtarët të kryenin krime (Pika 13) .....	136
6. Pretendim për gabim në konkluzionin se krimet u kryen në prani të ushtarakëve me grada më të ulëta (Pika 14) .....	138
7. Pretendim për gabim në lidhje me cënueshmërinë e veçantë të Dëshmitarëve 3 dhe 6 (Pika 15) .....	139
8. Pretendim për gabim në konkluzionin se Dëshmitari 3 dhe Dëshmitari 6 ende vuanin pasoja fizike në kohën e dhënies së dëshmimeve të tyre (Pikat 16 dhe 17) .....	141
9. Pretendim për gabime në konkluzionin se frika për jetën e Dëshmitarit 6 u shtua kur mësoi për vdekjen e Skënder Kuqit, duke qenë rrjedhimisht faktor rëndues (Pika 18) .....	142
10. Pretendim për gabim të Dhomës Gjyqësore në ushtrimin jo të duhur të kompetencës së saj gjyqësore duke marrë parasysh se dënimi i dhënë ishte haptazi i tepruar në të gjitha rrethanat (Pika 19) .....	144
<b>V. VENDIM .....</b>	<b>148</b>
<b>VI. ARSYETIM PJESËRISHT MOSPAJTUES I GJYKATËSIT PATRICK ROBINSON. 150</b>	
A. HYRJE .....	150
B. VENDIMET E KUNDËRSHTUARA TË DHOMËS GJYQËSORE .....	155
1. Vendimi i 31 tetorit 2007 .....	156
2. Vendimi i 15 nëntorit 2007 .....	156
3. Vendimi i 20 nëntorit 2007 .....	160
4. Vendimi i 26 nëntorit 2007 në lidhje me Kabashin dhe Vendimi i 5 dhjetorit 2007 .....	162
5. Vendimi i 26 nëntorit 2007 në lidhje me dëshmitarin tjetër dhe Urdhri i 30 nëntorit 2007 për Caktim Date .....	163
6. Vendimi i 21 dhjetorit 2007 .....	165
C. PËRFUNDIM .....	167
<b>VII. SHTOJCA I: HISTORIA PROCEDURALE .....</b>	<b>170</b>
A. PËRBËRJA E DHOMËS SË APELIT .....	170
B. DOSJET E APELIT .....	170
1. Apeli i Prokurorisë .....	170
2. Apeli i Lahi Brahimajt .....	171
C. AVOKATËT E PROKURORISË DHE TË MBROJTJES .....	171
D. KONFERENCAT MBI GJENDJEN .....	172
E. TRANSFERIMI I IDRIZ BALAJT .....	172
F. LIRIMI I PËRKOHSHËM I LAHI BRAHIMAJT .....	172
G. SEANCA E APELIT .....	172
<b>VIII. SHTOJCA II: FJALORI .....</b>	<b>173</b>
A. LISTA E VENDIMEVE TË TRIBUNALIT DHE TË TJERA .....	173
1. TPNJ .....	173

2. TPNR .....	182
3. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut .....	184
4. Të tjera.....	185
B. LISTA E SHKURTIMEVE .....	186

## I. HYRJE

1. Dhoma e Apelit e Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë prej Vitit 1991 (përkatësisht “Dhoma e Apelit” dhe “Tribunali”), ka marrë dy apele ndaj aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore I (“Dhoma Gjyqësore”) të 3 prillit 2008 në çështjen *Prokurori kundër Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt*, Lënda nr. IT-04-84-T (“Aktgjykimi”).<sup>1</sup>

### A. Rrethanat

2. Ramush Haradinaj u lind më 3 korrik 1968 në Gllogjan, në komunën e Deçanit, në Kosovë, në ish Jugosllavi.<sup>2</sup> Aktakuza pretendon se nga 1 marsi 1998 ose rreth kësaj date e deri nga mesi i qershorit 1998, ai shërbeu si komandant *de facto* në UÇK, dhe se në mes të qershorit 1998, ai u emërua komandant, me komandë të përgjithshme të forcave të UÇK-së në zonën e Dukagjinit.<sup>3</sup> Idriz Balaj u lind më 23 gusht 1971 në Gllarevë, në komunën e Klinës në Kosovë.<sup>4</sup> Aktakuza pretendon se gjatë gjithë kohës së Aktakuzës, ai ishte anëtar i UÇK-së dhe komandonte një njësi speciale e njohur si “Shqiponjat e Zeza”.<sup>5</sup> Lahi Brahimaj u lind më 26 janar 1970 në Jabllanicë, në komunën e Gjakovës, në Kosovë.<sup>6</sup> Aktakuza pretendon se gjatë gjithë kohës së Aktakuzës ai ishte anëtar i UÇK-së i cili kreu detyrën e Zëvendëskomandantit të Shtabit Operativ të Dukagjinit nga data 23 qershor 1998 deri më 5 korrik 1998, dhe më pas atë të Drejtorit të Financës së Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së.<sup>7</sup>

3. Ngjarjet që shërbyen si shkak për nisjen e kësaj çështjeje ndodhën në Kosovë midis 1 marsit 1998 dhe 30 shtatorit 1998.<sup>8</sup> Aktakuza pretendon se gjatë kësaj periudhe UÇK-ja përdoqi dhe rrëmbeu civilë serbë dhe romë/egjiptianë kosovarë, si dhe civilë

<sup>1</sup> Njoftim për Apel i Prokurorisë; Dosja e Apelit të Prokurorisë; Njoftim për Apel i Brahimajt; Dosja e Apelit të Brahimajt.

<sup>2</sup> Aktakuza, para. 1.

<sup>3</sup> Aktakuza, para. 2; Aktgjykim, para. 2.

<sup>4</sup> Aktakuza, para. 8.

<sup>5</sup> Aktakuza, para. 9; Aktgjykim, para. 3.

<sup>6</sup> Aktakuza, para. 11.

<sup>7</sup> Aktakuza, para. 12; Aktgjykim, para. 4.

<sup>8</sup> Aktakuza, para. 13; Aktgjykim, para. 1.

shqiptarë kosovarë për të cilët mendohej se bashkëpunonin me forcat serbe në zonën e Dukagjinit në Kosovë.<sup>9</sup> Prokuroria akuzoi Ramush Haradinajn, Idriz Balajn, dhe Lahi Brahimajn si pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale (“NPK”) për kryerjen e krimeve kundër njerëzimit, bazuar në Nenin 5 të Statutit të Tribunalit (“Statuti”), dhe shkeljeve të ligjeve ose zakoneve të luftës, bazuar në Nenin 3 të Statutit.<sup>10</sup> Qëllimi i përbashkët kriminal i NPK-së së pretenduar ishte konsolidimi i kontrollit të plotë të UÇK-së mbi zonën e Dukagjinit nëpërmjet largimit të paligjshëm dhe keqtrajtimit të kategorive të lartpërmendura të civilëve.<sup>11</sup> Ndryshe, Prokuroria akuzoi tre të akuzuarit për përgjegjësi individuale penale sipas paragrafit 1 të Nenit 7 të Statutit për kryerje, planifikim, nxitje, urdhërim, ose për ndihmë dhe inkurajim në kryerjen e krimeve të pretenduara në Aktakuzë.<sup>12</sup>

4. Dhoma Gjyqësore përfundoi se provat e paraqitura ishin të pamjaftueshme për vërtetimin e ekzistencës së NPK-së në të cilën morën pjesë tre të akuzuarit. Ajo i shpalli tre të akuzuarit të pafajshëm lidhur me Pikat 6, 14, 20, 22 (lidhur me vrasjen e Nurijs dhe Istref Krasniqit dhe vrasjen e Sanije Balajt), 30, 36, dhe 37 të Aktakuzës.<sup>13</sup> Dhoma Gjyqësore gjithashtu i shpalli Ramush Haradinajn dhe Idriz Balajn të pafajshëm lidhur me Pikat 28 dhe 32 të Aktakuzës dhe gjykoi se Lahi Brahimajt nuk do t’i ngarkohej përgjegjësi sipas Pikave 28 dhe 32 të Aktakuzës, për pjesëmarrje në NPK.<sup>14</sup> Gjithashtu Dhoma Gjyqësore i shpalli Ramush Haradinajn dhe Idriz Balajn të pafajshëm në lidhje me të gjitha akuzat alternative në Aktakuzë.<sup>15</sup>

5. Dhoma Gjyqësore shpalli Lahi Brahimajn fajtor për torturim si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës, sipas Pikës 28 të Aktakuzës, dhe torturim dhe trajtim mizor si shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës, sipas Pikës 32 të Aktakuzës.<sup>16</sup> Lahi Brahimaj u

<sup>9</sup> Aktakuza, para. 14, 26; Aktgjykim, para. 1.

<sup>10</sup> Aktakuza, para. 25; Aktgjykim, para. 5.

<sup>11</sup> Aktakuza, para. 26; Aktgjykim, para. 5.

<sup>12</sup> Aktakuza, para. 17-24; Aktgjykim, para. 5.

<sup>13</sup> Aktgjykim, para. 475-478, 502-503.

<sup>14</sup> Aktgjykim, para. 478, 502-503.

<sup>15</sup> Aktgjykim, para. 502-503.

<sup>16</sup> Aktgjykim, para. 479-481, 504.

shpall i pafajshëm lidhur me të gjitha Pikat e tjera të Aktakuzës.<sup>17</sup> Dhoma Gjyqësore e dënoi Lahi Brahimajn me një dënim të vetëm me 6 vjet burgim.<sup>18</sup>

### **B. Apeli i Prokurorisë**

6. Më 2 maj 2008, Prokuroria dorëzoi Njoftimin për Apel duke paraqitur tri arsye për apelim ndaj Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore. Së pari, Prokuroria kërkon nga Dhoma e Apelit që: (a) të shfuqizojë vendimet për lirim të tre të akuzuarve nga përgjegjësia penale bazuar në pretendimin për pjesëmarrje në NPK për krime të kryera në Shtabin e UÇK-së dhe në burgun në Jabllanicë sipas Pikave 24, 26, 28, 30, 32, dhe 34 të Aktakuzës; (b) të shfuqizojë vendimet për lirim të tre të akuzuarve nga përgjegjësia individuale penale sipas Pikave 24 dhe 34 të Aktakuzës; (c) të shfuqizojë vendimin për lirim të Lahi Brahimajt nga përgjegjësia individuale penale sipas Pikës 26 të Aktakuzës; dhe (d) t'ia kthejë çështjen një Dhome Gjyqësore për rigjykim me qëllim përcaktimin e përgjegjësisë së tre të akuzuarve për këto krime.<sup>19</sup> Së dyti, Prokuroria kërkon nga Dhoma e Apelit që të shfuqizojë vendimin e shpalljes së pafajësisë së Idriz Balajt për akuzën për vrasje dhe ta dënojë atë për Pikën 14 të Aktakuzës për vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës sipas Nenit 3 të Statutit, duke qenë se ka ndihmuar ose inkurajuar vrasjet e motrës “S”, nënës së Dëshmitarit 4, dhe motrës “M”.<sup>20</sup> Së treti, Prokuroria kërkon nga Dhoma e Apelit që të shfuqizojë vendimin e shpalljes së pafajësisë së Idriz Balajt për akuzën për përdhunim, torturim dhe trajtim mizor të Dëshmitares 61, dhe për trajtim mizor të Dëshmitarit 1, dhe ta dënojë atë për Pikat 36 dhe 37 për përdhunim, torturim dhe trajtim mizor të Dëshmitares 61 dhe trajtim mizor të Dëshmitarit 1 si shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës sipas Nenit 3 të Statutit.<sup>21</sup>

### **C. Apeli i Brahimajt**

7. Më 5 maj 2008, Lahi Brahimaj dorëzoi Njoftimin për Apel duke paraqitur nëntëmbëdhjetë arsye për apelim, ku kërkon nga Dhoma e Apelit që të shfuqizojë

<sup>17</sup> Aktgjykim, para. 504.

<sup>18</sup> Aktgjykim, para. 501, 505.

<sup>19</sup> Njoftimi për Apel i Prokurorisë, para. 6-7; Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 42-43.

<sup>20</sup> Njoftimi për Apel i Prokurorisë, para. 16; Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 71.

<sup>21</sup> Njoftimi për Apel i Prokurorisë, para. 21; Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 89, 96.

vendimin për dënimin e tij lidhur me akuzën për torturim dhe trajtim mizor të Dëshmitarit 6 dhe Dëshmitarit 3, dhe kundërshton dënimin e tij.<sup>22</sup>

#### **D. Seanca e Apelit**

8. Më 28 tetor 2009, Dhoma e Apelit dëgjoi parashtrimet gojore të palëve në lidhje me këto apele. Pasi ka shqyrtuar parashtrimet gojore dhe me shkrim prej palëve, Dhoma e Apelit paraqet më poshtë Aktgjykimin e vet.

---

<sup>22</sup> Njoftimi për Apel i Brahimajt, para. 27-28; Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 181-182.

## II. STANDARDI I RISHIKIMIT

9. Në apel, argumentet e palëve duhet të përqëndrohen në gabimet ligjore që zhvlerësojnë vendimin e Dhomës Gjyqësore dhe në gabime faktuale që shkaktojnë dështimin e drejtësisë.<sup>23</sup> Këto kritere janë të përkufizuara në Nenin 25 të Statutit dhe të mirëpërcaktuara në jurisprudencën e Tribunalëve të tjerë *ad hoc*.<sup>24</sup> Në rrethana të veçanta, Dhoma e Apelit shqyrton edhe apeline ku një palë ka ngritur një çështje ligjore që nuk e zhvlerëson Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, mirëpo gjithsesi është e një rëndësie më të gjerë për jurisprudencën e Tribunalit.<sup>25</sup>

10. Pala që pretendon ekzistencën e gabimit ligjor duhet të identifikojë gabimin e pretenduar, të paraqesë argumente në mbështetje të pretendimit të saj dhe të shpjegojë mënyrën se si gabimi e zhvlerëson vendimin.<sup>26</sup> Pretendimi për një gabim ligjor që nuk ka asnjë gjasë të ndryshojë rezultatin e një vendimi mund të hidhet poshtë për këtë arsye.<sup>27</sup> Edhe sikur argumentet e palës të jenë të pamjaftueshme në mbështetje të pretendimit të gabimit, gjithsesi Dhoma e Apelit për arsye të tjera mund të konkludojë se ekziston gabim ligjor.<sup>28</sup> Apeluesi që pretendon ekzistencën e gabimit ligjor duke u bazuar në mungesën e mendimit të arsyetuar, duhet të identifikojë çështjet konkrete, përfundimet

<sup>23</sup> Aktgjykimi i Apelit *Nchamihigo*, para. 7; Aktgjykimi i Apelit *Zigiranyirazo*, para. 8; Aktgjykimi i Apelit *Karera*, para. 7.

<sup>24</sup> Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 9; Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 10; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 11; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 8; Aktgjykimi i Apelit *Haxhihasanoviq dhe Kubura*, para. 7; Aktgjykimi i Apelit *Haliloviq*, para. 6.

<sup>25</sup> Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 9; Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 10; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 11; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 8; Aktgjykimi i Apelit *Oriq*, para. 7; Aktgjykimi i Apelit *Haxhihasanoviq dhe Kubura*, para. 7.

<sup>26</sup> Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para.10; Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 11; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Nchamihigo*, para. 8; Aktgjykimi i Apelit *Zigiranyirazo*, para. 9.

<sup>27</sup> Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 10; Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 11; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 12.

<sup>28</sup> Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 10; Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 11; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 9; Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 11; Aktgjykimi i Apelit *Haxhihasanoviq dhe Kubura*, para. 8. *Shih gjithashtu* Aktgjykimin e Apelit *Nchamihigo*, para. 8; Aktgjykimi i Apelit *Zigiranyirazo*, para. 9.

faktuale, ose argumentet të cilat sipas tij nuk janë shqyrtuar nga Dhoma Gjyqësore, dhe të shpjegojë arsyen pse mosshqyrtimi i tyre e bën të pavlefshëm vendimin.<sup>29</sup>

11. Dhoma e Apelit shqyrton përfundimet ligjore të Dhomës Gjyqësore për të përcaktuar nëse janë ose nuk janë të drejta.<sup>30</sup> Nëqoftëse Dhoma e Apelit gjen një gabim ligjor në Aktgjykim që buron prej zbatimit të standardit të gabuar ligjor prej Dhomës Gjyqësore, Dhoma e Apelit qartëson standardin e duhur ligjor dhe rrjedhimisht shqyrton përfundimet përkatëse faktuale të Dhomës Gjyqësore.<sup>31</sup> Në këtë mënyrë, Dhoma e Apelit jo vetëm që korrigjon gabimin ligjor por gjithashtu zbaton standardin e duhur ligjor në lidhje me provat e administruara gjatë procesit gjyqësor kurdoherë që nevojitet dhe përcakton nëse është e bindur jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm në lidhje me përfundimin faktual të kundërshtuar prej apeluesit para konfirmimit të këtij përfundimi në apel.<sup>32</sup> Dhoma e Apelit nuk do të shqyrtojë tërë dokumentacionin e procesit gjyqësor sërish. Ajo përgjithësisht do të shqyrtojë vetëm provat e përmendura nga Dhoma Gjyqësore në tekstin e Aktgjykimit ose në një poshtëshënim përkatës, provat e administruara gjatë procesit gjyqësor dhe të cilave u referohen palët dhe, sipas nevojës, provat shtesë të pranuar në apel.<sup>33</sup>

<sup>29</sup> Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 10; Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 9; Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 11; Aktgjykimi i Apelit *Haliloviq*, para. 7; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 9.

<sup>30</sup> Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 11; Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 14; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 10; Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Haliloviq*, para. 8.

<sup>31</sup> Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 11; Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 14; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 10; Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Oriq*, para. 9; Aktgjykimi i Apelit *Haxhihasanoviq dhe Kubura*, para. 9; Aktgjykimi i Apelit *Nchamihigo*, para. 9; Aktgjykimi i Apelit *Zigiranyirazo*, para. 10; Aktgjykimi i Apelit *Karera*, para. 9.

<sup>32</sup> Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 11; Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 14; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 10; Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Oriq*, para. 9; Aktgjykimi i Apelit *Nchamihigo*, para. 9; Aktgjykimi i Apelit *Zigiranyirazo*, para. 10; Aktgjykimi i Apelit *Karera*, para. 9.

<sup>33</sup> Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 14; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Haxhihasanoviq dhe Kubura*, para. 9; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 15; Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 8.

12. Gjatë shqyrtimit të pretendimeve për gabime ligjore, Dhoma e Apelit zbaton standardin e arsyeshmërisë.<sup>34</sup> Gjatë shqyrtimit të përfundimeve të Dhomës Gjyqësore, Dhoma e Apelit zëvendëson përfundimin e Dhomës Gjyqësore me përfundimin e vet vetëm nëse asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të kishte arritur në përfundimin e parë.<sup>35</sup> Dhoma e Apelit zbaton të njëjtin standard arsyeshmërie ndaj pretendimeve për gabime faktuale pavarësisht faktit nëse vërtetimi i faktit u bazua në prova të drejtpërdrejta apo rrethanore.<sup>36</sup> Për më tepër, Dhoma e Apelit shfuqizon një vendim të Dhomës Gjyqësore vetëm në rast se gabimi faktual ka shkaktuar dështimin e drejtësisë.<sup>37</sup>

13. Gjatë zbatimit të këtyre parimeve themelore, Dhoma e Apelit kujton se ka identifikuar llojet e argumenteve të pamjaftueshme në apel të cilat hidhen poshtë menjëherë.<sup>38</sup> Në veçanti, Dhoma e Apelit, pa dhënë arsyetim të hollësishëm, do të hedhë poshtë (a) argumente që nuk i identifikojnë përfundimet faktuale të kundërshtuara, që shtrembërojnë përfundimet faktuale ose provat, ose që nuk marrin në konsideratë përfundime të tjera të vlefshme faktuale; (b) thjesht pohime se Dhoma Gjyqësore sigurisht që nuk ka shqyrtuar prova të vlefshme, pa provuar që asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh, në bazë të provave, nuk do të kishte arritur në përfundimin e Dhomës Gjyqësore; (c) kundërshtime lidhur me përfundimet faktuale mbi të cilat nuk mbështetet një dënim, dhe argumente që janë dukshëm të parëndësishme, që mbështesin ose që nuk janë në kundërshtim me përfundimin e kundërshtuar; (d) argumente të cilat kundërshtojnë shfrytëzimin ose mosshfrytëzimin e një prove nga Dhoma Gjyqësore, pa shpjeguar arsyen

<sup>34</sup> Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 15; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 14; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 11; Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Haxhihasanoviq dhe Kubura*, para. 10.

<sup>35</sup> Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 15; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 14; Aktgjykimi i Apelit *Haxhihasanoviq dhe Kubura*, para. 10; Aktgjykimi i Apelit *Oriq*, para. 10; Aktgjykimi i Apelit *Haliloviq*, para. 9; Aktgjykimi i Apelit *Limaj dhe të tjerë*, para. 12.; Aktgjykimi i Apelit *Nchamihigo*, para. 10; Aktgjykimi i Apelit *Zigiranyirazo*, para. 11.

<sup>36</sup> Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 14; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 11; Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Haxhihasanoviq dhe Kubura*, para. 10.

<sup>37</sup> Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 15; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 14; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 11; Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Oriq*, para. 10; Aktgjykimi i Apelit *Nchamihigo*, para. 10; Aktgjykimi i Apelit *Zigiranyirazo*, para. 11.

<sup>38</sup> Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 18; Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 17; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 16-18; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 17; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 15; Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 17.

pse verdiktit i fajësisë nuk qëndron në bazë të provave të tjera; (e) argumente në kundërshtim me gjykimin e shëndoshë; (f) kundërshtime lidhur me përfundimet faktuale në raste kur rëndësia e përfundimit faktual është e paqartë dhe nuk është shpjeguar nga pala apeluese; (g) thjesht përsëritje të argumenteve të cilat kanë qenë të pasuksesshme gjatë procesit gjyqësor pa provuar nëse mospranimi i tyre nga Dhoma Gjyqësore përbënte gabim që do të përlligjte ndërhyrjen e Dhomës së Apelit; (h) pretendime mbi bazë të materialeve që nuk janë administruar gjatë procesit gjyqësor; (i) thjesht pohime që nuk mbështeten nga asnjë provë, deklaratatë pashtjelluara, mospërcaktime të gabimeve; dhe (j) thjesht pohime se Dhoma Gjyqësore nuk u dha rëndësinë e duhur provave ose nuk bëri interpretimin e tyre sipas një mënyre të caktuar.<sup>39</sup>

---

<sup>39</sup> Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 18; Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 17; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para 17-27; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para 14-21; Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 18-24; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 17-31; Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 256-313; Aktgjykimi i Apelit *Nchamihigo*, para. 11-12; Aktgjykimi i Apelit *Zigiranyirazo*, para. 12-13.

### III. APELI I PROKURORISË

#### A. Pretendim për Shkelje të të Drejtës së Prokurorisë për Gjykim të Drejtë

##### (Pika 1)

##### 1. Hyrje

14. Prokuroria pretendon se Dhoma Gjyqësore kreu gabim ligjor duke shkelur të drejtën e saj për gjykim të drejtë sipas paragrafit 1 të Nenit 20 të Statutit.<sup>40</sup> Në veçanti, Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore bëri gabim kur hodhi poshtë kërkesën e Prokurorisë për zgjatjen e afatit kohor që do t'i mundësonte asaj të shfrytëzonte të gjitha masat e arsyeshme për të siguruar dëshmitë e dy dëshmitarëve kyç, të Shefqet Kabashit (“Kabashi”) dhe të një dëshmitari tjetër, dhe urdhëroi mbylljen e çështjes së Prokurorisë përpara se të mund të merreshin këto masa të arsyeshme.<sup>41</sup> Prokuroria deklaron se këta dëshmitarë zotëronin prova të drejtpërdrejta për fajësinë e të tre të akuzuarve dhe refuzuan të dëshmonin për shkak të kërcënimeve dhe frikës.<sup>42</sup>

15. Prokuroria pretendon se gabimi i Dhomës Gjyqësore e bën të pavlefshëm vendimin meqë i pamundësoi Prokurorisë të paraqiste dëshmi vendimtare lidhur me: (a) pjesëmarrjen e Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt në NPK për të kryer krimet në shtabin e UÇK-së dhe në burgun në Jabllanicë sipas Pikave 24, 26, 28, 30, 32 dhe 34 të Aktakuzës; (b) përgjegjësinë individuale penale të Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt sipas Pikave 24 dhe 34 të Aktakuzës; dhe (c) përgjegjësinë individuale penale të Lahi Brahimajt sipas Pikës 26 të Aktakuzës.<sup>43</sup> Rrjedhimisht, Prokuroria kërkon nga Dhoma e Apelit që të shfuqizojë vendimin e shpalljes së pafajësisë së Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt për Pikat e lartpërmendura dhe

<sup>40</sup> Njoftimi për Apel i Prokurorisë, para. 3; Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 5.

<sup>41</sup> Njoftimi për Apel i Prokurorisë, para. 3; Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 4-5.

<sup>42</sup> Njoftimi për Apel i Prokurorisë, para. 3.

<sup>43</sup> Njoftimi për Apel i Prokurorisë, para. 5.

t'ia kthejë çështjen një Dhome Gjyqësore për rigjykim,<sup>44</sup> duke deklaruar se rigjykimi do të ofronte një mundësi të arsyeshme për t'i dëgjuar këta dëshmitarë kyç.<sup>45</sup>

16. Mbrojtja<sup>46</sup> pretendon se pika e parë e Apelit të Prokurorisë është e pabazë. Mbrojtja argumenton se Dhoma Gjyqësore bëri përpjekje të shumta për marrjen e dëshmimeve të Kabashit dhe dëshmitarit tjetër, dhe se pavarësisht përpjekjeve e Dhomës Gjyqësore, që të dy dëshmitarët vendosmërisht nuk pranuan të dëshmonin gjatë gjithë procesit gjyqësor, megjithëse ishin të vetëdijshëm për pasojat e mundshme të mospranimit.<sup>47</sup> Mbrojtja argumenton se deri në fund të procedimit të çështjes së Prokurorisë nuk pati kurrfarë treguesi që Prokuroria do të mund të siguronte dëshmitë e tyre brenda kohës së parashikueshme, dhe se për këtë arsye Dhoma Gjyqësore kishte të drejtë të konkludonte se Prokurorisë i ishte dhënë mundësia e duhur për paraqitjen e çështjes së saj.<sup>48</sup>

17. Dhoma e Apelit rikujton se, kur njëra nga palët në apel pretendon se i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë, pala në fjalë duhet të provojë që Dhoma Gjyqësore ka bërë shkelje të një dispozite të Statutit dhe/ose të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të Tribunalit (“Rregullorja”), dhe që ajo shkelje për pasojë ka shkaktuar një gabim ligjor që e bën të pavlefshëm aktgjykimin.<sup>49</sup> Dhoma e Apelit thekson se vendimet e Dhomës Gjyqësore lidhur me administrimin gjyqësor, si për shembull vendimet që përcaktojnë kohën që ka në dispozicion një palë për paraqitjen e çështjes, si dhe kërkesat për shtyrjen e afatit për paraqitjen e provave, janë vendime në kompetencën e Dhomës Gjyqësore të cilat Dhoma e Apelit i respekton.<sup>50</sup> Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit duhet të

<sup>44</sup> Njoftimi për Apel i Prokurorisë, para. 6; Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 43.

<sup>45</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 42-43. *Shih gjithashtu* TA. 23-53, 104-105, 120-128 dhe 158-159 (Seancë Publike dhe Private).

<sup>46</sup> Vini re se “Mbrojtja” u referohet avokatëve të tre të akuzuarve, meqë Balaj dhe Brahimaj iu bashkuan Dosjes së Përgjigjes së Haradinajt, me përqëndrim në arsyen 1 të Apelit të Prokurorisë. *Shih* Dosja e Përgjigjes së Balajt, para. 14-16; Dosja e Përgjigjes së Brahimajt, para. 3.

<sup>47</sup> Dosja e Përgjigjes së Haradinajt, para. 2

<sup>48</sup> Dosja e Përgjigjes së Haradinajt, para. 3. *Shih gjithashtu* TA. 61-93, 103-120 dhe 159-163 (Seancë Publike dhe Private).

<sup>49</sup> Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 21; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 119; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 221; Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerë*, para. 87; Neni 25(1)(a) i Statutit.

<sup>50</sup> *Prokurori k. Stanislav Galiqi*, Lënda Nr. IT-98-29-AR73, Vendim lidhur me Kërkesën e Prokurorisë për të bërë Apel, 14 dhjetor 2001, para. 7 (i referohet në veçanti kompetencës së Dhomës Gjyqësore për të caktuar afatet kohore për paraqitjen e çështjes së Prokurorisë); *Prokurori k. Jadranko Përliqi dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-74-AR73.4, Vendim mbi Apelin e Prokurorisë në lidhje me Vendimin e Dhomës Gjyqësore për të Shkurtuar Afatin Kohor për Procedimin e Çështjes së Prokurorisë, 6 shkurt 2007, para. 20.

përcaktojë nëse Dhoma Gjyqësore shpërdoroi kompetencën e saj duke mbyllur çështjen e Prokurorisë përpara se të dëshmonin Kabashi dhe dëshmitari tjetër, që do të përbënte shkelje të detyrimit të saj sipas paragrafit 1 të Nenit 20 të Statutit për granatimin e një gjykimi të drejtë dhe duke i kushtuar kujdesin e duhur mbrojtjes së viktimave dhe dëshmitarëve. Në rast se Dhoma Gjyqësore ka shpërdoruar kompetencën e saj, Dhoma e Apelit duhet të përcaktojë nëse kjo shkelje ka shkaktuar një gabim ligjor që e bën të pavlefshëm Aktgjykimin.

## 2. Vendimet e Dhomës Gjyqësore që pretendohet ta kenë privuar Prokurorinë prej të drejtës për gjykim të drejtë

18. Prokuroria përmend disa vendime të Dhomës Gjyqësore të cilat sipas pretendimit të saj, veç e veç ose bashkërisht cënuan të drejtën e saj për gjykim të drejtë,<sup>51</sup> ndër të cilët: (a) një vendim gojor i 31 tetorit 2007;<sup>52</sup> (b) një vendim gojor i 15 nëntorit 2007;<sup>53</sup> (c) një vendim gojor i 20 nëntorit 2007;<sup>54</sup> (d) një vendim gojor i 26 nëntorit 2007 lidhur me Kabashin;<sup>55</sup> (e) një vendim gojor i 26 nëntorit 2007 lidhur me dëshmitarin tjetër;<sup>56</sup> (f) një urdhër për caktim date i 30 nëntorit 2007;<sup>57</sup> (g) një vendim me shkrim i 5 dhjetorit 2007;<sup>58</sup> dhe (h) një vendim me shkrim i 21 dhjetorit 2007.<sup>59</sup> Dhoma e Apelit do të trajtojë secilin vendim veç e veç.

<sup>51</sup> Njoftimi për Apel i Prokurorisë, para. 4 dhe Shtojca Konfidenciale, f. 1-2; Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 17.

<sup>52</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 19-22 (citon T. 9984-9986 (31 tetor 2007) (Seancë Publike) (“Vendim i 31 tetorit 2007”).

<sup>53</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 40 (citon T. 10876 (15 nëntor 2007) (Seancë Private) (“Vendim i 15 nëntorit 2007”).

<sup>54</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 24-25 (citon T. 10935-10936, 10956 (20 nëntor 2007) (Seancë Publike) (“Vendim i 20 nëntorit 2007”).

<sup>55</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 24, 26 (citon T. 10977-10979 (26 nëntor 2007) (Seancë Publike) (“Vendim i 26 nëntorit 2007 lidhur me Kabashin”).

<sup>56</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 37 (citon T. 10975-10978 (26 nëntor 2007) (Seancë Publike) (“Vendim i 26 nëntorit 2007 lidhur me dëshmitarin tjetër”).

<sup>57</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 23 (citon *Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-T, Urdhër për Caktim Date për Dorëzimin e Dosjeve Përfundimtare dhe për Argumentet Përmbyllëse, 30 nëntor 2007 (“Urdhër për Caktim Date i 30 nëntorit 2007”).

<sup>58</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 24 (citon *Prokurori kundër Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda nr. IT-04-84-T, Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Leje për Apelim të Vendimit të Dhomës Gjyqësore në lidhje me Shefqet Kabashin, 5 dhjetor 2007 (“Vendim i 5 dhjetorit 2007”).

<sup>59</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 24 (citon *Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-T, Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Rihapjen e Procedimit të Çështjes së Saj për Dëgjimin e Dëshmisë së Shefqet Kabashit dhe për Përfaqësim Juridik të Autoriteteve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, 21 dhjetor 2007 (“Vendim i 21 dhjetorit 2007”).

19. Gjatë Seancës së Apelit, Prokuroria më tej pretendoi se, duke marrë parasysh rrethanat e veçanta të procesit gjyqësor gjatë të cilit dy dëshmitarë kyç nuk dëshmuuan për shkak të kërcënimeve, Dhoma Gjyqësore ishte e detyruar në bazë të paragrafit 1 të Nenit 20 të Statutit që të shqyrtonte *proprio motu* mundësinë e pranimit të deklaratave të tyre me shkrim në bazë të paragrafit F të Rregullës 89 të Rregullores.<sup>60</sup> Dhoma e Apelit rikujton se pa autorizim konkret prej saj, gjatë seancës së apelit palët nuk duhet të paraqesin argumente të reja që nuk janë përfshirë në dosjet e tyre me shkrim.<sup>61</sup> Duke marrë parasysh se Prokuroria e ngriti këtë çështje për herë të parë gjatë Seancës së Apelit dhe pa lejen e Dhomës së Apelit, Dhoma e Apelit nuk do ta shqyrtojë atë.

(a) Vendimi i 31 tetorit 2007 dhe Urdhri për Caktim Date i 30 nëntorit 2007

20. Prokuroria deklaroi se ngurtësia e Dhomës Gjyqësore në mosndryshimin e afatit kohor që i kishte caktuar Prokurorisë për paraqitjen e çështjes, e privoi Prokurorinë prej marrjes së dëshmisë së Kabashit dhe të dëshmitarit tjetër, dhe përbën shpërdorim të kompetencës së saj dhe shkelje të të drejtës së Prokurorisë për gjykim të drejtë.<sup>62</sup> Në lidhje me këtë aspekt Prokuroria thekson se Dhoma Gjyqësore i kishte caktuar 125 orë për paraqitjen e çështjes.<sup>63</sup> Prokuroria deklaroi se, ndonëse Dhoma Gjyqësore e dinte që ende nuk kishte dëgjuar dëshmitarët kyç të Prokurorisë dhe që këta dëshmitarë kishin frikë të dëshmonin për shkak të kërcënimeve, kur procedimi i çështjes prej Prokurorisë po i afrohej afatit prej 125 orësh, “125 mbeti shifra e ngurtësuar e Dhomës [Gjyqësore],”<sup>64</sup> dhe që “Dhoma [Gjyqësore] u tregua tepër e rreptë për kufizimet kohore dhe e mbylli çështjen e Prokurorisë.”<sup>65</sup> Prokuroria parashtroi se gabimin e Dhomës Gjyqësore e vërteton Vendimi i 31 tetorit 2007, ku Dhoma Gjyqësore theksonte se: (a) “kishte rishikuar kohën e mbetur brenda afatit 125 orësh” si dhe “dëshmitarët e mbetur nga lista e dëshmitarëve”; (b) priste që Prokuroria ta përfundonte çështjen e saj deri më 16 nëntor 2007; dhe që (c) Prokuroria, Mbrojtja, Dhoma Gjyqësore ishin “të gjitha nën presionin e

<sup>60</sup> TA. 23-24, 30-31, 34-38, 43-44, 47-52, 60-61, 120-124, 127 (Seancë Publike). *Shih gjithashtu* TA. 66, 77-81, 87-93, 103, 161-162 (Seancë Publike) (ku Mbrojtja i përgjigjet këtij argumenti).

<sup>61</sup> *Prokurori k. Miroslav Brallos*, Lënda nr. IT-95-17-A, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Mosmarrje në Konsideratë të Dëshmive dhe mbi Kërkesën e Apeluesit për t’iu Përgjigjur Argumenteve Gojore të Prokurorisë, 5 mars 2007, para. 15.

<sup>62</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 17.

<sup>63</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 18.

<sup>64</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 18, 20.

<sup>65</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 20.

afateve.”<sup>66</sup> Prokuroria më tej i referohet Urdhrit për Caktim Date të 30 nëntorit 2007, në të cilin Dhoma Gjyqësore bën të ditur se “paraqitja e provave të Prokurorisë në këtë çështje ka përfunduar dhe rrjedhimisht mbyllet çështja e Prokurorisë.”<sup>67</sup> Prokuroria pohon se në kundërshtim me deklaratën e Dhomës Gjyqësore, ajo as nuk kishte përfunduar me paraqitjen e provave dhe as nuk e kishte mbyllur çështjen e saj, duke patur parasysh se dëshmitarët kyç të Prokurorisë ende nuk kishin dëshmuar.<sup>68</sup> Prokuroria argumenton se ky vendim i Dhomës Gjyqësore dëshmon “ngutje të paarsyeshme për të marrë vendim”.<sup>69</sup>

21. Në përgjigjen e saj, Mbrojtja thekson se, ndonëse Prokuroria lë të kuptohet se i ishte dhënë kohë e pamjaftueshme për paraqitjen e çështjes, ajo asnjëherë nuk kërkoi nga Dhoma Gjyqësore zgjatje të afatit kohor mbi 125 orë.<sup>70</sup> Në këtë drejtim, Mbrojtja vë në dukje se më 15 tetor 2007, Dhoma Gjyqësore theksoi shprehimisht se Prokuroria nuk kishte kërkuar zgjatje të afatit.<sup>71</sup> Mbrojtja vëren se gjithsesi, më 31 tetor 2007, Dhoma Gjyqësore zgjati afatin kohor për procedimin e çështjes prej Prokurorisë deri më 16 nëntor 2007, për t’i mundësuar Prokurorisë paraqitjen e dëshmisë së Kabashit dhe dëshmitarit tjetër nëpërmjet videolidhjes.<sup>72</sup> Mbrojtja pohon se me dështimin e përpjekjeve për të siguruar dëshminë e dëshmitarit tjetër, Dhoma Gjyqësore zgjati edhe një herë afatin kohor të Prokurorisë deri më 20 nëntor 2007, për të mundësuar dëshminë e Kabashit nëpërmjet lidhjes me video.<sup>73</sup> Mbrojtja më tej pohon se më 20 nëntor 2007, kur Kabashi nuk pranoi të dëshmonte, Dhoma Gjyqësore zgjati për të tretën herë afatin kohor deri më 27 nëntor 2007, për t’i dhënë Prokurorisë edhe një mundësi për marrjen e dëshmisë prej dëshmitarit tjetër.<sup>74</sup> Për më tepër, Mbrojtja pohon se më 26 nëntor 2007, pasi dëshmitari tjetër nuk u paraqit për të dhënë dëshmi me videolidhje, dhe Prokuroria informoi Dhomën Gjyqësore se ai ishte shtruar në spital, Prokuroria nuk bëri më kërkesë për zgjatjen e afatit

<sup>66</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 19.

<sup>67</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 23, *citon* Urdhëresë për Caktim Date e 30 nëntorit 2007.

<sup>68</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 23.

<sup>69</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 23.

<sup>70</sup> Dosja e Përgjigjes së Haradinajt, para. 9; *shih gjithashtu* TA. 66-67 (Seancë Publike).

<sup>71</sup> Dosja e Përgjigjes së Haradinajt, para. 10.

<sup>72</sup> Dosja e Përgjigjes së Haradinajt, para. 11.

<sup>73</sup> Dosja e Përgjigjes së Haradinajt, para. 13; *shih gjithashtu* TA. 70 (Seancë Publike).

<sup>74</sup> Dosja e Përgjigjes së Haradinajt, para. 14.

kohor për paraqitjen e çështjes së saj me qëllim marrjen e dëshmisë së tij ose verifikimin e gjendjes së tij<sup>75</sup>.

(b) Vendimi i 15 nëntorit 2007

22. Prokuroria thekson se më 15 nëntor 2007, dëshmitari tjetër u arrestua pasi nuk ishte paraqitur për të dhënë dëshmi nëpërmjet videolidhjes më 13 nëntor 2007; megjithatë, atë nuk mund ta sillnin në vendndodhjen e videolidhjes para orës 19:00.<sup>76</sup> Prokuroria pretendon se për shkak të “ngulmimit të saj të tepruar në afatet kohore,” Dhoma Gjyqësore nuk pranoi të bënte lëshime lidhur me vonesën e dëshmitarit duke e zgjatur orarin e punës atë ditë ose caktuar një seancë për ditën e nesërme, dhe nuk dha kurrfarë arsyetimi për moslejimin, me përjashtim të konstatimit se një gjë e tillë ishte e pamundur.<sup>77</sup>

23. Mbrojtja deklaroi se, ndonëse Prokuroria fajëson Dhomen Gjyqësore që nuk mundësoi dëshminë e dëshmitarit tjetër më 15 nëntor duke mos vazhduar orarin e punës përtej orës 19:00 ose duke mos caktuar një seancë për ditën e nesërme, Prokuroria në atë kohë nuk bëri një kërkesë të tillë.<sup>78</sup> Në këtë drejtim, Mbrojtja vë në dukje se menjëherë pas kësaj, Prokuroria dorëzoi një mocion në të cilin pranoi se Dhoma Gjyqësore u detyrua të pezullojë seancën pa e dëgjuar dëshmitarin tjetër dhe se Dhoma Gjyqësore nuk mund të mblidhej të nesërmen.<sup>79</sup> Më tej Mbrojtja thekson se më 15 nëntor 2007, dëshmitari tjetër deklaroi në gjyq në prani të avokatit të tij se nuk do të pranonte të dëshmonte po qe se do ta çonin tek vendi i videolidhjes.<sup>80</sup> Sipas Mbrojtjes, duke qenë se Dhoma Gjyqësore i dha Prokurorisë një mundësi tjetër për të marrë dëshminë e dëshmitarit tjetër më 26 nëntor 2007, argumenti i Prokurorisë është qartësisht i pabazë.<sup>81</sup>

<sup>75</sup> Dosja e Përgjigjes së Haradinajt, para. 15.

<sup>76</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 40.

<sup>77</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 40-41; *shih gjithashtu* TA. 32 (Seancë Publike).

<sup>78</sup> Dosja e Përgjigjes së Haradinajt, para. 79.

<sup>79</sup> Dosja e Përgjigjes së Haradinajt, para. 79.

<sup>80</sup> Dosja e Përgjigjes së Haradinajt, para. 80.

<sup>81</sup> Dosja e Përgjigjes së Haradinajt, para. 80; *shih gjithashtu* TA. 81-85 (Seancë Publike).

(c) Vendimi i 20 nëntorit 2007

24. Prokuroria vëren se gjatë seancës së 20 nëntorit 2007, avokati publik amerikan që përfaqësonte Kabashin informoi Dhomën Gjyqësore se Kabashi nuk pranoi “të dëshmoi sot dhe [...] nuk ka ndërmend të japë dëshmi në këtë proces sot”.<sup>82</sup> Prokuroria pohon se më vonë, Dhoma Gjyqësore mori vendimin e 20 nëntorit 2007 me të cilin mbylli çështjen e Prokurorisë me përjashtim të zgjatjes së jashtëzakonshme të afatit kohor deri më 27 nëntor 2007 për të dëgjuar dëshminë e dëshmitarit tjetër.<sup>83</sup> Prokuroria pretendon se duke vepruar në këtë mënyrë, Dhoma Gjyqësore nuk mori parasysh mundësinë se Kabashi mund të dëshmonte në të ardhmen pasi të konsultohej me avokatin që i ishte caktuar për ndihmë juridike lidhur me gjykim të mundshëm për shpërfillje të gjykatës në Shtetet e Bashkuara.<sup>84</sup>

25. Në përgjigjen e saj, Mbrojtja vë në dukje se gjatë seancës së 20 nëntorit, Kabashi nuk pranoi t’i përgjigjej asnjë pyetjeje të Prokurorisë dhe e bëri të qartë se ai nuk ishte “i gatshëm të fliste përpara këtij Tribunali”.<sup>85</sup> Mbrojtja gjithashtu thekson se Kryegjykatësi e informoi Kabashin mbi dënimet për shpërfillje; se Kabashi konfirmoi se nuk do t’i përgjigjej asnjë pyetjeje që do t’i bëhej atij si dëshmitar në çështjen *Haradinaj dhe të tjerë*; dhe se Michael Karnavas, avokat i Kabashit i caktuar nga Tribunali, informoi Dhomën Gjyqësore se Kabashi ishte plotësisht i vetëdijshëm për pasojat e një qëndrimi të tillë.<sup>86</sup> Mbrojtja gjithashtu thekson se Dhoma Gjyqësore vuri në dukje se me muaj të tërë “kishte bërë përpjekje’ për të siguruar dëshminë e Z. Kabashit”; se procedimi i çështjes së Prokurorisë ishte thuajse në përfundim dhe se Kabashi vazhdimisht refuzonte të dëshmonte; dhe, “në rast të ndonjë ndryshimi rrënjësor në qëndrimin e Z. Kabashi, që do të nxiste besimin se ai me të vërtetë kishte ndërmend të dëshmonte, Dhoma Gjyqësore do të miratonte edhe një kërkesë për dëgjimin e dëshmisë së tij.”<sup>87</sup> Mbrojtja pretendon se Dhoma Gjyqësore e përfundoi videolidhjen me arsyetimin se pasi Prokuroria kishte kërkuar nga Dhoma Gjyqësore që Kabashit t’i jepej mundësia që gjatë natës të rishikonte

<sup>82</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 25.

<sup>83</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 25.

<sup>84</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 25; *shih gjithashtu* TA. 47 (Seancë Publike).

<sup>85</sup> Dosja e Përgjigjes së Haradinajt, para. 33.

<sup>86</sup> Dosja e Përgjigjes së Haradinajt, para. 36-37.

<sup>87</sup> Dosja e Përgjigjes së Haradinajt, para. 39.

qëndrimin e tij me ndihmën e këshillimit juridik, Kabashi konfirmoi se nuk do ta ndryshonte qëndrimin edhe sikur të shtyhej seanca.<sup>88</sup>

(d) Vendimi i 26 nëntorit 2007 lidhur me Kabashin

26. Prokuroria thekson se gjatë seancës së 26 nëntorit 2007, Dhoma Gjyqësore “edhe një herë shfaqti ngulmimin e saj për një gjykim të shpejtë” duke hedhur poshtë Mocionin e Prokurorisë së datës 23 nëntor 2007<sup>89</sup>, për zgjatjen e afatit në procedimin e çështjes prej Prokurorisë për të siguruar dëshminë e Kabashit.<sup>90</sup> Prokuroria pretendon se duke hedhur poshtë Mocionin e 23 nëntorit 2007, Dhoma Gjyqësore nuk mori parasysh argumentin e Prokurorisë lidhur me gjasat e marrjes së dëshmisë së Kabashit në qoftë se ai do të informohej për procedimin e mundshëm kundër të tij për shpërfillje të gjykatës si pasojë.<sup>91</sup> Prokuroria gjithashtu argumenton se Dhoma Gjyqësore shfaqti “ngut për mbylljen e procedimit të çështjes prej Prokurorisë dhe përfundimin e gjykimit” kur deklaroi se:

[...] me sa duket, Prokuroria nuk i ka kushtuar vëmendje udhëzimit të Dhomës Gjyqësore dhënë në seancën e 20 nëntorit 2007, gjatë të cilës u informua se me përjashtim të zgjatjes së afatit kohor deri më 27 nëntor 2007 për të dëgjuar dëshminë e dëshmitarit tjetër, Dhoma e konsideroi çështjen e Prokurorisë të mbyllur. Për më tepër, Prokuroria tanimë ka tejkalluar kufirin prej 125 orësh që iu caktua në fillim të procesit gjyqësor.<sup>92</sup>

27. Mbrojtja argumenton se Dhoma Gjyqësore me të drejtë hodhi poshtë Mocionin e 23 nëntorit 2007,<sup>93</sup> dhe vë në dukje se këtë vendim Dhoma Gjyqësore e mbështeti “mbi faktin që Z. Kabashi ende nuk pranonte të jepte dëshmi dhe mbi faktin që nuk kishte kurrfarë ndryshimi thelbësor të rrethanave që nga seanca e fundit.”<sup>94</sup> Mbrojtja deklaroi se “thjesht mundësia se më vonë ai do të ndryshonte qëndrimin e tij më vonë në qoftë se do

<sup>88</sup> Dosja e Përgjigjes së Haradinajt, para. 40; *shih gjithashtu* TA. 70-72 (Seancë Publike).

<sup>89</sup> *Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-T, Mocion i Prokurorisë për Zgjatjen e Afatit Kohor për Procedimin e Çështjes së Prokurorisë me qëllim marrjen e Dëshmisë së Shefqet Kabashit, 23 nëntor 2007 (“Mocion i 23 nëntorit 2007”).

<sup>90</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 26.

<sup>91</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 26.

<sup>92</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 26 (citon T. 10978 (26 nëntor 2007) (Seancë Publike)).

<sup>93</sup> Dosja e Përgjigjes së Haradinajt, para. 47.

<sup>94</sup> Dosja e Përgjigjes së Haradinajt, para. 46.

të vazhdonte të merrte ndihmë juridike, nuk përlegjnin shtyrjen e mëtejshme të afatit për procedimin e çështjes prej Prokurorisë.”<sup>95</sup>

(e) Vendimi i 26 nëntorit 2006 lidhur me dëshmitarin tjetër

28. Prokuroria më tej bën të ditur se më 26 nëntor 2006, dëshmitari tjetër përsëri u caktua për të dhënë dëshmi me anë të videolidhjes.<sup>96</sup> Mirëpo para seancës, Prokuroria u informua se dëshmitari tjetër ishte shtruar në spital dhe se do të nevojiteshin shtatë deri në dhjetë ditë për të vlerësuar gjendjen e tij.<sup>97</sup> Prokuroria vë në dukje se kur informoi Dhomen Gjqësore për këto zhvillime, Dhoma Gjqësore theksoi: “Si pasojë, nuk mund të dëgjojmë [...] dëshminë e [dëshmitarit tjetër ditën e sotme, e cila së bashku me ditën e nesërme përbëjnë ditët e fundit të afatit për paraqitjen e çështjes së Prokurorisë.”<sup>98</sup> Prokuroria argumenton se Dhoma Gjqësore bëri gabim që mbylli çështjen e Prokurorisë lidhur me dëshmitarin tjetër më 26 nëntor 2007, pa i mundësuar Prokurorisë shtyrje të afatit kohor për të marrë informacion lidhur me gjendjen shëndetësore të dëshmitarit tjetër dhe pa marrë parasysh mundësinë për marrjen e dëshmisë së tij.<sup>99</sup> Prokuroria gjithashtu vëren se, kur urdhëroi mbylljen e çështjes së Prokurorisë, Dhoma Gjqësore theksoi se “Prokuroria tanimë ka tejkaluar afatin kohor prej 125 orësh që iu caktua në fillim të procesit gjyqësor,” dhe argumenton se kjo deklaratë tregon qartë që Dhoma Gjqësore u përqëndrua në zhvillimin e një gjykimi të shpejtë duke shpërfillur detyrimin e saj për garantimin e një gjykimi të drejtë.<sup>100</sup>

29. Mbrojtja bën të ditur se më 23 nëntor 2007, Prokuroria informoi Dhomen Gjqësore se dëshmitari tjetër ishte shtruar në spital, se nuk ishte në dispozicion për të dhënë dëshmi më 26 nëntor 2007, dhe se mjekët e tij do të “rivlerësonin gjendjen e tij brenda 7 deri në 10 ditësh.”<sup>101</sup> Mbrojtja parashtron se rrjedhimisht, Prokuroria kishte në dispozicion tri ditë për të kërkuar shtyrje të seancës për marrjen e një vlerësimi të mëtejshëm mjekësor, ose kërkesë për zgjatje të afatit për marrjen e dëshmisë së

<sup>95</sup> Dosja e Përgjigjes së Haradinajt, para. 46; *shih gjithashtu* TA. 72-74 (Seancë Publike).

<sup>96</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 37.

<sup>97</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 37.

<sup>98</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 37, *citon* T. 10975 (26 nëntor 2007) (Seancë Publike).

<sup>99</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 37; *shih gjithashtu* TA. 32, 47.

<sup>100</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 38, *citon* T. 10978 (26 nëntor 2007) (Seancë Publike).

<sup>101</sup> Dosja e Përgjigjes së Haradinajt, para. 83.

dëshmitarit tjetër. Mirëpo Prokuroria nuk e bëri këtë as atëherë, e as më vonë.<sup>102</sup> Mbrojtja argumenton se, në qoftë se Prokuroria do të ishte e mendimit se një shtyrje e seancës ose zgjatje e afatit kohor ishte e nevojshme për garantimin e të drejtës së saj për gjykim të drejtë, atëherë ishte detyra e saj të kërkonte marrjen e këtyre masave nga Dhoma Gjyqësore.<sup>103</sup> Mbrojtja gjithashtu argumenton se deklarata e Dhomës Gjyqësore që nuk do të mund të dëgjonte dëshminë e dëshmitarit tjetër më 26 nëntor 2007, ishte e saktë dhe nuk paragjykonte asnjë kërkesë të mëtejshme të Prokurorisë për zgjatje të afatit kohor.<sup>104</sup>

(f) Vendim i 5 dhjetorit 2007

30. Prokuroria pretendon se më 5 dhjetor 2007, Dhoma Gjyqësore zbatoi në mënyrë të gabuar Rregullën 73(B) të Rregullores kur hodhi poshtë kërkesën e Prokurorisë për Leje për Apel të Ndërkohshëm të Vendimit të 26 nëntorit 2007 lidhur me Kabashin.<sup>105</sup> Prokuroria bën të ditur se kur hodhi poshtë Kërkesën për Leje, Dhoma Gjyqësore gjykoi se “Prokuroria nuk kishte paraqitur kurrfarë argumenti lidhur me gjasën nëse Shefqet Kabashi me të vërtetë do të dëshmonte ndonjëherë.”<sup>106</sup> Prokuroria deklaroi se kur nxori këtë përfundim, Dhoma Gjyqësore nuk mori parasysh argumentin e Prokurorisë lidhur me gjasën e marrjes së dëshmisë së Kabashit, – gjegjësisht se:

[...] në qoftë se Shefqet Kabashi do të informohej siç duhej nga avokati i tij publik amerikan ose nga avokati që i caktoi Tribunali, për pasojat e mundshme të procedimit kundër tij për shpërfillje të Tribunalit, ai do të ndryshonte qëndrim dhe do të dëshmonte.<sup>107</sup>

31. Mbrojtja parashtron se Dhoma Gjyqësore i ka zbatuar drejtë dispozitat e Rregullës 73(B) të Rregullores, dhe se Prokuroria nuk ka provuar asnjë gabim të dukshëm në arsyetimin e Dhomës Gjyqësore.<sup>108</sup>

<sup>102</sup> Dosja e Përgjigjes së Haradinajt, para. 83-90.

<sup>103</sup> Dosja e Përgjigjes së Haradinajt, para. 88.

<sup>104</sup> Dosja e Përgjigjes së Haradinajt, para. 87-88; *shih gjithashtu* TA 85-87 (Seancë Publike).

<sup>105</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 27 (citon *Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-T, Kërkesë e Prokurorisë për Leje për Apel të Ndërkohshëm të Vendimit të Dhomës Gjyqësore lidhur me Shefqet Kabashin, 30 nëntor 2007 (“Kërkesë për Leje”).

<sup>106</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 28 (citon Vendimin e 5 dhjetorit 2007, para. 3).

<sup>107</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 29.

<sup>108</sup> Dosja e Përgjigjes së Haradinajt, para. 52; *shih gjithashtu* TA. 74 (Seancë Publike).

(g) Vendim i 21 dhjetorit 2007

32. Prokuroria vëren se gjatë seancës së 10 dhjetorit 2007, një gjykatës i një gjykate qarku në Shtetet e Bashkuara pohoi se në qoftë se Dhoma Gjyqësore do të rihapte çështjen dhe caktonte një datë për dëgjimin e dëshmisë së Kabashit, gjykatësi “ sipas të gjitha gjasave do të lëshonte një urdhër që do të detyronte Shefqet Kabashin të dëshmonte atë ditë.”<sup>109</sup> Prokuroria parashtron se, në qoftë se Kabashi nuk do të dëshmonte në ditën e caktuar, ka të ngjarë që gjykatësi ta gjykonte fajtor për shpërfillje të Tribunalit.<sup>110</sup> Prokuroria thekson se ndonëse Dhoma Gjyqësore gjykoj se “mundësia për procedim penal mbi akuza për shpërfillje përpara një gjykate shtetërore në vetvete nuk përbën rrethanë të re që do të kërkonte rihapje” të çështjes, informacioni i gjykatës amerikane sugjeron se “nuk bëhej fjalë *thjesht* për një mundësi për fillimin e një procedimi penal mbi akuza për shpërfillje ose akuza të tjera nga një Gjykatë Federale e Shteteve të Bashkuara për të siguruar dëshminë e Shefqet Kabashit, por për një gjasë *krejtësisht të ndodhshme*.”<sup>111</sup> Prokuroria argumenton se ndonëse ky faktor duhej ta kishte bindur Dhomën Gjyqësore të rihapte çështjen si masë për sigurimin e dëshmisë së Kabashit,<sup>112</sup> Dhoma Gjyqësore hodhi poshtë kërkesën e Prokurorisë për rihapjen e çështjes,<sup>113</sup> dhe në këtë mënyrë “nuk i kushtoi rëndësinë e duhur gjasës së konsiderueshme për nisjen e procedimit penal për shpërfillje kundër Shefqet Kabashit në Shtetet e Bashkuara, përfshirë dhe burgimin e tij, qëllimi i së cilit do të ishte ta detyronte Kabashin që të dëshmonte.”<sup>114</sup>

33. Mbrojtja deklaron se Dhoma Gjyqësore nuk ka kryer gabim të dukshëm me Vendimin e 21 dhjetorit 2007, me të cilin hodhi poshtë kërkesën e Prokurorisë për rihapjen e çështjes së saj.<sup>115</sup> Në mbështetje të këtij pohimi, Mbrojtja argumenton se Kabashi vazhdimisht bëri të ditur se ai do të ishte i gatshëm të shkonte në burg sesa të

<sup>109</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 32 (pa citimet e brendshme).

<sup>110</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 32.

<sup>111</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 33 (pa citimet e brendshme).

<sup>112</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 35.

<sup>113</sup> *Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-T, Kërkesë e Prokurorisë për Rihapjen e Procedimit të Çështjes së Saj për Dëgjimin e Dëshmisë së Shefqet Kabashit dhe për Përfaqësim Juridik të Autoriteteve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, 17 dhjetor 2007, Publike me Shtojcën Konfidenciale (“Mocion i Prokurorisë i datës 17 dhjetor 2007”).

<sup>114</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 31; *shih gjithashtu* TA. 74-76 (Seancë Publike).

<sup>115</sup> Dosja e Përgjigjes së Haradinajt, para. 57.

dëshmonte, dhe se argumenti i Prokurorisë që ai do të ndryshonte qëndrim, po që se kundër tij do të niste procedim penal për shpërfillje në Shtetet e Bashkuara, është “thjesht spekulim.”<sup>116</sup> Mbrojtja argumenton se “nuk pati kurrfarë ndryshimi të rrethanave që do të arsyetonte marrjen e masës së jashtëzakonshme të rihapjes së çështjes së Prokurorisë në këtë fazë shumë të vonë të gjyqimit.”<sup>117</sup>

### 3. Analizë

34. Thelbi i kontekstit faktual të Apelit të Prokurorisë është atmosfera e paparë e frikësimit të gjithëpranishëm dhe të rëndë të dëshmitarëve që mbizotëroi gjatë procesit gjyqësor. Dhoma Gjyqësore e pranoi këtë në Aktgjykim duke vënë re se:

[...] gjatë gjithë procesit, Dhoma Gjyqësore hasi në vështirësi të konsiderueshme për marrjen e dëshmive nga një numër i madh dëshmitarësh. Shumë dëshmitarë përmendën frikën si arsye parësore pse nuk dëshironin të paraqiteshin para Dhomës Gjyqësore për të dëshmuar. Dhoma Gjyqësore fitoi përshtypje të fortë se procesi po zhvillohej në një atmosferë ku dëshmitarët ndiheshin të pasigurtë. Shkak ishin një sërë faktorësh specifikë për Kosovën, për shembull bashkësitë e vogla të Kosovës, lidhjet e ngushta familjare dhe fisnore që e bënë të vështirë ruajtjen e anonimitetit. Palët vetë ishin dakord se në Kosovë ekzistonte një gjendje sigurie e paqëndrueshme e cila ishte veçanërisht e dëmshme për dëshmitarët.<sup>118</sup>

35. Në këto rrethana të frikësimit të dëshmitarëve, Dhoma Gjyqësore ka për detyrë të bëjë ç’është e mundur për të garantuar mundësinë e një gjykimi të drejtë. Lloji i frikësimit të dëshmitarëve përshkruar prej Dhomës Gjyqësore minon qëllimin themelor të Tribunalit përcaktuar në paragrafin 1 të Nenit 20 të Statutit: garantimin e një gjykimi të drejtë dhe të shpejtë dhe duke i kushtuar vëmendjen e duhur mbrojtjes së viktimave dhe të dëshmitarëve. Eliminimi i frikësimit të dëshmitarëve është detyrë parësore dhe e domosdoshme e Dhomës Gjyqësore. Dhoma Gjyqësore gjithmonë ka për detyrë që “të mundësojë të gjitha masat e zbatueshme lehtësuese që ka në dispozicion sipas Rregullores dhe Statutit kur ballafaqohet me një kërkesë të një pale për ndihmë në

<sup>116</sup> Dosja e Përgjigjes së Haradinajt, para. 57.

<sup>117</sup> Dosja e Përgjigjes së Haradinajt, para. 57.

<sup>118</sup> Aktgjykim, para. 6 (pa citimet e brendshme).

paraqitjen e çështjes”,<sup>119</sup> dhe ky detyrim është gjithsesi më i madh kur faktorë të jashtëm përpiqen të minojnë aftësinë e një pale për paraqitjen e provave të veta gjatë procesit gjyqësor. Që Tribunali të punojë në mënyrë të efektshme, Dhomat Gjyqësore duhet të eliminojnë frikësimin e dëshmitarëve duke marrë të gjitha masat e arsyeshme në dispozicion me kërkesën e cilësdo palë ose *proprio motu*.

36. Një Dhomë Gjyqësore disponon kompetenca të gjera për garantimin e një gjykimit të drejtë. Sipas Rregullës 54 të Rregullores, një Dhomë Gjyqësore mund të lëshojë urdhra, thirrje, urdhërparaqitje, autorizime dhe urdhra transferimi që mund të jenë të nevojshme për hetime ose për përgatitjen apo kryerjen e procesit gjyqësor, duke përfshirë kompetencën për miratimin e masave për mbrojtjen e dëshmitarëve, marrjen dëshmive nëpërmjet videolidhjes ose deklaratave me shkrim; dhe thirrjen e dëshmitarëve si dhe urdhërimin e paraqitjes së tyre. Për më tepër, në rast të dështimit të këtyre masave, me kërkesën e cilësdo palë ose *proprio motu*, një Dhomë Gjyqësore mund të urdhërojë shtyrjen ose pezullimin e procesit gjyqësor.<sup>120</sup>

37. Dhoma Gjyqësore në këtë çështje pranoi se dëshmitarët e thirrur nga Prokuroria po ballafaqoheshin me vështirësi të veçanta për të dëshmuar, duke theksuar se “shumë dëshmitarë të Prokurorisë në këtë çështje shprehën frikë për paraqitjen e tyre si dëshmitarë para Dhomës Gjyqësore”.<sup>121</sup> Në veçanti, Dhoma Gjyqësore e dinte se Kabashi dhe dëshmitari tjetër ngurronin të dëshmonin.<sup>122</sup> Në të vërtetë, në seancë publike, Kabashi ngriti çështjen e frikësimit të gjithëpranishëm të dëshmitarëve duke thënë se “kishte njerëz që u pyetën si dëshmitarë dhe emrat e tyre as që figurojnë në listat e dëshmitarëve për shkak se janë të vararë. Unë nuk dua masa mbrojtëse se masa të tilla në realitet nuk ekzistojnë; ato ekzistojnë vetëm brenda kësaj salle gjyqësore, por jo jashtë saj.”<sup>123</sup>

<sup>119</sup> Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 52.

<sup>120</sup> Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 52.

<sup>121</sup> Aktgjykim, para. 22.

<sup>122</sup> *Shih Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-T, Kërkesë e Prokurorisë për Lëshimin e Urdhërparaqitjes për të Dëshmuar (Konfidenciale, por përmendet në Aktgjykim), 25 maj 2007, para. 2; Kabashi, T. 5438-5439 (5 qershor 2007) (Seancë Publike), T. 10939-10941 (20 nëntor 2007) (Seancë Publike); *shih përgjithësisht* Aktgjykim, para. 28; Aktgjykim, Shtojca A (Historia Procedurale), para. 20, 24.

<sup>123</sup> Kabashi, T. 5439-5440 (5 qershor 2007) (Seancë Publike).

38. Për më tepër, Dhoma Gjyqësore dinte se Kabashi dhe dëshmitari tjetër ishin veçanërisht të rëndësishëm për Prokurorinë.<sup>124</sup> Kabashi, ish-pjesëtar i UÇK-së, do të dëshmonte, *mes të tjerash*, për veprime konkrete të keqtrajtimit nga ana e të akuzuarve, përfshirë dhe urdhërimin e vrasjes dhe rrahjes së disa personave konkretë. Ai gjithashtu do të dëshmonte për rolin drejtues të të akuzuarve lidhur me disa veprime, si për shembull marrjet në pyetje dhe ekzekutimet.<sup>125</sup> Dëshmitari tjetër do të dëshmonte për keqtrajtimin që iu bë gjatë kohës që ishte në duart e të akuzuarve, si dhe konkretisht për veprime torturimi dhe gjymtimi që i kishte parë të akuzuarit duke i kryer.<sup>126</sup> Dëshmitë e të dy dëshmitarëve mund të kishin qenë të rëndësishme lidhur me përgjegjësinë e të akuzuarve për krimet e kryera në shtabin e UÇK-së dhe në burgun në Jabllanicë, përfshirë dhe krimet e kryera nëpërmjet të NPK-së së pretenduar.<sup>127</sup> Mirëpo, pavarësisht rëndësisë së Kabashit dhe dëshmitarit tjetër, të dy dëshmitarët me të vërtetë nuk dëshmuan në mënyrë të plotë asnjëherë gjatë gjykimit, duke e privuar Prokurorinë prej mbështetjes kyçe për argumentin e saj. Më pas, të akuzuarit u shpallën të pafajshëm lidhur me thujtë të gjitha akuzat të cilat mundësisht do të provoheshin me ndihmën e dëshmitarëve të të dy dëshmitarëve.<sup>128</sup>

39. Dhoma e Apelit kujton se Dhoma Gjyqësore gëzon kompetenca të konsiderueshme në administrimin gjyqësor të çështjeve që gjykon. Megjithatë, mënyrën e zbatimit të këtyre kompetencave, Dhoma Gjyqësore duhet ta përcaktojë në përputhje me çështjen që gjykon. Në të vërtetë, një gjë që është e arsyeshme në një proces gjyqësor, nuk është automatikisht e arsyeshme në një proces gjyqësor tjetër. Për këtë arsye, problemi nëse Dhoma Gjyqësore shpërdori apo nuk shpërdori kompetencën e saj, duhet vlerësuar nën dritën e të gjithë faktorëve të rëndësishëm në çështjen në fjalë dhe jo veçazi.

40. Shqyrtuar veç e veç dhe jashtë kuadrit të procesit gjyqësor, mund të thuhet se çdo vendim i Dhomës Gjyqësore lidhur me Kabashin dhe dëshmitarin tjetër përfshihet në

<sup>124</sup> *Shih* T. 10120 (1 nëntor 2007) (Seancë Publike); T. 10956 (20 nëntor 2007) (Seancë Publike).

<sup>125</sup> *Shih* Mocion i 23 nëntorit 2007, f. 3-4.

<sup>126</sup> *Shih* Deklaratë e dëshmitarit tjetër, 13 janar 2004, para. 15, 23, 24; Dosja e Apelit të Prokurorisë, Shtojca B (Konfidenciale).

<sup>127</sup> *Krahaso* Aktakuzën e Ndryshuar për Herë të Katërt, f. 31-39 (Pikat 24, 26, 28, 30, 32, 34) me Dosjen e Apelit të Prokurorisë, Shtojcat A dhe B.

<sup>128</sup> *Shih* Aktgjykim, para. 502-504.

kuadrin e kompetencës gjyquese të Dhomës Gjyqësore. Megjithatë, duke i shqyrtuar këto vendime bashkërisht, sidomos në kuadrin e frikësimit të rëndë të dëshmitarëve që karakterizoi procesin gjyqësor, del qartë se Dhoma Gjyqësore gaboi rëndë kur nuk mori masat e mjaftueshme për të mundësuar dëshminë e Kabashit dhe dëshmitarit tjetër. Në të kundërt Dhoma Gjyqësore me sa duket i kushtoi rëndësi të tepruar faktit që të siguronte se Prokuroria nuk do të tejkalonte kohën që i ishte caktuar paraprakisht për të paraqitur çështjen e saj, dhe që të respektoheshin afatet kohore të Dhomës Gjyqësore për paraqitjen e provave, pavarësisht mundësisë për marrjen e dëshmive të dy dëshmitarëve kyç. Përcaktimi i gabuar i përparësive tregon se Dhoma Gjyqësore nuk vlerësoi rëndësinë e rrezikut që sillte frikësimi i dëshmitarëve ndaj ndershmërisë së procesit gjyqësor. Dhoma e Apelit vëren se, që nga fillimi i gjykimit Dhoma Gjyqësore ishte e informuar për rrezikun e madh ndaj dëshmitarëve<sup>129</sup> dhe gjithsesi në mënyrë flagrante nuk mori masat e nevojshme për të mundësuar mbrojtjen e dëshmitarëve të rrezikuar dhe për të garantuar ndershmërinë e procesit.

41. Dhoma Gjyqësore gaboi kur në nëntor dhe dhjetor 2007 nxori një sërë vendimesh të cilat kufizuan ndjeshëm përpjekjet e Prokurorisë për marrjen e dëshmisë së Kabashit dhe dëshmitarit tjetër. Disa prej këtyre gabimeve u bënë në përgjigjet ndaj kërkesave konkrete të Prokurorisë, kurse në disa raste të tjera Dhoma Gjyqësore duhej të kishte vepruar *proprio motu* për të mundësuar dhënien e dëshmive prej dëshmitarëve dhe mbrojtjen e duhur të dëshmitarëve të rrezikuar.<sup>130</sup> Për sa i përket Kabashit, pas seancës

<sup>129</sup> *Shih* Fjala hyrëse, T. 359-361 (5 mars 2007): “ZJ DEL PONTE: [...] Mbrojtja e dëshmitarëve që patën guximin të flasin ka qenë dhe mbetet shumë e rëndësishme. Ju e dini që shumë dëshmitarë nuk duan të dëshmojnë. Disa madje janë të tmerruar. Frikësimi dhe kërcënimet që përjetojnë dëshmitarët në këtë çështje janë një problem i madh dhe i vazhdueshëm për personat në fjalë dhe për Prokurorinë. Ky problem nuk është zhdukur. Kërcënimet ndaj dëshmitarëve vazhdojnë, qoftë tërthorazi, qoftë haptazi. Vetëm gjatë kësaj fundjave, dëshmitari-viktimë i ynë i parë i drejtpërdrejtë [...] Z. Kryetar, unë vetëm po e informoj gjykatën që këtë fundjavë [...] mora informacion lidhur me kërcënimet që tani po i bëhen një dëshmitari. [...] Pra nuk kuptoj pse të mos e informoj gjykatën për një ngjarje, për fakte që ndodhën gjatë kësaj fundjave dhe që lidhen drejtpërsëdrejti me këtë proces gjyqësor. Sepse, Z. Kryetar, po nuk pata dëshmitarë që do të vijnë në këtë gjyq, unë do të detyrohem të tërheq aktakuzën. GYKATËSI ORIE: Zonja Prokurore, mendoj që nuk është e pavend të informohet gjykata për kërcënime. Mirëpo mbetet pikëpyetje, [...] nëse duhet të hyjmë në hollësi të mëtejshme ku nuk do të jemi në gjendje të hetojmë çështjen më tej, nëse kjo do të ishte qasja më e mirë ndaj kësaj çështjeje.”

<sup>130</sup> *Shih* Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 52. Dhoma e Apelit me shqetësim të madh thekson se ndonjëherë ka ndodhur që informacione të besueshme lidhur me dëshmitarë të mbrojtur të jenë bërë publike nga Dhoma Gjyqësore. Dhoma e Apelit rikujton se sipas Rregullës 75(F) të Rregullores, kur urdhërohen masa mbrojtëse, ato *mbeten në fuqi* në çdo proces gjyqësor para këtij Tribunali *deri në shfuqizimin, ndryshimin ose shtimin e tyre*. Për më tepër, Dhoma e Apelit thekson se dëshmitarë të mundshëm që nuk dëshmojnë

me videolidhje së datës 20 nëntor 2007, gjatë të cilës ai dhe avokati i tij në mënyrë të ngatërruar dhe të paqartë refuzuan të flisnin,<sup>131</sup> mbeti e hapur mundësia që Kabashi të dëshmonte në rrethana të tjera. Mirëpo Dhoma Gjyqësore vendosi të mos këmbëngulte në përpjekjet për të dëgjuar dëshminë e tij dhe e qortoi Prokurorisë që po përpiquej të riplanifikonte dhënien e dëshmisë së Kabashit, meqë “Dhoma Gjyqësore e konsideronte çështjen e Prokurorisë të mbyllur” dhe “Prokuroria tanimë i kishte tejkaluar 125 orët që i ishin caktuar në fillim të çështjes.”<sup>132</sup> Nga ky shpjegim del qartë se Dhoma Gjyqësore zgjodhi respektimin e afateve kohore në vend që të ndihmonte Prokurorinë në kapërcimin e orvatjeve të frikësimit të dëshmitarëve. Dhoma Gjyqësore gjithashtu hodhi poshtë kërkesën e Prokurorisë për leje për apel të vendimit për mosdëgjimin e dëshmisë së Kabashit.<sup>133</sup> Dhoma Gjyqësore e shpjegoi këtë vendim të saj duke iu referuar përsëri afateve kohore dhe numrit të orëve që i kishte caktuar Prokurorisë për paraqitjen e çështjes së saj.<sup>134</sup>

42. Në urdhrin e 21 dhjetorit 2007, Dhoma Gjyqësore përsëri refuzoi rihapjen e çështjes së Prokurorisë pas përfundimit të parashtrimeve të saj, me gjithë faktin se Prokuroria kishte provuar se kishte shumë të ngjarë që më në fund të merrej dëshmia e Kabashit.<sup>135</sup> Vendimi mbi Rihapjen në mënyrë të pajustificueshme nuk mori në konsideratë një urdhër të një gjykatësi të një gjykate qarku të Shteteve të Bashkuara ku thuhej se nëse çështja do të rihapej dhe do të caktohej data e dëshmisë së Kabashit, “kishte shumë të ngjarë” që ai të lëshonte një urdhër që do të detyronte Kabashin të dëshmonte atë ditë.<sup>136</sup> Vendimi i Dhomës Gjyqësore nuk mori parasysh faktin që vetë prania fizike e Kabashit në Shtetet e Bashkuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e ekspozonte atë ndaj dënimeve për shpërfillje të gjykatës, të përcaktuara nga gjykatat federale të

---

mund të përballen me rreziqe të ngjashme me ato të atyre që kanë dëshmuar. Në veçanti, për dëshmitarët që nuk dëshmojnë për shkak të frikës nevojitet anonimitet i vazhdueshëm. *Krahaso me* Aktgjykimi i Apelit *Nshogoza*, para. 65, 67.

<sup>131</sup> *Shih* Kabashi, T. 10935-10937, 10941, 10958-10959, 10964 (20 nëntor 2007) (Seancë Publike).

<sup>132</sup> T. 10978 (26 nëntor 2007) (Seancë Publike). Dhoma Gjyqësore përmendi nevojën për ndryshime “rrënjësore” që do ta bindnin atë të shtynte afatin për dhënien e dëshmisë së Kabashit (*shih* Kabashi, T. 10961 (20 nëntor 2007) (Seancë Publike); T. 1097 7-10979 (26 nëntor 2007) (Seancë Publike)), një standard që Prokuroria do ta ketë shumë të vështirë ta plotësojë kur bëhet fjalë për dëshmitarë të cilët janë objekt kërcënimesh ose kanë frikë të dëshmojnë.

<sup>133</sup> Vendim i 5 dhjetorit 2007, para. 3.

<sup>134</sup> Vendim i 5 dhjetorit 2007, para. 3.

<sup>135</sup> Vendim i 21 dhjetorit 2007, para. 7-8.

<sup>136</sup> Mocion i Prokurorisë i datës 17 dhjetor 2007, para. 4.

Shteteve të Bashkuara, përfshirë burgimin,<sup>137</sup> në rast se do të refuzonte të dëshmonte. Për shumë dëshmitarë të tjerë që nuk pranonin të dëshmonin gjatë këtij procesi gjyqësor, arrestimi dhe rreziku i menjëhershëm i burgimit kanë qenë masë efektive për ti detyruar të dëshmonin,<sup>138</sup> gjë që sugjeron qartësisht se sikur Kabashi të kërcënohej me arrestim, ndoshta do të bindej edhe ai që të dëshmonte.

43. Edhe dëshminë e dëshmitarit tjetër Dhoma Gjyqësore e trajtoi haptazi në mënyrë të padrejtë dhe të pamatur. Megjithëse ishte e vetëdijshme për vështirësitë për të bindur dëshmitarin tjetër që të dëshmonte<sup>139</sup> dhe se me gjasë ai ishte dëshmitar i rëndësishëm për Prokurorinë,<sup>140</sup> Dhoma Gjyqësore në shumë raste nuk bëri përpjekje që do të rezultonin në marrjen e dëshmisë së tij. Një mospërpjekje e tillë u duk qartë gjatë seancës së 15 nëntorit 2007. Dhoma Gjyqësore u informua se dëshmitari tjetër ishte arrestuar në bazë të një aktakuze të Tribunalit, dhe sipas informacionit që kishte Dhoma Gjyqësore, dëshmitari tjetër do të kishte qenë në dispozicion për të dëshmuar me videolidhje rreth orës 18:30.<sup>141</sup> Mirëpo, ndonëse ishte e vetëdijshme për mosgatishmërinë e dëshmitarit tjetër për të dëshmuar dhe rëndësinë e mundshme të kësaj dëshmie për çështjen e Prokurorisë, Dhoma Gjyqësore e vonoi ndjeshëm dhënien e dëshmisë së tij për arsye logjistike, objektivisht më pak të rëndësishme. Ajo komentoi se:

[...] jo vetëm që është e enjte rreth orës 19:00 por gjithashtu edhe 125 orë që kur Prokuroria filloi me paraqitjen e çështjes së saj. Nuk ka kurrfarë mundësie që të zhvillojmë seancë të premtën ose të hënën, e kemi shqyrtuar këtë mundësi. Një gjë e tillë është e pamundur. E marta[...] është e rezervuar për një dëshmitar tjetër, [por edhe sikur [dëshmitari tjetër] të mund të dëshmonte, ekziston mundësi e arsyeshme që të mos arrijmë më tej se ai nuk do t'u përgjigjet pyetjeve. Ka edhe një mundësi – që ai të fillojë t'u përgjigjet pyetjeve, dhe pastaj, sigurisht, çfarë hapash të ndërmarrim kur nuk ka më kohë.<sup>142</sup>

Gjuha dhe qëndrimi i Dhomës Gjyqësore tregojnë qartë se ajo u dha përparësi faktorëve logjistikë dhe numrit të orëve që i ishin caktuar Prokurorisë për paraqitjen e çështjes prej saj, në vend të faktorit shumë më të rëndësishëm të marrjes së dëshmisë së një dëshmitari

<sup>137</sup> *Shih në përgjithësi United States v. Marquado*, 149 F.3d 36 (1st Cir. 1998).

<sup>138</sup> Shih çështjet e Sadri Selcës dhe Avni Krasniqit, të cilët dëshmuuan pasi ishin arrestuar dhe sjellë në Hagë nën akuza për shpërfillje të gjykatës (Aktgjykim, Shtojca A (Historia Procedurale), para 21-22).

<sup>139</sup> *Shih p.sh.*, T. 5667-5668 (14 qershor 2007) (Seancë Publike); T. 10956 (20 nëntor 2007) (Seancë Publike).

<sup>140</sup> *Shih p.sh.*, T. 10956, 20 nëntor 2007 (Seancë Publike).

<sup>141</sup> T. 10876 (15 nëntor 2007) (Seancë Private).

<sup>142</sup> T. 10876 (15 nëntor 2007) (Seancë Private).

potencialisht të rëndësishëm, i cili më së fundi ishte në dispozicion për të dhënë dëshmi. Arsyetimi i Dhomës Gjyqësore për mospranimin e dëgjimit të menjëhershëm të dëshmitarit tjetër, nuk mori parasysh frikësimin e dëshmitarëve që e karakterizonte çështjen si dhe rëndësinë e marrjes së dëshmisë së dëshmitarit kur ishte e mundur. Dhoma Gjyqësore ishte e vetëdijshme se dëshmitari tjetër mund të ishte jobashkëpunues por në të njëjtën kohë pranoi që ekzistonte mundësia për bashkëpunim.

44. Qëndrimi i gabuar i Dhomës Gjyqësore ndaj dëshmitarit tjetër vazhdoi më 26 nëntor 2007 kur refuzimi i saj që të dëgjonte dëshmitarin tjetër më 15 nëntor 2007 u bë i qartë. Megjithëse dëshmitari tjetër ishte ricaktuar për të dhënë dëshmi me videolidhje, Prokuroria informoi Dhomën Gjyqësore se:

[dëshmitari tjetër] është shtruar në spital që prej javës së kaluar [...]. Atë po e ekzaminon mjeku, dhe informacionin e fundit e morëm të premten, besoj, të premten e kaluar, se [...] autoritetet thanë se gjendja e tij do të rivlerësohet brenda 7-10 ditësh nga ajo datë.<sup>143</sup>

Në vend që të gjente zgjidhje për këtë rrethanë, Dhoma Gjyqësore përsëri u përpoq t'i jepte përparësi afatit kohor, duke thënë se:

[...] nuk mund të dëgjojmë dëshmitarin—dëshminë e [dëshmitarit tjetër] ditën e sotme, që së bashku me ditën e nesërme përbëjnë ditët e fundit për paraqitjen e çështjes së Prokurorisë.<sup>144</sup>

Pas katër ditësh, Dhoma Gjyqësore lëshoi Urdhrin për Caktim Date të 30 nëntorit 2007, ku përcaktoi afatet kohore për dorëzimin e dosjeve gjyqësore përfundimtare dhe të argumenteve përmbyllëse të palëve, pasi bëri të ditur se,

[...] paraqitja e provave të Prokurorisë në këtë çështje ka përfunduar dhe rrjedhimisht mbyllet procedimi i çështjes prej saj [...].<sup>145</sup>

45. Dhoma e Apelit vëren se, duke patur parasysh paralajmërimin e Prokurorisë të datës 26 nëntor 2007 se gjendja shëndetësore e dëshmitarit tjetër do të rivlerësohej brenda një jave, dhe duke qenë në dijeni se frikësimi i dëshmitarëve po kërcënonte ndershmërinë e procesit gjyqësor, një Dhomë e arsyeshme Gjyqësore do të kishte urdhëruar *proprio*

<sup>143</sup> Dhoma e Apelit vëren se data “të premten e kaluar”, të cilës i referohet Prokuroria, është 23 nëntori 2007. T. 10975 (26 nëntor 2007) (Seancë Publike).

<sup>144</sup> T. 10975 (26 nëntor 2007) (Seancë Publike).

<sup>145</sup> Urdhër për Caktim Date i 30 nëntorit 2007, f. 2.

*motu* shtyrjen ose pezullimin e procesit për një kohë të arsyeshme, për t'i mundësuar Prokurorisë mbledhjen e informacionit lidhur me gjendjen shëndetësore të dëshmitarit dhe për të gjetur mundësinë e marrjes së dëshmisë së tij pas daljes nga spitali. Vendimet për mosdëgjimin e dëshmitarit tjetër dhe moszgjatjen e afatit kohor ishin mjaft të dëmshme duke qenë se dëshmitari tjetër kishte dhënë përgjigje të paqarta nëse do të dëshmonte ose jo,<sup>146</sup> duke e lënë hapur mundësinë që kur të ndodhej para videolidhjes më së fundi do të kishte dëshmuar.

46. Dhoma e Apelit gjithashtu vëren me shqetësim vendimin e Dhomës Gjyqësore për mospranimin e dy dëshmitarëve të propozuar nga Prokuroria të cilët do të dëshmonin për disa nga të njëjtat ngjarje si dëshmitari tjetër.<sup>147</sup> Dhoma Gjyqësore e bazoi vendimin e saj pjesërisht në përfshirjen me vonesë të këtyre dëshmitarëve në listën e dëshmitarëve të Prokurorisë dhe refuzoi të dëgjonte dëshmitë e tyre duke cituar rëndësinë e “administrimit të rregullt dhe në kohë të çështjes” dhe “afimit të kohës për mbylljen e çështjes së Prokurorisë”.<sup>148</sup> Duke marrë parasysh vështirësitë e hasura në marrjen e dëshmisë së dëshmitarit tjetër,<sup>149</sup> dhe në kuadrin e frikësimit me të cilin po ballafaqoheshin të gjithë dëshmitarët,<sup>150</sup> ky vendim përsëri u dha përparësi të panevojshme faktorëve logjistikë në vend të të drejtës së Prokurorisë për gjykim të drejtë.

47. Ndonëse Prokuroria në apelin e saj përqëndrohet vetëm në aspekte të qëndrimit të Dhomës Gjyqësore ndaj Kabashit dhe dëshmitarit tjetër, Dhoma e Apelit vëren se ky nuk është shembulli i vetëm i mosmarrjes së masave të nevojshme nga ana e Dhomës Gjyqësore kundër ndikimit të frikësimit të mundshëm të dëshmitarëve mbi çështjen e Prokurorisë. Për shembull, pas vdekjes së një dëshmitari,<sup>151</sup> Prokuroria përfshiu një

<sup>146</sup> *Shih* T. 10633-10635 (13 nëntor 2007) (Seancë Publike).

<sup>147</sup> *Krahaso Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-T, Shtojca Konfidenciale A, Lista e Ndryshuar për Herë të Tretë e Prokurorisë dhe Kërkesa për Pranimin e Dy Deklaratave sipas Rregullës 92 *Bis*, 14 shtator 2007, para. 7, me Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 16.

<sup>148</sup> *Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-T, Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Shtimin e Dy Dëshmitarë në Listën e Saj të Dëshmitarëve dhe për Zëvendësimin e një Dëshmitari me një Tjetër, 1 nëntor 2007, para. 6-8.

<sup>149</sup> *Shih* Aktgjykim, Shtojca A (Historia Procedurale), para. 24.

<sup>150</sup> *Shih* Aktgjykim, para. 22.

<sup>151</sup> *Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-T, Kërkesë Konfidenciale për Shtyrjen e Vendimit mbi “Kërkesë drejtuar Prokurores që të Propozojë Zvogëlimin e Kuadrit të Aktakuzës” pas Vdekjes së një Dëshmitari të Prokurorisë, 16 shkurt 2007, para. 2; *shih gjithashtu* Konferencë Paragjyqësore, T. 304-307 (1 mars 2007) (Seancë Private).

dëshmitar tjetër në listën e saj të dëshmitarëve, i cili do të dëshmonte për disa çështje të ngjashme.<sup>152</sup> Kur ky dëshmitar refuzoi të dëshmonte, Prokuroria bëri kërkesë për urdhërparaqitje për të dëshmuar dhe i dha Dhomës Gjyqësore informacione që të mund të përcaktonte nëse kishte nevojë për vlerësim të rrezikut për dëshmitarin.<sup>153</sup> Pavarësisht se dëshmia e dëshmitarit ishte “mjaft e rëndësishme për të justifikuar lëshimin e urdhërparaqitjes”, Dhoma Gjyqësore vendosi të refuzonte kërkesën për urdhërparaqitje bazuar në faktin që nuk ishte bërë një vlerësim i rrezikut,<sup>154</sup> ndonëse Prokuroria kishte ofruar të bënte një vlerësim të tillë në rast se Dhoma Gjyqësore do të gjykonte se ishte i nevojshëm.<sup>155</sup>

48. Shqyrtuar bashkërisht, vendimet e Dhomës Gjyqësore për dëshmitarët e Prokurorisë, sidomos për Kabashin dhe dëshmitarin tjetër, tregojnë se Dhoma Gjyqësore nuk i ushtroi kompetencat e saj në mënyrë të arsyeshme, duke marrë parasysh kuadrin e frikësimit të rëndë të dëshmitarëve. Dhoma e Apelit vëren se Dhoma Gjyqësore kuptoi rëndësinë e dëshmimeve të të dy dëshmitarëve kyç, duke ofruar zgjatje të kufizuara të afateve kohore të parashikuara fillimisht për marrjen e dëshmimeve të dëshmitarëve.<sup>156</sup> Këto përpjekje mund të bëhen në kuadër të kompetencave gjyqësore të një Dhome Gjyqësore në raste kur gjykimi zhvillohet në rrethana të zakonata, e veçanërisht në raste kur Prokuroria nuk ka kundërshtuar vendime të Dhomës Gjyqësore. Mirëpo rrethanat e këtij procesi gjyqësor ishin të jashtëzakonshme dhe kërkonin që Dhoma Gjyqësore t'i paraprinte garantimit të një procesi të drejtë gjyqësor në përputhje me Statutin.<sup>157</sup> Ato

<sup>152</sup> *Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-T, Lista e Ndryshuar e Dëshmitarëve të Prokurorisë (Konfidenciale), 2 mars 2007, para. 4. Dhoma e Apelit vëren se në disa dokumente ky dëshmitar përmendet edhe si “Dëshmitari 11”.

<sup>153</sup> *Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-T, Shtojca Konfidenciale A ndaj Kërkesës së 23-të të Prokurorisë për Urdhërparaqitje për të Dëshmuar, 19 tetor 2007, para. 4.

<sup>154</sup> *Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-T, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Urdhërparaqitje për të dëshmuar për Dëshmitarin 25, 30 tetor 2007, f. 2.

<sup>155</sup> *Shih* Kabashi, T. 5439-5440; 5471-5473 (5 qershor 2007) (Seancë Publike); *Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-T, Urdhër në vend të Aktakuzës për Shpërfillje të Gjykatës lidhur me Shefqet Kabashin, 5 qershor 2007, f. 2-3. Dhoma e Apelit gjithashtu vëren se në qershor 2007, pasi Kabashi kishte ardhur në Tribunal dhe kishte refuzuar që të dëshmonte, Dhoma Gjyqësore duhej ta kishte arrestuar menjëherë për shpërfillje të gjykatës.

<sup>156</sup> Vendim i 31 tetorit 2007; T. 10893 (15 nëntor 2007) (Seancë Publike); T. 10956 (20 nëntor 2007) (Seancë Publike).

<sup>157</sup> Dhoma e Apelit thekson se Dhoma Gjyqësore duhej të kishte përdorur të gjitha masat e arsyeshme, qoftë me kërkesë të një pale ose *proprio motu*, për të marrë dëshminë e Kabashit dhe dëshmitarit tjetër në kuadër të kësaj çështjeje. Një qasje e tillë duhej të përfshinte miratimin e shtyrjeve të mëtejshme të afateve kohore për të ndihmuar Prokurorinë në marrjen e dëshmimeve të dëshmitarëve kyç.

kërkonin që Dhoma Gjyqësore të tregojë më fleksibël lidhur me çështje dytësore si orari i dëshmitarëve, logjistika gjyqësore dhe afatet kohore. Dhoma Gjyqësore nuk tregoi fleksibilitetin e nevojshëm dhe për pasojë ndihmoi që frikësimi i dëshmitarëve të arrinte të pengonte Prokurorinë në paraqitjen e provave me gjasë thelbësore në mbështetje të argumenteve të saj.<sup>158</sup>

49. Në përputhje me këtë, Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore nuk mori masat e nevojshme kundër frikësimit të dëshmitarëve që përshkoi procesin gjyqësor, dhe në veçanti nuk ndihmoi Prokurorinë në kërkesat e saj për të siguruar dëshminë e Kabashit dhe dëshmitarit tjetër. Duke marrë parasysh rëndësinë e mundshme të këtyre dëshmitarëve për çështjen e Prokurorisë, Dhoma e Apelit konkludon se në kuadrin e kësaj çështjeje, gabimi minoi ndershmërinë e procesit që garanton Statuti dhe Rregullorja, dhe rezultoi në dështimin e drejtësisë.

#### 4. Përfundim

50. Për këto arsye, Dhoma e Apelit, me përjashtim të mendimit mospajtues të Gjykatësit Robinson, miraton këtë pikë të Apelit të Prokurorisë dhe shfuqizon vendimin e Dhomës Gjyqësore të: (a) shpalljes së pafajësisë së Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt për pjesëmarrje në një NPK për të kryer krime në shtabin e UÇK-së dhe në burgun në Jabllanicë sipas Pikave 24, 26, 28, 30, 32 dhe 34 të Aktakuzës; (b) shpalljes së pafajësisë së Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt për përgjegjësi individuale penale sipas Pikave 24 dhe 34 të Aktakuzës; dhe (c) shpalljes së pafajësisë së Lahi Brahimajt për përgjegjësi individuale penale sipas Pikës 26 të Aktakuzës.

<sup>158</sup> *Shih* Neni 20(1) i Statutit. Dhoma e Apelit vëren se që nga dita e parë e procesit gjyqësor, Dhoma Gjyqësore ishte e informuar që frikësimi i dëshmitarëve paraqiste rrezik të konsiderueshëm ndaj ndershmërisë së procesit gjyqësor. *Shih* T. 359-361 (5 mars 2007) (Seancë Publike). Theksohet se në trajtimin që Dhoma Gjyqësore u bëri çështjeve si për shembull konfidencialiteti i dëshmitarëve nuk tregoi kujdes të mjaftueshëm ndaj këtij rreziku, me pasojë zbulimin e dhënave konfidenciale të dëshmitarëve. *Krahaso. Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-PT, Urdhër mbi Publikimin e një Memorandumi dhe për Intervistat me një Burim dhe Dëshmitar të Prokurorisë, 13 dhjetor 2006 (“Vendim i 13 dhjetorit 2006”), f. 1; *Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-PT, Mocion i Prokurorisë për Masa Mbrojtëse për Identitetin e një Personi që Mund të Japë Informacion sipas Rregullës 68 lidhur me Palë të Treta, 25 tetor 2006, dorëzuar konfidencialisht, por që u bë publik me urdhrin e Dhomës Gjyqësore (*shih* Vendim i 13 dhjetorit 2006, f. 9). Dhoma Gjyqësore gjithashtu nxori informacion konfidencial lidhur me shëndetin e një dëshmitari. *Shih Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-T, Vendim mbi Mocionin për Videcolidhje [dëshmitari tjetër], 14 shtator 2007, para. 3.

Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit urdhëron rigjykimin e Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt për këto pika.<sup>159</sup>

51. Mirëpo Dhoma e Apelit nuk do ta interpretojë Apelin e Prokurorisë si kërkesë për të shfuqizuar fajësinë e Lahi Brahimajt lidhur me dy nga pikat e lartpërmendura për të cilat ai u dënua, gjegjësisht Pikat 28 dhe 32. Rrjedhimisht Lahi Brahimaj nuk do të rigjykohet lidhur me këto dy pika.

**B. Pretendimet për Gabime lidhur me Vrasjet e Motrës “S”, të Nënës së Dëshmitarit 4, dhe Motrës “M” (Pika 2)**

52. Dhoma Gjyqësore konkludoi se: (a) ushtarë të UÇK-së vranë motrën “S”, nënën e Dëshmitarit 4, dhe motrën “M”; (b) këto vrasje lidheshin ngushtë me konfliktin e armatosur në Kosovë dhe (c) viktimat nuk merrnin pjesë aktive në luftime në kohën kur u kryen vrasjet.<sup>160</sup> Dhoma Gjyqësore më tej konkludoi se veprimet e Idriz Balajt ishin “një hallkë në zinxhirin e ngjarjeve” që çuan drejt vrasjes së këtyre grave, duke qenë se ai “i solli dhe mbajti ato në afërsi të autorëve të këtij krimi”.<sup>161</sup> Megjithatë, Shumica e Dhomës Gjyqësore e liroi Idriz Balajn nga akuza për ndihmë ose inkurajim në kryerjen e vrasjes së motrës “S”, nënës së Dëshmitarit 4, dhe motrës “M”,<sup>162</sup> dhe rrjedhimisht e shpalli të pafajshëm për Pikën 14 të Aktakuzës.<sup>163</sup> Dhoma Gjyqësore gjykoi se nuk kishte prova të mjaftueshme lidhur me ngjarjet që vijuan pas rënies së këtyre tri grave në duart e UÇK-së, dhe si pasojë Dhoma Gjyqësore nuk kishte “bazë të mjaftueshme për vlerësimin e mëtejshëm të lidhjes dhe rëndësisë së veprimeve të Idriz Balajt”. Dhoma Gjyqësore më tej arsyetoi se “nuk ekzistojnë prova që tregojnë se Idriz Balaj, me vetëdije ndihmoi apo mundësoi kryerjen e ndonjërisë prej këtyre vrasjeve meqenëse nuk ekzistojnë prova

<sup>159</sup> Dhoma e Apelit bën të ditur që gjatë rigjykimit Dhoma Gjyqësore duhet ta zbatojë versionin e fundit të Rregullores (IT/32/Rev. 44 të 10 dhjetorit 2009).

<sup>160</sup> Aktgjykim, para. 239- 240.

<sup>161</sup> Aktgjykim, para. 242.

<sup>162</sup> Aktgjykim, para. 242.

<sup>163</sup> Aktgjykim, para. 503. Pika 14 e Aktakuzës akuzon Idriz Balajn për Shkelje të Ligjeve ose Zakoneve të Luftës, Vrasje dhe Trajtim Mizor, bazuar në Nenin e Përbashkët 3(1)(a) të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, të ndëshkueshëm sipas Nenit 3 dhe Nenit 7(1) të Statutit. Aktakuza, para. 70.

konkrete që tregojnë se në atë kohë Idriz Balaj kishte dijeni se ishin kryer apo do të kryheshin këto vrasje.”<sup>164</sup>

53. Prokuroria e kundërshton këtë përfundim duke argumentuar se Dhoma Gjyqësore gaboi kur gjykoi se nuk ishin vërtetuar elementët e synimit kriminal dhe veprimit të fajshëm për ndihmë dhe inkurajim.<sup>165</sup>

54. Lidhur me synimin kriminal të ndihmës dhe inkurajimit, Prokuroria pohon se Dhoma Gjyqësore gaboi kur zbatoi standardin jo të duhur ligjor në konkluzionin se ky element nuk ishte vërtetuar.<sup>166</sup> Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore i kërkoi të provonte se Idriz Balaj “dinte me siguri ” se krimi kryesor do të kryhej, në vend që t’i kërkonte të provonte se Idriz Balaj kishte dijeni se krimi kishte të ngjarë të kryhej.<sup>167</sup> Prokuroria argumenton se Dhoma e Apelit e TPNR-së, në çështjen *Ndindabahizi*, konfirmoi kushtin e dijenisë së gjasës.<sup>168</sup> Sipas Prokurorisë, meqë synimi kriminal i kërkuar për të përcaktuar përgjegjësinë për planifikim, nxitje dhe urdhërim është “dijenja e gjasës së konsiderueshme”, dhe meqë përgjegjësia për ndihmë dhe inkurajim nuk është më e rëndë se format e tjera të përgjegjësisë, do të ishte e pakuptimtë të kërkohet “synim kriminal më të rëndë lidhur me ndihmën dhe inkurajimin”.<sup>169</sup> Për më tepër, Prokuroria argumenton se logjikisht, kushti i dijenisë së gjasës duhet të jetë “kusht për të dy elementët e synimit kriminal për ndihmë dhe inkurajim: dijeni për ndodhjen e krimin dhe dijeni për veprimin ndihmës.”<sup>170</sup> Së fundi, Prokuroria pohon se, “sikur Dhoma Gjyqësore të kishte zbatuar standardin e duhur të dijenisë së gjasës, ajo do të kishte konkluduar se [Idriz] Balaj kishte synimin kriminal të nevojshëm për ndihmë dhe inkurajim.”<sup>171</sup>

55. Në mbështetje të këtij argumenti, Prokuroria drejton vëmendjen në provat se Idriz Balaj si kreu i Shqiponjave të Zeza duhet të ketë ditur se Shqiponjat e Zeza dhe UÇK-ja

<sup>164</sup> Aktgjykim, para. 242.

<sup>165</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 45.

<sup>166</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para 58-70. Prokuroria heq dorë nga pretendimi tjetër që fillimisht paraqiti në Njoftimin e saj për Apel , që Dhoma Gjyqësore ka bërë gabim faktual gjatë vlerësimit të kushtit të *synimit kriminal*. Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 45, sh. 121.

<sup>167</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para 59-62.

<sup>168</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 59, i referohet Aktgjykimit të Apelit *Ndindabahizi*, para. 122.

<sup>169</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 60.

<sup>170</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 61.

<sup>171</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 63.

në përgjithësi “njiheshin për dhunë.”<sup>172</sup> Në veçanti, Prokuroria argumenton se Idriz Balaj, njeri me pushtet në UÇK, mori pjesë në keqtrajtimin e familjes për shkak të lidhjeve të saj me policinë serbe.<sup>173</sup> Prokuroria më tej argumenton se “vrasja ishte një mundësi e menduar për [Idriz] Balajn”, siç shihet nga fakti që ai kishte kërcënuar motrën “S” me vrasje në rast se ajo do të refuzonte të vriste dikë tjetër, dhe nga fakti që një ushtar tjetër i UÇK-së i kishte thënë nënës së Dëshmitarit 4 se do të vritej po qe se përpiquej të udhëtonte.<sup>174</sup> Së fundi, Prokuroria vë në dukje provat që për mendimin e saj vërtetojnë se Idriz Balaj kishte dijeni se viktimat ishin të pambrojtura, duke qenë se ai ishte komandant i ushtarëve të UÇK-së që sulmuan familjen gjatë natës, dhe se e dinte që viktimat ishin femra të paarmatosura që nuk kishin bashkëshort ose baba në shtëpi.<sup>175</sup>

56. Idriz Balaj përgjigjet se Prokuroria “nuk provoi që Dhoma Gjyqësore zbatoi standardin e gabuar ligjor dhe nuk vërtetoi jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se provat vërtetuan se Z. Balaj kishte synimin e nevojshëm kriminal për ndihmë dhe inkurajim.”<sup>176</sup> Ai argumenton se Dhoma Gjyqësore zbatoi standardin e drejtë ligjor lidhur me “dijeninë se veprimet e tij/saj ndihmuan ose mundësuan kryerjen e krimit”,<sup>177</sup> dhe se ajo me të drejtë konkludoi se ky element nuk ishte vërtetuar meqë nuk pati asnjë provë që Idriz Balaj të kishte dijeni se “madje po mendohej” kryerja e këtyre vrasjeve në kohën që ai veproi.<sup>178</sup>

57. Dhoma e Apelit vëren se, në lidhje me elementin e synimit kriminal të ndihmës dhe inkurajimit, Dhoma Gjyqësore e shpjegoi standardin ligjor si më poshtë:

Ndihmuesi/inkurajuesi duhet të jetë në dijeni se veprimet e tij ose të saj ndihmojnë në kryerjen e krimit prej keqbërësit kryesor. Ndihmuesi/inkurajuesi duhet të jetë gjithashtu në dijeni të veprimeve kriminale të keqbërësit kryesor, megjithëse jo për sa i përket cilësimit të tyre ligjor, dhe gjendjes mendore kriminale të tij ose të saj. Mirëpo nuk është e nevojshme që ndihmuesi/inkurajuesi të dijë për krimin konkret të synuar ose për krimin konkret të kryer; mjafton që ai ose ajo të dijë që ka të ngjarë se do të kryhet një prej krimeve, nëse vërtet është kryer.<sup>179</sup>

<sup>172</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 68-69.

<sup>173</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 66.

<sup>174</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 65.

<sup>175</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 67.

<sup>176</sup> Dosja e Përgjigjes së Balajt, para. 65.

<sup>177</sup> Dosja e Përgjigjes së Balajt, para. 69.

<sup>178</sup> Dosja e Përgjigjes së Balajt, para. 70.

<sup>179</sup> Aktgjykim, para. 145 (pa citimet e brendshme).

Dhoma e Apelit më tej vëren se Shumica e Dhomës Gjyqësore konkludoi se “nuk ekzistojnë prova që tregojnë se Idriz Balaj, me vetëdije mundësoi apo kontribuoi në kryerjen e ndonjëres prej këtyre vrasjeve meqenëse nuk ekzistojnë prova konkrete që tregojnë se në atë kohë Idriz Balaj kishte dijeni se ish-in kryer apo do të kryeshin këto vrasje.”<sup>180</sup>

58. Sipas Dhomës së Apelit, është e përcaktuar qartë se, për përmbushjen e elementit të synimit kriminal për ndihmë dhe inkurajim, “duhet të vërtetohet se ndihmuesi dhe inkurajuesi kanë pasur dijeni që veprimet e tyre ndihmuan kryerjen e krimit konkret nga kryesi kryesor” (për shembull, vrasje, shfarosje, përdhunim, torturim),<sup>181</sup> dhe se ndihmuesi dhe inkurajuesi kanë “pasur dijeni për elementët thelbësorë të krimit që kreu kryesi kryesor”.<sup>182</sup> Nëse synimi kriminal i kryesit kryesor të krimit përbën element të krimit kryesor, jo domosdoshmërisht ndihmuesi dhe inkurajuesi kanë synim të njëjtë me kryesin kryesor të krimit,<sup>183</sup> por ata duhet të kenë pasur dijeni për synimin e kryesit kryesor të krimit.<sup>184</sup> Synimi kriminal mund të provohet nëse ndihmuesi dhe inkurajuesi nuk janë të sigurtë se cili nga krimet do të kryhet përfundimisht.<sup>185</sup> Në këtë drejtim, kur një i akuzuar “ka dijeni se një nga krimet ka të ngjarë të kryhet, dhe kur një prej këtyre krimeve në të vërtetë është kryer, atëherë ai ka synuar të mundësojë kryerjen e krimit dhe është fajtor si ndihmues dhe inkurajues.”<sup>186</sup> Rrjedhimisht, Dhoma Gjyqësore ka përcaktuar standardin e drejtë ligjor lidhur me synimin kriminal për ndihmë dhe inkurajim.<sup>187</sup>

<sup>180</sup> Aktgjykim, para. 242.

<sup>181</sup> Aktgjykim i Apelit *Aleksovski*, para. 163 (citon Aktgjykimin e Apelit *Tadiq*, para. 229); *shih gjithashtu* Aktgjykim i Apelit *Bllashkiq*, para. 45 (citon Aktgjykimin e Apelit *Vasileviq*, para. 102); Aktgjykim i Apelit *Kërnojelac*, para. 51.

<sup>182</sup> Aktgjykim i Apelit *Oriq*, para. 43 (citon Aktgjykimin e Apelit *Simiq*, para. 86); Aktgjykim i Apelit *Aleksovski*, para. 162.

<sup>183</sup> Aktgjykim i Apelit *Kërstiq*, para. 140; Aktgjykim i Apelit *Kërnojelac*, para. 51-52; Aktgjykim i Apelit *Simiq*, para. 86.

<sup>184</sup> Aktgjykim i Apelit *Simiq*, para. 86; Aktgjykim i Apelit *Bërgjanin*, para. 487; Aktgjykim i Apelit *Bllagojeviq dhe Jokiq*, para. 127; Aktgjykim i Apelit *Kërstiq*, para. 140-141.

<sup>185</sup> Aktgjykim i Apelit *Bllashkiq*, para. 50 (citon Aktgjykimin *Bllashkiq*, para. 287); Aktgjykim i Apelit *Simiq*, para. 86.

<sup>186</sup> Aktgjykim i Apelit *Bllashkiq*, para. 50 (citon Aktgjykimin *Bllashkiq*, para. 287); Aktgjykim i Apelit *Simiq*, para. 86.

<sup>187</sup> *Shih* Aktgjykim, para. 145.

59. Për më tepër, Dhoma e Apelit nuk mund të identifikojë asnjë gabim të Dhomës Gjyqësore në zbatimin e standardit ligjor për synimin kriminal lidhur me ndihmën dhe inkurajimin.<sup>188</sup> Elementi i dijenisë se një krim do të kryhej nga keqbërësi kryesor është në përputhje me jurisprudencën e Tribunalit siç u tha më lart. Për më tepër, Dhoma e Apelit vëren se Dhoma Gjyqësore përfundimin e saj nuk e mbështeti mbi faktin se Idriz Balaj “nuk ishte i sigurt” që do të kryhej një krim, por mbi mungesën e provave që do të vërtetonin se ai dijeni se me veprimet e tij po ndihmonte kryerjen e një krimi kundër motrave.<sup>189</sup>

60. Dhoma e Apelit gjykon se provat të cilave iu referohet Prokuroria, në rastin më të mirë tregojnë se Idriz Balaj vuri gra të pambrojtura në kontakt me ushtarë të UÇK-së që njiheshin për dhunë. Prokuroria nuk paraqet prova lidhur me çfarë ndodhi me gratë nga momenti kur u panë gjallë për herë të fundit e deri në kohën kur u vranë, dhe në veçanti se cilët ushtarë të UÇK-së i vranë ato ose rrethanat e vrasjes së tyre. Siç konkludoi me të drejtë Dhoma Gjyqësore, asnjë provë nuk dëshmon se Idriz Balaj në periudhën përkatëse kishte dijeni se ndaj këtyre grave do të kryhej krim.<sup>190</sup>

61. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore nuk gaboi kur përfundoi se Idriz Balaj nuk kishte synimin e nevojshëm kriminal për të ndihmuar dhe inkurajuar vrasjet e motrës “S”, motrës “M”, dhe nënës së Dëshmitarit 4. Në përputhje me këtë përfundim, Dhoma e Apelit nuk do të shqyrtojë pretendimin e Prokurorisë lidhur me elementin e veprimit të fajshëm.

62. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit hedh poshtë këtë pikë të apelit dhe lë në fuqi vendimin e Dhomës Gjyqësore për shpalljen e Idriz Balajt të pafajshëm për Pikën 14.

<sup>188</sup> *Shih* Aktgjykim i Apelit *Bllagojeviq dhe Jokiq*, para. 223.

<sup>189</sup> Aktgjykim, para. 242.

<sup>190</sup> Aktgjykim, para. 242.

**C. Pretendime për Gabime lidhur me Përdhunimin, Torturimin dhe Trajtimin**  
**Mizor të Dëshmitares 61 dhe Trajtimin Mizor të Dëshmitarit 1 (Pika 3)**

63. Dhoma Gjyqësore shpalli Idriz Balajn të pafajshëm lidhur me akuzat për përdhunim, trajtim mizor dhe torturim të Dëshmitares 61, dhe trajtim mizor dhe torturim të Dëshmitarit 1 si shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës, të përfshira në Pikat 36 dhe 37 të Aktakuzës.<sup>191</sup>

64. Prokuroria argumenton se, duke qenë se u konstatua që Idriz Balaj ishte “Togeri”, ishte “krejt e palogjikshme” që Dhoma Gjyqësore ta shpallte të pafajshëm për Pikën 36 të Aktakuzës, meqë kishte dëshmi të qarta dhe përputhëse se një ushtar i UÇK-së i quajtur “Toger” kishte ndaluar, arrestuar, marrë në pyetje dhe përdhunuar Dëshmitaren 61.<sup>192</sup> Prokuroria gjithashtu argumenton se Dhoma Gjyqësore bëri gabim ligjor kur konkludoi se Dëshmitari 1 nuk iu nënshtroi trajtimit mizor të Idriz Balajt dhe ushtarëve të UÇK-së të cilët e futën atë në pus dhe më pas mbuluan pusin me kapak, dhe për këtë arsye shpalli Idriz Balajn të pafajshëm lidhur me Pikën 37 të Aktakuzës.<sup>193</sup> Rrjedhimisht Prokuroria kërkon që Dhoma e Apelit të shfuqizojë vendimin e shpalljes së pafajësisë së Idriz Balajt për Pikat 36 dhe 37 të Aktakuzës, ta shpallë atë fajtor dhe t’i japë dënimin e duhur.<sup>194</sup>

65. Idriz Balaj përgjigjet se konkluzionet e Dhomës Gjyqësore ishin të arsyeshme, dhe argumenton se argumentet e Prokurorisë janë thjesht thirrje drejtuar Dhomës së Apelit që të rivlerësojë besueshmërinë e dëshmitarëve dhe peshën e disa provave të veçanta.<sup>195</sup> Rrjedhimisht ai kërkon që Dhoma e Apelit të lërë në fuqi vendimin e Dhomës Gjyqësore për shpalljen e pafajësisë së tij.<sup>196</sup>

<sup>191</sup> Aktgjykim, para. 459-469, 503.

<sup>192</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 72-89; TA. 54 (Seancë Publike).

<sup>193</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 90-96; TA. 59 (Seancë Publike).

<sup>194</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 89, 96; TA. 59-60 (Seancë Publike).

<sup>195</sup> Dosja e Përgjigjes së Balajt, para. 95; TA. 100 (Seancë Publike).

<sup>196</sup> Dosja e Përgjigjes së Balajt, para. 98.

1. Pretendimet për përdhunim, torturim dhe trajtim mizor të Dëshmitares 61 nga Idriz

Balaj

(a) A gaboi Dhoma Gjyqësore kur konkludoi se ekzistonte dyshim i arsyeshëm që Idriz Balaj (i njohur si “Toger”) ishte përgjegjës për përdhunimin, torturimin dhe trajtimin mizor të Dëshmitares 61

66. Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore keqinterpretoi provat dhe nuk mori parasysh dëshmi të tjera thelbësore kur konkludoi se ekzistonte dyshim i arsyeshëm se Idriz Balaj ose një ushtar tjetër i UÇK-së përdhuan Dëshmitaren 61. Sipas Prokurorisë, provat nuk vënë aspak në dyshim faktin se ishte Idriz Balaj ai që përdhanoi Dëshmitaren 61, “duke marrë parasysh dëshminë e saj të qartë dhe përputhëse se atë e kishte përdhunuar një ushtar i UÇK-së i quajtur Toger.”<sup>197</sup> Prokuroria pohon se bazuar në provat, është e pamundur që ajo ta ketë ngatërruar atë me ndonjë person tjetër, dhe se asnjë Dhomë Gjyqësore e arsyeshme nuk do të arrinte në përfundimin e kësaj Dhome Gjyqësore.<sup>198</sup>

67. Në mbështetje të argumentit të saj, Prokuroria parashtron se Dëshmitarja 61 e kishte parë Togerin në shtëpinë e saj kur ai së bashku me katër ushtarë të tjerë të UÇK-së kishin ardhur për të gjetur atë dhe bashkëshortin e saj. Ndonëse Dëshmitarja 61 e pa Togerin, ajo nuk e identifikoi atë meqenëse nuk e njohte; por, burri i saj e identifikoi atë si personi që njihej si “Togeri”. Prokuroria gjithashtu argumenton se Dëshmitarja 61 kishte dëgjuar ushtarë të tjerë duke iu drejtuar një ushtari të UÇK-së me emrin “Toger”. Sipas Prokurorisë, kjo dëshmi tregon se Dëshmitarja 61 që nga fillimi e dinte se cili prej ushtarëve ishte Togeri, dhe Dhoma Gjyqësore nuk e shqyrtoi fare këtë dëshmi.<sup>199</sup>

68. Idriz Balaj përgjigjet se, në kundërshtim me argumentin e Prokurorisë, gjatë procesit gjyqësor nuk u paraqit asnjë provë që do të dëshmonte se në shtëpinë e Dëshmitares 61 kishte dritë të mjaftueshme për t’i mundësuar asaj të identifikonte se cili nga ushtarët ishte Togeri. Për më tepër, kishte prova lidhur me faktin se ndërprerjet e

<sup>197</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 73.

<sup>198</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 73-75; TA. 55-57 (Seancë Publike).

<sup>199</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 78-80; TA. 54-56 (Seancë Publike).

rrymës elektrike në atë rajon ishin të shpeshta.<sup>200</sup> Prokuroria nuk e pyeti Dëshmitaren 61 nëse mund ta shihte qartë Togerin dhe madje ajo vetë tha që ishte errësirë dhe nuk mund t'i shihte qartë ushtarët.<sup>201</sup> Gjatë pyetjeve nga Mbrojtja, Dëshmitarja 61 theksoi se nuk mund t'i përshkruante ushtarët pasi ishte shumë errët:

Pyetje: Tre ushtarët e tjerë që fillimisht erdhën në shtëpinë tuaj, a mund t'i përshkruani Dhomës Gjyqësore se si dukeshin ata?

Përgjigje: Nuk e di. Nuk i pashë. Të gjithë ishin të njëjtë. Nuk i pashë të gjithë në të njëjtën kohë. Ishte natë. Nuk i pashë brenda. I pashë vetëm jashtë. Pastaj jashtë ishte errësirë. Nuk i shihja dot prandaj s'mund t'jua përshkruaj se si dukeshin.<sup>202</sup>

69. Idriz Balaj gjithashtu vë në dukje se Dëshmitarja 61 dëshmoi se bashkëshorti i saj, Dëshmitari 1, i kishte treguar se kush ishte Togeri pasi ishin kthyer në shtëpi më vonë atë mëngjes. Idriz Balaj argumenton se kjo dëshmi e vë edhe më në dyshim besueshmërinë e Dëshmitares 61 lidhur me “Togerin” meqenëse është e pamundur të konkludohet saktësisht nëse informacioni i Dëshmitares 61 bazohej në përvojën e saj apo në informacionin që i kishte dhënë bashkëshorti pasi ishin kthyer në shtëpi.<sup>203</sup>

70. Idriz Balaj deklaroi se Dëshmitarja 61 dëshmoi që ajo kishte pasur mundësi ta shihte personin që e kishte marrë në pyetje për një kohë të gjatë në dhomë përpara se ta përdhunonte. Mirëpo pavarësisht këtij fakti, Dëshmitarja 61 nuk ishte në gjendje të identifikonte atë person si Idriz Balaj në fotomontazhin që përmbante fotografinë e tij në tetor 2002.<sup>204</sup> Për më tepër, Idriz Balaj vë në dukje se Dëshmitarja 61 dëshmoi që ajo nuk ishte në gjendje të përshkruante burrin që e kishte përdhunuar atë, por që ishte e sigurtë se ai ishte “i shkurtër, jo i gjatë, me flokë të zeza, [...] vetëm pak më i gjatë se unë.”<sup>205</sup> Ai më tej argumenton se ky përshkrim nuk përputhet me faktin që Dëshmitarja 61 është e gjatë 1.58 m, kurse ai 1.78 m.<sup>206</sup>

71. Idriz Balaj gjithashtu rikujton dëshminë e Dëshmitares 61 se kur kishte dëgjuar që “Togeri” ishte në Hagë, ajo e kishte parë në televizor dhe kishte vërejtur se, “Ai duket më

<sup>200</sup> Dosja e Përgjigjes së Balajt, para. 105, sh. 126.

<sup>201</sup> Dosja e Përgjigjes së Balajt, para. 105-106.

<sup>202</sup> Dosja e Përgjigjes së Balajt, para. 107 (citon Dëshmitaren 61, T. 4043 (11 maj 2007) (Seancë Publike)).

<sup>203</sup> Dosja e Përgjigjes së Balajt, para. 108-110.

<sup>204</sup> Dosja e Përgjigjes së Balajt, para. 112-116; TA. 96-97 (Seancë Publike).

<sup>205</sup> Dosja e Përgjigjes së Balajt, para. 117; TA. 98 (Seancë Publike).

<sup>206</sup> Dosja e Përgjigjes së Balajt, para. 118; TA. 98 (Seancë Publike).

i moshuar. Personi në televizor nuk mu duk si Togeri. Ai duket më i moshuar. Familja ime më tha që Togeri ishte në televizion dhe se Togeri ishte në Hagë.”<sup>207</sup>

72. Dhoma e Apelit vëren se Dhoma Gjyqësore u bind se një ushtar i UÇK-së kishte përdhunuar dhe torturuar Dëshmitaren 61.<sup>208</sup> Megjithatë, ajo gjithashtu vuri në dukje se ekzistonte dyshim i arsyeshëm lidhur me identitetin e këtij ushtari. Në veçanti, Dhoma Gjyqësore mori parasysh, ndër të tjerë, faktin që Dëshmitarja 61 nuk e njohu Idriz Balajn kur iu tregua fotomontazhi i Tribunalit; deklaratën e saj se kur e pa Idriz Balajn në televizor në vitin 2005, ai nuk iu duk si njeriu që e kishte përdhunuar; dhe dëshminë e saj se nuk do të ishte më në gjendje të njohte personin që e kishte përdhunuar atë.<sup>209</sup> Dhoma Gjyqësore më tej vuri re se Dëshmitari 1 nuk mund të ketë ditur se kush e kreu përdhunimin e Dëshmitares 61, duke pasur parasysh dyshimet më të mëdha që lindin nga provat e administruara të identifikimit.<sup>210</sup>

73. Dhoma e Apelit është e bindur se, duke marrë parasysh paqartësitë që dalin nga identifikimi i Idriz Balajt nga Dëshmitarja 61, provat lidhur me fajësinë e tij nuk janë të sigurta. Për këtë arsye, Dhoma Gjyqësore veprroi në përputhje me kompetencat e saj gjyqësore kur konkludoi se ekzistonte dyshim i arsyeshëm nëse ai përdhunoi dhe torturoi Dëshmitaren 61.

74. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit hedh poshtë argumentin e Prokurorisë.

(b) A gaboi Dhoma Gjyqësore kur nuk u mbështet në prova të tjera identifikuese

75. Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore nuk shqyrtoi dëshmi për një karakteristikë tjetër identifikuese të ushtarit të UÇK-së, “Togeri”, konkretisht faktin se ai i foli Dëshmitares 61 në shqip dhe se ajo e dalloi që ai nuk vinte nga fshati i saj, dhe në të vërtetë Idriz Balaj nuk ishte nga fshati i saj. Prokuroria gjithashtu parashtroi se Dhoma Gjyqësore nuk shqyrtoi provat që tregonin se Togeri komandonte dhe u jepte urdhra ushtarëve të tjerë gjatë ngjarjes në fjalë, dhe se ai mbante shënime në një fletore gjatë

<sup>207</sup> Dosja e Përgjigjes së Balajt, para. 119-121 (citon Dëshmitaren 61, T. 4050-4051 (11 maj 2007) (Seancë Publike)); TA. 97-98 (Seancë Publike).

<sup>208</sup> Aktgjykim, para. 465-466.

<sup>209</sup> Aktgjykim, para. 469.

<sup>210</sup> Aktgjykim, para. 469.

gjithë kohës së marrjes në pyetje të Dëshmitares 61. Sipas Prokurorisë, Dhoma Gjyqësore duhej t'i kishte përdorur këto prova për të identifikuar ushtarin që përdhanoi Dëshmitaren 61 si Idriz Balaj, sepse po ashtu si personi që përdhanoi Dëshmitaren 61, edhe Idriz Balaj komandonte ushtarët e UÇK-së dhe “mbante një fletore me emrat e bashkëpunëtorëve.”<sup>211</sup>

76. Idriz Balaj përgjigjet se të folurit e gjuhës shqipe nuk është metodë e besueshme për identifikimin e një individi konkret, duke pasur parasysh se shumica e madhe e popullsisë flisnin shqip dhe se UÇK-ja përbëhej nga shqiptarë etnikë nga e gjithë Kosova. Për më tepër, Idriz Balaj vë në dukje se kur u pyet nëse mund ta dallonte prejardhjen e keqbërësit kryesor nga theksi i tij, Dëshmitarja 61 u përgjigj se vetëm mund të thoshte që ai fliste shqip.<sup>212</sup> Ai gjithashtu argumenton se fakti që keqbërësi kryesor mbante shënime gjatë marrjes në pyetje nuk ka pothuajse kurrfarë vlere provuese meqë kjo është një karakteristikë e përgjithshme e marrjeve në pyetje.<sup>213</sup>

77. Dhoma e Apelit rikujton se:

për sa u përket përfundimeve faktuale, një Dhomë Gjyqësore duhet t'i bazojë përfundimet e veta vetëm mbi fakte që janë thelbësore për përcaktimin e fajësisë lidhur me një akuzë konkrete. Nuk ka nevojë t'u referohet dëshmimeve të të gjithë dëshmitarëve apo çdo prove të marrë në gjyq. Shkurtimisht, një Dhomë Gjyqësore duhet të përqëndrohet në përcaktimin e qartë, të kuptimtë dhe përmbledhës vetëm të atyre përfundimeve ligjore dhe faktuale nga jurisprudenca e disponueshme lidhur me një çështje dhe moria e fakteve të paraqitura gjatë procesit gjyqësor, mbi të cilat mbështeti vendimin e saj për të dënuar ose shpallur të pafajshëm një individ.<sup>214</sup>

Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore shqyrtoi provat që ishin thelbësore për përcaktimin e fajësisë së mundshme të Idriz Balajt lidhur me këtë Pikë. Për më tepër, Dhoma e Apelit nuk është e mendimit se provat e tjera identifikuese që citon Prokuroria u japin vlerë më të madhe fakteve që shqyrtoi Dhoma Gjyqësore. Rrjedhimisht, Prokuroria nuk vërtetoi që Dhoma Gjyqësore gaboi kur nuk mori parasysh prova të tilla në Aktgjykimin e saj.

78. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit hedh poshtë argumentin e Prokurorisë.

<sup>211</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 81-82; TA. 57-58 (Seancë Publike).

<sup>212</sup> Dosja e Përgjigjes së Balajt, para. 129, 130 (i referohet Dëshmitares 61, T. 4000 (11 maj 2007) (Seancë Publike)); TA. 98 (Seancë Publike).

<sup>213</sup> Dosja e Përgjigjes së Balajt, para. 131.

<sup>214</sup> Aktgjykim i Apelit *Haxhihasanoviç dhe Kubura*, para. 13 (pa citimet e brendshme).

(c) A gaboi Dhoma Gjyqësore kur nuk u mbështet në prova të dorës së dytë

79. Duke patur parasysh dyshimet që lindën nga dëshmitë e Dëshmitarëve 1 dhe 61 rreth asaj nëse ishte Togeri ai që kreu përdhunimin, Dhoma Gjyqësore vendosi që të mos mbështetej në dëshmi të dorës së dytë sipas të cilave Togeri pranoi se kishte përdhunuar Dëshmitaren 61.<sup>215</sup>

80. Prokuroria vë në dukje dëshmi sipas të cilave tre komandantë të lartë të UÇK-së, ndër të cilët Shemsedin Cekaj, i thanë Dëshmitares 61 se “Togeri” kishte pranuar se kishte kryer krimin dhe se kjo nuk do të përsëritej. Prokuroria më tej vëren se dëshmitë e Dëshmitarëve 61, 1, dhe 56 lidhur me këtë pikë përputhen me njëra-tjetrën, dhe se fakti që kjo nuk iu kujtua Shemsedin Cekajt është i parëndësishëm. Rrjedhimisht, sipas Prokurorisë, Dhoma Gjyqësore gaboi kur nuk mori parasysh këtë dëshmi të dorës së dytë si konfirmim.<sup>216</sup>

81. Idriz Balaj përgjigjet se dëshmitë e Dëshmitarit 1 dhe Dëshmitarit 56 (i ati i Dëshmitarit 1) nuk janë të besueshme meqë për shkak të vdekjes së tij gjatë kohës së procesit gjyqësor Dëshmitarit 1 nuk iu bënë pyetje nga Mbrojtja, dhe se Dëshmitari 56 ishte një burrë i moshuar dhe i sëmurë që kishte mjaft vështirësi të kuptonte domethënien e betimit solemn përpara dhënies së dëshmisë, duke deklaruar disa herë se ai nuk ishte dëshmitar.<sup>217</sup> Për më tepër, Idriz Balaj kundërshton karakterizimin që i bën Prokuroria dëshmisë së Shemsedin Cekajt, një komandant i UÇK-së. Ndonëse Prokuroria pohon se Shemsedin Cekajt “nuk iu kujtua” pranimi i Togerit, Idriz Balaj vë në dukje dëshminë e Shemsedin Cekajt se për këto ngjarje për herë të parë kishte dëgjuar nga Prokuroria kur e kontaktoi atë herën e parë lidhur me çështjen.<sup>218</sup>

<sup>215</sup> Aktgjykim, para. 469.

<sup>216</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 84.

<sup>217</sup> Dosja e Përgjigjes së Balajt, para 137-138 (citon Dëshmitarin 56, T. 7111, 7130 (18 korrik 2007) (Seancë Private)).

<sup>218</sup> Dosja e Përgjigjes së Balajt, para. 132-133, para. 135 (citon Shemsedin Cekajn, T. 4518 (17 maj 2007) (Seancë Private)). Dëshmitari 56 tha që emri i personit ishte “Abedin Ceki, Shabedin Ceki”. Dëshmitari 56, T. 7106 (18 korrik 2007) (Seancë Private). Idriz Balaj nuk kundërshton faktin që bëhet fjalë për Shemsedin Cekajn. Dosja e Përgjigjes së Balajt, para. 132.

82. Dëshmitarja 61 dëshmoi se pas ngjarjes, tre “komandantë” erdhën në shtëpinë e saj dhe i thanë që Togeri kishte pranuar se e kishte përdhunuar atë. Gjatë dëshmisë së saj, ajo tha:

Të nesërmen në mëngjes në orën 5:00 të mëngjesit, vjehri im shkoi në shtab. Ai u tregoi atyre se çfarë na kishte ndodhur mua dhe të birit. Pastaj ata erdhën dhe më pyetën se çfarë ndodhi. Unë u tregova se çfarë kishte ndodhur, se çfarë më bëri ai. Pastaj ata pyetën atë. Fillimisht ai nuk pranoi. Ai tha që unë kisha gënjyer, por kjo nuk ishte e vërtetë. Unë iu tregova se çfarë ndodhi në të vërtetë. Ata pastaj erdhën tek unë. Më thanë që nuk kishte qenë gënjeshtër – Unë u thashë që nuk ishte gënjeshtër dhe se kjo ishte e vërteta. Ata më pas shkuan përsëri tek ai dhe e pyetën përsëri. Atëherë ai e pranoi.<sup>219</sup>

Kur u pyet për të sqaruar këtë deklaratë, Dëshmitarja 61 tha përsëri që “Ai fillimisht nuk e pranoi, por më vonë po.”<sup>220</sup> Ajo nuk tha asgjë tjetër lidhur me rrethanat e pranimit të pretenduar.

83. Dhoma e Apelit gjykon se rrethanat e dëshmisë së Dëshmitarit 56 vënë në dyshim besueshmërinë e kësaj dëshmie. Ai ishte i hutuar, nuk donte të dëshmonte, dhe në përgjithësi dukej se nuk i kuptonte pyetjet që i bëheshin.<sup>221</sup> Ai shpesh herë tha, “Unë jam 75 vjeçar. Jam i sëmurë. Jam i paaftë. Ju lutem mos më ngarkoni me gjëra të këtilla. Kaq di dhe kaq po ju them.”<sup>222</sup> Është me rëndësi të theksohet se në kundërshtim me sugjerimin e Prokurorisë, dëshmia e Dëshmitarit 56 nuk vërtetoi pohimin e Dëshmitares 61 se tre “komandantë” të UÇK-së i kishin thënë që Togeri kishte pranuar se e kishte përdhunuar. Dëshmitari 56 tha që ushtarë të UÇK-së kishin ardhur në shtëpinë e tij pas ngjarjes dhe se nuk dinte më shumë se kaq.<sup>223</sup>

84. Me vdekjen e Dëshmitarit 1 gjatë kohës që po zhvillohej procesi gjyqësor, Dhoma Gjyqësore pranoi si prova pesë deklaratat e tij me shkrim, por përjashtoi shumë pjesë të tyre që lidheshin me veprimet dhe sjelljen e të akuzuarit, të cilat kishin mospërputhje të brendshme, nuk mund të konfirmoheshin dhe/ose ishin në kundërshtim të drejtpërdrejtë

<sup>219</sup> Dëshmitarja 61, T. 3997 (11 maj 2007) (Seancë Publike).

<sup>220</sup> Dëshmitarja 61, T. 3997 (11 maj 2007) (Seancë Publike).

<sup>221</sup> Dëshmitari 56, T. 7120-7121 (18 korrik 2007) (Seancë Private).

<sup>222</sup> Dëshmitari 56, T. 7104 (18 korrik 2007) (Seancë Private).

<sup>223</sup> Dëshmitari 56, T. 7106 (18 korrik 2007) (Seancë Private).

me dëshmi të dhëna nën betim.<sup>224</sup> Për më tepër, në këto deklarata nuk ka informacion lidhur me pretendimin për pranimin nga ana e Togërit.<sup>225</sup>

85. Gjithashtu, siç u theksua më lart, Dëshmitari 56 nuk ishte në gjendje të fliste lidhur me këtë pikë. Dhoma e Apelit gjithashtu vëren se Shemsedin Cekaj, njëri nga ushtarakët e UÇK-së të cilit, sipas Dëshmitarit 1, Togëri ia raportoi rastin, dëshmoi që nuk i njihje Dëshmitaren 61 dhe Dëshmitarin 1.<sup>226</sup> Shemsedin Cekaj më tej dëshmoi se deri në momentin kur e kishte informuar Prokuroria, nuk kishte dëgjuar që këta dëshmitarë të ishin marrë nga shtëpitë e tyre.<sup>227</sup> Vetëm Dëshmitarja 61 tha që kishte dëgjuar se Togëri kishte pranuar se e kishte përdhunuar atë. Dhoma e Apelit nuk dyshon që Dëshmitarja 61 dëshmoi me vullnetin e saj të lirë dhe në mënyrë të ndershme; megjithatë, gjatë vlerësimit të besueshmërisë së dëshmisë së saj të dorës së dytë lidhur me këtë pikë, duhen marrë parasysh edhe faktorët rrethanorë.<sup>228</sup> Dëshmitarja 61 është viktimë e drejtpërdrejtë krimesh të rënda, përdhunim, torturim dhe trajtim mizor, në duart e një personi që ajo e identifikon si “Togëri”. Deklarata e saj që përmendet është dëshmi e dorës së dytë, ose me fjalë të tjera, ajo dëshmoi se ushtarë të UÇK-së i kishin thënë asaj që Togëri kishte pranuar se kishte kryer përdhunimin.

86. Në rrethana të tilla, ishte e arsyeshme që Dhoma Gjyqësore të trajtonte me kujdes dëshminë e dorës së dytë lidhur me pretendimin për pranimin nga ana e Togërit, dhe në fund të mos mbështetej mbi të. Prokuroria nuk arriti të provonte se Dhoma Gjyqësore veproi në mënyrë të paarsyeshme kur konkludoi se nuk ishte provuar jashtë çdo dyshimi

<sup>224</sup> *Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-T, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin si Prova të Pesë Deklaratave të Dëshmitarit 1 Sipas Rregullës 92 *quarter* së bashku me Shtojcën Konfidenciale, 28 nëntor 2007, para. 20.

<sup>225</sup> P1250 (Deklaratë e Dëshmitarit 1, 24 gusht 2002), f. 3, 5 (E Mbyllur me Vullë); P1251 (Deklaratë e Dëshmitarit 1, 16 tetor 2002), f. 3 (e Vulosur).

<sup>226</sup> Shemsedin Cekaj, T. 4517-4518 (17 maj 2007) (Seancë Private).

<sup>227</sup> Shemsedin Cekaj, T. 4518 (17 maj 2007) (Seancë Private).

<sup>228</sup> *Prokurori k. Dushko Tadiqit i njohur si “Dule”*, Lënda Nr. IT-94-1-T, Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes lidhur me Dëshmi të Dorës së Dytë, 5 gusht 1996, para. 15-16 (ku thuhet “Dhoma Gjyqësore udhëhiqet nga Rregullorja ku përcaktohet qartë se besueshmëria duhet të jetë pjesë përbërëse e pranueshmërisë. [...] Gjatë shqyrtimit të vlerës provuese të dëshmisë së dorës së dytë, Dhoma Gjyqësore është e detyruar që t’i kushtojë vëmendje të posaçme treguesve të besueshmërisë së saj. Në marrjen e vendimit, Dhoma Gjyqësore, sipas nevojës, mund të marrë parasysh nëse deklarata është bërë me vullnet të lirë, nëse ajo është e vërtetë dhe e besueshme.”); *Prokurori k. Zlatko Aleksovskit*, Lënda Nr. IT-95-14/1-AR73, Vendim mbi Apelin e Prokurorisë lidhur me Pranueshmërinë e Provave, 16 shkurt 1999, para. 15 (ku thuhet se “një Dhomë Gjyqësore duhet të bindet se dëshmia është e besueshme për qëllimin në fjalë [...] dhe për këtë qëllim mund të marrë parasysh përmbajtjen e dëshmisë së dorës së dytë dhe rrethanat që e shkaktuan atë”).

të arsyeshëm që personi përgjegjës për përdhunimin, torturim dhe trajtimin mizor të Dëshmitares 61, ishte Idriz Balaj, apo se ai kishte planifikuar që dikush tjetër të kryente këto veprime.

87. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit hedh poshtë argumentin e Prokurorisë.

2. Pretendimi për përgjegjësinë e Idriz Balajt në trajtimin mizor të Dëshmitarit 1

88. Prokuroria pretendon se Dhoma Gjyqësore bëri gabim ligjor kur nuk nxori përfundimin se veprimet e ushtarëve të UÇK-së që hodhën Dëshmitarin 1 në pus përbëjnë trajtim mizor. Sipas argumentit të Prokurorisë, “veprimet e kryera mbi Dëshmitarin 1 padyshim përfshihen në përkufizimin e trajtimit mizor sipas Nenit 3 të Statutit, meqenëse ato përbënin sulm të rëndë mbi dinjitetin e tij njerëzor ose së paku i shkaktuan atij vuajtje të rëndë shpirtërore.”<sup>229</sup> Sipas Prokurorisë, Idriz Balaj “veproi si personi epror dhe u dha urdhra ushtarëve të tjerë që sollën Dëshmitaren 61 dhe bashkëshortin e saj në shtab.”<sup>230</sup> Megjithatë, Prokuroria nuk pretendon se Idriz Balaj i udhëzoi shprehimisht ushtarët e tjerë që të hidhnin Dëshmitarin 1 në pus.<sup>231</sup>

89. Në përgjigjen e tij, Idriz Balaj argumenton se “bazuar në faktet ekzistuese, asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të kishte arritur në përfundimin që këto veprime përbëjnë trajtim mizor”<sup>232</sup> dhe se “nuk kishte prova që Z. Balaj personalisht mori pjesë në hedhjen e Dëshmitarit 1 në pus.”<sup>233</sup>

90. Dhoma e Apelit rikujton dëshminë e Dëshmitares 61 se Idriz Balaj (i njohur si “Togeri”) kishte shkuar në shtëpinë e saj së bashku me katër persona të tjerë dhe e kishte pyetur vjehrrin e saj, i cili e kishte hapur derën, se ku e kishte të birin.<sup>234</sup> Vjehri u kishte thënë se i biri po flinte, por megjithatë burrat morën Dëshmitaren 61 dhe bashkëshortin e saj (Dëshmitarin 1).<sup>235</sup> Dëshmitari 1 njohu Togerin.<sup>236</sup> Kur po largohej nga shtëpia, Dëshmitarja 61 nuk priste që do të kthehej e gjallë në shtëpi meqenëse burri i saj i kishte

<sup>229</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 91; *shih gjithashtu* TA. 59 (Seancë Publike).

<sup>230</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 82; *shih gjithashtu* TA. 58 (Seancë Publike).

<sup>231</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 92.

<sup>232</sup> Dosja e Përgjigjes së Balajt, para. 152.

<sup>233</sup> Dosja e Përgjigjes së Balajt, para. 146; *shih gjithashtu* TA. 102 (Seancë Publike).

<sup>234</sup> Dëshmitarja 61, T. 3982 (11 maj 2007) (Seancë Publike).

<sup>235</sup> Dëshmitarja 61, T. 3982 (11 maj 2007) (Seancë Publike).

<sup>236</sup> Dëshmitarja 61, T. 4003 (11 maj 2007) (Seancë Publike).

thënë që Togeri “kishte bërë masakra”.<sup>237</sup> Ajo shpjegoi se “Për këtë arsye e kishim frikë dhe për këtë arsye mendonim se nuk do të ktheheshim më në shtëpi.”<sup>238</sup> Më pas Dëshmitarja 61 dhe Dëshmitari 1 u çuan në shtabin e UÇK-së që zgjati rreth 15-20 minuta në këmbë.<sup>239</sup> Dëshmitari 1 i kishte duart e lidhura pas shpinës dhe dy burra e çuan tek pusi.<sup>240</sup> Në deklaratën e tij, Dëshmitari 1 theksoi se Togeri e çoi gruan e tij në shtabin e UÇK-së.<sup>241</sup>

91. Sipas Dëshmitares 61, më pas, kur ishin kthyer në shtëpi, Dëshmitari 1 i kishte treguar që e kishin futur në një pus të mbushur me ujë deri në mes dhe të mbyllur me kapak.<sup>242</sup> Dëshmitarja 61 nuk dinte hollësi të tjera se çfarë i kishte ndodhur bashkëshortit të saj gjatë kohës që kishte qëndruar në pus. Ajo deklaroi se, “Ai vetëm tha që e kishin marrë dhe futur në pus. Nuk më tregoi asgjë se çfarë e kishin pyetur. Vetëm më tha që e kishin futur në pus dhe se e kishin ruajtur me roje.”<sup>243</sup> Dëshmitarja 61 vuri në dukje që rrobat e bashkëshortit të saj ishin të lagura dhe se ai i ndërroi kur u kthyen në shtëpi.<sup>244</sup>

92. Në deklaratën e Dëshmitarit 1, hollësitë rreth ngjarjes dallojnë nga dëshmia e Dëshmitares 61. Sipas një deklaratë të Dëshmitarit 1, pasi kishin arritur në shtabin e UÇK-së, Togeri e kishte marrë gruan e tij brenda në shtab kurse dy ushtarë të maskuar e kishin çuar Dëshmitarin 1 te një pus përpara shtëpisë. Më pas, ata e kishin hedhur në pus dhe ia kishin vënë pusit kapakun. Dëshmitari 1 deklaroi se pusi ishte “rreth tri metra i thellë dhe i mbushur me 1.5 metra ujë, kështu që uji i arrinte deri në qafë.”<sup>245</sup> Nga kjo dëshmi, Dhoma Gjyqësore konkludoi se nuk ishte provuar se duke e futur Dëshmitarin 1 në pus apo me veprime të tjera ushtarë të UÇK-së i kishin shkaktuar atij vuajtje ose lëndime të rënda mendore ose fizike, apo kishin sulmuar rëndë dinjitetin e tij njerëzor.

<sup>237</sup> Dëshmitarja 61, T. 3985, 3987 (11 maj 2007) (Seancë Publike).

<sup>238</sup> Dëshmitarja 61, T. 3987 (11 maj 2007) (Seancë Publike).

<sup>239</sup> Dëshmitarja 61, T. 3990 (11 maj 2007) (Seancë Private).

<sup>240</sup> Dëshmitarja 61, T. 3991 (11 maj 2007) (Seancë Publike); Aktgjykim, para. 460.

<sup>241</sup> P1250 (Deklaratë e Dëshmitarit 1, 23-24 gusht 2002, f. 3) (E Vulosur).

<sup>242</sup> Dëshmitarja 61, T. 4005-4006 (11 maj 2007) (Seancë Publike).

<sup>243</sup> Dëshmitarja 61, T. 4007 (11 maj 2007) (Seancë Publike). Dhoma Gjyqësore nuk e trajtoi këtë deklaratë në Aktgjykim.

<sup>244</sup> Dëshmitarja 61, T. 4007 (11 maj 2007) (Seancë Publike).

<sup>245</sup> P1250 (Deklaratë e Dëshmitarit 1, 23-24 gusht 2002, f. 3) (E Mbyllur me Vulë). Dhoma e Apelit është e mendimit që mospërputhja lidhur me pikën nëse niveli i ujit ishte deri në qafën apo mesin e Dëshmitarit 1 ishte e vogël dhe jovendimtare për çështjen që shqyrton.

Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore nuk u bind jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se Dëshmitari 1 ishte viktimë e trajtimit mizor ose torturimit.<sup>246</sup>

(a) A gaboi Dhoma Gjyqësore kur konkludoi se trajtimi i Dëshmitarit 1 nuk përmbushi standardin e veprës penale të trajtimit mizor sipas Nenit 3

93. Për të gjykuar nëse trajtimi i Dëshmitarit 1 plotëson kërkesat ligjore për trajtim mizor sipas Nenit 3, Dhoma e Apelit rikujton Aktgjykimin *Çelebiqi*, ku u konstatua se:

Baza për përfshirjen e trajtimit mizor në kuadrin e Nenit 3 të Statutit është moslejimi i tij sipas nenit të përbashkët 3(1) të Konventave të Gjenevës, i cili parashkruan, “dhunën ndaj jetës dhe individit, sidomos vrasjet e çdo lloji, gjymtimin, trajtimin mizor dhe torturim”. Përveç se nuk lejohet sipas nenit të përbashkët 3, trajtimi mizor apo mizoria janë të ndëshkueshëm sipas nenit 87 të Konventës së Tretë të Gjenevës, e cila trajton dënimet për robërit e luftës, dhe nenit 4 të Protokollit Shtesë II, sipas të cilit ndalohen veprimet e mëposhtme:

Dhuna ndaj jetës, shëndetit dhe mirëqenies mendore dhe fizike të individëve, në veçanti vrasja dhe trajtimi mizor, si për shembull tortura, gjymtimi apo çdo formë e ndëshkimit trupor.

Për sa i përket trajtimit çnjerëzor, asnjë dokument ndërkombëtar nuk e përkufizon këtë shkelje, ndonëse ajo është e ndaluar konkretisht nga neni 5 i Deklaratës Universale të Drejtave të Njeriut, neni 7 i ICCPR-së, neni 5, paragrafi 2 i Konventës Ndëramerikane për të Drejtat e Njeriut, dhe neni 5 i Kartës Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe Popujve. Në secilin nga këto dokumente, kjo shkelje përmendet brenda së njëjtës kategori shkeljeje si trajtim çnjerëzor.<sup>247</sup>

94. Po ashtu si dokumentet e lartpërmendura të të drejtës ndërkombëtare jurisprudencia e Tribunalit nuk mundëson përkufizim gjithëpërfshirës të veprës penale të trajtimit mizor, por Dhoma e Apelit përkufizoi elementet e trajtimit mizor si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës si më poshtë:

a. një veprim ose mosveprim i qëllimshëm [...] që shkakton vuajtje ose lëndim të rëndë mendor ose fizik apo përbën sulm të rëndë ndaj dinjitetit njerëzor,

b. që kryhet mbi një individ që nuk merr pjesë aktivisht në luftime.<sup>248</sup>

95. Dhoma e Apelit gjykon se, ndonëse Dëshmitari 1 (individ që nuk merrte pjesë aktivisht në luftime) nuk ishte viktimë e një veprimi ose mosveprimi të qëllimshëm me

<sup>246</sup> Aktgjykim, para. 467.

<sup>247</sup> Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 548-549.

<sup>248</sup> Aktgjykim i Apelit *Bllashkiq*, para. 595 (citon Aktgjykimin e Apelit *Çelebiqi*, para. 424, 426 (pa citimet e brendshme)).

pasojë vuajtje apo lëndim të rëndë *fizik*, trajtimi që iu bë i shkaktoi atij vuajtje të rëndë *mendore* dhe përbënte sulm të rëndë ndaj dinjitetit të tij njerëzor. Dëshmia e Dëshmitares 61 (gruaja e Dëshmitarit 1) tregon se bashkëshorti i saj e njihte Togerin dhe e kishte frikë meqë e dinte se kishte kryer “masakra.”<sup>249</sup> Për më tepër, pasi çifti u zgjua me forcë në mes të natës dhe u prej shtëpisë nga burra të armatosur, dhe pasi Dëshmitari 1 përfundoi në pus, gruan e tij e çuan për ta marrë në pyetje në një shtab të UÇK-së që njihej për dhunë. Në kundërshtim me përfundimin e Dhomës Gjyqësore, përfundimi i vetëm i arsyeshëm që del nga provat është se Dëshmitari 1 pësoi dëmtim të rëndë *mendor* kur e hodhën në pus dhe e ndanë nga gruaja e tij, e cila tani ishte në duart e ushtarëve të armatosur të UÇK-së. Rrjedhimisht Prokuroria provoi veprimin e fajshëm të krimit.

96. Për sa i përket synimit kriminal, kur merren parasysh të gjitha provat lidhur me këtë ngjarje, përfundimi i vetëm i arsyeshëm që mund të nxirret është se ushtarët e UÇK-së që hodhën Dëshmitarin 1 në pus gjatë kohës që disa të tjerë çuan gruan e tij për t’u marrë në pyetje, kishin për qëllim që t’i shkaktonin vuajtje të rëndë *mendore* Dëshmitarit 1, i cili nuk merrte pjesë aktivisht në luftime.

97. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit miraton pjesërisht pikën e apelit të Prokurorisë dhe shfuqizon përfundimin e Dhomës Gjyqësore sipas të cilit trajtimi i Dëshmitarit 1 nuk përbënte trajtim mizor sipas Nenit 3 të Statutit.

98. Pasi ka konkluduar se veprimet e kryera ndaj Dëshmitarit 1 përbënin trajtim mizor, Dhoma e Apelit do të shqyrtojë përgjegjësinë e Idriz Balajt për këto veprime.

(b) A është Idriz Balaj përgjegjës për trajtimin mizor të Dëshmitarit 1

99. Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore konkludoi që Idriz Balaj ishte njëri prej ushtarëve të UÇK-së që morën Dëshmitarin 1 dhe gruan e tij dhe i çuan në shtabin e UÇK-së në Irzniq. Ajo gjithashtu pohon se provat tregojnë që Idriz Balaj ishte përgjegjës dhe se pjesëmarrja e tij personale në trajtimin mizor të Dëshmitarit 1 e bën atë fajtor për kryerjen e krimit.<sup>250</sup>

<sup>249</sup> Dëshmitarja 61, T. 3986-3987 (11 maj 2007) (Seancë Publike).

<sup>250</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 95; TA. 54, 58-60 (Seancë Publike).

100. Idriz Balaj përgjigjet se nuk kishte dëshmi, madje as nga Dëshmitari 1, që ai kishte hedhur Dëshmitarin 1 në pus. Ai pretendon se nuk ekzistonte plan paraprak për hedhjen e Dëshmitarit 1 në pus, dhe se nuk kishte prova për dijeninë ose pjesëmarrjen e tij në një plan të tillë. Rrjedhimisht sipas Idriz Balajt, “elementet e dy formave të vetme të përgjegjësisë penale që pretendohen në këtë pikë, kryerje dhe planifikim, thjesht nuk u provuan gjatë procesit gjyqësor.”<sup>251</sup>

101. Dhoma e Apelit vëren se, sipas Dëshmitares 61, dy burra të tjerë, dhe jo Idriz Balaj, hodhën bashkëshortin e saj në pus. Provat nuk tregojnë nëse Idriz Balaj kishte dijeni se Dëshmitarin 1 e kishin hedhur në pus. Për më tepër, dëshmia kryesore lidhur me çështjen nëse Idriz Balaj kreu ose planifikoi trajtimin mizor të Dëshmitarit 1 vjen pikërisht nga Dëshmitari 1. Mirëpo Dëshmitari 1 nuk ishte i disponueshëm për pyetje nga Mbrojtja për shkak të vdekjes së tij të parakohshme, dhe për këtë arsye dëshmia e tij duhet të konfirmohet që të mund të mbështesë një dënim.<sup>252</sup> Në këto rrethana dhe duke patur parasysh vlerën e kufizuar konfirmuese të dëshmisë së Dëshmitares 61, Dhoma e Apelit nuk mendon që i vetmi përfundim i arsyeshëm që mund të nxirrej nga provat ishte se Idriz Balaj kreu apo planifikoi trajtimin mizor të Dëshmitarit 1.

<sup>251</sup> Përgjigje e Balajt, para. 145-146. Balaj gjithashtu u akuzua për kryerjen e Pikave 36 dhe 37 përmes ndërmarrjes së përbashkët kriminale, por Dhoma Gjyqësore konkludoi se Prokuroria nuk e kishte provuar ekzistencën e një ndërmarrjeje të tillë. Aktgjykim, para. 475-478, 503; TA. 102 (Seancë Publike).

<sup>252</sup> Jurisprudenca e Tribunalit parashih dhe mbrojtjen e një të akuzuari gjatë një procesi gjyqësor ku dëshmitë pranohen pa iu nënshtuar pyetjeve nga pala kundërshtarë. Dhoma e Apelit në *Prokurori k. Galiqit* gjykoj se pranimi si provë i deklaratave me shkrim të dëshmitarëve në vend të dëshmisë gojore, nuk paraqet shkelje të Nenit 21(4)(e) të Statutit, dhe në mbështetje të kësaj citon praktikën gjyqësore përkatëse të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. *Prokurori k. Stanislav Galiqit*, Lënda Nr. IT-98-29-AR73.2, Vendim mbi Apelin e Ndërkohshëm lidhur me Rregullën 92bis(C), 7 qershor 2002, f. 9, sh. 34. Dhoma Gjyqësore në çështjen *Millutinoviqi dhe të tjerë* e shfrytëzoi këtë vendim për të mbështetur parimin lidhur me Rregullën 92 quater që pranimi si provë i një deklaratave me shkrim në vend të dëshmisë gojore në raste kur dëshmitari nuk paraqitet për pyetje nga pala kundërshtarë, në vetvete nuk mbështet një dënim, me përjashtim të rasteve kur dëshmia me shkrim konfirmohet edhe nga prova të tjera. *Prokurori k. Millan Millutinoviqit dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-05-87-T, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranim të Dëshmive sipas Rregullës 92 quater, 16 shkurt 2007, para. 13. Së fundi, Dhoma e Apelit e ka shtjelluar këtë parim në lidhje me një intervistë me Prokurorinë të një të akuzuari në një çështje me më shumë të akuzuar, ku i akuzuari nuk dëshmon dhe për këtë arsye nuk është i disponueshëm për pyetjet e të bashkakuzuarve. Dhoma e Apelit gjykoj se në rrethana të tilla dhe në raste kur dëshmia në fjalë është e domosdoshme për verdiktin e fajësisë, duhet të ketë përputhje jo vetëm të provave lidhur me veprimet dhe sjelljen e të akuzuarit por edhe të provave për çdo “element vendimtar” të çështjes së Prokurorisë. *Prokurori k. Jadranko Përliqit dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-74-AR73.6, Vendim mbi Apelet Ndaj Vendimit për Pranimin e Transkriptit të Marrjes në Pyetje të Jadranko Përliqit, 23 nëntor 2007, para. 58-59.

102. Si pasojë, ndonëse Prokuroria provoi se ushtarë të UÇK-së kryen trajtim mizor ndaj Dëshmitarit 1, ajo nuk provoi se Idriz Balaj ishte përgjegjës për këtë trajtimin sipas në kuadrin e formave të përgjegjësisë për të cilat e akuzoi Prokuroria.

103. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit miraton pjesërisht pikën e tretë të apelit të Prokurorisë, ku ajo argumenton se Dhoma Gjyqësore bëri gabim ligjor kur konkludoi se hedhja në pus e Dëshmitarit 1 nga ana e ushtarëve të UÇK-së nuk përbënte trajtim mizor sipas Nenit 3 të Statutit. Dhoma e Apelit hedh poshtë të gjitha aspektet e tjera të pikës së tretë të apelit të Prokurorisë dhe lë në fuqi pafajësinë për Idriz Balajn lidhur me Pikën 37 të Aktakuzës.

## IV. APELI I LAHI BRAHIMAJT

### A. Pretendime për Gabime Lidhur me Besueshmërinë e Dëshmitarit 6 (Pika 1)

104. Dhoma Gjyqësore e shpalli Lahi Brahimajn fajtor për torturim si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës, Pika 28 e Aktakuzës.<sup>253</sup> Ajo konkludoi se Lahi Brahimaj personalisht mori pjesë në trajtimin mizor dhe torturimin e Dëshmitarit 6.<sup>254</sup>

105. Lahi Brahimaj parashtron se, gjatë nxjerrjes së këtij përfundimi, Dhoma Gjyqësore bëri gabime ligjore dhe/ose faktuale kur nuk mori parasysh ose nuk shpjegoi arsyet përkatëse e rrëzimit të aspekteve themelore të vlerësimit të besueshmërisë së Dëshmitarit 6.<sup>255</sup>

106. Fillimisht, Dhoma e Apelit rithekson se apeluesi që pretendon gabim ligjor mbi bazën e mungesës së shpjegimit të arsyetuar, duhet të identifikojë çështjet konkrete, përfundimet faktuale apo argumentet të cilat, sipas apeluesit, Dhoma Gjyqësore nuk i ka shqyrtuar, dhe duhet të shpjegojë se pse ky mosveprim e zhvlerëson vendimin. Dhoma e Apelit vëren se në këtë pikë të apelit, ndonëse Lahi Brahimaj identifikon gabime konkrete që pretendohet t'i ketë bërë Dhoma Gjyqësore, ai nuk ofron shpjegim të hollësishëm se si saktësisht këto gabime të pretenduara zhvlerësojnë Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore. Gjithsesi, Dhoma e Apelit thekson se Lahi Brahimaj jep një informacion të tillë në hyrjen e Dosjes së tij të Apelit. Konkretisht, ai thekson se thelbi i apelit të tij ka të bëjë me dëshmitë e Dëshmitarit 3 dhe 6, si më poshtë:

lirisht mund të thuhet se, po të mos ishin dëshmitë e tyre, ai do ishte shpallur i pafajshëm lidhur me të gjitha pikat e aktakuzës. Për këtë arsye, siç thuhet më poshtë, besueshmëria, përputhshmëria dhe saktësia e këtyre dy dëshmitarëve kërkojnë analizë të hollësishme, dhe para se Dhoma Gjyqësore të bindej jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm lidhur me dëshmitë e tyre, ajo duhej të jepte një mendim të arsyetuar për bazën mbi të cilën mbështeti përfundimin e saj që ata ishin të besueshëm, përputhës dhe të saktë. Dhoma Gjyqësore nuk dha një mendim të tillë të arsyetuar, gjë që përbën thelbin e këtij apeli.<sup>256</sup>

<sup>253</sup> Aktgjykim, para. 504.

<sup>254</sup> Aktgjykim, para. 395.

<sup>255</sup> Njoftim për Apel i Brahimajt, para. 7; Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 21-64; TA. 136-140 (Scancë Publike).

<sup>256</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 5.

Dhoma e Apelit konkludon se këto hollësi, së bashku me shpjegimin prej Lahi Brahimajt të pretendimeve për gabime në pikën 1 të apelit të tij, plotësojnë kushtin e shpjegimit të mënyrës se si gabimet e pretenduara të Dhomës Gjyqësore e bëjnë të pavlefshëm vendimin në fjalë.

#### 1. Pretendimi për shkelje të Rregullës 68 nga ana e Prokurorisë

107. Lahi Brahimaj pohon se, nga fundi i pyetjeve të tij për Dëshmitarin 6, Prokuroria paraqiti përkthimin në anglisht të një dokumenti (“Përkthimi anglisht”) që sugjeronte se Dëshmitari 6 ishte polic ose person i përfshirë drejtpërsëdrejti në veprimtari policore.<sup>257</sup> Lahi Brahimaj më tej parashton se gjatë pyetjeve që vijuan, Dëshmitari 6 “deklaroi se nuk kishte kurrfarë lidhjesh me policinë ose ushtrinë.”<sup>258</sup> Lahi Brahimaj deklaroi se, “sikur Dëshmitari 6 të ishte i përfshirë në veprimtari policore, mbrojtja do të kishte pasur të drejtën të hetonte nëse ai mori pjesë aktivisht në luftime.”<sup>259</sup> Mirëpo për shkak të paraqitjes së vonët të përkthimit anglisht, ai pretendon se u privua prej mundësisë që të bënte pyetje mbi këtë aspekt dhe të vinte në provë besueshmërinë e Dëshmitarit 6 lidhur me këtë pikë.<sup>260</sup> Lahi Brahimaj argumenton se Dhoma Gjyqësore bëri gabim kur nuk mori parasysh dhe/ose nuk paraqiti arsyet për rrëzimin e këtij argumenti paraqitur prej tij dhe Idriz Balajt në Dosjet e tyre Gjyqësore Përfundimtare.<sup>261</sup>

108. Në përgjigjen e saj, Prokuroria pohon se më 31 maj 2007 ajo ia tregoi Lahi Brahimajt dokumentet origjinale në BKS dhe në shqip përpara se të fillonin pyetjet e Mbrojtjes për Dëshmitarin 6.<sup>262</sup> Prokuroria argumenton se paraqitja me vonesë e një dokumenti të vetëm “nuk paraqet shkelje konkrete të nxjerrjes së materialeve”.<sup>263</sup> Prokuroria më tej deklaroi se, prej ditës kur mori përkthimin më 4 qershor 2007 dhe deri në ditën e fundit të procesit gjyqësor, Lahi Brahimaj nuk kërkoi që t’i bënte Dëshmitarit 6

<sup>257</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 25.

<sup>258</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 24.

<sup>259</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 25; TA. 134 (Seancë Publike).

<sup>260</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 25; TA. 135-136 (Seancë Publike).

<sup>261</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para 27-28 (citon Dosjen Përfundimtare Gjyqësore të Brahimajt, para. 16; Dosja Përfundimtare Gjyqësore e Balajt, para. 47).

<sup>262</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 21.

<sup>263</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 21.

pyetje lidhur me përkthimin anglisht<sup>264</sup> dhe se ai nuk tregon çfarë ndikimi do të kishin pasur pyetjet lidhur me përkthimin anglisht, në Aktgjykimin.<sup>265</sup>

109. Në kundërpërgjigjen e tij, Lahi Brahimaj rithekson se Prokuroria e paraqiti përkthimin anglisht pasditen që Dëshmitari 6 filloi dhënien e dëshmisë, se Prokuroria dinte që “çdo provë për bashkëpunimin midis Dëshmitarit 6 dhe policisë serbe kishte rëndësi të madhe për mbrojtjen”, dhe se “nxjerrja’ e dokumentit pa përkthimin përkatës gjatë kohës që ky dëshmitar shumë i rëndësishëm po përgatitej të hynte në sallën e gjyqit për herë të parë, nuk është në përputhje me formulimin ose frymën e Rregullës 68(i).”<sup>266</sup> Lahi Brahimaj gjithashtu pretendon se pyetjet lidhur me përkthimin anglisht ishin të rëndësishme për arsye se “me gjasë do të anonin drejt dyshimit të arsyeshëm në favor të të Akuzuarit.”<sup>267</sup>

110. Dhoma e Apelit thekson se Rregulla 68 e Rregullores detyron Prokurorinë që të publikojë “sa më shpejt që të ketë mundësi” çdo material që “mund të çojë drejt sugjerimit të pafajësisë ose lehtësimit të fajësisë së të akuzuarit, ose mund të ndikojë në besueshmërinë e provave të Prokurorit.”<sup>268</sup> Ky është detyrim i vazhdueshëm që zbatohet sa herë që Prokuroria merr informacione të reja, dhe jo kusht për nxjerrjen e të gjitha materialeve shfajësuese brenda një afati të caktuar gjatë procesit gjyqësor.<sup>269</sup> Në këtë çështje, origjinalet në BKS dhe në shqip të dokumentit në fjalë u bënë publike më 31 maj 2007,<sup>270</sup> kurse përkthimi i tij më 4 qershor 2007.<sup>271</sup> Dhoma e Apelit vëren se Lahi Brahimaj nuk jep asnjë informacion për sa i përket kohës se kur e mori Prokuroria përkthimin anglisht, dhe rrjedhimisht nuk provon që Prokuroria nuk paraqiti dokumentin “sa më shpejt që pati mundësi” në përputhje me detyrimin e saj që buron nga Rregulla 68 e Rregullores.

<sup>264</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 21; TA. 149 (Seancë Publike).

<sup>265</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 22.

<sup>266</sup> Dosja e Përgjigjes së Brahimajt, para. 3.1; TA. 132-134, 157-158 (Seancë Publike).

<sup>267</sup> Dosja e Përgjigjes së Brahimajt, para. 4.

<sup>268</sup> Rregulla 68(i) e Rregullores.

<sup>269</sup> *Shih* Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 270-275 (ku konkludohet se Prokuroria “nuk shfrytëzoi kohë të tepruar për nxjerrjen” e materialeve sipas Rregullës 68 në rrethanat e asaj çështjeje, ku Prokuroria e nxori materialin pas përfundimit të procesit gjyqësor dhe tetë muaj pasi e kishte marrë).

<sup>270</sup> Dosja e Përgjigjes së Brahimajt, para. 3.1.

<sup>271</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 25.

111. Lidhur me argumentin se Lahi Brahimaj u privua prej mundësisë së paraqitjes së disa pyetjeve të caktuara mbi këtë çështje,<sup>272</sup> Dhoma e Apelit vë në dukje pretendimin e Lahi Brahimajt se mbrojtja e tij mbështetej mbi argumentin se Dëshmitari 6 “ishte krijesë e forcave të sigurimit serb gjatë kohës së qëndrimit të tij në Jabllanicë, dhe se ai vazhdonte të ishte krijesë e tyre edhe gjatë kohës që po dëshmonte në Dhomën Gjyqësore.”<sup>273</sup> Dhoma e Apelit vëren se po ta kishte çmuar përkthimin anglisht si të rëndësishëm për pyetjet ndaj Dëshmitarit 6, ai mund t’i kishte kërkuar Dhomës Gjyqësore rithirrjen e Dëshmitarit 6 për këtë qëllim. Dhoma e Apelit thekson se gjatë seancës së 5 qershorit 2007, Dhoma Gjyqësore vuri në dukje gatishmërinë e saj për të marrë parasysht një kërkesë të tillë.<sup>274</sup>

112. Dhoma e Apelit gjithashtu gjykon se Lahi Brahimaj mund ta kishte paraqitur përkthimin anglisht si provë materiale që lidhet me dëshminë e Dëshmitarit 6 apo të kishte kërkuar pranimin e tij si provë dokumentare me lejen e Dhomës Gjyqësore. Mirëpo, nga parashtrimet e Lahi Brahimajt si dhe nga dokumentacioni gjyqësor nuk rezulton që ai ti ketë shqyrtuar këto mundësi. Dhoma e Apelit rithekson se, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme, një palë nuk mund të heshtë lidhur me një çështje gjatë procesit gjyqësor dhe ta ngrejë këtë çështje për herë të parë gjatë apelit.

113. Për më tepër, Dhoma e Apelit vëren se Lahi Brahimaj kishte mundësinë që t’i bënte pyetje Dëshmitarit 6 lidhur me çështje që mund të ishin të rëndësishme për tezën e mbrojtjes së tij se Dëshmitari 6 “ishte krijesë e forcave të sigurimit serb”,<sup>275</sup> si për shembull, nëse ishte “rezervist i policisë”,<sup>276</sup> pse kishte një pistoletë,<sup>277</sup> dhe nëse ishte spiun i Serbisë.<sup>278</sup> Lahi Brahimaj nuk tregoi se si do të ndikonte marrja më herët e përkthimit në pyetjet që do të bënte ai.

114. Bazuar në sa më sipër, Dhoma e Apelit konkludon se Lahi Brahimaj nuk provoi që Prokuroria kreu shkelje të Rregullës 68 të Rregullores, apo që ai u privua prej

<sup>272</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 25.

<sup>273</sup> Dosja e Përgjigjes së Brahimajt, para. 4.

<sup>274</sup> T. 5474-5476 (5 qershor 2007) (Seancë Publike).

<sup>275</sup> Dosja e Përgjigjes së Brahimajt, para. 4.

<sup>276</sup> Dëshmitari 6, T. 5305 (4 qershor 2007) (Seancë Publike).

<sup>277</sup> Dëshmitari 6, T. 5352 (4 qershor 2007) (Seancë Publike).

<sup>278</sup> Dëshmitari 6, T. 5402 (4 qershor 2007) (Seancë Publike).

mundësisë së verifikimit të duhur të Dëshmitarit 6, përse i përket pretendimit për lidhjet e tij me forcat e sigurimit serb.

115. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit e hedh poshtë këtë nënpikë të apelit.

2. Pretendim për pabesueshmërinë e dëshmisë së Dëshmitarit 6 lidhur me kontaktin e tij me Sretë Camoviqin

116. Lahi Brahimaj pretendon se Dhoma Gjyqësore nuk shqyrtoi argumentin e tij se pabesueshmëria e dëshmisë së Dëshmitarit 6 lidhur me marrëdhëniet e tij me shërbimin e sigurimit serb tregoi që Dëshmitari 6 ishte nuk ishte i besueshëm.<sup>279</sup> Konkretisht, ai pretendon që Dëshmitari 6 dëshmoi se disa ditë pas largimit të tij nga Jabllanica, ai kishte takuar në Gjakovë dy policë dhe Sretë Camoviqin, Shefin e shërbimit të sigurimit serb. Lahi Brahimaj pohon se, ndonëse Sretë Camoviqi kishte dijeni se Dëshmitari 6 ishte mbajtur në Jabllanicë, ai nuk e pyeti Dëshmitarin 6 për përjetimet e tij në Jabllanicë apo për ushtarët e UÇK-së ose për të tjerë që pretendohet të ishin mbajtur atje.<sup>280</sup> Lahi Brahimaj argumenton se është pothuajse e pamundur që Shefi i sigurimit shtetëror serb në Gjakovë apo policia serbe, të mos e kenë pyetur Dëshmitarin 6 lidhur me fatin e kolegut të tyre të zhdukur me të cilin Dëshmitari 6 pretendoi të ishte mbajtur atje, në qoftë se kishin dijeni se Dëshmitari 6 sapo kishte dalë nga Jabllanica.<sup>281</sup>

117. Prokuroria përgjigjet se Dhoma Gjyqësore e shqyrtoi si duhej dëshminë e Dëshmitarit 6 në kuadër të komunikimit të tij me Sretë Camoviqin dhe dy policët. Prokuroria gjithashtu vë në dukje se Dhoma Gjyqësore e pyeti Dëshmitarin 6 lidhur me mospërputhjet e pretenduara në dëshminë e tij.<sup>282</sup>

118. Dhoma e Apelit vëren se Dëshmitari 6 dëshmoi se e kishte njohur Sretë Camoviqin me vite të tëra meqë ai kishte qenë “profesor” në shkollën e mesme të atjeshme.<sup>283</sup> Ai dëshmoi se, pas lirimit të tij nga Jabllanica, rastësisht kishte takuar Sretë

<sup>279</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 21, 33-41; TA. 137-138 (Seancë Publike).

<sup>280</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 34.

<sup>281</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 38-39.

<sup>282</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 24.

<sup>283</sup> Dëshmitari 6, T. 5279 (1 qershor 2007) (Seancë Private).

Camoviqin në hotelin Pashtrik kur kishte shkuar aty për të pirë kafe.<sup>284</sup> Dëshmitari 6 shpjegoi që kishte kaluar një gjysmë ore duke pirë kafe me Sretë Camoviqin, por kishte diskutuar me të mbajtjen e tij në Jabllanicë vetëm për rreth dhjetë minuta.<sup>285</sup> Dëshmitari 6 tha:

Më pyeti: si ishte, çfarë përjetove? Dhe unë i thashë që ishte periudhë shumë e keqe, që UÇK-ja ishte e ashpër ndaj meje, i tregova që më keqtrajtuam dhe që më pas ma morën makinën. Dhe pastaj ai më tha, m'i sill fotografitë dhe do të marrësh kopje të dokumenteve.<sup>286</sup>

Dëshmitari 6 dëshmoi se Sretë Camoviqi nuk e kishte pyetur për torturuesit e tij<sup>287</sup> apo për të arrestuarit e tjerë.<sup>288</sup> Dhoma Gjyqësore gjithashtu qartësoi me Dëshmitarin 6 se Sretë Camoviqi nuk e kishte pyetur për personat që kishte parë gjatë kohës së burgimit të tij.<sup>289</sup>

119. Dhoma e Apelit e konsideron spekulim pretendimin e Lahi Brahimajt se nuk ka të ngjarë që Sretë Camoviqi të mos e ketë pyetur Dëshmitarin 6 për përjetimet e tij gjatë burgimit në Jabllanicë dhe për fatin e kolegut të tij të zhdukur. Kjo çështje nuk ishte thelbësore për vlerësimin e besueshmërisë së Dëshmitarit 6 nga ana e Dhomës Gjyqësore dhe ajo nuk kishte nevojë ta shqyrtonte atë. Për këtë arsye Lahi Brahimaj nuk ka provuar që Dhoma Gjyqësore gaboi në vlerësimin që i bëri dëshmisë së Dëshmitarit 6 lidhur me këtë çështje.

120. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit e hedh poshtë këtë nënpikë të apelit.

3. A gaboi Dhoma Gjyqësore kur nuk shqyrtoi konkretisht pretendimin për mosdhënien e një shpjegimi të besueshëm prej Dëshmitarit 6 lidhur me ndryshimin e kushteve të burgimit të tij

121. Lahi Brahimaj pretendon se Dhoma Gjyqësore nuk arsyetoi rrëzimin e argumentit të tij të paraqitur në Dosjen Gjyqësore Përfundimtare se Dëshmitari 6 nuk dha shpjegim

<sup>284</sup> Dëshmitari 6, T. 5301-5303 (4 qershor 2007) (Seancë Publike).

<sup>285</sup> Dëshmitari 6, T. 5304 (4 qershor 2007) (Seancë Publike).

<sup>286</sup> Dëshmitari 6, T. 5304 (4 qershor 2007) (Seancë Publike).

<sup>287</sup> Dëshmitari 6, T. 5305 (4 qershor 2007) (Seancë Publike).

<sup>288</sup> Dëshmitari 6, T. 5309 (4 qershor 2007) (Seancë Publike).

<sup>289</sup> Dëshmitari 6, T. 5308 (4 qershor 2007) (Seancë Publike).

për përmirësimin e kushteve të burgimit të tij.<sup>290</sup> Konkretisht, Lahi Brahimaj tërheq vëmendjen në atë pjesë të dëshmisë së Dëshmitarit 6 se pas keqtrajtimit të tij në Jabllanicë për katër javë me radhë, arrestuesit e tij “papuritmas” e lejuan të shëtiste nëpër lëndinën rreth kazermës dhe të lante enë, dhe se ai kishte mundësia të ikte por vendosi të mos vepronte ashtu.<sup>291</sup> Sipas Lahi Brahimajt, i vetmi shpjegim i besueshëm për këtë ndryshim të pretenduar të rrethanave ishte se Dëshmitari 6 nuk pësoi keqtrajtim të vazhdueshëm për një periudhë të gjatë.<sup>292</sup>

122. Prokuroria përgjigjet se Lahi Brahimaj nuk ka treguar se në çfarë mënyre argumenti se Dëshmitari 6 nuk dha shpjegim për përmirësimin e kushteve të burgimit mund të ndikojë në besueshmërinë e Dëshmitarit 6.<sup>293</sup>

123. Dhoma e Apelit konkludon se argumenti i Lahi Brahimajt lidhur me paaftësinë e Dëshmitarit 6 për të shpjeguar kushtet e burgimit të tij është spekulim. Lahi Brahimaj nuk identifikoi asnjë mospërputhje të vetme në shpjegimin e Dëshmitarit 6 apo ndonjë provë tjetër të administruar që do të kundërshtonte këtë shpjegim. Ai nuk paraqiti as prova të tjera që do të provonin se ky shpjegim ishte i paarsyeshëm. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit gjykon se ishte logjikisht e mundshme që Dhoma Gjyqësore ta pranonte këtë shpjegim.

124. Bazuar në sa më sipër, Dhoma e Apelit e hedh poshtë këtë nënpikë të apelit.

4. A gaboi Dhoma Gjyqësore kur nuk shqyrtoi konkretisht pretendimet për mospërputhje

125. Lahi Brahimaj pretendon se Dhoma Gjyqësore nuk shqyrtoi dhe/ose nuk arsyetoi rrëzimin e shumë argumenteve lidhur me mospërputhjet në dëshminë e Dëshmitarit 6, që ai i paraqiti në Dosjen e tij Gjyqësore Përfundimtare.<sup>294</sup> Së pari, ai deklaroi se dëshmia e Dëshmitarit 6, që e kishin rrahur me shkop bejsbolli deri në humbje të vetëdijes, dhe se e kishin rrahur dhe torturuar rregullisht për katër javë rresht—nuk përputhet me lëndimet e

<sup>290</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 51-54 (citon Dosjen Gjyqësore Përfundimtare të Brahimajt, para. 113-114).

<sup>291</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 52.

<sup>292</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 53.

<sup>293</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 34.

<sup>294</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 48-50, 55-63.

pretenduara.<sup>295</sup> Ai thotë se i vetmi lëndim që u konstatua gjatë ekzaminimit që kreu Doktor Shkëlzen Zajmi ishte një thyerje e kyçit të dorës,<sup>296</sup> dhe se mungesa e lëndimeve të tjera të rënda përveç lëndimit të lartpërmendur hedh dyshim të konsiderueshëm mbi dëshminë e Dëshmitarit 6.<sup>297</sup>

126. Lahi Brahimaj gjithashtu argumenton se Dhoma Gjyqësore nuk shqyrtoi një sërë kundërthëniesh të dukshme në dëshminë e Dëshmitarit 6, disa ndër të cilat ishin si vijon:<sup>298</sup> Dëshmitari 6 dëshmoi se nuk i kishin dhënë asgjë për të ngrënë, dhe më vonë ai tha që i kishin dhënë ujë dhe bukë; ai dëshmoi se nuk mund të dallonte dot natën prej ditës gjatë kohës që u mbajt, mirëpo dalloi kohën kur të arrestuarit e pretenduar u morën nga dhoma; dhe, fillimisht ai tha që kishte parë fotografi të Nazmi Brahimajt dhe Lahi Brahimajt dhe i kishte mësuar emrat e tyre kurse më vonë tha që nuk kishte parë fotografi të tyre. Lahi Brahimaj gjithashtu pohon se Dëshmitari 6 dha një përgjigje “krejtësisht të pabesueshme” kur u pyet lidhur me domethënien e fjalisë “lirimi i tij është me kusht. Nëse gabimi përsëritet, i akuzuari [Dëshmitari 6] do të nxirret në gjyq”, lexohet në një dokument që iu dha atij gjatë lirimimit nga Jabllanica. Së fundi, Lahi Brahimaj pretendon se Dëshmitari 6 dha shpjegime të ndryshme lidhur me identitetin e keqtrajtuesit të katër personave të panjohur, duke thënë fillimisht se nuk e dinte kush ishte i pranishëm kur ndodhi keqtrajtimi dhe se nuk mund t’i përshkruante keqbërësit, dhe më vonë pretendoi se “Nazmiu dhe Hamzai” ishin aty.”<sup>299</sup>

127. Prokuroria përgjigjet se Dhoma Gjyqësore me të drejtë konkludoi se dëshmia e Dëshmitarit 6 lidhur me lëndimet e tij ishte e besueshme, dhe vë në dukje se, përfundimet e saj se rrahjet që pësoi Dëshmitari 6 i shkaktuan atij vuajtje dhe lëndime të rënda fizike, Dhoma Gjyqësore i bazoi mbi dëshmitë e Dëshmitarëve 6 dhe 23, si dhe mbi raportin mjekësor nga ekzaminimi i Dëshmitarit 6.<sup>300</sup> Prokuroria më tej pohon se Dhoma

<sup>295</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 48-50.

<sup>296</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 49.

<sup>297</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 50; TA. 156 (Scancë Publike).

<sup>298</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 21, 55-60 (citon Dosjen Gjyqësore Përfundimtare të Brahimajt, para. 118-122, 155-156). Lahi Brahimaj paraqet argumentet e tij lidhur me pretendimet për mospërputhje të dëshmisë së Dëshmitarit 6 me atë të Dëshmitarit 3 në Pikën 3 të apelit të tij. Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 62. Rrjedhimisht këto pretendime për mospërputhje do të trajtohen në lidhje me Pikën 3 të Apelit të Lahi Brahimajt.

<sup>299</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para 55-60.

<sup>300</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para 30-32; TA. 151-152 (Scancë Publike).

Gjyqësore me të drejtë mori parasysh të gjitha mospërputhjet e brendshme në dëshminë e Dëshmitarit 6 dhe në mënyrë të arsyeshme gjykoi se:

[...] duke qenë se provat e paraqitura në këtë çështje lidhen me ngjarjet që ndodhën në vitin 1998, ajo nuk do t'i konsiderojë si zhvlerësuese për provat, mospërputhjet e vogla midis dëshmive të dëshmitarëve të caktuar në gjyq dhe deklaratave të tyre të mëparshme, kur në fund të fundit dëshmitarët kanë rrëfyer thelbin e ngjarjes së akuzuar në hollësi të pranueshme, pa dobësuar aspektet thelbësore të dëshmisë së tyre.<sup>301</sup>

Sipas Prokurorisë, Lahi Brahimaj nuk ka provuar se pranimi i dëshmisë së Dëshmitarit 6 nga ana e Dhomës Gjyqësore ishte i paarsyeshëm, apo se po të pranohej argumenti i tij, kjo do të ndikonte në dënimin e tij.<sup>302</sup>

128. Dhoma e Apelit rikujton se, sipas Nenit 23(2) të Statutit dhe Rregullës 98 *ter* (C) të Rregullores, Dhoma Gjyqësore kanë detyrim të japin një mendim të arsyetuar me shkrim.<sup>303</sup> Mendimi i arsyetuar garanton të drejtën për apel të të akuzuarit dhe mundësinë që Dhoma e Apelit të kuptojë dhe rishikojë përfundimet e Dhomës Gjyqësore si dhe vlerësimin e saj të provave.<sup>304</sup> Mirëpo një Dhomë Gjyqësore nuk është e detyruar të shqyrtojë çdo argument me hollësi.<sup>305</sup> Dhoma e Apelit rikujton se:

për sa u përket përfundimeve ligjore, ky detyrim nuk kërkon që Dhoma Gjyqësore të diskutojë gjerësisht të gjithë praktikën gjyqësore të Tribunalit Ndërkombëtar lidhur me një çështje të caktuar ligjore, por vetëm të identifikojë precedentët mbi të cilët bazohen përfundimet e saj. Për sa u përket përfundimeve faktuale, një Dhomë Gjyqësore duhet t'i bazojë përfundimet e veta vetëm mbi fakte që janë thelbësore për përcaktimin e fajësisë lidhur me një akuzë të caktuar. Nuk ka nevojë t'u referohet dëshmive të të gjithë dëshmitarëve apo çdo prove të administruar në gjyq. Shkurtimisht, një Dhomë Gjyqësore duhet të përqëndrohet në përcaktimin e qartë, të kuptimtë dhe përmbledhës vetëm të atyre përfundimeve ligjore dhe faktuale nga jurisprudenca e disponueshme lidhur me një çështje dhe moria e fakteve të paraqitura gjatë procesit gjyqësor, mbi të cilat mbështeti vendimin e saj për shpalljen e një individi fajtor ose të pafajshëm.<sup>306</sup>

<sup>301</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 35; TA. 147 (Seancë Publike).

<sup>302</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 35.

<sup>303</sup> Aktgjykimi i Apelit *Naletiliq dhe Martinoviq*, para. 603; Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerë*, para. 23; Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*. Aktgjykimi i Apelit, para. 41; Aktgjykimi i Apelit *Furunxhija*, para. 69.

<sup>304</sup> Aktgjykimi i Apelit *Limaj dhe të tjerë*, para. 81 (citon Aktgjykimin e Apelit *Naletiliq dhe Martinoviq*, para. 603, Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerë*, para. 23; Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 41).

<sup>305</sup> Aktgjykimi i Apelit *Furunxhija*, para. 69 (citon jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*Van de Hurk v. The Netherlands*)).

<sup>306</sup> Aktgjykimi i Apelit *Haxhihasanoviq dhe Kubura*, para. 13 (pa citimet e brendshme).

129. Dhoma e Apelit gjithashtu rikujton se Dhoma Gjyqësore gëzon kompetenca të konsiderueshme kur shqyrton mospërputhje të vogla në dëshminë e një dëshmitari. Megjithatë, këto kompetenca duhet të jenë në pajtim me të drejtën e çdo të akuzuari për një mendim të arsyetuar. Në këtë drejtim, Dhoma e Apelit theksoi:

Merret si e mirëqenë pandehma se Dhoma Gjyqësore ka vlerësuar të gjitha provat e paraqitura, në qoftë se nuk ka ndonjë tregues se Dhoma Gjyqësore ka shpërfillur krejtësisht ndonjë provë të caktuar. Ndonëse rastet kur Dhoma Gjyqësore në arsyetimin e saj nuk ka shqyrtuar ndonjë provë që është qartësisht e rëndësishme për përfundimet mund të jenë shenjë shpërfilljeje, kjo nuk do të thotë që çdo mospërputhje që nuk është diskutuar prej Dhomës Gjyqësore, e bën arsyetimin e saj të mangët. Duke marrë parasysh faktin se mospërputhjet e vogla ndodhin shpesh gjatë dëshmive të dëshmitarëve dhe nuk ndikojnë në besueshmërinë e tyre, është brenda kompetencës së Dhomës Gjyqësore që të vlerësojë dhe të përcaktojë nëse dëshmia në tërësi është e besueshme, pa e shpjeguar në hollësi vendimin e saj. Nëse Dhoma Gjyqësore nuk i është referuar dëshmisë së një dëshmitari, madje edhe sikur ajo të ishte në kundërshtim me përfundimin e saj, duhet supozuar se Dhoma Gjyqësore ka vlerësuar dhe peshuar dëshminë dhe ka konstatuar se ajo nuk e pengoi të arrinte në përfundimin e saj përkatës.<sup>307</sup>

Rrjedhimisht ndonëse një Dhomë Gjyqësore nuk është e detyruar të shpjegojë të gjitha hollësitë e vlerësimit të saj të mospërputhjeve të vogla në dëshmitë e dëshmitarëve, ajo gjithashtu nuk mund t'i shpërfillë krejtësisht të gjitha mospërputhjet.

130. Dhoma e Apelit vëren se Dhoma Gjyqësore në përgjithësi shpjegoi mënyrën dhe kriterin e saj të vlerësimit të dëshmive të dhëna *viva voce*.<sup>308</sup> Dhoma Gjyqësore shpjegoi se ajo (a) vlerësoi përputhshmërinë e brendshme të dëshmisë të secilit dëshmitar dhe nëse kishte dëshmi mbështetëse; (b) nuk i konsideroi si zhvlerësuese për provat, mospërputhjet e vogla midis dëshmive të dëshmitarëve, kur në fund të fundit dëshmitarët kishin rrëfyer thelbin e ngjarjes së akuzuar në hollësi të pranueshme; dhe (c) pranoi disa pjesë të caktuara të dëshmive të dëshmitarëve dhe hodhi poshtë disa të tjera.<sup>309</sup>

131. Dhoma e Apelit më tej vëren se, lidhur me pretendimin për trajtim mizor dhe torturim të Dëshmitarit 6 sipas Pikës 28 të Aktakuzës, Dhoma Gjyqësore bëri përmbledhje të dëshmisë së Dëshmitarit 6. Ajo vuri në dukje se, më 13 qershor 1998 ose rreth kësaj date, në një oborr me ndërtesa në Jabllanicë, ushtarë të UÇK-së rrahën egërsisht Dëshmitarin 6, dhe se pothuajse për katër javë rresht, Dëshmitari 6 u mbajt në

<sup>307</sup> Aktgjykim i Apelit *Kvoçka dhe të tjerë*, para. 23 (pa citimet e brendshme).

<sup>308</sup> Aktgjykim, para. 13.

<sup>309</sup> Aktgjykim, para. 13 (pa citimet e brendshme).

një dhomë të oborrit dhe u rrah rregullisht nga ushtarë të UÇK-së. Dhoma Gjyqësore gjithashtu vuri re se Dëshmitari 6 ishte në gjendje të rëndë fizike dhe kishte pasoja të përhershme fizike nga rrahjet.<sup>310</sup> Dhoma Gjyqësore më pas konkludoi se e konsideronte Dëshmitarin 6 të besueshëm, se ishte bindur që rrahjet i shkaktuan atij vuajtje dhe lëndime të rënda fizike, se rrahësit kishin për qëllim t'i shkaktonin vuajtje dhe lëndime, dhe se për këto arsye ushtarët e UÇK-së ishin përgjegjës për trajtimin mizor të Dëshmitarit 6.<sup>311</sup> Dhoma Gjyqësore arriti në përfundimin se ushtarë të UÇK-së e keqtrajtuan Dëshmitarin 6 për ta ndëshkuar për bashkëpunim të pretenduar me serbët, si dhe për ta diskriminuar për arsye politike.<sup>312</sup> Rrjedhimisht, Dhoma Gjyqësore konkludoi se ushtarët e UÇK-së e torturuan Dëshmitarin 6.<sup>313</sup>

132. Dhoma Gjyqësore konkludoi se Lahi Brahimaj mori pjesë në keqtrajtimin e Dëshmitarit 6. Në nxjerrjen e këtij përfundimi, ajo mori parasysh dëshminë e Dëshmitarit 6 se, mes të tjerash, Lahi Brahimaj ishte shpeshherë i pranishëm gjatë rrahjeve, ishte ndër ata që e akuzonin Dëshmitarin 6 se kishte lidhje me serbët, se ai dëgjoi se të tjerët i drejttoheshin me emrin “Lahi” apo “Magjup”, dhe se kishte dëgjuar nga Gani Brahimaj se “Magjup” ishte nofka e Lahi Brahimajt. Për më tepër, Dhoma Gjyqësore arriti në përfundimin se Dëshmitari 6 e pa shpesh Lahi Brahimajn afërsisht gjatë katër javëve që e rrahën, dhe theksoi se më pas ai e njohu Lahi Brahimajn midis një grupi fotografish në fotomontazh. Rrjedhimisht, Dhoma Gjyqësore konkludoi se “është e bindur jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se Lahi Brahimaj mori pjesë personalisht në trajtimin mizor dhe torturimin e Dëshmitarit 6, dhe se ai duhet të shpallet fajtor për kryerjen e këtyre krimeve.”<sup>314</sup>

133. Përveç dëshmisë së Dëshmitarit 6, Dhoma Gjyqësore gjithashtu mori parasysh edhe dëshminë e Pekka Haverinen-it,<sup>315</sup> Dëshmitarit 23,<sup>316</sup> Dëshmitarit 16,<sup>317</sup> dhe

<sup>310</sup> Aktgjykim, para. 391; *shih gjithashtu* Aktgjykim, para. 381-384, 392, 395.

<sup>311</sup> Aktgjykim, para. 391.

<sup>312</sup> Aktgjykim, para. 392.

<sup>313</sup> Aktgjykim, para. 392.

<sup>314</sup> Aktgjykim, para. 395.

<sup>315</sup> Aktgjykim, para. 386.

<sup>316</sup> Aktgjykim, para. 387.

<sup>317</sup> Aktgjykim, para. 388.

Dëshmitarit 7.<sup>318</sup> Dëshmitë e këtyre dëshmitarëve konfirmuan se Dëshmitari 6 u mbajt nga UÇK-ja, se ai pësoi lëndime si pasojë e rrahjeve, dhe se ai e njohu Lahi Brahimajn në një fotomontazh që iu tregua gjatë intervistës me një hetues të Prokurorisë. Mirëpo asnjë nga këta dëshmitarë nuk e konfirmoi identifikimin që Dëshmitari 6 i bëri Lahi Brahimajt si njëri nga ata që e rrahën dhe e akuzuan se ishte spiun i serbëve. Si pasojë Dhoma Gjyqësore u mbështet vetëm në dëshminë identifikuese të Dëshmitarit 6 kur shpalli Lahi Brahimajn fajtor për Pikën 28 të Aktakuzës.

134. Dhoma e Apelit vëren se Dhoma Gjyqësore konkludoi se Dëshmitari 6 ishte i besueshëm pa i dhënë arsyet për këtë përfundim dhe pa i shqyrtuar pretendimet e mospërputhjeve në dëshminë e tij. Dhoma e Apelit pranon se Dhoma Gjyqësore nuk ka detyrim të shqyrtojë çdo mospërputhje të vogël në deklaratën e një dëshmitari; mirëpo, ajo gjithsesi duhet t'i shqyrtojë mospërputhjet e pretenduara në raste si ky, kur dëshmia e dëshmitarit në fjalë është dëshmia kryesore mbi të cilën Dhoma Gjyqësore bazohet në vendimin e saj për të shpallur fajtor të Akuzuarin. Dhoma e Apelit konkludon se ky gabim shkeli të drejtën e Lahi Brahimajt për mendim të arsyetuar dhe përbën gabim ligjor. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit do të shqyrtojë argumentet e Lahi Brahimajt të paraqitura në këtë nënpikë të apelit për të përcaktuar nëse një Dhomë Gjyqësore e arsyeshme do të arrinte në përfundim se Dëshmitari 6 ishte i besueshëm me gjithë mospërputhjet e pretenduara në dëshminë e tij.<sup>319</sup>

135. Lidhur me pretendimin e Lahi Brahimajt se lëndimet e Dëshmitarit 6 nuk përputhen me keqtrajtimin që iu bë,<sup>320</sup> meqenëse i vetmi lëndim që përmendet në raportin mjekësor të Dr. Shkëlzen Zajmit ishte një thyerje e kyçit të dorës së majtë,<sup>321</sup> Dhoma e Apelit vëren se i vetmi raport mjekësor nga Dr. Shkëlzen Zajmi në dokumentacionin gjyqësor është Prova P336. Ky raport përmban fjalët “Shërbimi Radiografik” dhe thotë, “rekomandim për ekzaminim [...] radiografi të rrugëve urinare dhe parakrahut të majtë”, që do të thotë se u ekzaminuan vetëm parakrahu i majtë dhe rrugët urinare të Dëshmitarit 6. Ky raport nuk pasqyron rezultatet e një ekzaminimi të gjerë mjekësor të Dëshmitarit 6,

<sup>318</sup> Aktgjykim, para. 389-390.

<sup>319</sup> *Shih* Aktgjykim i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 385-388.

<sup>320</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 48-50.

<sup>321</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 49.

dhe për këtë arsye nuk ndikon në peshën provuese të dëshmisë së Dëshmitarit 6 lidhur me lëndimet e tjera të tij, si dhe lidhur me rrahjet që i shkaktuan ato. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit nuk mendon se raporti mjekësor nuk përputhet me rrëfimin e Dëshmitarit 6 për rrahjet dhe lëndimet e tij dhe konkludon se raporti nuk ndikon mbi besueshmërinë e Dëshmitarit 6.

136. Për sa i përket përgjigjes së Dëshmitarit 6 në pyetjen se çfarë domethënie kishte fjalia “lirimi i tij është me kusht. Nëse gabimi përsëritet, i akuzuari do të nxirret në gjyq”, e cila paraqitet në dokumentin që iu dha gjatë lirimit të tij, Dhoma e Apelit vëren se Dëshmitari 6 u përgjigj se në dokument thuhej se ai nuk duhej të shkonte në Gjakovë për arsye personale.<sup>322</sup> Dhoma e Apelit e konsideron spekulim pohimin e Lahi Brahimajt se kjo deklaratë është e pabesueshme. Lahi Brahimaj nuk vë në dukje asnjë mospërputhje midis kësaj deklarate dhe ndonjë deklarate tjetër dhënë gjatë dëshmisë së Dëshmitarit 6. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit gjykon se ajo nuk ndikon në besueshmërinë e Dëshmitarit 6.

137. Lidhur me pretendimin se Dëshmitari 6 fillimisht deklaroi se kishte parë fotografi të Nazmi Brahimajt dhe Lahi Brahimajt dhe se kishte mësuar emrat e tyre, dhe më pas mohoi që kishte parë fotografitë e tyre,<sup>323</sup> Dhoma e Apelit vëren se Dëshmitari 6 dëshmoi që gjatë burgimit të tij katërjavësh, ai nuk ia dinte emrin askujt, por i kishte parë Nazmi Brahimajn dhe Lahi Brahimajn çdo ditë.<sup>324</sup> Dhoma e Apelit gjykon se nuk ka mospërputhje në dëshminë e Dëshmitarit 6 lidhur me këtë çështje. Dëshmitari 6 fillimisht deklaroi që kishte parë fotografi të Lahi dhe Nazmi Brahimajt dhe më pas menjëherë korrigjoi veten duke thënë që kishte parë fytyrat e tyre.<sup>325</sup> Më tej dëshmia e tij përputhej me faktin që nuk kishte parë fotografi të tyre, por i kishte parë personalisht.<sup>326</sup>

138. Lidhur me pretendimin e Lahi Brahimajt për mospërputhje në dëshminë e Dëshmitarit 6 nëse Nazmiu dhe Hamzai ishin të pranishëm gjatë rrahjes së katër të

<sup>322</sup> Dëshmitari 6, T. 5255 (1 qershor 2007) (Seancë Private).

<sup>323</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 57.

<sup>324</sup> Dëshmitari 6, T. 5295 (4 qershor 2007) (Seancë Publike).

<sup>325</sup> Dëshmitari 6, T. 5295 (4 qershor 2007) (Seancë Publike).

<sup>326</sup> Dëshmitari 6, T. 5296 (4 qershor 2007) (Seancë Publike) (ku thotë se “për ato dy javë kisha liri më të madhe, pastaj pashë fytyrat e tyre [...]” dhe “Nuk më treguan fotografi të tyre; Ata i pashë vetë”); Dëshmitari 6, T. 5297 (4 qershor 2007) (Seancë Publike) (ku thotë se “Nuk pashë fotografi të tyre. I shikoja fytyrat e tyre çdo ditë [...]).

burgosurve të panjohur, Dhoma e Apelit gjykon se dëshmia e Dëshmitarit 6 lidhur me këtë çështje është jopërcaktuese. Dhoma e Apelit vëren se gjatë seancës së pyetjeve nga Prokuroria, Dëshmitari 6 dëshmoi për të parën herë se në të njëjtën dhomë me të, ishin edhe katër të burgosur të tjerë për tri ditë, dhe se gjatë kësaj periudhe ata u rrahën me shkopinj bejsbolli dhe u goditën me thika nëpër gjithë trupin. Kur u pyet se, “Gjatë kohës që ata ishin në dhomë, a pe ndonjë person tjetër nga ata që përmende, Lahi Brahimajn dhe Hamanë?”, Dëshmitari 6 u përgjigj, “Nazmiu dhe Hamzai ishin aty.”<sup>327</sup> Nga kjo dëshmi, është e paqartë nëse Dëshmitari 6 donte të thoshte se Nazmiu dhe Hamzai ishin në dhomë gjatë kohës që po rriheshin katër të burgosurit, apo nëse ata erdhën në dhomë në një moment gjatë kohës që këta të burgosur ishin aty. Dhoma e Apelit vëren se më pas, kur u pyet nga Mbrojtja se kush ishte i pranishëm gjatë kohës që po rriheshin katër të burgosurit, Dëshmitari 6 u përgjigj: “Nuk i njihja.”<sup>328</sup> Dhoma e Apelit gjykon se, duke marrë parasysh paqartësinë në deklaratën e parë të Dëshmitarit 6, nuk mund të konkludohet se këto dy deklaratat kanë mospërputhje, dhe për këtë arsye, deklaratat nuk çenojnë besueshmërinë e Dëshmitarit 6.

139. Dhoma e Apelit gjykon se mospërputhjet e tjera të pretenduara në dëshminë e Dëshmitarit 6 lidhur me kohën gjatë ditës, dhe nëse dëshmitarit iu dha ushqim, janë të vogla dhe nuk ndikojnë mbi besueshmërinë e dëshmisë së tij në tërësi.<sup>329</sup> Në këtë drejtim, Dhoma e Apelit rikujton se mospërputhjet e vogla nuk e bëjnë dëshminë e një dëshmitari të pabesueshme dhe Dhomat Gjyqësore gëzojnë kompetencë për vlerësimin dhe për të gjykuar nëse dëshmia në tërësi është e besueshme.<sup>330</sup>

140. Si pasojë Dhoma e Apelit konkludon se, mbi bazën e provave të administruara, një Dhomë Gjyqësore e arsyeshme do të mund të përfundonte se mospërputhjet në dëshminë e Dëshmitarit 6 nuk ndikuan në besueshmërinë e tij.

141. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit e hedh poshtë këtë nënpikë të apelit.

<sup>327</sup> Dëshmitari 6, T. 5228 (1 qershor 2007) (Seancë Publike).

<sup>328</sup> Dëshmitari 6, T. 5330 (4 qershor 2007) (Seancë Publike).

<sup>329</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 56.

<sup>330</sup> Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerë*, para. 23 (citon Aktgjykimin e Apelit *Çelebiqi*, para. 481, 498; Aktgjykimi i Apelit *Kupreshiq dhe të tjerë*, para. 32).

5. A gaboi Dhoma Gjyqësore kur nuk shqyrtoi konkretisht motivin

142. Lahi Brahimaj pretendon se Dhoma Gjyqësore nuk e trajtoi dhe/ose shpjegoi arsyen për rrëzimin e argumentit të tij se Dëshmitari 6 kishte “motive për të dhënë dëshmi armiqësore” kundër tij.<sup>331</sup> Ai pohon se këto motive burojnë nga armiqësia midis Dëshmitarit 6 dhe familjes Brahimaj, armiqësia e Dëshmitarit 6 ndaj UÇK-së, dhe dëshira e tij për kompensim në pará për makinën e tij konfiskuar prej ushtarëve të UÇK-së.<sup>332</sup> Lahi Brahimaj shpjegon se, kur Nazmi Brahimaj i dha Dëshmitarit 6 vërtetimet për konfiskimin e makinës, armës, letërnjoftimit, patentës së shoferit dhe kuletës kur u lirua nga Jabllanica, Dëshmitari 6 e kërcënoi Nazmi Brahimajn duke i thënë se “do të derdhet gjak për makinën.”<sup>333</sup> Ai gjithashtu vëren se Dëshmitari 6 pyeti Dhomën Gjyqësore se ku mund të kërkonte zhdëmtim për humbjen e makinës së tij.<sup>334</sup>

143. Prokuroria përgjigjet se Dhoma Gjyqësore “shqyrtoi drejt të gjithë faktorët që mund të kishin ndikuar në besueshmërinë e Dëshmitarit 6, përfshirë motivin për të gënjyer, siç pretendon Brahimaj.”<sup>335</sup> Ajo argumenton se Lahi Brahimaj thjesht përsërit të njëjtin argument që parashtroi gjatë procesit gjyqësor dhe nuk provon se përfundimi i Dhomës Gjyqësore që Dëshmitari 6 ishte i besueshëm, ishte i paarsyeshëm.<sup>336</sup>

144. Dhoma e Apelit merr parasysh dëshminë e Dëshmitarit 6 se pas lirimt të tij nga Jabllanica, ushtarët e UÇK-së mbajtën makinën, armën, letërnjoftimin, patentën e shoferit dhe kuletën e tij.<sup>337</sup> Dëshmitari 6 gjithashtu tha se ishte zemëruar që nuk i ishte kthyer arma dhe makina kur u lirua.<sup>338</sup> Gjithashtu ai tha:

I kërkoja [Nazmiut] që të m’i kthente dokumentet dhe kuletën. Kisha rreth 50 marka gjermane aty. I kërkoja që të ma kthente makinën time dhe dokumentet, dhe kur po

<sup>331</sup> Njoftimi për Apel i Brahimajt, para. 7; *shih gjithashtu* Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 21, 29-32 (citon Dosjen Përfundimtare Gjyqësore të Brahimajt, para. 87-91).

<sup>332</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 29-31.

<sup>333</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 30; TA. 140 (Seancë Publike).

<sup>334</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 32.

<sup>335</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 23 (pa citimet e brendshme); *shih gjithashtu* TA. 146-147 (Seancë Publike).

<sup>336</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 23.

<sup>337</sup> Dëshmitari 6, T. 5254-5255 (1 qershor 2007) (Seancë Private), T. 5379-5380 (4 qershor 2007) (Seancë Publike).

<sup>338</sup> Dëshmitari 6, T. 5378-5379 (4 qershor 2007) (Seancë Publike).

largohesha i thashë që do të derdhej gjak për makinën. Dhe ai më tha, “Shko në shtëpi. Merri këto letra dhe shko në shtëpi.”<sup>339</sup>

Më tej, Dëshmitari 6 ngriti edhe çështjen e zhdëmtimit për makinën kur tha:

Kam një pyetje. Për torturat që pësova, për makinën që ma vodhën, çfarë duhet të bëj që të dëmshtëpërblehem për atë që pësova gjatë luftës? Duhet tu drejtohem juve ose diku tjetër?<sup>340</sup>

Dëshmitari 6 gjithashtu dëshmoi se ushtarë të UÇK-së kishin shkaktuar vdekjen e djalit të vëllait meqë nuk kishte kush ta çonte atë në spital gjatë kohës që Dëshmitari 6 mbahej i arrestuar.<sup>341</sup> Dëshmitari më tej i quajti ushtarët e UÇK-së që e rrahën atë “ushtarë që hiqen si luftëtarë”;<sup>342</sup> dhe, kur u pyet nëse fshati i tij mbështeste UÇK-në, ai u përgjigj se “askush nga fshati nuk u mobilizua. Ndoshta ndonjë nga kapadainjtë po [...]”, që Lahi Brahimaj e interpreton si tregues të armiqësisë së Dëshmitarit 6 ndaj UÇK-së.<sup>343</sup>

145. Dhoma e Apelit rikujton se një Dhomë Gjyqësore mund të marrë vendim për dënim “mbi bazë të një dëshmitari të vetëm, ndonëse një dëshmi e tillë duhet të vlerësohet me kujdes të madh, dhe të bëhet kujdes për t’u ruajtur nga ushtrimi i një motivi të nënkuptuar të dëshmitarit.”<sup>344</sup> Dhoma e Apelit më tej rikujton se “një Dhomë Gjyqësore së paku duhet të shpjegojë në pika të shkurtra pse pranoi dëshmitë e dëshmitarëve që mund të kishin motive apo nxitje për të implikuar të akuzuarin; në këtë mënyrë, një Dhomë Gjyqësore vë në dukje se ka vlerësuar me kujdes dëshminë e tillë.”<sup>345</sup>

146. Në nënpjesën e Aktgjykimit me titull “burimet dhe përdorimi i provave”, Dhoma Gjyqësore përgjithësisht trajtoi çështjen e motiveve të mundshme të dëshmitarëve që dëshmuan gjatë procesit gjyqësor, dhe shpjegoi se “mori parasysh rrethanat individuale të çdo dëshmitari, ndër të cilat [...] nëse dëshmitari mund të kishte një motiv themelor për të dhënë një rrëfim të caktuar të ngjarjeve.”<sup>346</sup> Dhoma Gjyqësore më tej u shpreh:

Në disa raste, vetëm një dëshmitar dëshmoi për një ngjarje për të cilën u akuzuan të Akuzuarit. Dhoma e Apelit vendosi se dëshmia e një dëshmitari të vetëm për një

<sup>339</sup> Dëshmitari 6, T. 5256 (1 qershor 2007) (Seancë Private).

<sup>340</sup> Dëshmitari 6, T. 5403 (4 qershor 2007) (Seancë Publike).

<sup>341</sup> Dëshmitari 6, T. 5255 (1 qershor 2007) (Seancë Private).

<sup>342</sup> Dëshmitari 6, T. 5208 (1 qershor 2007) (Seancë Publike).

<sup>343</sup> Dëshmitari 6, T. 5263 (1 qershor 2007) (Seancë Private); Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 31.

<sup>344</sup> Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 274.

<sup>345</sup> Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 146.

<sup>346</sup> Aktgjykim, para. 13.

çështje faktuale nuk kërkon ligjërisht konfirmim. Në këto raste, Dhoma Gjyqësore tregoi një kujdes të veçantë dhe mori parasysh të gjitha rrethanat me rëndësi për dëshminë e dëshmitarit, përfshirë ndonjë motiv kyç për dëshminë e dëshmitarit dhe faktorë të tjerë të përmendur.<sup>347</sup>

Mirëpo Dhoma Gjyqësore asnjëherë nuk i shqyrtoi konkretisht argumentet e Lahi Brahimajt, të paraqitura në Dosjen e tij Gjyqësore Përfundimtare, lidhur me motivin e mundshëm të Dëshmitarit 6 për ta implikuar Lahi Brahimajn.<sup>348</sup> Përkundrazi, siç u tha më lart, Dhoma Gjyqësore konkludoi se Dëshmitari 6 ishte i besueshëm pa dhënë arsye në mbështetje të këtij konkluzioni.

147. Dhoma e Apelit konkludon se, meqenëse dëshmia e Dëshmitarit 6 ishte vendimtare për shpalljen e Lahi Brahimajt fajtor për këtë Pikë, Dhoma Gjyqësore duhej të kishte shpjeguar arsyen konkrete të përfundimit që Dëshmitari 6 ishte i besueshëm megjithëse kishte dëshmi për motiv të mundshëm të tij. Dhoma e Apelit gjykon se duke mos vepruar kështu, Dhoma Gjyqësore shkeli të drejtën e Lahi Brahimajt për mendim të arsyetuar dhe rrjedhimisht kreu gabim ligjor. Si pasojë Dhoma e Apelit do të vlerësojë provat e administruara për të përcaktuar nëse një Dhomë Gjyqësore e arsyeshme do të kishte konkluduar se Dëshmitari 6 ishte i besueshëm pavarësisht dëshmimeve për ekzistencën e një motivi të mundshëm të tij.<sup>349</sup>

148. Dhoma e Apelit gjykon se dëshmia e Dëshmitarit 6 kishte të bënte kryesisht me të rrahjet që pësoi gjatë kohës që ishte në duart e UÇK-së, fakt i pranuar nga Dhoma Gjyqësore.<sup>350</sup> Për më tepër, dëshminë e Dëshmitarit 6 e konfirmuan edhe dëshmitë e Pekka Haverinen-it,<sup>351</sup> Dëshmitarit 23,<sup>352</sup> Dëshmitarit 16,<sup>353</sup> dhe Dëshmitarit 7.<sup>354</sup> Ndonëse keqtrajtimi i Dëshmitarit 6 mund ta ketë bërë që t'i urrente torturuesit e tij, në provat e administruara në gjyq nuk ka asnjë provë që tregon se një urrejtje e tillë e shtyu Dëshmitarin 6 të implikonte Lahi Brahimajn në mënyrë të rreme. Për më tepër, gjatë dëshmisë së tij, Dëshmitari 6 nuk u përpoq ta fshihte urrejtjen që kishte; e pranoi me

<sup>347</sup> Aktgjykim, para. 14 (pa citimet e brendshme).

<sup>348</sup> Dosja Përfundimtare Gjyqësore e Brahimajt, para. 87-91.

<sup>349</sup> *Shih* Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 385-388.

<sup>350</sup> Aktgjykim, para. 391.

<sup>351</sup> Aktgjykim, para. 386.

<sup>352</sup> Aktgjykim, para. 387.

<sup>353</sup> Aktgjykim, para. 388.

<sup>354</sup> Aktgjykim, para. 389-390.

çiltërsi se ishte zemëruar kur nuk ia kishin kthyer makinën dhe armën kur e liruan, e informoi Dhomën Gjyqësore për deklaratën e tij se do të derdhej gjak për makinën, dhe e informoi Dhomën Gjyqësore se mendonte se ushtarë të UÇK-së ishin shkaktarë për vdekjen e nipit të tij. Në këtë kontekst, Dhoma e Apelit nuk është bindur se Dëshmitari 6 po përpiqej ta implikonte në mënyrë të rreme Lahi Brahimajn. Duke pasur parasysh provat e administruara, Dhoma e Apelit konkludon se, pavarësisht provave të kësaj natyre, një Dhome Gjyqësore e arsyeshme do të arrinte në përfundimin se Dëshmitari 6 ishte i besueshëm.

149. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit hedh poshtë këtë nënpikë të apelit.

#### 6. Pretendime për gabime lidhur me identifikimin

150. Lahi Brahimaj pretendon se kishte “mangësi të shumta” në identifikimin që bëri Dëshmitari 6, të cilat ai i përmend në Dosjen e tij Gjyqësore Përfundimtare, dhe pretendon se Dhoma Gjyqësore nuk i mori parasysh kur vlerësoi besueshmërinë dhe saktësinë e dëshmisë së Dëshmitarit 6.<sup>355</sup> Ai argumenton se Dëshmitari 6 nuk e dinte as emrin e Lahi Brahimajt dhe as emrat e Nazmi Brahimaj apo “Hamzës”, dhe se i mësoi vetëm pas lirimit të tij.<sup>356</sup> Ai gjithashtu argumenton se Dëshmitari 6 nuk ishte në gjendje t’i identifikonte komandantët ose të thoshte nëse Lahi Brahimaj ishte komandant.<sup>357</sup> Ai pretendon se Dëshmitari 6 nuk ishte në gjendje t’i identifikonte personat për të cilët pretendohet se u mbajtën gjatë të njëjtës periudhë me të,<sup>358</sup> dhe as “Hamzë Brahimajn”, i cili, sipas dëshmitarit, ishte përgjegjës për rrahjet.<sup>359</sup> Lahi Brahimaj argumenton se në Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore nuk ka asnjë dëshmi se këto mangësi u morën parasysh gjatë vlerësimit të besueshmërisë dhe saktësisë së dëshmisë së Dëshmitarit 6.<sup>360</sup>

<sup>355</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 42 (citon Dosjen Gjyqësore Përfundimtare të Brahimajt, para. 101-107, 149-154), 23-47.

<sup>356</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 43.

<sup>357</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 43.

<sup>358</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 44-45.

<sup>359</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 46.

<sup>360</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 47.

151. Prokuroria përgjigjet se në Aktgjykimin e saj, Dhoma Gjyqësore e shqyrtoi drejt çështjen e identifikimeve.<sup>361</sup> Ajo argumenton se Dëshmitari 6 identifikoi saktë Lahi Brahimajn dhe vëllain e tij Nazmi Brahimajn,<sup>362</sup> dhe se gjatë procesit gjyqësor, Lahi Brahimaj nuk e kundërshtoi këtë pikë.<sup>363</sup> Së fundi, Prokuroria argumenton se Lahi Brahimaj nuk tregon se si lidhen pretendimet për “identifikime të tjera të dështuara” me besueshmërinë e Dëshmitarit 6 apo se si ato ndikuan në shpalljen e tij fajtor.<sup>364</sup>

152. Dhoma e Apelit rikujton se në raste të çështjeve të ndërlikuara, si për shembull vlerësimi i provave identifikuese, plotësimi i kushtit të mendimit të arsyetuar nga Dhoma Gjyqësore është më i vështirë.<sup>365</sup> Dhoma e Apelit ka konkluduar se, “kur fajësia shpallet mbi bazë të dëshmisë identifikuese të një dëshmitari në rrethana të vështira, Dhoma Gjyqësore duhet të zbatojë përpikmërisht detyrimin e saj për ‘mendim të arsyetuar’.”<sup>366</sup> Në raste të tilla, nga Dhoma Gjyqësore kërkohet që të “shpjegojë qartësisht faktorët mbi të cilët është mbështetur për identifikimin e të akuzuarit dhe të shqyrtojë si duhet çdo faktor të rëndësishëm që ndikon negativisht në besueshmërinë e dëshmimeve identifikuese.”<sup>367</sup> Dhoma e Apelit vëren se në raste:

kur dokumentacioni gjyqësor dhe arsyet e vendimit gjyqësor tregojnë mungesë të vlerësimit të provave të rëndësishme, dhe sidomos shpërfillje të plotë të këtyre provave, atëherë i takon trupit gjykues shqyrtues që të ndërhyjë.<sup>368</sup>

153. Në këtë çështje, provat lidhur me identifikimin e Lahi Brahimajt nga Dëshmitari 6 tregojnë se identifikimi u bë në rrethana të vështira. Në këtë drejtim, Dhoma e Apelit thekson ndriçimin e paktë në dhomë<sup>369</sup> si dhe dëshminë e Dëshmitarit 6 se atë e rrahu jo vetëm Lahi Brahimaj por edhe disa ushtarë të tjerë, dhe se ishte i sëmurë dhe shpeshherë

<sup>361</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 28 (citon Aktgjykimin, para. 29-31); TA. 149-150 (Seancë Publike).

<sup>362</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 28 (citon Dëshmitarin 6, T. 5371-5373 (4 qershor 2007) (Seancë Publike dhe Private) dhe Aktgjykimin, para. 382, sh. 1915-1916; para. 385-386, 395).

<sup>363</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 28 (citon Dëshmitarin 6, T. 5371-5372 (4 qershor 2007) (Seancë Publike dhe Private)).

<sup>364</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 29.

<sup>365</sup> Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerë*, para. 24.

<sup>366</sup> Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerë*, para. 39.

<sup>367</sup> Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerë*, para. 39.

<sup>368</sup> Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerë*, para. 39, citon *Harper v. The Queen*, [1982], [1982] 1 S.C.R. 2, f. 14.

<sup>369</sup> Dëshmitari 6, T. 5325-5326, 5401 (4 qershor 2007) (Seancë Publike).

pa vetëdije.<sup>370</sup> Për më tepër, për shpalljen e fajësisë së Lahi Brahimajt, Dhoma Gjyqësore u mbështet vetëm në dëshminë identifikuese të Dëshmitarit 6.<sup>371</sup> Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore duhej të kishte qenë veçanërisht e përpiktë në zbatimin e detyrimit të saj për të dhënë mendim të arsyetuar.<sup>372</sup>

154. Dhoma e Apelit vëren se në nënpjesën e Aktgjykimit me titull “Burimet dhe përdorimi i provave”, Dhoma Gjyqësore diskutoi kriteret që zbatoi gjatë vlerësimit të provave identifikuese në përgjithësi, përfshirë “provat e identifikimit *stricto sensu* dhe provat e njohjes”.<sup>373</sup> Mirëpo në Aktgjykim, Dhoma Gjyqësore nuk ofroi arsyetim konkret në lidhje me besueshmërinë e dëshmisë identifikuese së Dëshmitarit 6. Siç u përmend më parë, Dhoma Gjyqësore pa dhënë arsye, konkludoi se dëshmia e Dëshmitarit 6 ishte e besueshme, përfshirë dhe dëshminë e tij identifikuese. Duke qenë se Dhoma Gjyqësore nuk zbatoi detyrimin e saj, Dhoma e Apelit do të vlerësojë besueshmërinë e identifikimit të Lahi Brahimajt nga Dëshmitari 6 për të përcaktuar nëse një Dhomë Gjyqësore e arsyeshme do të kishte vlerësuar një dëshmi të tillë si të besueshme.<sup>374</sup>

155. Dhoma e Apelit rikujton se Dhoma Gjyqësore duhet t’i marrë parasysh vështirësitë që lidhen me provat e identifikimit në një çështje të veçantë, dhe t’i vlerësojë me kujdes përpara se t’i pranojë si bazë e vetme për fajësinë. Në veçanti, duke pasur parasysh mangësitë e perceptimit njerëzor dhe rrezikun e dështimit të drejtësisë kur një Dhomë Gjyqësore mbështetet mbi dëshmitë e dëshmitarëve madje më vetëbesues që pretendojnë se kanë identifikuar një të akuzuar pa pasur mundësinë e duhur për të verifikuar vëzhgimet e tyre, Dhoma Gjyqësore duhet të jetë shumë e kujdesshme përpara se të shpallë fajësinë e një personi mbi bazë të dëshmisë identifikuese të një dëshmitari të vetëm të bërë në kushte të vështira.<sup>375</sup>

<sup>370</sup> Dëshmitari 6, T. 5326 (4 qershor 2007) (Seancë Publike).

<sup>371</sup> Aktgjykim, para. 395.

<sup>372</sup> Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 274 (citon Aktgjykimin e Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerë*, para. 135).

<sup>373</sup> Aktgjykim, para. 29.

<sup>374</sup> *Shih* Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 385-388.

<sup>375</sup> Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerë*, para. 34. *Shih gjithashtu Prokurori k. Dragolub Kunaracit dhe të tjerëve.*, Lëndët Nr. IT-96-23-T dhe IT-96-23/1-T, Vendim mbi Mocionin për Shpallje të Pafajësisë, 3 korrik 2000, para. 8

156. Për të përcaktuar nëse vendimi i Dhomës Gjyqësore për t'u mbështetur në provat e identifikimit ishte i paarsyeshëm dhe nëse e kjo bën verdiktin e fajësisë të gabuar, Dhoma e Apelit do të shqyrtojë ndër të tjerë këta faktorë të rëndësishëm:

[...] identifikimet e të akuzuarve nga dëshmitarë të cilët kanë mund t'u hedhin vetëm një vështrim të shpejtë apo që nuk kanë mund t'i shohin qartë të akuzuarit; identifikime të bëra në errësirë apo si pasojë e një ngjarjeje tronditëse për dëshmitarin; dëshmi kontradiktore ose të pasakta lidhur me karakteristikat fizike të të akuzuarit gjatë kohës së ngjarjes; identifikim i gabuar ose mohim i aftësisë për identifikim pasuar nga identifikimi i mëvonshëm i të akuzuarit nga dëshmitari; ekzistenca e dëshmiave të papajtueshme; dhe kujtesa e vonshme e dëshmitarit lidhur me të akuzuarin së bashku me "mundësinë e qartë" nga rrethanat që dëshmitari të jetë ndikuar nga të tjerë.<sup>376</sup>

Për më tepër, Dhoma e Apelit rikujton se në provat e identifikimit mund të ndikojë edhe koha që ka kaluar midis momentit të krimit dhe ballafaqimit.<sup>377</sup>

157. Dëshmitari 6 dëshmoi se më 13 qershor 1998,<sup>378</sup> rreth orës 13:00, në rrugën kryesore në afërsi të Volljakës, në komunën e Klinës, atë e ndaluan mbi dhjetë ushtarë të UÇK-së.<sup>379</sup> Sipas dëshmitarit, disa nga këta ushtarë ishin të veshur me rroba civile dhe disa të tjerë me uniforma kamuflazhi, ndonëse askush prej tyre nuk kishte shenja në uniformë.<sup>380</sup> Dëshmitari 6 nuk identifikoi asnjë nga këta ushtarë me emër, dhe nga dëshmia e tij nuk mund të thuhet se Lahi Brahimaj ishte në mesin e tyre. Dëshmitari tha se e çuan në Jabllanicë, në komunën e Gjakovës.<sup>381</sup> Pas mbërritjes së tij atje, para orës 18:00 kur ende kishte dritë, atë e çuan në një dhomë ku disa ushtarë e rrahën njëri pas tjetrit me shkelma dhe me shkopinj bejsbolli dhe sende të tjera.<sup>382</sup> Ai dëshmoi se nuk i kujtohej ta kishte parë Lahi Brahimajn atë natë.<sup>383</sup> Dëshmitari 6 gjithashtu dëshmoi se të nesërmen, më 14 qershor 1998, persona të cilët ai nuk i identifikoi e çuan në një dhomë, në një shtëpi katërdhomëshe, njëkatëshe, me tulla të kuqe, që ndodhej në mes të

<sup>376</sup> Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerë*, para. 40 (pa citimet e brendshme).

<sup>377</sup> Aktgjykimi i Apelit *Limaj dhe të tjerë*, para. 30.

<sup>378</sup> Dëshmitari 6, T. 5168-5170 (31 maj 2007) (Seancë Publike), T. 5293, 5386 (4 qershor 2007) (Seancë Publike); P331 (Hartë në të cilën dëshmitari shënoi udhëtimin e tij) (E Vulosur).

<sup>379</sup> Dëshmitari 6, T. 5171, 5173-5174 (31 maj 2007) (Seancë Publike dhe Private), T. 5190-5191, 5193 (1 qershor 2007) (Seancë Publike), T. 5293-5294 (4 qershor 2007) (Seancë Publike); P331 (Hartë në të cilën dëshmitari shënoi udhëtimin e tij) (E Vulosur).

<sup>380</sup> Dëshmitari 6, T. 5193-5194 (1 qershor 2007) (Seancë Publike).

<sup>381</sup> Dëshmitari 6, T. 5197-5201, 5203 (1 qershor 2007) (Seancë Publike); P331 (Hartë ku dëshmitari ka shënuar udhëtimin e tij) (E vulosur).

<sup>382</sup> Dëshmitari 6, T. 5207-5211, 5214-5215 (1 qershor 2007) (Seancë Publike), T. 5324, 5350-5351 (4 qershor 2007) (Seancë Publike).

<sup>383</sup> Dëshmitari 6, T. 5372 (4 qershor 2007) (Seancë Publike).

oborrit.<sup>384</sup> Ai u mbajt në një dhomë të kësaj shtëpie gjatë gjithë qëndrimit të tij në Jabllanicë.<sup>385</sup> Kjo është dhoma ku sipas dëshmisë së Dëshmitarit 6 Lahi Brahimaj e rrahu atë dhe ishte i pranishëm gjatë kohës që e rrahën të tjerët.

158. Dhoma e Apelit vëren se ndriçimi në dhomë ishte i dobët. Dëshmitari 6 dëshmoi se gjatë kohës që u mbajt dhe u rrah në këtë dhomë, ai nuk ishte në gjendje të dallonte orën ose ditën nga nata.<sup>386</sup> Dëshmitari 6 dëshmoi se dhoma kishte një dritare të mbuluar me dërrasa, kështu që në dhomë depërtonte shumë pak dritë.<sup>387</sup> Dëshmitari 6 gjithashtu dëshmoi se në dhomë nuk kishte llambë dhe për këtë arsye ishin në errësirë.<sup>388</sup>

159. Dhoma e Apelit merr parasysh dëshminë e Dëshmitarit 6 se Hamzë Brahimaj ishte njëri nga personat që e rrahën gjatë mbajtjes së tij në të njëjtën dhomë ku e kishte rrahur Lahi Brahimaj.<sup>389</sup> Ai gjithashtu dëshmoi se gjatë katër javëve të para të mbajtjes gjatë të cilave e rrahën dhe e mbajtën vetëm në dhomën ku kryheshin rrahjet, ai e pa Hamzë Brahimajn thuajse çdo ditë.<sup>390</sup> Gjatë intervistës me hetuesin e Prokurorisë Pekka Haverinen, Dëshmitari 6 bëri identifikim të gabuar të Hamzë Brahimajt.<sup>391</sup> Mirëpo Dhoma e Apelit gjykon se identifikimi i gabuar i Hamzë Brahimajt nga Dëshmitari 6 nuk e bën të pabesueshëm identifikimin e Lahi Brahimajt nga ai.

160. Dhoma e Apelit më tej gjykon se, pavarësisht kushteve të vështira në dhomën ku u kryen rrahjet, provat tregojnë se Dëshmitari 6 mësoi emrin e njërit prej burrave që e rrahën, të cilin e identifikoi si Lahi Brahimaj, gjatë periudhës “një javë e gjysmë”<sup>392</sup> para se të lirohej nga Jabllanica, atëherë kur e lejuan të dilte nga dhoma ku mbahej dhe i kërkuan të ndihmonte Gani Brahimajn në kuzhinë.<sup>393</sup> Dëshmitari 6 dëshmoi se gjatë kohës së mbajtjes së tij, ai dëgjoi vetëm emrat e Lahi Brahimajt, Nazmi Brahimajt dhe

<sup>384</sup> Dëshmitari 6, T. 5204-5205, 5216 (1 qershor 2007) (Seancë Publike), T. 5316, 5324 (4 qershor 2007) (Seancë Publike); P332 (fotografi e oborrit me ndërtesa në Jabllanicë).

<sup>385</sup> Dëshmitari 6, T. 5205, 5213, 5216 (1 qershor 2007) (Seancë Publike), T. 5316-5317, 5325, 5347 (4 qershor 2007) (Seancë Publike).

<sup>386</sup> Dëshmitari 6, T. 5325 (4 qershor 2007) (Seancë Publike).

<sup>387</sup> Dëshmitari 6, T. 5325-5326 (4 qershor 2007) (Seancë Publike).

<sup>388</sup> Dëshmitari 6, T. 5401 (4 qershor 2007) (Seancë Publike).

<sup>389</sup> Dëshmitari 6, T. 5208-5209 (1 qershor 2007) (Seancë Publike).

<sup>390</sup> Dëshmitari 6, T. 5219 (1 qershor 2007) (Seancë Publike).

<sup>391</sup> Haverinen, T. 6344-6345, 6347 (27 qershor 2007) (Seancë Publike).

<sup>392</sup> *Shih* Dëshmitari 6, T. 5386 (4 qershor 2007) (Seancë Publike).

<sup>393</sup> *Shih* Dëshmitari 6, T. 5218, 5244-5245 (1 qershor 2007) (Seancë Publike), T. 5295-5297, 5378 (4 qershor 2007) (Seancë Publike).

Hamzës, dhe se nuk mësoi emra të ushtarëve të tjerë të UÇK-së.<sup>394</sup> Rrjedhimisht Dëshmitari 6 nuk e mësoi emrin e Lahi Brahimajt përpara rrahjeve apo gjatë katër javëve që u rrah, por vetëm pas ndërprerjes së rrahjeve.<sup>395</sup> Dhoma e Apelit vëren se Dhoma Gjyqësore e pyeti Dëshmitarin 6 lidhur me këtë çështje, dhe ai pohoi se gjatë dy javëve të fundit të mbajtjes së tij, Gani Brahimaj i tregoi emrat e disa personave.<sup>396</sup> Dëshmitari 6 gjithashtu dëshmoi se gjatë kësaj periudhe, ai dëgjoji të tjerë duke iu drejtuar Lahi Brahimajt me “Lahi” dhe “Magjup”,<sup>397</sup> dhe se Gani Brahimaj i kishte treguar që “Magjup” ishte nofka e Lahi Brahimajt.<sup>398</sup>

161. Dhoma e Apelit thekson se Lahi Brahimaj nuk e kundërshtoi faktin që Dëshmitari 6 bëri identifikim të saktë të tij kur hetuesi i Prokurorisë Pekka Haverinen i tregoi fotomontazhin që përmbante fotografinë e Lahi Brahimajt.<sup>399</sup> Dhoma Gjyqësore deklaroi se në përgjithësi, ajo ishte e bindur se fotomontazhet u krijuan për të mos ndikuar mbi dëshmitat të cilëve iu treguan, dhe se kjo u arrit nëpërmjet paraqitjes së fotografive me madhësi, ngjyra dhe ndriçim të ngjashëm të sfondit, dhe me individë të cilët u ngjanin të Akuzuarve,<sup>400</sup> megjithëse nuk u ndoqën çdo herë udhëzimet e Prokurorisë për kryerjen e identifikimeve me fotomontazh.<sup>401</sup>

162. Lidhur me argumentin e Lahi Brahimajt se Dëshmitari 6 nuk ishte në gjendje t’i identifikonte komandantët apo të tregonte nëse Lahi Brahimaj ishte komandant, Dhoma e Apelit konkludon se ky argument është jobindës. Dëshmitari 6 e identifikoi Lahi Brahimajn sepse atë e kishte rrahur Lahi Brahimaj vetë, dhe sepse ia kishte mësuar emrin gjatë një jave e gjysmë para lirimit. Nuk është me rëndësi nëse Dëshmitari 6 ishte ose nuk ishte në gjendje të identifikonte Lahi Brahimajn si komandant.

163. Pas vlerësimit të kujdesshëm të provave të identifikimit dhe duke marrë parasysh rrethanat e vështira në të cilat u bë identifikimi, Dhoma e Apelit u bind se një gjykues i

<sup>394</sup> Dëshmitari 6, T. 5226 (1 qershor 2007) (Seancë Publike).

<sup>395</sup> Dëshmitari 6, T. 5378 (4 qershor 2007) (Seancë Publike).

<sup>396</sup> Dëshmitari 6, T. 5378 (4 qershor 2007) (Seancë Publike).

<sup>397</sup> Dëshmitari 6, T. 5245 (1 qershor 2007) (Seancë Publike). Ndonjëherë në transkript thuhet “Magjupi” në vend të “Magjup”. *Shih, p.sh.*, T. 5218 (1 qershor 2007) (Seancë Publike).

<sup>398</sup> Dëshmitari 6, T. 5218-5219 (1 qershor 2007) (Seancë Publike).

<sup>399</sup> Dëshmitari 6, T. 5371 (4 qershor 2007) (Seancë Publike).

<sup>400</sup> Aktgjykim, para. 30.

<sup>401</sup> Aktgjykim, para. 31.

arsyeshëm faktesh do të konkludonte jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se Dëshmitari 6 e identifikoi saktë Lahi Brahimajn si personi që e kishte torturuar atë më parë, kur e pa atë më pas në oborr gjatë një jave e gjysmë para lirimit, gjatë së cilës mësoi emrin Lahi Brahimajt.

164. Rrjedhimisht kjo nënpikë e Apelit hidhet poshtë.

## 7. Përfundim

165. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit hedh poshtë këtë pikë të apelit.

### **B. Pretendime për Gabime lidhur me Torturimin e Dëshmitarit 6 (Pika 2)**

166. Lahi Brahimaj argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se ai e torturoi Dëshmitarin 6 për arsye se donte ta ndëshkonte për bashkëpunimin e pretenduar me serbët dhe ta diskriminonte për arsye politike.<sup>402</sup>

167. Prokuroria përgjigjet se Dhoma Gjyqësore me të drejtë konkludoi se Lahi Brahimaj e torturoi Dëshmitarin 6 për bashkëpunimin e pretenduar me serbët, duke qenë se Dëshmitari 6, për të cilin u konkludua se ishte dëshmitar i besueshëm, dëshmoi se Lahi Brahimaj mori pjesë në torturimin e tij dhe e akuzoi se kishte lidhje dhe spiunonte për serbët.<sup>403</sup> Dhoma e Apelit do t'i shqyrtojë me radhë pretendimet për gabime.

#### 1. Pretendim për gabim lidhur me akuzën se Lahi Brahimaj ka vepruar me synim

168. Lahi Brahimaj argumenton se, në përfundimin se ai duhej dënuar për torturim dhe jo trajtim mizor, Dhoma Gjyqësore gaboi kur e fajësoi për sjelljen e ushtarëve të panjohur të UÇK-së, të një komandanti të panjohur dhe Nazmi Brahimajt, i cili shfaqti qëllimin diskriminues ndaj Dëshmitarit 6 mbi bazën e bashkëpunimit të pretenduar me serbët dhe për arsye politike.<sup>404</sup> Prokuroria përgjigjet se Dëshmitari 6 dëshmoi se Lahi Brahimaj

<sup>402</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 65-74.

<sup>403</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 37-40; TA. 148, 150-151 (Seancë Publike).

<sup>404</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 66-67, 74.1.

mori pjesë në torturimin e tij dhe e akuzoi Dëshmitarin 6 se kishte lidhje me serbët ose ishte spiun i tyre.<sup>405</sup>

169. Dhoma e Apelit rikujton se gjatë seancës së pyetjeve shtesë të Prokurorisë, Dëshmitari 6 dëshmoi se Lahi Brahimaj dhe Nazmi Brahimaj e kishin akuzuar se kishte “ndenjor me serbë” gjatë kohës që ata jepnin e merrnin me serbë gjatë luftës.<sup>406</sup> Kur u pyet se si e kuptonte këtë akuzë, Dëshmitari 6 u përgjigj,

Atë natë kur arritëm aty, ata bënë pyetje të tilla dhe pastaj vazhduan të më torturonin. Dhe pastaj, ata, ushtarët, erdhën dhe më thanë, Ti je spiun i Serbisë. Ata nuk më konsideronin shqiptar, madje as tani nuk më konsiderojnë shqiptar [...] Ata vetëm thanë —ata përpiqeshin në një farë mënyre të talleshin me mua. Dhe unë nuk e di pse.<sup>407</sup>

Dhoma e Apelit gjithashtu vëren faktin se edhe gjatë seancës së pyetjeve kryesore të Prokurorisë edhe gjatë pyetjeve nga Mbrojtja, Dëshmitari 6 dëshmoi se atë e kishte rrahur vetë Lahi Brahimaj.<sup>408</sup>

170. Në bazë të dëshmisë së Dëshmitarit 6 si dhe dëshmive të Dëshmitarëve 7, 16, dhe 23, Dhoma Gjyqësore arriti në përfundimin se ushtarë të UÇK-së e keqtrajtuuan Dëshmitarin 6 për ta ndëshkuar për bashkëpunim të pretenduar me serbët, si dhe për ta diskriminuar për arsye politike, dhe rrjedhimisht konkludoi se ushtarët e UÇK-së torturuan Dëshmitarin 6.<sup>409</sup>

171. Dhoma e Apelit gjykon se, ndonëse provat e paraqitura lidhur me këtë çështje tregojnë se ushtarët e UÇK-së, një komandant i panjohur dhe Nazmi Brahimaj synonin të diskriminonin Dëshmitarin 6 për bashkëpunimin e pretenduar me serbët, ato gjithashtu tregojnë qartë se edhe Lahi Brahimaj kishte një synim të tillë, duke qenë se edhe ai bëri disa nga këto komente. Pra Dhoma Gjyqësore nuk i atribuoi Lahi Brahimajt synimet e të tjerëve në mënyrë të palejueshme. Për më tepër, duke marrë parasysh provat në tërësi, Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore në mënyrë të arsyeshme konkludoi se Lahi Brahimaj kishte synim të diskriminonte Dëshmitarin 6 për bashkëpunimin e

<sup>405</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 38-39.

<sup>406</sup> Dëshmitari 6, T. 5397-5398 (4 qershor 2007) (me theks të veçantë) (Seancë Publike).

<sup>407</sup> Dëshmitari 6, T. 5400 (4 qershor 2007) (Seancë Publike).

<sup>408</sup> Dëshmitari 6, T. 5208-5209, 5219-5220 (1 qershor 2007) (Seancë Publike), T. 5372-5373 (4 qershor 2007) (Seancë Publike).

<sup>409</sup> Aktgjykim, para. 392.

pretenduar me serbët, dhe rrjedhimisht kishte synimin e nevojshëm kriminal për torturimin e Dëshmitarit 6.

172. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit e hedh poshtë këtë argument.

2. Pretendim për gabim lidhur me arsyen për keqtrajtimin e Dëshmitarit 6 (arsye politike)

173. Lahi Brahimaj argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se ai synoi të diskriminonte Dëshmitarin 6 për arsye politike, pa iu referuar ndonjë prove që dëshmonte se ai me të vërtetë kishte një synim të tillë.<sup>410</sup> Lahi Brahimaj pohon se, ndonëse Dhoma Gjyqësore u referohet provave që përbëhen nga deklarata të “Komandant Magjupit”, këto deklarata nuk mund t’i atribuohen atij sepse Dhoma Gjyqësore asnjëherë nuk vërtetoi se ai ishte “Magjupi”.<sup>411</sup> Për më tepër, Lahi Brahimaj argumenton se, përfundimin e saj se Dëshmitari 6 u keqtrajtua për arsye politike, Dhoma Gjyqësore me gjasë e bazoi në faktin se Dëshmitari 6 ishte nga një fshat që nuk e përkrahte UÇK-në, dhe se për këtë arsye vlen të theksohet se tjerë nga fshati i tij nuk u keqtrajtuuan kur vizituan Jabllanicën.<sup>412</sup> Prokuroria përgjigjet se përfundimi i Dhomës Gjyqësore ishte i arsyeshëm dhe bazohet në prova.<sup>413</sup>

174. Dhoma Gjyqësore rikujtoi dëshmitë e Dëshmitarëve 7, 16 dhe 23 lidhur me përpjekjet e një grupi fshatarësh për lirim të Dëshmitarit 6.<sup>414</sup> Gjatë përpjekjeve për lirim të Dëshmitarit 6, “Magjupi” u tha fshatarëve se Dëshmitari 6 ishte dënuar dhe se ai duhej ta vuante dënimin duke qëndruar me UÇK-në. Gjithashtu “Magjupi” e pyeti grupin pse nuk luftonin në vijën e frontit, dhe dikush nga fshatarët i tha se ata kishin pritur që udhëheqësi i tyre në luftë të ishte Rugova. “Magjupi” u përgjigj me zemërim se e konsideronte Rugovën tradhtar dhe përkrahës të autoriteteve serbe.<sup>415</sup> Bazuar në këtë dëshmi dhe prova të tjera, Dhoma Gjyqësore konkludoi se ushtarët e UÇK-së e keqtrajtuuan Dëshmitarin 6 për ta ndëshkuar për bashkëpunim të pretenduar me serbët dhe

<sup>410</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 69, 74.2.

<sup>411</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 69.

<sup>412</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 70, 74.3.2.

<sup>413</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 40.

<sup>414</sup> Aktgjykim, para. 387-390.

<sup>415</sup> Aktgjykim, para. 389.

për ta diskriminuar për arsye politike, dhe rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore arriti në përfundimin se ushtarët e UÇK-së e torturuan Dëshmitarin 6.<sup>416</sup> Më tej Dhoma Gjyqësore konkludoi se Lahi Brahimaj ishte përgjegjës për torturimin e Dëshmitarit 6, siç u diskutua gjerësisht në nënpjesën pararendëse.<sup>417</sup>

175. Dhoma e Apelit rikujton përfundimin e saj më lart se Dhoma Gjyqësore nuk i atribuoi Lahi Brahimajt në mënyrë të palejueshme synimet e të tjerëve për diskriminimin e Dëshmitarit 6 për bashkëpunim të pretenduar me serbët, dhe se në bazë të provave të paraqitura Dhoma Gjyqësore konkludoi në mënyrë të arsyeshme se Lahi Brahimaj kishte këtë synim. Dhoma e Apelit mendon se provat bazuar në të cilat një gjykues i arsyeshëm faktesh mund të arrihte në përfundimin se Lahi Brahimaj synonte të diskriminonte Dëshmitarin 6 për bashkëpunim të pretenduar me serbët, i shërbejnë një gjykuesi të arsyeshëm faktesh edhe për nxjerrjen e përfundimit se Lahi Brahimaj synonte diskriminimin e Dëshmitarit 6 për arsye politike. Ky përfundim vlen edhe sikur deklaratat e “Magjupit” të mos i atribuohen Lahi Brahimajt. Së fundi, argumenti i Lahi Brahimajt se ai nuk e diskriminoi Dëshmitarin 6 bazuar në faktin se persona të tjerë nga fshati i tij nuk u keqtrajtuuan në mënyrë të ngjashme, është spekulim.

176. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit hedh poshtë argumentin e Lahi Brahimajt.

### 3. Pretendim për gabim lidhur me arsyen për keqtrajtimin e Dëshmitarit 6 (bashkëpunim i pretenduar me serbët)

177. Lahi Brahimaj pretendon se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se ai shfaqti synim për ndëshkimin e Dëshmitarit 6 për bashkëpunim të pretenduar me serbët, për arsye se, pavarësisht nga provat që tregojnë se ai dhe disa ushtarë të UÇK-së e akuzuan Dëshmitarin 6 se ishte spiun i Serbisë, “vetë Dëshmitari 6 dëshmoi se ata nuk e mendonin këtë me të vërtetë, por vetëm kishin dashur të talleshin me të.”<sup>418</sup> Prokuroria përgjigjet se përfundimi i Dhomës Gjyqësore ishte i arsyeshëm dhe mbështetet në prova.<sup>419</sup>

<sup>416</sup> Aktgjykim, para. 392.

<sup>417</sup> Aktgjykim, para. 395.

<sup>418</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 74.5; *shih gjithashtu* para. 68.

<sup>419</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 40.

178. Dhoma e Apelit rikujton dëshminë e Dëshmitarit 6 se Lahi Brahimaj dhe Nazmi Brahimaj e akuzuan se rrinte me serbë.<sup>420</sup> Kur u pyet se si e kuptonte këtë akuzë, Dëshmitari 6 u përgjigj se natën kur arriti aty, atë e keqtrajtua ushtarë të cilët i thanë se ishte spiun i Serbisë. Dëshmitari 6 tha se ata nuk e konsideronin si shqiptar dhe se edhe tani ata nuk e konsiderojnë shqiptar. Kur u pyet që ta sqaronte këtë, Dëshmitari 6 tha, “Ata vetëm thanë—ata në një farë mënyre po përpiqeshin të talleshin me mua. Nuk e di pse.”<sup>421</sup> Kjo dëshmi doli në fund të dhënies së dëshmisë prej Dëshmitarit 6, gjatë seancës së pyetjeve shtesë të Prokurorisë, dhe paraqet përpjekjet e fundit të Prokurorisë për të përcaktuar nivelin e dijenisë së Dëshmitarit 6 mbi arsyet e arrestimit dhe torturimit të tij prej UÇK-së. Bazuar në dëshminë e Dëshmitarit 6, që akuza se ai “rrinte me serbë” donte të thoshte se ishte “spiun i Serbisë” dhe se “ata nuk e konsideronin shqiptar”, Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore në mënyrë të arsyeshme konkludoi se Lahi Brahimaj shfaqti synim për ta ndëshkuar Dëshmitarin 6 për bashkëpunim të pretenduar me serbët. Për më tepër, Dhoma e Apelit gjykon se shpjegimi i mëpasëm i Dëshmitarit 6 se torturuesit e tij “në një farë mënyre po përpiqeshin të talleshin me të”, në mënyrë të arsyeshme përputhet me përfundimin se Dëshmitari 6 u keqtrajtua për arsye se konsiderohej si spiun i Serbisë.

179. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit hedh poshtë argumentin e Lahi Brahimajt.

4. Pretendime për gabime të tjera lidhur me arsyen për keqtrajtimin e Dëshmitarit 6

180. Lahi Brahimaj paraqet disa argumente ku pretendon se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se ai synonte keqtrajtimin e Dëshmitarit 6 për lidhjet e tij me serbët, dhe diskriminimin e tij për arsye politike.<sup>422</sup> Prokuroria përgjigjet se përfundimi i Dhomës Gjyqësore ishte i arsyeshëm dhe mbështetet në prova.<sup>423</sup>

181. Lahi Brahimaj argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se ai synonte keqtrajtimin e Dëshmitarit 6 për lidhjet e tij me serbët dhe diskriminimin e tij për arsye politike, për arsye se Dëshmitari 7 deklaroi se nuk e dinte arsyen e rrëmbimit të

<sup>420</sup> Dëshmitari 6, T. 5397-5398 (4 qershor 2007) (me theks të shtuar) (Seancë Publike).

<sup>421</sup> Dëshmitari 6, T. 5400 (4 qershor 2007) (Seancë Publike).

<sup>422</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 65.

<sup>423</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 40.

Dëshmitarit 6.<sup>424</sup> Dhoma e Apelit gjykon se fakti që Dëshmitari 7 dëshmoi se nuk e dinte arsyen e rrëmbimit të Dëshmitarit 6<sup>425</sup> në asnjë mënyrë nuk i bën përfundimet e Dhomës Gjyqësore të paarsyeshme.

182. Lahi Brahimaj argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se ai synonte keqtrajtimin e Dëshmitarit 6 për lidhjet e tij me serbët dhe diskriminimin e tij për arsye politike, për arsye se Dëshmitari 6 dëshmoi se, fillimisht kur e arrestuan, atij i bënë pyetje por pa i shpjeguar pse po e rrihnin.<sup>426</sup> Dhoma e Apelit gjykon se dëshmia e Dëshmitarit 6, se kur e rrahën për herë të parë, askush nuk ia shpjegoi arsyen e arrestimit të tij<sup>427</sup>, përputhet me dëshminë e tij se më vonë torturuesit e akuzuan se kishte lidhje me serbët dhe ishte spiun i tyre.

183. Lahi Brahimaj argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se ai synonte keqtrajtimin e Dëshmitarit 6 për lidhjet e tij me serbët dhe diskriminimin e tij për arsye politike, për arsye se Dëshmitari 6 dëshmoi se asnjëherë nuk e mësoi arsyen e arrestimit të tij.<sup>428</sup> Dhoma e Apelit mendon se Lahi Brahimaj e citon jashtë kontekstit dëshminë e Dëshmitarit 6, që asnjëherë nuk i thanë se pse e kishin arrestuar. Gjatë seancës së pyetjeve kryesore të Prokurorisë, kur u pyet nëse ia kishin thënë arsyen e arrestimit të tij deri në momentin që u lirua, Dëshmitari 6 u përgjigj, “Jo.”<sup>429</sup> Duke pasur parasysh dëshminë e Dëshmitarit 6 në tërësi, prej deklaratës së Dëshmitarit 6 Dhoma e Apelit nxjerr përfundimin që askush nuk ia tha arsyen *zyrtare* të arrestimit të tij, ndonëse kjo arsye mund të konkludohet prej deklaratave dhe veprimeve të keqtrajtuesve të tij.

184. Lahi Brahimaj argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se ai synonte keqtrajtimin e Dëshmitarit 6 për lidhjet e tij me serbët dhe diskriminimin e tij për arsye politike, për arsye se, ndonëse Dhoma Gjyqësore arriti në përfundimin se

<sup>424</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 71.1.

<sup>425</sup> Aktgjykim, para. 390 (citon P1248 (Deklarata e Dëshmitarit 7, 28 prill 2004, para. 40-41) (E Mbyllur me Vulë)).

<sup>426</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 71.2.

<sup>427</sup> Aktgjykim, para. 382 (citon Dëshmitarin 6, T. 5210 (1 qershor 2007) (Seancë Publike), 5400 (4 qershor 2007) (Seancë Publike)).

<sup>428</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 71.3.

<sup>429</sup> Dëshmitari 6, T. 5252-5253 (1 qershor 2007) (Seancë Publike) (me theks të shtuar).

dokumenti i lirimimit të Dëshmitarit 6 vërtetoi se ai ishte diskriminuar për këto arsye,<sup>430</sup> Dëshmitari 6 dëshmoi të kundërtën - se në dokument shkruhej se ai nuk duhej të shkonte në Gjakovë për arsye private.<sup>431</sup>

[...] Ky dokument thotë që unë nuk kam nevojë të shkoj në Gjakovë, nuk duhet të shkoj në Gjakovë për arsye private. Familja ime është 30 anëtarëshe dhe tri ditë pas burgosjes sime në Jabllanicë, djali i vëllait vdiq sepse nuk kishte se kush ta çonte në spital. Dhe ata – ata janë shkaktarë sepse më mbajtën aty dhe m'i morën të gjitha dokumentet, patentën, makinën. Dhe më thanë që duhej të qëndroja në shtëpi, të mos lëvizja nga shtëpia, por unë nuk e bëra këtë. Nuk isha arrogant si ata. Kisha familje për të cilën duhej të kujdesesha, nuk mund të rrija brenda. Kështu, shkova në SPB-në e Gjakovës dhe i nxora përsëri të njëjtat dokumente, patentën dhe të tjera, dhe bleva një makinë të re, të dorës së dytë, një më të lirë. Ata i bren ndërgjegjja për këtë.<sup>432</sup>

Dhoma e Apelit gjykon se shqyrtimi i dëshmisë së lartpërmendur bën të qartë se, kur Dëshmitari 6 përmendi fjalët “arsye private” gjatë pyetjeve lidhur me vendimin e UÇK-së për lirimimin e tij, ai nuk e kishte fjalën për arsyet për të cilat ishte arrestuar, por për mendimin e tij se lirimi i tij ishte me kusht dhe e kufizonte lëvizjen e tij. Sipas tij, meqë ishte liruar me kusht prej burgimit, ai nuk kishte të drejtë të shkonte në Gjakovë për “arsye private”.<sup>433</sup> Rrjedhimisht Lahi Brahimaj e ka shtrembëruar dëshminë e Dëshmitarit 6.

185. Si pasojë argumentet e Lahi Brahimajt hidhen poshtë.

##### 5. Pretendim për gabim lidhur me arsyen për keqtrajtimin e Dëshmitarit 6 (armëmbajtje)

186. Lahi Brahimaj pretendon se Dhoma Gjyqësore gaboi kur nuk mori parasysh arsyen e mundshme për arrestimin dhe keqtrajtimin e Dëshmitarit 6, konkretisht faktin që ai mbante një armë pa lejen e UÇK-së.<sup>434</sup>

187. Prokuroria nuk i përgjigjet konkretisht këtij argumenti por vë në dukje faktin se Dëshmitari 6 u rrëmbye nga ushtarë të UÇK-së dhe u mbajt në Jabllanicë pasi ata kishin

<sup>430</sup> Dokumenti që Nazmi Brahimaj i dha Dëshmitarit 6 ishte Prova P335. Është një “vendim” nga Shtabi Operativ i UÇK-së i Nënzonës së Dukagjinit, Shtabi Lokal i Jabllanicës, i datës 25 korrik 1998 ku lexohet: “Në përputhje me rregulloren e UÇK-së, [Shtabi Operativ i Nënzonës së Dukagjinit] mori vendim për lirimimin e të Akuzuarit [Dëshmitari 6]. Lirimi i tij është me kusht. Në qoftë se i përsërit gabimet, i Akuzuari [Dëshmitari 6] do të procedohet.” P335 (Dokument i nënshkruar nga Nazmi Brahimaj) (I Mbyllur me Vulë).

<sup>431</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 71.4.

<sup>432</sup> Dëshmitari 6, T. 5253-5256 (1 qershor 2007) (Seancë Publike dhe Private) (me theks të shtuar).

<sup>433</sup> Dëshmitari 6, T. 5255-5256 (1 qershor 2007) (Seancë Private).

<sup>434</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 73, 74.4.

gjetur në makinën e tij një pistoletë me leje të policisë dhe një fotografi të Dëshmitarit 6 me një polic në pension.<sup>435</sup>

188. Dhoma e Apelit rikujton dëshminë e Dëshmitarit 6 lidhur me këtë çështje. Dëshmitari 6 ishte në makinën e tij kur e ndaluan në një postbllok të UÇK-së; pjesëtarë të UÇK-së e kontrolluan makinën e tij dhe gjetën dhe konfiskuan një pistoletë dhe lejen e armën. Gjatë pyetjeve nga Mbrojtja, Dëshmitari 6 shpjegoi se pistoletën e kishte trashëguar nga i ati, se e kishte reregjistruar në emrin e tij, dhe se e kishte pasur gjatë kohës kur pushtetin e kishin policët shqiptarë dhe më pas kur kontrollin e morën policët serbë.<sup>436</sup> Dëshmitari 23 e përshkroi ngjashëm këtë ngjarje.<sup>437</sup> Dëshmitari 6 gjithashtu dëshmoi për lirimin e tij nga objekti i UÇK-së në Jabllanicë, dhe për faktin që ia konfiskuan armën dhe nuk ia kthyen më.<sup>438</sup>

189. Dhoma Gjyqësore i trajtoi të gjitha këto dëshmi në Aktgjykim.<sup>439</sup> Rrjedhimisht Lahi Brahimaj është i pasaktë në pretendimin se Dhoma Gjyqësore “nuk mori parasysh” çështjen e konfiskimit të armës së Dëshmitarit 6. Për më tepër, fakti që UÇK-ja konfiskoi armën e Dëshmitarit 6 dhe nuk ia ktheu më, madje as pas lirit të tij, nuk e bën të paarsyeshëm përfundimin e Dhomës Gjyqësore se ushtarë të UÇK-së, ndër të cilët Lahi dhe Nazmi Brahimaj, e akuzuan Dëshmitarin 6 se kishte lidhje me serbët ose ishte spiun i tyre, dhe e keqtrajtuuan atë për ta ndëshkuar për bashkëpunim të pretenduar me serbët dhe për ta diskriminuar për arsye politike.<sup>440</sup>

190. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit hedh poshtë argumentin e Lahi Brahimajt.

## 6. Përfundim

191. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit e hedh poshtë këtë pikë të apelit

<sup>435</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 39.

<sup>436</sup> Dëshmitari 6, T. 5194 (1 qershor 2007) (Seancë Publike), T. 5352-5353 (4 qershor 2007) (Seancë Publike).

<sup>437</sup> Dëshmitari 23, T. 10540-10541 (12 nëntor 2007) (Seancë Publike).

<sup>438</sup> Dëshmitari 6, T. 5254 (1 qershor 2007) (Seancë Private), T. 5361, 5378-5380 (4 qershor 2007) (Seancë Publike).

<sup>439</sup> Aktgjykim, para. 381, 384, 387.

<sup>440</sup> Aktgjykim, para. 382, 392, 395.

**C. Pretendime për Gabime në lidhje me Torturimin dhe Trajtimin Mizor të**  
**Dëshmitarit 3 (Pikat 3-6)**

192. Dhoma Gjyqësore e shpalli fajtor Lahi Brahimajn për torturim dhe trajtim mizor, si shkelje të ligjeve dhe zakoneve të luftës, sipas Pikës 32 të Aktakuzës.<sup>441</sup> Dhoma Gjyqësore “konstatoi dy incidente të sjelljes kriminale, të veçuara në kohë dhe hapësirë”.<sup>442</sup> Së pari, Dhoma Gjyqësore konkludoi se Lahi Brahimaj “e solli Dëshmitarin 3 në një dhomë në oborrin me ndërtesa në Jabllanicë”, ku Dëshmitari 3 u rrah me shkopinj bejsbolli. Më tej, Dhoma konstatoi se:

Dëshmitari 3 u mbajt në atë dhomë deri kur Lahi Brahimaj e çoi në një dhomë tjetër dhe e mori në pyetje ndërkohë që persona të tjerë e rihnin. Dhoma Gjyqësore konkludoi se roli i Lahi Brahimajt gjatë marrjes në pyetje të Dëshmitarit 3 pas mbërritjes së këtij të fundit në objektin e Jabllanicës vërteton synimin për t'i shkaktuar vuajtje të rënda fizike me qëllim që ta ndëshkonte për mosdorëzimin e një arme dhe ta diskriminonte sepse mendohej se kishte lidhje me serbët.<sup>443</sup>

Si rrjedhojë, Dhoma gjykoi se Lahi Brahimaj ishte përgjegjës për torturimin e Dëshmitarit 3.<sup>444</sup> Së dyti, Dhoma Gjyqësore konstatoi se Lahi Brahimaj “personalisht, e futi Dëshmitarin 3 në bagazhin e një makinë dhe simuloi ekzekutimin e tij”,<sup>445</sup> duke i shkaktuar në këtë mënyrë Dëshmitarit 3 vuajtje të rënda mendore.<sup>446</sup> Rrjedhimisht ajo e shpalli Lahi Brahimajn përgjegjës për trajtim mizor të Dëshmitarit 3.<sup>447</sup>

1. Pretendime për gabime në lidhje me vlerësimin nga Dhoma Gjyqësore të dëshmisë së  
Dëshmitarit 6 për torturimin e Dëshmitarit 3 (Pikat 3 dhe 5.1)

193. Lahi Brahimaj e kundërshton përfundimin e Dhomës Gjyqësore se Dëshmitari 3 ishte rrahur, duke vënë në dukje se në paragrafin 445 të Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore ishte arritur në përfundim se Dëshmitari 3 ishte rrahur, megjithëse në të njëjtën kohë pranoi se “Dëshmitari 6 po ashtu dëshmoi se Dëshmitari 3 nuk ishte rrahur, gjë që

<sup>441</sup> Aktgjykim, para. 504.

<sup>442</sup> Aktgjykim, para. 481.

<sup>443</sup> Aktgjykim, para. 451.

<sup>444</sup> Aktgjykim, para. 451, 481. Dhoma Gjyqësore konkludoi se incidenti i parë ishte njëkohësisht torturim dhe trajtim mizor, por shpalli fajësi vetëm për torturim bazuar në ligjet e fajësisë së shumëfishtë.

<sup>445</sup> Aktgjykim, para. 451.

<sup>446</sup> Aktgjykim, para. 451.

<sup>447</sup> Aktgjykim, para. 449, 451.

duket se bie ndesh me dëshminë e Dëshmitarit 3”.<sup>448</sup> Lahi Brahimaj argumenton se Dhoma Gjyqësore kishte konkluduar se të dy dëshmitarët, Dëshmitari 3 dhe Dëshmitari 6, ishin të besueshëm, pa dhënë ndonjë arsye për këto konkluzione dhe pa e trajtuar këtë mospërputhje midis dëshmive. Sipas Lahi Brahimajt, Dhoma Gjyqësore përkundrazi “zgjodhi të riinterpretojë dëshminë e Dëshmitarit 6, ’sikur donte të thoshte se ai nuk kishte pasur dijeni që Dëshmitarin 3 po e rrihnin’”, që ishte e paarsyeshme, duke pasur parasysh “dëshminë e qartë dhe të padiskutueshme të Dëshmitarit 6 për këtë pikë”.<sup>449</sup>

194. Lahi Brahimaj arsyeton se Dhoma Gjyqësore nuk mori parasysh një numër kundërshtish në dëshmitë e këtyre dy dëshmitarëve. Më konkretisht, ai vë në dukje se: (a) Dhoma Gjyqësore hamendësoi se Dëshmitari 3 ishte rrahur kur mbërriti në kazermë, ndonëse Dëshmitari 6 dëshmoi se Dëshmitari 3 nuk ishte rrahur;<sup>450</sup> (b) konkluzioni i Dhomës Gjyqësore se Dëshmitari 6 nuk hyri në dhomën ku mbahej Dëshmitari 3, bie ndesh me faktet e konstatuara nga Dhoma Gjyqësore;<sup>451</sup> (c) konkluzioni i Dhomës Gjyqësore se Dëshmitari 6 nuk ishte në gjendje të qartësonte nëse Dëshmitari 3 ishte rrahur, dhe interpretimi prej saj i dëshmisë së Dëshmitarit 6, se donte të thoshte që ai nuk kishte pasur dijeni për rrahjen e Dëshmitarit 3, nuk pasqyrojnë dëshmitë;<sup>452</sup> dhe (d) Dëshmitari 6 dha një shpjegim bindës se përse Dëshmitari 3 nuk ishte rrahur, që asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk mund ta hidhte poshtë.<sup>453</sup> Së fundi, Lahi Brahimaj arsyeton se, përderisa mund të argumentohet se nga dëshmia mund të nxirren, në mënyrë të arsyeshme, më shumë se një përfundim, Dhoma Gjyqësore në përputhje me parimin *in dubio pro reo*, nuk kishte zgjedhje tjetër veçse të nxirrte një përfundim në përputhje me pafajësinë e Lahi Brahimajt.<sup>454</sup>

195. Prokuroria përgjigjet se vlerësimi nga Dhoma Gjyqësore i dëshmive të Dëshmitarit 6 dhe Dëshmitarit 3 ishte i arsyeshëm.<sup>455</sup> Ajo arsyeton se nuk kishte prova të administruara që tregonin ndonjë kontakt të drejtpërdrejt midis Dëshmitarit 3 dhe

<sup>448</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 76.

<sup>449</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 77; *shih gjithashtu* TA. 141-142 (Seancë Publike).

<sup>450</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 79.1.

<sup>451</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 79.2.

<sup>452</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 79.3.

<sup>453</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 81.

<sup>454</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 81-82; TA. 141-142 (Seancë Publike).

<sup>455</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 41; *shih gjithashtu* TA. 146-147 (Seancë Publike).

Dëshmitarit 6, dhe se dëshmia e Dëshmitarit 6 konfirmon dëshminë e Dëshmitarit 3 në lidhje me praninë e tij në oborrin me ndërtesa të UÇK-së në Jabllanicë si edhe arratisjen e tij.<sup>456</sup> Prokuroria pretendon se dëshmia e Dëshmitarit 6 nuk e cënon konkluzionin e Dhomës Gjyqësore për sa i takon torturimit të Dëshmitarit 3, dhe as nuk ndikon në konkluzionin e saj se Dëshmitarët 3 dhe 6 ishin të besueshëm.<sup>457</sup> Prokuroria deklaroi se Dhoma Gjyqësore me të drejtë nuk i kushtoi rëndësi spekulimit të Dëshmitarit 6 për arsyet e mosrrahjes së Dëshmitarit 3.<sup>458</sup> Së fundi, Prokuroria argumenton se Lahi Brahimaj nuk ka provuar se analiza dhe konkluzionet e Dhomës Gjyqësore për sa u takon provave kanë qenë të paarsyeshme.<sup>459</sup>

196. Dhoma e Apelit kujton se, ndonëse Dhoma Gjyqësore ushtron kompetencë të konsiderueshme në trajtimin e mospërputhjeve të vogla në dëshmitë e dëshmitarëve, kjo kompetencë duhet të jetë në pajtim me të drejtën e një të akuzuari për një arsyetim prej saj.<sup>460</sup> Në përputhje me të drejtën për dhënien e arsytimit, Dhoma Gjyqësore është e detyruar të ofrojë arsye të mjaftueshme për parapëlqimin e dëshmisë së një dëshmitari kyç ndaj një tjetri..<sup>461</sup>

197. Dhoma e Apelit vë në dukje se, kur Dhoma Gjyqësore konkludoi se Lahi Brahimaj ishte fajtor për torturim dhe trajtim mizor të Dëshmitarit 3, ajo u mbështet kryesisht në dëshmitë e Dëshmitarit 3 dhe Dëshmitarit 6. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore ishte e detyruar të ofronte një arsyetim, i cili qoftë edhe shkurtimisht të trajtonte mospërputhjet në dëshmitë e tyre dhe të shpjegonte përse ajo preferoi dëshminë e Dëshmitarit 3 ndaj asaj të Dëshmitarit 6. Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore e plotësoi këtë detyrim për arsyet e shtjelluara më poshtë.

<sup>456</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 41.

<sup>457</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 41.

<sup>458</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 41.

<sup>459</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 42.

<sup>460</sup> *Shih më sipër* Nën pjesa 4, Pjesa A, Kapitulli IV.

<sup>461</sup> Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerë.*, para. 32; Aktgjykimi i Apelit *Nchamihigo*, para. 281-282, 354; Aktgjykimi i Apelit *Muvunyi*, para 142-147.

(a) A “hamendësoi” Dhoma Gjyqësore se Dëshmitari 3 ishte rrahur

198. Lahi Brahimaj vë në dukje konkluzionin e Dhomës Gjyqësore se “provat nuk tregojnë që Dëshmitari 6 e pa rrahjen e parë të Dëshmitarit 3”. Lahi Brahimaj argumenton se në nxjerrjen e këtij konkluzioni, Dhoma Gjyqësore hamendësoi se Dëshmitari 3 ishte rrahur kur kishte mbërritur në Jabllanicë edhe pse, sipas Lahi Brahimajt dhe dëshmisë së Dëshmitarit 6, Dëshmitarin 3 nuk e kishin rrahur. Sipas Lahi Brahimajt, provat përputhen po ashtu me konkluzionin se rrahja nuk kishte ndodhur. Lahi Brahimaj gjithashtu vë në dukje se as Prokuroria, as Dhoma Gjyqësore nuk e pyetën Dëshmitarin 6 nëse Dëshmitari 3 mund të ishte rrahur pa dijeninë e Dëshmitarit 6.<sup>462</sup>

199. Prokuroria përgjigjet se vlerësimi nga Dhoma Gjyqësore i dëshmive të Dëshmitarit 6 dhe Dëshmitarit 3 ishte i arsyeshëm në lidhje me torturimin e Dëshmitarit 3 në oborrin me ndërtesa në Jabllanicë.<sup>463</sup>

200. Dhoma e Apelit nuk pajtohet me Lahi Brahimajn se Dhoma Gjyqësore hamendësoi se Dëshmitarin 3 e kishin rrahur, dhe se më tej nuk mori parasysh dëshmitë e kundërta. Përkundrazi, Dhoma e Apelit gjykon se del qartë që Dhoma Gjyqësore i ka shqyrtuar dëshmitë e Dëshmitarit 6 dhe Dëshmitarit 3 në lidhje me këtë çështje dhe ofroi një arsyetim, ku trajtoheshin qartë kundërshtitë në dëshmitë e tyre dhe arsye të parapëlqimit të dëshmisë së dëshmitarit të fundit ndaj dëshmisë së dëshmitarit të mëparshëm. Konkretisht, Dhoma Gjyqësore konkludoi se dëshmia e Dëshmitarit 6 që Dëshmitari 3 nuk ishte rrahur, bie ndesh me dëshminë e Dëshmitarit 3, por megjithatë e pranoi dëshminë e Dëshmitarit 3 për shkak se: (a) dukej se Dëshmitari 6 pati shumë pak ose aspak kontakt të drejtpërdrejtë me Dëshmitarin 3;<sup>464</sup> dhe (b) nga provat nuk dilte qartë që Dëshmitari 6 ta kishte parë Dëshmitarin 3, kur ai u arratis nga dhoma. Për këtë arsye, Dhoma Gjyqësore gjykoj se, “Dëshmitari 6 nuk ishte në gjendje të vërtetonte nëse

<sup>462</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 79.1; TA. 141-142 (Seancë Publike).

<sup>463</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 41.

<sup>464</sup> Në veçanti, provat nuk treguan se Dëshmitari 6 e pa rrahjen e parë të Dëshmitarit 3, apo se ai kishte hyrë në dhomën e tij kur i çonte ushqim dhe ujë.

Dëshmitarin 3 e kishin rrahur”, dhe e interpretoi dëshminë e tij “në kuptimin që ai nuk kishte dijeni se Dëshmitarin 3 e kishin rrahur”.<sup>465</sup>

201. Dhoma e Apelit kujton se Dhoma Gjyqësore mund të pranojë vetëm disa pjesë të dëshmisë së një dëshmitari dhe të hedhë poshtë pjesët e tjera.<sup>466</sup> Për këtë arsye, Dhoma Gjyqësore nuk ishte e detyruar të pranonte çdo aspekt të dëshmisë së Dëshmitarit 6. Dhoma Gjyqësore pati avantazhin e vëzhgimit të drejtpërdrejtë të të dy dëshmitarëve dhe ishte në pozitë më të mirë se Dhoma e Apelit për të vlerësuar besueshmërinë dhe saktësinë e provave për këtë çështje.<sup>467</sup>

202. Për më tepër, Dhoma e Apelit e gjykon të pabazë sugjerimin e Lahi Brahimajt se Prokuroria ose Dhoma Gjyqësore duhej ta kishin pyetur Dëshmitarin 6 për mundësinë e rrahjes së Dëshmitarit 3 pa dijeninë e Dëshmitarit 6. Dhoma e Apelit gjykon se çdo përgjigje nga ana e Dëshmitarit 6 për këtë pyetje do të ishte spekulative dhe se, në qoftë se Lahi Brahimaj mendonte që përgjigjja e kësaj pyetjeje mund të kishte hedhur dritë mbi këtë pikë, ai mund ta kishte ngritur këtë çështje vetë gjatë procesit.

203. Duke pasur parasysh sa më lart, Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore e kreu detyrën e saj për trajtimin e mospërputhjeve në deklaratat e këtyre dy dëshmitarëve kyç dhe shpjegimin e arsyes së saj mbi parapëlqimin e dëshmisë së një dëshmitarit ndaj tjetrit nëpërmjet një arsyetimi. Lahi Brahimaj nuk ka gjetur asnjë gabim të Dhomës Gjyqësore në këtë drejtim.

204. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit e hedh poshtë këtë argument.

(b) A gaboi Dhoma Gjyqësore në konkluzionin se Dëshmitari 6 nuk hyri në dhomën ku mbahej Dëshmitari 3

205. Lahi Brahimaj argumenton se konkluzioni i Dhomës Gjyqësore, se provat nuk treguan që Dëshmitari 6 hyri në dhomën e Dëshmitarit 3 kur i çonte ushqim dhe ujë, bie

<sup>465</sup> Aktgjykim, para. 445.

<sup>466</sup> Aktgjykimi i Apelit *Bllagojeviq dhe Jokiq*, para. 82 (që citon Aktgjykimin e Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerë*, para. 333). *Shih gjithashtu* Aktgjykimi i Apelit *Ntagerura e të tjerë*, para. 214; Aktgjykim i Apelit *Kamuhanda*, para. 248)

<sup>467</sup> Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para 485, 496-498; Aktgjykimi i Apelit *Furunxhija*, para. 37

ndesh me faktet e konstatuara nga Dhoma Gjyqësore në paragrafët 418, 427, dhe 443 të Aktgjykimit të saj.<sup>468</sup> Lahi Brahimaj gjithashtu argumenton se dëshmia e Dëshmitarit 6<sup>469</sup> tregon se Dëshmitari 6 duhet të ketë hyrë në dhomën ku mbaheshin Dëshmitari 3 dhe dy të burgosur të tjerë.<sup>470</sup> Lahi Brahimaj vë në dukje se Dhoma Gjyqësore tërhoqi vëmendjen ndaj dëshmisë së Dëshmitarit 6 se, në të njëjtën ditë, rreth orës 13:00, burri nga Grabanica arriti të arratisë, duke ikur nga dritarja e dhomës së tij, ndërsa burri nga Zahaqi dhe Pal Krasniqi u kapën tek orvateshin të bënin të njëjtën gjë.<sup>471</sup> Së fundi, Lahi Brahimaj citon gjashtë pjesë nga dëshmia e Dëshmitarit 6 për mënyrën se si Dëshmitari 6, *ndër të tjerë*, i kishte ndihmuar dy burrat në dhomë, për shembull, duke u sjellë ushqim dhe ujë, që sipas Lahi Brahimajt, mbështet pikëpamjen e tij se Dëshmitari 6 duhej të kishte hyrë në dhomë.<sup>472</sup> Bazuar në sa më sipër, Lahi Brahimaj pretendon se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk mund të nxirrte përfundimin se Dëshmitari 6 nuk kishte hyrë në dhomë dhe se, si pasojë, konkluzioni i Dhomës Gjyqësore që Dëshmitari 6 nuk kishte hyrë në dhomë kur sillte ushqim dhe ujë është “vërtetë i pandershëm”.<sup>473</sup>

206. Prokuroria përgjigjet se: (a) nuk kishte prova se Dëshmitari 6 kishte kontakt të drejtpërdrejtë me Dëshmitarin 3; (b) Dëshmitari 6 nuk ishte në dhomë ku dhe kur Dëshmitari 3 rrihej; dhe (c) Dëshmitari 6 dëshmoi se nuk kishte hyrë në dhomën ku mbahej i burgosur Dëshmitari 3.<sup>474</sup>

207. Dhoma e Apelit kujton se Dëshmitari 6, gjatë pyetjeve nga Mbrojtja, dëshmoi se nuk hynte në dhomë, por se bukën dhe ujin i shpinte deri tek dera e dhomës. Ai dëshmoi më tej se e linte ujin brenda dhomës, e mbyllte derën dhe pastaj Pal Krasniqi e merrte. Por, ai nuk e dinte nëse dikush e pinte këtë ujë.<sup>475</sup> Dhoma e Apelit konkludon se, bazuar

<sup>468</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 79.2.

<sup>469</sup> Dëshmitari 6, T. 5332-5337 (4 qershor 2007) (Seancë Publike), T. 5237-5238 (1 qershor 2007) (Seancë Publike).

<sup>470</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 79.2.

<sup>471</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 79.2; Aktgjykimi, para. 443 (që citon Dëshmitarin 6, T. 5236-5238 (1 qershor 2007) (Seancë Publike), T. 5338-5339, 5389-5390 (4 qershor 2007) (Seancë Publike)). *Shih gjithashtu* Aktgjykimi, para. 418, 427.

<sup>472</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 79.2 (që citon T. 5237-5238 (1 qershor 2007) (Seancë Publike), T. 5332-5333, 5335-5336 (4 qershor 2007) (Seancë Publike)).

<sup>473</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 79.2.

<sup>474</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 41..

<sup>475</sup> Dëshmitari 6, T. 5336-5337 (4 qershor 2007) (Seancë Publike).

në dëshminë e dhënë nga Dëshmitari 6 për këtë pikë, Dhoma Gjyqësore gjykoi në mënyrë të arsyeshme se Dëshmitari 6 nuk kishte hyrë në dhomën ku mbaheshin Dëshmitari 3 dhe dy burrat e tjerë, kur ai u çonte ushqim dhe ujë. Për më tepër, konkluzioni i Dhomës Gjyqësore në këtë drejtim nuk bie ndesh me pjesët e tjera të Aktgjykimit. Si rrjedhojë, Dhoma Gjyqësore nuk ka bërë ndonjë gabim fakti.

208. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit e hedh poshtë këtë argument.

(c) A gaboi Dhoma Gjyqësore në konkluzionin se Dëshmitari 6 nuk e pa Dëshmitarin 3 kur ai u arratis nga dhoma

209. Më tej Lahi Brahimaj argumenton se konkluzioni i Dhomës Gjyqësore, se nuk dilte qartë që Dëshmitari 6 e pa Dëshmitarin 3 teksa u arratis nga dhoma e tij, nuk pasqyron provat. Ai pohon se, në këto rrethana, përfundimi i Dhomës Gjyqësore se Dëshmitari 6 nuk ishte në gjendje të vërtetonte nëse Dëshmitari 3 ishte ose nuk ishte rrahur, sikurse edhe interpretimi prej saj i dëshmisë së Dëshmitarit 6, se donte të thoshte që ai nuk kishte pasur dijeni për rrahjen e Dëshmitarit 3, shfaq mangësi të rënda.<sup>476</sup>

210. Prokuroria përgjigjet se Dëshmitari 6 e pa Dëshmitarin 3 teksa orvatej të arratisej.<sup>477</sup>

211. Dhoma e Apelit kujton se kur Dëshmitari 6 u pyet gjatë pyetjeve kryesore të Prokurorisë nëse i kishte parë të tre burrat, apo vetëm Dëshmitarin 3, të iknin nga dritarja, ai u përgjigj se kishte parë burrin nga Grabanica duke vrapuar mes për mes lëndinës, pasi kishte hapur dritaren që të iknin edhe dy burrat e tjerë dhe kur i kishte ndihmuar të kalonin nëpër të; por më pas Dëshmitari 6 dëshmoi se nuk e kishte parë aspak burrin nga Grabanica.<sup>478</sup> Konkluzioni i Dhomës Gjyqësore se “nuk ishte e qartë nëse Dëshmitari 6 e kishte parë Dëshmitarin 3 teksa u arratis nga dhoma e tij” është konkluzioni që një gjykyes i arsyeshëm faktesh do të kishte nxjerrë mbështetur në provat e disponuara. Si rezultat, Dhoma Gjyqësore nuk ka bërë gabim faktual.

<sup>476</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 79.3, 80.

<sup>477</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 41

<sup>478</sup> Dëshmitari 6, T. 5236-5238 (1 qershor 2007) (Seancë Publike).

212. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit e hedh poshtë këtë argument.

(d) A gaboi Dhoma Gjyqësore në rrëzimin e arsyeve të dhëna nga Dëshmitari 6 se përse Dëshmitari 3 nuk ishte rrahur

213. Lahi Brahimaj argumenton se arsyet e dhëna nga Dëshmitari 6 se përse Dëshmitari 3 nuk ishte rrahur provojnë palogjikshmërinë e konkluzionit të Dhomës Gjyqësore se Dëshmitari 6 nuk ishte në gjendje të provonte nëse Dëshmitari 3 ishte rrahur apo nuk ishte rrahur.<sup>479</sup>

214. Prokuroria përgjigjet se Dhoma Gjyqësore me të drejtë nuk i kushtoi rëndësi spekulimit të Dëshmitarit 6 për moskeqtrajtimin e Dëshmitarit 3.<sup>480</sup>

215. Dhoma e Apelit konstaton se Dëshmitari 6 dëshmoi se e dinte që burrin nga Grabanica nuk e rrahën, për shkak se “ishte martuar me dikë nga Jabllanica dhe se familja e gruas së tij kishte ardhur dhe ndërhyrë, dhe atë nuk e rrahën”.<sup>481</sup> Dhoma e Apelit gjykon se, edhe sikur të pranohej dëshmia e Dëshmitarit 6, se Dëshmitari 3 ishte martuar me dikë nga Jabllanica dhe se familja e gruas së tij kishte ardhur dhe ndërhyrë, një gjykues i arsyeshëm faktesh gjithsesi do të kishte pranuar dëshminë e Dëshmitarit 3 se e kishin rrahur.<sup>482</sup> Si pasojë, Dhoma e Apelit gjykon se Lahi Brahimaj nuk ka provuar ndonjë gabim nga ana e Dhomës Gjyqësore në nxjerrjen e përfundimit se Dëshmitari 3 ishte rrahur, pavarësisht dëshmisë në fjalë.

216. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit e hedh poshtë këtë argument.

<sup>479</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 80-82..

<sup>480</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 41.

<sup>481</sup> Dëshmitari 6, T. 5336 (4 qershor 2007) (Scancë Publike).

<sup>482</sup> *Shih* Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerë*, para. 23.

(e) A gaboi Dhoma Gjyqësore kur pranoi dëshminë e Dëshmitarit 3 duke marrë parasysh se kjo dëshmi nuk u konfirmua, por përkundrazi binte ndesh me dëshminë e Dëshmitarit 6 (Pika 5.1)

217. Lahi Brahimaj argumenton se Dhoma Gjyqësore nuk mori parasysh se Dëshmitari 6, i vetmi dëshmitar i pranishëm, i cili mund të kishte mbështetur dëshminë e Dëshmitarit 3, nuk e konfirmoi dëshminë e Dëshmitarit 3.<sup>483</sup> Ndonëse Lahi Brahimaj pranon se konfirmimi nuk nevojitet, ai pretendon se dëshmia e Dëshmitarit 6 bie ndesh me dëshminë e Dëshmitarit 3 dhe se Dëshmitari 6 dha arsye të qarta dhe bindëse për këtë kundërthënie.<sup>484</sup> Lahi Brahimaj argumenton se Dhoma Gjyqësore nuk mundi të japë “një arsyetim për mosmarrjen në konsiderate të një mungese të tillë provash materiale.”<sup>485</sup>

218. Në përgjigjen e saj, Prokuroria mbështetet në jurisprudencën e Tribunalit dhe argumenton se Dhoma Gjyqësore ka zbatuar në mënyrë korrekte ligjin për shqyrtimin e dëshmisë së një dëshmitari të pakonfirmuar.<sup>486</sup> Prokuroria argumenton se Lahi Brahimaj nuk citon ndonjë burim autoritar në mbështetje të pretendimit të tij se, pavarësisht mungesës së kushtit ligjor për konfirmimin e dëshmisë së një dëshmitari, konfirmimi do të kishte qenë i dobishëm për vlerësimin e besueshmërisë së dëshmisë së Dëshmitarit 3.<sup>487</sup> Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore i mori parasysh mospërputhjet e pretenduara midis dëshmisë së Dëshmitarit 3 dhe Dëshmitarit 6, dhe se Lahi Brahimaj nuk arriti të provonte se konkluzioni i Dhomës Gjyqësore ishte i paarsyeshëm.<sup>488</sup>

<sup>483</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 94; TA. 132 (Seancë Publike). Lahi Brahimaj gjithashtu kujton argumentet që ngriti në Pikat 3 dhe 4 të Apelit të tij. Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 93. Këto argumente janë trajtuar nga Dhoma e Apelit sipas Pikave 3 dhe 4 të Apelit të Lahi Brahimajt.

<sup>484</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 91-94.

<sup>485</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 94.

<sup>486</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 46 (që citon Aktgjykimin e Apelit *Tadiq*, para. 65; Aktgjykimin e Apelit *Aleksovski*, para. 62-64; Aktgjykimin e Apelit *Çelebiqi*, para. 492; Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq e të tjerë*, para. 33); *shih gjithashtu* TA. 146-147 (Seancë Publike).

<sup>487</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 46.

<sup>488</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 47 (që citon Aktgjykimin, para. 445). *Shih gjithashtu* Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq e të tjerë*, para. 333; Aktgjykimi i Apelit *Bllagojeviq dhe Jokiq*, para. 82 (ku pohohet se nuk është e paarsyeshme që Dhoma Gjyqësore të pranojë pjesë të caktuara të dëshmisë së një dëshmitari dhe të hedhë poshtë pjesët e tjera).

219. Dhoma e Apelit kujton se një Dhomë Gjyqësore është e lirë të mbështetet në dëshminë e një dëshmitari të vetëm në nxjerrjen e përfundimeve të saj.<sup>489</sup> Dëshmia e një dëshmitari të vetëm mund të pranohet pa pasur nevojë për konfirmim, edhe kur ajo ka të bëjë me një fakt material.<sup>490</sup> Në rastin në fjalë, Dhoma Gjyqësore mori parasysh se Dëshmitari 6 ishte në oborrin me ndërtesa në Jabllanicë në të njëjtën kohë që Dëshmitari 3 mbahej i ndaluar aty. Dhoma Gjyqësore shqyrtoi edhe disa aspekte të caktuara të dëshmisë së Dëshmitarit 6 në vlerësimin e dëshmisë së Dëshmitarit 3, konkretisht, pohimin e Dëshmitarit 6 se Dëshmitari 3 nuk ishte rrahur, që binte ndesh me dëshminë e Dëshmitarit 3.<sup>491</sup> Sikurse u diskutua më sipër, Dhoma Gjyqësore dha një shpjegim të mjaftueshëm se përse preferoi dëshminë e Dëshmitarit 3 ndaj asaj të Dëshmitarit 6 në lidhje me këtë çështje, pavarësisht kundërshtive në këto dëshmi. Bazuar sa më sipër, Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore nuk gaboi kur u mbështet në dëshminë e Dëshmitarit 3, pa kërkuar konfirmimin e saj dhe pavarësisht faktit se dëshmia e Dëshmitarit 3 u kundërshtua nga dëshmia e Dëshmitarit 6.

220. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit e hedh poshtë këtë nënpikë të apelit.

(f) A e shkeli Dhoma Gjyqësore parimin *in dubio pro reo*

221. Dhoma e Apelit i ka hedhur poshtë të dy nënpikat e apelit të ngritura nga Lahi Brahimaj në lidhje me mospërputhjet midis dëshmisë së Dëshmitarit 3 dhe Dëshmitarit 6. Si rrjedhojë, Dhoma e Apelit nuk është e bindur se Lahi Brahimaj ka provuar që Dhoma Gjyqësore e ka zbatuar gabim parimin *in dubio pro reo* në nxjerrjen e përfundimit të saj se Dëshmitari 3 është rrahur, pavarësisht dëshmisë së Dëshmitarit 6 për të kundërtën, si pjesë e konkluzionit të saj jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se Lahi Brahimaj ishte fajtor për torturim dhe trajtim mizor të Dëshmitarit 3.

<sup>489</sup> Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerë*, para. 33.

<sup>490</sup> Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 65; Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, para. 62; Aktgjykimi i Apelit *Celebiciq*, para. 492, 506; Aktgjykimi i Apelit *Kayishema dhe Ruzindana*, para. 154

<sup>491</sup> Aktgjykimi, para. 445.

(g) Përfundim

222. Si rrjedhojë, Dhoma e Apelit i hedh poshtë pikat 3 dhe 5.1 të apelit të Lahi Brahimajt.

2. Pretendime për gabime në vlerësimin e Dhomës Gjyqësore të dëshmisë për kohëzgjatjen e qëndrimit të Dëshmitarit 3 në oborrin me ndërtesa të UÇK-së në Jabllanicë (Pika 4)

223. Lahi Brahimaj parashtron se Dhoma Gjyqësore nuk trajtoi kundërshtinë materiale dhe të papajtueshme midis dëshmisë së Dëshmitarit 3 dhe Dëshmitarit 6 në lidhje me kohën që Dëshmitari 3 qëndroi në oborrin me ndërtesa në Jabllanicë, faktor që ka të bëjë me vlerësimin e besueshmërisë së Dëshmitarit 3. Ai argumenton se Dhoma Gjyqësore “e vuri në dukje si duhej” këtë mospërputhje, por nuk e trajtoi gjatë vlerësimit prej saj të besueshmërisë së Dëshmitarit 3 gjë që përbën gabim ligjor.<sup>492</sup>

224. Në përgjigjen e saj, Prokuroria argumenton se përfundimi i Dhomës Gjyqësore në lidhje me besueshmërinë e Dëshmitarit 3 dhe dëshminë e tij për sa i takon qëndrimit të tij në oborrin me ndërtesa në Jabllanicë është i arsyeshëm.<sup>493</sup> Prokuroria po ashtu parashtron se Dëshmitari 3 bëri më shumë se një përshkrim të shkurtër të dy të burgosurve të tjerë, dhe se ai ishte në gjendje të përshkruante lëndimet e tyre, mungesën e një nevojtojeje në dhomë dhe kushtet e ndalimit gjatë natës.<sup>494</sup> Prokuroria argumenton më tej se gjatë pyetjeve nga Mbrojtja, Dëshmitari 3 iu përmbajt dëshmisë së tij se kishte qëndruar në ndërtesat në oborrin në Jabllanicë dy net, dhe përsëriti se duart ia mbanin të lidhura gjatë natës.<sup>495</sup>

225. Dhoma e Apelit konstaton se mospërputhja në fjalë qëndron në faktin se Dëshmitari 3 dëshmoi se ishte mbajtur dy net dhe tri ditë, ndërsa Dëshmitari 6 dëshmoi se Dëshmitari 3 u arratis andej ditën që ishte arrestuar.

<sup>492</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 84-85, 88; *shih gjithashtu* Njoftimi për Apel i Brahimajt, para. 10.

<sup>493</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 43 (që citon Aktgjykimin, para. 440, 446).

<sup>494</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 43, poshtëshënimet 133-136 (citon Dëshmitarin 3, T. 7946-7947, 7950-7951 (4 shtator 2007) (Seancë private)).

<sup>495</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 43, poshtëshënimi 138 (citon Dëshmitarin 3, T. 8010 (5 shtator 2007) (Seancë private)).

226. Ndonëse Dhoma Gjyqësore e konsideroi Dëshmitarin 6 të besueshëm,<sup>496</sup> kjo nuk do të thotë se ajo ishte e detyruar të pranonte çdo aspekt të dëshmisë së tij. Dhoma e Apelit kujton se Dhoma Gjyqësore mund të pranojë disa pjesë të dëshmisë së një dëshmitari dhe të hedhë poshtë pjesët e tjera.<sup>497</sup> Mirëpo për shkak të faktit se dëshmia e Dëshmitarit 6 binte ndesh me dëshminë e Dëshmitarit 3, dhe faktit se Dhoma Gjyqësore zgjodhi dëshminë e të dytit ndaj asaj të dëshmitarit të parë, Dhoma Gjyqësore e shpalli Lahi Brahimajn fajtor kryesisht në bazë të dëshmisë së Dëshmitarit 3. Në këtë mënyrë, Dhoma Gjyqësore erdhi në përfundimin se Dëshmitari 3 ishte i besueshëm për këtë aspekt konkret, pa paraqitur arsye të mjaftueshme për këtë konkluzion. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit nuk është në gjendje të përcaktojë rëndësinë që Dhoma Gjyqësore i kushtoi mospërputhjes midis dëshmive të dy dëshmitarëve në lidhje me kohëzgjatjen e mbajtjes së Dëshmitari 3, apo nëse Dhoma Gjyqësore nuk e mori parasysh këtë mospërputhje. Dhoma e Apelit konkludon se mungesa e një veprimi të tillë nga ana e Dhomës Gjyqësore bie ndesh me të drejtën e Lahi Brahimajt për një opinion të arsyetuar, që përbën gabim ligjor. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit do të shqyrtojë argumentin e Lahi Brahimajt sipas kësaj pike të apelit, me qëllim që të përcaktojë nëse një Dhomë Gjyqësore e arsyeshme do të kishte arritur në përfundimin se Dëshmitari 3 ishte i besueshëm në rrethanat përkatëse.

227. Dhoma e Apelit konstaton se Dhoma Gjyqësore i shqyrtoi dëshmitë e Dëshmitarit 3 dhe Dëshmitarit 6 në lidhje me kohëzgjatjen e mbajtjes së Dëshmitarit 3 në ndërtesat brenda oborrit në Jabllanicë,<sup>498</sup> dhe konkludoi se Dëshmitari 3 u mbajt në dhomën brenda oborrit me ndërtesa në Jabllanicë dy net dhe tri ditë.<sup>499</sup>

228. Në pjesën përkatëse të dëshmisë së Dëshmitarit 6 për këtë pikë pohohet se rreth mesit të korrikut 1998, në ditën pas mbërritjes në Jabllanicë të një burri nga Zahaqi, dhe dy-tri orë pas mbërritjes së Pal Krasniqit, arriti një burrë i tretë nga Grabanica, Komuna e

<sup>496</sup> Aktgjykimi, para. 391.

<sup>497</sup> Aktgjykimi i Apelit *Bllagojeviq dhe Jokiq*, para. 82, Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerë* Aktgjykimi i Apelit, para. 333). *Shih gjithashtu* Aktgjykimi i Apelit *Ntagerura e të tjerë*, para. 214; Aktgjykimi i Apelit *Kamuhanda*, para. 248.

<sup>498</sup> Aktgjykim, para. 443, 446.

<sup>499</sup> Aktgjykim, para. 440.

Klinës.<sup>500</sup> Më tej, Dëshmitari 6 dëshmoi se në të njëjtën ditë, rreth orës 1300, burri nga Grabanica mundi të arratisëj, duke ikur nga dritarja e dhomës, ndërsa burri nga Zahaqi dhe Pal Krasniqi u kapën teksa orvateshin të arratiseshin.<sup>501</sup> Dhoma Gjyqësore u bind se dëshmia e Dëshmitarit 6 në lidhje me burrin nga Grabanica kishte të bënte me Dëshmitarin 3.<sup>502</sup> Dëshmia e Dëshmitarit 3 për këtë çështje është se aty nga fillimi apo mesi i korrikut 1998, Lahi Brahimaj e kishte marrë atë nga shtëpia e Tal Zekës në Zhabel, Komuna e Gjakovës, në Jabllanicë, dhe e kishte sjellë në një dhomë në ndërtesën e shtabit të UÇK-së, dhe pastaj ishte larguar.<sup>503</sup> Pas disa minutash, disa persona kishin hyrë në dhomë dhe e kishin rrahur Dëshmitarin 3 me shkopinj bejsbolli deri sa kishte humbur vetëdijen.<sup>504</sup> Dëshmitari 3 dëshmoi se e kishin mbajtur për dy net dhe tri ditë me dy persona të tjerë, dhe se të gjithë i kishin pasur duart të lidhura gjatë natës.<sup>505</sup>

229. Dhoma e Apelit vë në dukje se thelbi i dëshmisë së Dëshmitarit 6 kishte të bënte me konfiskimin e pasurisë së tij, përveç burgimit dhe rrahjeve në Jabllanicë,<sup>506</sup> kurse Dëshmitari 3 dha dëshmi të hollësishme për burgimin e tij në Jabllanicë, dhe në veçanti, për kushtet e burgimit të tij,<sup>507</sup> dhomën ku u mbajt,<sup>508</sup> personat që vinin në dhomë,<sup>509</sup> dhe teshat dhe gjendjen e dy burrave të tjerë të burgosur bashkë me të.<sup>510</sup> Në bazë të dëshmisë së drejtpërdrejtë të Dëshmitarit 3 rreth burgimit të tij dhe mbështetur në faktin se, e parë në tërësinë e saj, dëshmia e Dëshmitarit 6 ishte më shumë e përqendruar në çështje të tjera, si për shembull, në keqtrajtimin e tij, Dhoma e Apelit gjykon se një gjykues i arsyeshëm faktesh mund të kishte parapëlqyer dëshminë e Dëshmitarit 3 në lidhje me

<sup>500</sup> Aktgjykim, para. 443 (që citon Dëshmitarin 6, T. 5206, 5233, 5247-5249, 5252-5255 (1 qershor 2007) (Seancë Publike dhe private), T. 5293, 5297-5298, 5331-5332, 5334-5335, 5386, 5388-5389, 5391 (4 qershor 2007) (Seancë Publike)).

<sup>501</sup> Aktgjykim, para. 443 (që citon Dëshmitarin 6, T. 5236-5238 (1 qershor 2007) (Seancë Publike), T. 5338-5339, 5389-5390 (4 qershor 2007) (Seancë Publike)).

<sup>502</sup> Aktgjykim, para. 445.

<sup>503</sup> Aktgjykim, para. 440 (citon Dëshmitarin 3, T. 7937-7938, 7942-7943, 7945 (4 shtator 2007) (Seancë private), T. 8008 (5 shtator 2007) Seancë private)); D118 (Fotografi e një kasoljeje në Jabllanicë që përdorej si burg (pamje me një lëndinë)).

<sup>504</sup> Aktgjykim, para. 440 (citon Dëshmitarin 3, T. 7943, 7945-7946, 7948 (4 shtator 2007) (Seancë private), T. 8009 (5 shtator 2007) (Seancë private)).

<sup>505</sup> Aktgjykim, para. 440 (citon Dëshmitarin 3, T. 7945-7946, 7948, 7951 (4 shtator 2007) (Seancë private), T. 8009-8010 (5 shtator 2007) (Seancë private)).

<sup>506</sup> Aktgjykim, para. 381-385.

<sup>507</sup> Dëshmitari 3, T. 7948-7952 (4 shtator 2007) (Seancë private).

<sup>508</sup> Dëshmitari 3, T. 7951 (4 shtator 2007) (Seancë private).

<sup>509</sup> Dëshmitari 3, T. 7949 (4 shtator 2007) (Seancë private).

<sup>510</sup> Dëshmitari 3, T. 7946-7947, 7950-7951 (4 shtator 2007) (Seancë private).

kohëzgjatjen e burgimit të tij, ndaj rrëfimit të Dëshmitarit 6. Për më tepër, mospërputhja nuk lidhet me thelbin e dëshmisë së Dëshmitarit 3, pra, nëse Dëshmitari 3 u rrah apo nuk u rrah, por më shumë me një hollësi jothelbësore për çështjen në fjalë. Si pasojë, Dhoma e Apelit nuk gjykon se mospërputhja e cënon besueshmërinë e Dëshmitarit 3 aq sa të hedhë dyshime mbi dëshminë e tij se e kishin rrahur në shtabin e Jabllanicës dhe konkludon se përfundimi i nxjerrë nga Dhoma Gjyqësore është përfundimi që do të kishte nxjerrë çdo gjykues i arsyeshëm faktesh.

230. Rrjedhimisht kjo pikë e apelit hidhet poshtë.

3. Pretendime për gabime në vlerësimin nga Dhoma Gjyqësore të besueshmërisë së Dëshmitarit 3 (Pika 5)

231. Lahi Brahimaj pohon se Dhoma Gjyqësore ka bërë gabime faktuale dhe ligjore, duke mos shqyrtuar apo dhënë arsye në rrëzimin e kundërshtimeve thelbësore në lidhje me besueshmërinë dhe vërtetësinë e Dëshmitarit 3.<sup>511</sup> Ai parashtron se, ndonëse nuk ekziston kusht ligjor për konfirmim, Dhoma Gjyqësore, në vlerësimin e besueshmërisë së Dëshmitarit 3, duhej të kishte marrë parasysh “se dëshmia e Dëshmitarit 3 për keqtrajtim të pretenduar nuk ishte konfirmuar nga ndonjë dëshmitar tjetër.”<sup>512</sup> Konkretisht, ai parashtron se Dhoma Gjyqësore nuk mori në konsideratë: (a) mospërputhjet midis dëshmisë së Dëshmitarit 3 dhe asaj të Dëshmitarit 6 (pika 5.1);<sup>513</sup> (b) kundërshtitë në dëshmitë e Dëshmitarit 3 dhe të Fadil Fazliut (pika 5.2);<sup>514</sup> (c) motivin e fortë që kishte Dëshmitari 3 për të sajuar dëshminë e tij (pika 5.3);<sup>515</sup> dhe (d) mospërputhjet e brendshme në dëshminë e Dëshmitarit 3 (pika 5.4).<sup>516</sup> Më poshtë shqyrtohen me radhë argumentet konkrete në lidhje me secilin prej këtyre parashtrimeve.

<sup>511</sup> Njoftimi për Apel i Brahimajt, para. 11; Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 89-112; TA. 131-132, 141-144 (Seancë Publike).

<sup>512</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 91; *shih gjithashtu* Njoftimi për Apel i Brahimajt, para. 11.

<sup>513</sup> Njoftimi për Apel i Brahimajt, para. 11.1; Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 93-94.

<sup>514</sup> Njoftimi për Apel i Brahimajt, para. 11.2; Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 95; Dosja e Kundërpërgjigjes së Brahimajt, para. 11.

<sup>515</sup> Njoftimi për Apel i Brahimajt, para. 11.3; Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 96-100; Dosja e Kundërpërgjigjes së Brahimajt, para. 13.

<sup>516</sup> Njoftimi për Apel i Brahimajt, para. 11.4; Dosja e Apelit të Brahimajt, para 101-112.

232. Dhoma e Apelit gjykon se pika 5.1 lidhet me pikën 3 dhe si rrjedhojë e shqyrtoi pikën 5.1 në nënpjesën 1, pjesa C, Kapitulli IV më lart.

(a) Pretendim për kundërshti midis dëshmisë së Dëshmitarit 3 dhe dëshmisë të Fadil Fazliut (Pika 5.2)

233. Lahi Brahimaj argumenton se, në vlerësimin e saj të dëshmive në lidhje me Pikën 34 të Aktakuzës, Dhoma Gjyqësore vuri në dukje kundërshtinë kryesore midis dëshmisë së Fadil Fazliut dhe Dëshmitarit 3,<sup>517</sup> por se nuk ka ndonjë tregues që Dhoma Gjyqësore e mori parasysh këtë kundërshti në vlerësimin e besueshmërisë së Dëshmitarit 3.<sup>518</sup>

234. Prokuroria përgjigjet se dëshmia e Fadil Fazliut nuk lidhet me Pikën 32, sipas të cilës Lahi Brahimaj akuzohet për trajtim mizor dhe torturim të Dëshmitarit 3, por me akuzat që përmban Pika 34,<sup>519</sup> për të cilat të gjithë të akuzuarit u shpallën të pafajshëm. Prokuroria gjithashtu vë në dukje se Dhoma Gjyqësore nuk e hodhi poshtë dëshminë e Fadil Fazliut apo të Dëshmitarit 3 për Pikën 34, kur konkludoi se kishte dyshime të arsyeshme.<sup>520</sup> Prokuroria po ashtu pretendon se dëshmia e dhënë nga dëshmitari tjetër në lidhje me Pikën 34 do të kishte konfirmuar dëshminë e Dëshmitarit 3, dhe jo atë të Fadil Fazliut.<sup>521</sup>

235. Lahi Brahimaj përgjigjet se Prokuroria nuk mund të bazohet në çfarë do të kishte thënë dëshmitari tjetër, në rast se do të kishte dëshmuar në gjyq.<sup>522</sup>

236. Dhoma e Apelit konstaton se në lidhje me Pikën 34 të Aktakuzës, Dhoma Gjyqësore deklaroi se nuk ishte provuar që Naser Lika dhe Fadil Fazliu ishin torturuar apo trajtuar mizorisht.<sup>523</sup> Dhoma Gjyqësore konkludoi se dëshmitë në tërësinë e tyre, ndër të cilat dëshmitë e Fadil Fazliut, Dëshmitarit 3, dhe Dëshmitarit 6, treguan se Naser Lika dhe Fadil Fazliu kishin qenë të dy të pranishëm në shtëpinë e Tal Zekës në Zhabel dhe

<sup>517</sup> Njoftimi për Apel i Brahimajt, para. 95 (që citon Aktgjykimin, para. 454-455, 457).

<sup>518</sup> Njoftimi për Apel i Brahimajt, para. 95; Dosja e Kundërpërgjigjes së Brahimajt, para. 11; TA. 142 (Seancë Publike).

<sup>519</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 48.

<sup>520</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 48.

<sup>521</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 48.

<sup>522</sup> Dosja e Përgjigjes së Brahimajt, para. 12.

<sup>523</sup> Aktgjykim, para. 457.

më pas në Jabllanicë.<sup>524</sup> Sikurse përmbledhet në Aktgjykim, Dëshmitari 3 e pa “Ujku”, Tahir Qorrin, dhe një person të tretë, që mund të ketë qenë Sadri Berisha, që po i zbrisnin me dhunë shkallëve në shtëpinë e Tal Zekës Naser Likën dhe Fadil Fazliun, duke i shkelmuar dhe duke i rrahur, ndërsa Ujku i quante tradhtarë;<sup>525</sup> pas disa javësh, Dëshmitari 3 kishte parë Naser Likën, i cili i tha se i kishin çuar në Jabllanicë ku i kishin rrahur.<sup>526</sup> Dëshmia e Fadil Fazliut, sikurse është përmbledhur nga Dhoma Gjyqësore, është se ai dhe Naser Lika kishin mbërritur në shtëpinë e Tal Zekës.<sup>527</sup> Më pas, një grup ushtarësh të UÇK-së kishin ardhur në shtëpi dhe Lahi Brahimaj dhe një person i thirrur me emrin “Tahir” kishin ardhur për të folur me të pranishmit. Sipas Fadil Fazliut, një burrë i quajtur “Ujku” i kishte fyer atë dhe Naser Likën. Fadil Fazliu deklaroi se të nesërmen “Ujku” ishte kthyer me Arbnor Zenelin dhe i kishte fyer të pranishmit<sup>528</sup> dhe se ai kishte shkuar në Jabllanicë me dëshirën e tij, pasi Arbnor Zeneli i kishte thënë të shkonte aty.<sup>529</sup> Pas vlerësimit të dëshmisë, Dhoma Gjyqësore konkludoi se dëshmia e Fadil Fazliut binte ndesh me dëshminë e Dëshmitarit 3 në lidhje me faktin nëse Fadil Fazliu dhe Naser Lika ishin çuar në Jabllanicë me forcë apo kishin shkuar aty me dëshirën e tyre, dhe në lidhje me faktin nëse ishin keqtrajtuar apo burgosur.<sup>530</sup> Gjithashtu duhet vënë në dukje se Dhoma Gjyqësore kujtoi dëshminë e Dëshmitarit 6, pra, se nuk e njihnte një burrë të quajtur Naser Lika, nuk e njohu në fotografi, dhe se nuk e kishte parë asnjëherë në Jabllanicë apo gjetkë.<sup>531</sup>

237. Dhoma Gjyqësore e mori parasysh kontradiktën midis dëshmisë së Dëshmitarit 3 dhe të Fadil Fazliut si në lidhje me Pikën 32, po ashtu dhe në lidhje me Pikën 34. Në lidhje me Pikën 34, Dhoma Gjyqësore konkludoi se tërësia e të gjitha dëshmive nuk rezultonte në vërtetim përtej dyshimit të arsyeshëm; mirëpo, jo domosdoshmërisht kjo nuk rezulton në përfundimin se e gjithë dëshmia e Dëshmitarit 3, apo e gjithë dëshmia e Fadil Fazliut është e pabesueshme, dhe se duhet hedhur poshtë. Dhoma e Apelit gjykon

<sup>524</sup> Aktgjykim, para. 457.

<sup>525</sup> Aktgjykim, para. 455.

<sup>526</sup> Aktgjykim, para. 455, 457.

<sup>527</sup> Aktgjykim, para. 454.

<sup>528</sup> Aktgjykimi, para. 454.

<sup>529</sup> Aktgjykimi, para. 454.

<sup>530</sup> Aktgjykimi, para. 457.

<sup>531</sup> Aktgjykimi, para. 456.

se pranimi i disa pjesëve të dëshmisë së një dëshmitari dhe rrëzimi i disa të tjerave prej Dhomës Gjyqësore, sigurisht është pjesë e ushtrimit të kompetencës së saj.

238. Rrjedhimisht, kjo nënpikë e apelit hidhet poshtë.

(b) Pretendim për motiv të Dëshmitarit 3 për sajim dëshmie (Pika 5.3)

239. Lahi Brahimaj pretendon se dëshmitë treguan që Dëshmitari 3 kishte motiv të ekzagjeronte apo të gënjente me qëllim që të kërkonte një jetë më të mirë për vete dhe familjen e tij, duke marrë nga Prokuroria statusin e dëshmitarit të zhvendosur.<sup>532</sup> Në mbështetje të këtij pretendimi, ai parashtron, ndër të tjera, se, kur Dëshmitari 3 u pyet gjatë një interviste nga Prokuroria “nëse e dinte që për të siguruar zhvendosjen për vete dhe familjen, ai duhej të thurte një histori mjaft mbresëlënëse, ai e pranoi duke thënë se ‘po, ndoshta është me rëndësi’”.<sup>533</sup> Lahi Brahimaj parashtron se, përpara zhvendosjes së tij, Dëshmitari 3 jetonte në Itali, larg familjes, e cila nuk ishte në gjendje të bashkohej me të për arsye financiare, dhe se tani ai banon me familjen e tij në “një vend të tretë që, siç pohoi, kishte një nga standardet më të larta të jetesës në botën perëndimore” dhe se “në këtë mënyrë ka siguruar përfitime të konsiderueshme financiare dhe përfitime të tjera nga dëshmia e dhënë”.<sup>534</sup> Lahi Brahimaj deklaroi se Dëshmitari 3 kishte kërkuar që familja e tij të zhvendosej, dhe lë të kuptohet se Dëshmitari 3 nuk kishte arsye ta bënte këtë, sepse nuk kishte ndonjë problem me Lahi Brahimajn, familjen e Brahimajt, apo ndonjë njeri tjetër në Kosovë përpara, ose pas lufte.<sup>535</sup> Lahi Brahimaj argumenton se pavarësisht faktit që në Dosjen e tij Gjyqësore Përfundimtare ai argumenton se duke pasur parasysh këto rrethana dhe në mungesë të dëshmimeve të besueshme konfirmuese, do të ishte vendim i pabazuar që ai të shpallej fajtor mbështetur në dëshminë e Dëshmitarit 3, Dhoma Gjyqësore nuk zbatoi standardet e kërkuara të analizës së provave, sikundër përcaktohen

<sup>532</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 96; Dosja e Kundërpërgjigjes së Brahimajt, para. 13; *shih gjithashtu* TA. 142-143 (Seancë Publike).

<sup>533</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 97.

<sup>534</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 98-99.

<sup>535</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 97.

në paragrafin 13 të Aktgjykimit dhe/ose nuk dha ndonjë arsye për rrëzimin e argumenteve të tij.<sup>536</sup>

240. Prokuroria përgjigjet se Dëshmitari 3 nuk kishte motiv ta sajonte dëshminë. Në mbështetje të këtij pohimi, Prokuroria parashtron se Dëshmitari 3, gjatë pyetjeve nga Mbrojtja, e hodhi poshtë një akuzë të tillë dhe deklaroi se po tregonte të vërtetën.<sup>537</sup> Prokurori gjithashtu parashtron se frikësimi i dëshmitarëve e ka shoqëruar gjithë gjykimin, se një përqindje e madhe e dëshmitarëve të thirrur nga Dhoma Gjyqësore kishin shprehur frikë të dëshmonin në këtë çështje, dhe se Dhoma Gjyqësore u kishte akorduar masa mbrojtëse dëshmitarëve të thirrur nga Prokuroria mbështetur në shkaqe objektive të rrezikut për sigurinë apo mirëqenien e dëshmitarëve dhe familjeve të tyre.<sup>538</sup>

241. Dhoma e Apelit kujton, sikurse tregohet më sipër, se Dhoma Gjyqësore në nënpjesën e Aktgjykimit të titulluar “Burimet dhe përdorimi i provave”, përgjithësisht ka konstatuar se gjatë vlerësimit të dëshmive së dëshmitarëve gjatë gjykimin, ajo kishte parasysh “nëse dëshmitari mund të kishte një motiv themelor për të dhënë një rrëfim të caktuar të ngjarjeve”.<sup>539</sup> Dhoma Gjyqësore gjithashtu deklaroi se, ndonëse nuk kërkohet konfirmimi i dëshmisë për fakte materiale, në rastet kur ajo bazohet në dëshminë e një dëshmitari të vetëm për vërtetimin e një fakti material, ajo “ushtroi kujdes të veçantë, duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat me rëndësi për dëshminë e dëshmitarit, përfshirë çdo motiv të mundshëm bazë në dëshminë e dëshmitarit”.<sup>540</sup> Mirëpo Dhoma e Apelit konstaton se Dhoma Gjyqësore asnjëherë nuk i trajtoi qartësisht pretendimet e Lahi Brahimajt se Dëshmitari 3 kishte motiv për ta implikuar Lahi Brahimajn, edhe pse kur e shpalli Lahi Brahimajn fajtor për trajtim mizor dhe torturim, sipas Pikës 32 të Aktakuzës, Dhoma Gjyqësore u mbështet kryesisht në dëshminë e Dëshmitarit 3.<sup>541</sup> Përkundrazi,

<sup>536</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para 96, 100.

<sup>537</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 50 (që citon T. 8022-8023 (5 shtator 2007) (Seancë private)).

<sup>538</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 51 (që citon Aktgjykimin, para. 22).

<sup>539</sup> Aktgjykim, para. 13.

<sup>540</sup> Aktgjykim, para. 14.

<sup>541</sup> Aktgjykim, para. 445-451.

Dhoma Gjyqësore konkludoi se Dëshmitari 3 ishte i besueshëm pa dhënë arsye në mbështetje të përfundimit të saj.<sup>542</sup>

242. Dhoma e Apelit rithekson se, në rast kur Dhoma Gjyqësore shpall fajësinë e një të akuzuari duke u mbështetur në dëshminë e një dëshmitari të vetëm, dëshmia e atij dëshmitari “duhet të vlerësohet me maturinë e duhur, duke bërë kujdes që të parandalohet përdorimi i një motivi bazë nga ana e dëshmitarit”.<sup>543</sup> Për më tepër, “Dhoma Gjyqësore së paku duhet të shpjegojë shkurtimisht arsyen e pranimin të dëshmive të dëshmitarëve që mund të kenë pasur motive apo stimuj për implikimin e të akuzuarit; në këtë mënyrë, Dhoma Gjyqësore demonstroi vlerësimin e saj të kujdesshëm të një dëshmie të tillë”.<sup>544</sup>

243. Në përputhje me këtë jurisprudencë, Dhoma Gjyqësore ishte e detyruar të trajtonte, qoftë edhe shkurtimisht, se përse e gjykoi të besueshme dëshminë e Dëshmitarit 3, pavarësisht nga akuzat se Dëshmitari 3 kishte motiv që të implikonte Lahi Brahimajt. Dhoma e Apelit gjykon se një mosveprim i tillë i Dhomës Gjyqësore përbën gabim ligjor. Bazuar në sa më sipër, Dhoma e Apelit do të përcaktojë nëse një Dhomë Gjyqësore e arsyeshme mund ta kishte gjykuar Dëshmitarin 3 si të besueshëm, pavarësisht nga akuzat e Lahi Brahimajt.<sup>545</sup>

244. Pas vlerësimit të provave gjyqësore, Dhoma e Apelit konkludon se Lahi Brahimaj nuk ka mundur të vërtetojë ekzistencën e një motivi nga ana e Dëshmitarit 3 për të ekzagjeruar apo gënjyer në kërkim të një jete më të mirë për vete dhe familjen e tij. Dhoma e Apelit se argumentet në lidhje me këtë pikë të Lahi Brahimajt janë spekulative dhe pa bazë.

245. Dhoma e Apelit konstaton se duket sikur Lahi Brahimaj lë të kuptojë se Dëshmitari 3 kishte pranuar sajimin e historisë së tij në dëshminë e mëposhtme gjatë pyetjeve nga Mbrojtja:

Pyetje. Ju e dinit se për t’u zhvendosur, duhej të thurnit një histori mjaft mbresëlënëse rreth rëndësisë suaj në pikëpamje të burgimit, apo jo?

<sup>542</sup> Aktgjykim, para. 445.

<sup>543</sup> Aktgjykimi i Apelit *Kordiq* dhe Aktgjykimi i Apelit *Çerkez*, para. 274.

<sup>544</sup> Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 146.

<sup>545</sup> *Shih* Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 385-388.

A. Ndoshta është me rëndësi.<sup>546</sup>

246. Dhoma e Apelit nuk pajtohet me interpretimin e kësaj dëshmie prej Lahi Brahimajt. Dhoma e Apelit mendon se pyetja që iu bë Dëshmitarit 3 ishte e paqartë dhe çorientuese, dhe thekson se kur Dëshmitari 3 u pyet menjëherë pas kësaj nëse fajësonte Lahi Brahimajn për “rrënimin”<sup>547</sup> e tij, ai e mohoi me forcë atë akuzë dhe deklaroi, “Nuk jam këtu që të akuzoj Lahi Brahimajn për asgjë më shumë se sa më ka bërë.”<sup>548</sup> Një dëshmi e tillë nuk do të thotë se Dëshmitari 3 ka pranuar se e ka sajuar dëshminë e tij.

247. Për më tepër, Dhoma e Apelit gjykon që provat se Dëshmitari 3 nuk kishte pasur problem me Lahi Brahimajn përpara apo pas lufte dhe se jeta e tij ishte përmirësuar pas zhvendosjes, nuk tregojnë se Dëshmitari 3 gënjeu apo ekzagjeroi gjatë dëshmisë së tij me qëllim që ai dhe familja e tij të mund të zhvendoseshin. Në këtë drejtim, Dhoma e Apelit beson se zhvendosja është një prej masave që Dhomat Gjyqësore mund të marrin për mbrojtjen e dëshmitarëve gjatë gjykimit, dhe se, në rastin konkret, Dhoma Gjyqësore u akordoi masa mbrojtëse dëshmitarëve vetëm pasi përcaktoi se një dëshmitar i caktuar provonte “një rrezik objektivisht të bazuar për sigurinë apo mirëqenien e dëshmitarit apo familjes së dëshmitarit, në rast se zbulohet se dëshmitari kishte dëshmuar para Tribunalit”.<sup>549</sup>

248. Bazuar sa më sipër, Dhoma e Apelit konkludon se një Dhomë Gjyqësore e arsyeshme mund ta kishte gjykuar Dëshmitarin 3 si të besueshëm, pavarësisht nga akuzat e Lahi Brahimajt se ai kishte motiv për të sajuar dëshminë.

249. Si rrjedhojë, kjo nënpikë e apelit hidhet poshtë.

(c) Mospërputhje të tjera (Pika 5.4)

250. Lahi Brahimaj parashtron se në Dosjen Gjyqësore Përfundimtare të tij, ai ka ngritur çështje të tjera që lidhen me vlerësimin e besueshmërisë së Dëshmitarit 3. Së pari, pretendimi i Dëshmitarit 3 se arsyeja e ndalimit të tij ishte se Lahi Brahimaj “donte që ai

<sup>546</sup> Dëshmitari 3, T. 8022 (5 shtator 2007) (Seancë private).

<sup>547</sup> Dëshmitari 3, T. 8022 (5 shtator 2007) (Seancë private).

<sup>548</sup> Dëshmitari 3, T. 8023 (5 shtator 2007) (Seancë private).

<sup>549</sup> Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para. 22.

të ishte ushtari i tij”,<sup>550</sup> nuk ka kuptim, meqenëse Dëshmitari 3 “nuk ishte aspak një ushtar ideal”,<sup>551</sup> përkrahte UÇK-në, dhe se ndërkohë kishte luftuar krah për krah saj. Së dyti, pohimi i Dëshmitarit 3 se e kishin mbajtur të ndaluar në ndërtesat në oborrin në Jabllanicë për shkak se fshatarët e Grabanicës kishin dezertuar përballë sulmit të serbëve nuk ka kuptim, duke pasur parasysh se tërheqja ndodhi më 21 maj 1998, dhe se Dëshmitari 3 dëshmoi se nuk kishte pasur ndonjë problem me UÇK-në apo me Lahi Brahimajn për pothuaj dy muaj më pas.<sup>552</sup> Së treti, ndonëse Dëshmitari 3 e konfirmoi saktësinë e deklaratave që i kishte dhënë Prokurorisë, të cilat i ishin lexuar në shqip, kur gjatë pyetjeve u ballafaqua me dy pohime të marra nga këto deklarata, ai i mohoi ato, ndërsa ndryshimet në rrëfimin e tij ia atribuoi gabimeve të përkthyesit.<sup>553</sup> Së katërti, dëshmia e Dëshmitarit 6 ndryshon nga ajo e Dëshmitarit 3 në pikën ku Dëshmitari 6 dëshmoi se nuk pati të shtëna teksa Dëshmitari 3 po ikte mes për mes lëndinës, kurse Dëshmitari 3 dëshmoi se të shtënat ishin aq të shpeshta sa që shkaktuan rënie të degëve nga pemët.<sup>554</sup> Së pesti, kur u ballafaqua me faktin se deklarata e nënës së Dëshmitarit 3, dhënë Prokurorisë, nuk e përmendte pretendimin e tij për një rrëmbim të dytë, Dëshmitari 3 shpjegoi se nëna e tij nuk kishte pasur dijeni, gjë që është e papërfytyrueshme po të merret parasysh “atmosfera tejet e ngarkuar në Kosovë në atë kohë”.<sup>555</sup> Së gjashti, Dëshmitari 3 nuk ia përmendi pretendimin e tij për një rrëmbim të dytë Shërbimit Policor të Kosovës kur u intervistua ne 2002, edhe pse u intervistua si viktimë.<sup>556</sup> Lahi Brahimaj pretendon se nuk ka ndonjë tregues se Dhoma Gjyqësore i shqyrtoi këto aspekte<sup>557</sup> dhe argumenton se, në rast se Dhoma Gjyqësore në fakt i ka shqyrtuar, ajo nuk ofroi arsyetim për rrëzimin e tyre.<sup>558</sup>

<sup>550</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 102 (që citon T. 7943 (4 shtator 2007) (Seancë private)).

<sup>551</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 102.

<sup>552</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 103-104 (që citon T. 7897 (3 shtator 2007) (Seancë private), T. 7929 (4 shtator 2007) (Seancë private), T. 8006, 8008 (5 shtator 2007) (Seancë private)).

<sup>553</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 106-108.

<sup>554</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 109 (që citon T. 7957 (4 shtator 2007) (Seancë private), T. 5236 (1 qershor 2007) (Seancë Publike)); Dosja Gjyqësore Përfundimtare, para. 207.

<sup>555</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 110.

<sup>556</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 111.

<sup>557</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 101-112.

<sup>558</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 112.

251. Prokuroria përgjigjet se aftësitë luftarake të Dëshmitarit 3 nuk janë me rëndësi,<sup>559</sup> se mospërputhjet e pretenduara midis dëshmisë së Dëshmitarit 3 në gjyq dhe deklaratave të tij të mëparshme ishin marrë parasysh nga Dhoma Gjyqësore,<sup>560</sup> se Lahi Brahimaj nuk ka provuar që konstatimi i Dhomës Gjyqësore, se Dëshmitari 3 kishte dëgjuar të shtëna teksa po ikte nga shtabi i Jabllanicës, ishte i paarsyeshëm,<sup>561</sup> dhe se arsyet që Dëshmitari 3 nuk ia përmendi nënës së tij rrëmbimin e tij të dytë, janë të arsyeshme dhe të besueshme.<sup>562</sup>

252. Dhoma e Apelit thekson se, ndonëse një i akuzuar ka të drejtë për një mendim të arsyetuar, Dhomat Gjyqësore nuk janë të detyruara të trajtojnë çdo argument me hollësi. Dhomat Gjyqësore po ashtu nuk janë të detyruara të trajtojnë çdo mospërputhje në dëshminë e një dëshmitari, por gëzojnë kompetencë të konsiderueshme gjykimi në trajtimin e mospërputhjeve të vogla në dëshminë e dëshmitarëve. Mirëpo kjo kompetencë duhet të jetë në pajtim me të drejtën e të akuzuarit për një opinion të arsyetuar. Gjithashtu Dhoma Gjyqësore nuk mund të anashkalojë të gjitha mospërputhjet, veçanërisht kur, si në rastin konkret, për shpalljen e fajësisë së të akuzuarit, Dhoma Gjyqësore bazohet kryesisht në dëshminë e një dëshmitari.

253. Sikundër përmendet më parë, Dhoma Gjyqësore përgjithësisht ka deklaruar në Aktgjykim se ajo e ka vlerësuar përputhshmërinë e brendshme të dëshmisë të secilit dëshmitar dhe faktin nëse ka pasur dëshmi konfirmuese.<sup>563</sup> Mirëpo në cilësimin e Dëshmitarit 3 si të besueshëm, Dhoma Gjyqësore nuk dha ndonjë arsye, as nuk trajtoi ndonjëherë prej mospërputhjeve të pretenduara në dëshminë e tij. Si rrjedhojë, Dhoma e Apelit nuk është në gjendje të përcaktojë rëndësinë që Dhoma Gjyqësore u kushtoi këtyre faktorëve, nëse u kushtoi rëndësi, apo nëse këto mospërputhje nuk i mori fare parasysh.

254. Dhoma e Apelit konkludon se një gabim i tillë nga ana e Dhomës Gjyqësore ka shkelur të drejtën e Lahi Brahimajt për një mendim të arsyetuar, gjë që përbën gabim ligjor. Si pasojë, Dhoma e Apelit do të bëjë vlerësimin e argumenteve të tij sipas kësaj

<sup>559</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 53.

<sup>560</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 54 (që citon Aktgjykimin, para. 13).

<sup>561</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 54 (që citon Aktgjykimin, para. 441, shënimi. 2250).

<sup>562</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 54.

<sup>563</sup> Aktgjykim, para. 13.

nënpike të apelit për të përcaktuar nëse një Dhomë Gjyqësore e arsyeshme mund të kishte konkluduar se Dëshmitari 3 ishte i besueshëm, pavarësisht nga mospërputhjet në dëshminë e tij.<sup>564</sup>

255. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Dhoma e Apelit vëren se Dëshmitari 3 ka dhënë informacion thelbësor dhe të hollësishëm në lidhje me ndërtesat ku u mbajt burgosur,<sup>565</sup> kushtet e burgimit,<sup>566</sup> personat që hynë në dhomën e tij gjatë burgimit,<sup>567</sup> dhe veshjen dhe gjendjen e dy burrave të tjerë të burgosur bashkë me të.<sup>568</sup> Dhoma e Apelit mendon se mospërputhjet e pretenduara në dëshminë e tij janë të vogla dhe nuk e zhvlerësojnë këtë dëshmi në tërësinë e saj.

256. Për sa i takon kundërshtimit të parë nga Lahi Brahimaj ndaj besueshmërisë së Dëshmitarit 3, sipas kësaj nënpike të apelit, Dhoma e Apelit gjykon se deklarimi i Dëshmitarit 3 se shkak i ndalimit të tij ishte fakti se Lahi Brahimaj donte që ai të bëhej ushtari i tij, mund të bashkekzistojë në mënyrë të arsyeshme me faktin se ai mund të mos jetë konsideruar ushtar ideal dhe faktin që ndërkohë ai ishte përkrahës i UÇK-së. Argumenti i Lahi Brahimajt, se nuk kishte arsye që Dëshmitari 3 të mbahej i burgosur për ta bërë ushtar të UÇK-së, kur ndërkohë ai kishte luftuar në krah të UÇK-së, është pa vlerë: UÇK-ja nuk ishte lloji i organizatës ku anëtarësia ishte një çështje e qartë, përkundrazi, shpesh përfshinte shqiptarë të Kosovës që luftonin për UÇK-në në formë jozyrtare.<sup>569</sup> Rrjedhimisht mund të nxirret përfundimi se, ndonëse Dëshmitari 3 kishte luftuar në një rast për UÇK-në, kjo nuk do të thoshte se ishte i gatshëm të bënte të njëjtën gjë në një rast tjetër.

<sup>564</sup> *Shih* Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 385-388.

<sup>565</sup> Dëshmitari 3, T. 7951 (4 shtator 2007) (Seancë private).

<sup>566</sup> Dëshmitari 3, T. 7948, 7951 (4 shtator 2007) (Seancë private).

<sup>567</sup> Dëshmitari 3, T. 7949 (4 shtator 2007) (Seancë private).

<sup>568</sup> Dëshmitari 3, T. 7946-7947, 7950-7951 (4 shtator 2007) (Seancë private).

<sup>569</sup> *Shih* Aktgjykimi, para. 66 (ku vihet në dukje se organizimi i UÇK-së “përbëhej kryesisht nga njerëz të zakonshëm që caktonin roje nate dhe ngrinin postblloqe në hyrje të fshatrave” (citon Rrustem Tetajn, T. 3626 (7 maj 2007) (Seancë Publike), T. 3707 (8 maj 2007) (Seancë Publike)), para. 68 (ku vihet në dukje se fshatarët “vetorganizoheshin në mënyrë spontane në njësi mbrojtëse, shpesh duke zgjedhur një komandant fshati” (citon P328 (Jakup Krasniqi, Deklaratë Dëshmitarit, 24 maj 2007, para. 8); P340 (Jakup Krasniqi, *Limaj dhe të tjerë*, T. 3330, 3378-3379, 3415, 3450-3452, 3470-3471 (10-12 shkurt 2005)); Krasniqi, T. 5007-5009, 5046-5049 (30 maj 2007) (Seancë Publike)).

257. Në lidhje me kundërshtimin e dytë të Lahi Brahimajt, Dhoma e Apelit mendon se vonesa prej afërsisht dy muajsh nga koha që Dëshmitari 3 u tërhoq nga Grabanica, deri në kohën që u mbajt në Jabllanicë, ishte dukuri e arsyeshme në këto rrethana.

258. Së treti, Dhoma e Apelit gjykon se pasaktësitë në deklaratën e Dëshmitarit 3 dhënë Prokurorisë nuk janë të qenësishme dhe nuk kanë të bëjnë me ngjarjet kryesore për të cilat Dëshmitari 3 dha dëshmi dhe nuk arrijnë deri në atë shkallë sa të tregojnë se dëshmitari nuk ishte i besueshëm. Për më tepër, gabimet janë të pritshme kur punohet në gjuhë të ndryshme dhe këto gabime u korrigjuan kur Dëshmitari 3 u pyet gjatë gjyqimit.<sup>570</sup>

259. Së katërti, Dhoma Gjyqësore kishte mundësi të arsyeshme të pranonte versionin e Dëshmitarit 3 për ngjarjet që lidheshin me arratisjen e tij (p.sh., zjarr i dendur armësh) dhe të hidhte poshtë rrëfimin e Dëshmitarit 6 se nuk kishte pasur të shtëna teksa Dëshmitari 3 po ikte nëpër lëndinë. Në këtë drejtim, Dhoma e Apelit vëren përfundimin e Dhomës Gjyqësore se “nuk ishte e qartë që Dëshmitari 6 e pa Dëshmitarin 3 kur u arratis nga dhoma e tij.”<sup>571</sup>

260. Në lidhje me kundërshtimin e pestë të Lahi Brahimajt, kur Dëshmitarit 3 i thanë se nëna e tij nuk e kishte përmendur në deklaratën e saj rrëmbimin e tij të dytë, Dëshmitari 3 shpjegoi se, pasi e kishin rrëmbyer një herë, ai nuk i kishte treguar nënës për rrëmbimin e dytë sepse nuk donte që ajo të vuante, sidomos për shkak se ishte keq me shëndet.<sup>572</sup> Dhoma e Apelit gjykon se pranimi nga Dhoma Gjyqësore i këtij shpjegimi përbënte një ushtrim të arsyeshëm të kompetencës së saj gjyqësore.

261. Së fundi, shpjegimi i Dëshmitarit 3, se nuk i kishte treguar shërbimit policor të Kosovës për rrëmbimin e tij sepse i druhej diskutimit në telefon, dhe për shkak se biseda ishte i shkurtër,<sup>573</sup> është plotësisht i arsyeshëm.

<sup>570</sup> *Shih, p.sh.*, Dëshmitari 3, T. 8013 (5 shtator 2007) (Seancë private) (Dëshmitari 3 vuri në dukje se kishte korrigjuar një gabim të përkthyesit herën e tretë që i morën deklaratë).

<sup>571</sup> Aktgjykim, para. 445.

<sup>572</sup> Dëshmitari 3, T. 8025 (5 shtator 2007) (Seancë private).

<sup>573</sup> Dëshmitari 3, T. 8024 (5 shtator 2007) (Seancë private).

262. Mbështetur në sa më sipër, Dhoma e Apelit gjykon se një Dhomë Gjyqësore e arsyeshme do ta kishte konsideruar Dëshmitarin 3 të besueshëm, pavarësisht këtyre mospërputhjeve të pretenduara në dëshminë e tij.

263. Rrjedhimisht kjo nënpikë e apelit hidhet poshtë.

(d) Përfundim

264. Si pasojë, kjo pikë e apelit hidhet tërësisht poshtë.

4. Pretendime për gabime në lidhje me dëshminë e Dëshmitarit 3 për kthimin e tij në Jabllanicë (Pika 6)

265. Lahi Brahimaj parashtron se Dhoma Gjyqësore nxori një përfundim faktual për të cilin nuk kishte prova dhe që binte ndesh me provat e administruara<sup>574</sup> kur konkludoi se Dëshmitari 3 u kthye në Jabllanicë nga që mendonte se nuk ishte më në rrezik, sepse arma i ishte kthyer pronarit të ligjshëm.<sup>575</sup> Lahi Brahimaj argumenton se vendimi i Dëshmitarit 3 për t'u kthyer në Jabllanicë duhet parë në kontekstin e dëshmisë së tij, sipas të cilës Dëshmitari 3 pretendonte se ishin dhënë urdhra për ta kapur ose vvarë atë,<sup>576</sup> dhe se një person i quajtur Florim Zeneli ishte orvatur ta vriste.<sup>577</sup> Lahi Brahimaj pohon se vendimi i Dëshmitarit 3 për t'u kthyer në shtëpinë e Selim Ademit në Jabllanicë, që ndodhej më pak se 150 metra larg vendit ku banonte Lahi Brahimaj, është “i pashpjegueshëm”,<sup>578</sup> në dritën e dëshmisë së tij për keqtrajtim, për arratisje, dhe për urdhra të dhëna për ta vvarë atë, sikundër shihet nga pyetjet që Kryegjykatësi i bëri Dëshmitarit 3 gjatë dëshmisë së tij.<sup>579</sup> Lahi Brahimaj parashtron se shpjegimet e dhëna nga Dëshmitari 3 hedhin dyshime mbi besueshmërinë e tij<sup>580</sup> dhe se, duke qenë se nga

<sup>574</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 119; TA. 143-144 (Seancë private).

<sup>575</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 113.

<sup>576</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 114 (që citon Dëshmitarin 3, T. 7960 (4 shtator 2007) (Seancë private)).

<sup>577</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 114 (që citon Dëshmitarin 3, T. 7968 (4 shtator 2007) (Seancë private)).

<sup>578</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 115.

<sup>579</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 114-116. Gjykatësi Oric e pyeti Dëshmitarin 3 nëse kishte menduar se kthimi i tij në Jabllanicë ishte me “shumë rrezik”. Dëshmitari 3, T. 7968 (4 shtator 2007) (Seancë private).

<sup>580</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 116.

dëshmia mund të nxirreshin përfundime të ndryshme, Dhoma Gjyqësore bëri gabim ligjor kur nuk nxori një përfundim të pajtueshëm me pafajësinë e të akuzuarit.<sup>581</sup>

266. Në përgjigjen e saj, Prokuroria parashtron se shqyrtimi nga Dhoma Gjyqësore i dëshmisë së Dëshmitarit 3 ishte i arsyeshëm,<sup>582</sup> duke pasur parasysh të dy arsytet e dhëna nga Dëshmitari 3 gjatë dëshmisë për kthimin e tij në Jabllanicë, konkretisht, se do të ishte viktimizuar nga UÇK-ja dhe nga forcat serbe, dhe sepse mendonte se ishte zgjidhur problemi për të cilin Lahi Brahimaj e ndiqte, arma që mungonte.<sup>583</sup> Këtu, Prokuroria u referohet atyre pjesëve të dëshmisë së Dëshmitarit 3 ku shpjegohet se arma i ishte kthyer Lahi Brahimajt në kohën midis arratisjes së Dëshmitarit 3 nga ndërtesa e shtabit të UÇK-së dhe kthimit të tij në Jabllanicë, dhe nxjerr përfundimin se Dëshmitari 3 mendonte se rreziku që i vinte nga Lahi Brahimaj kishte kaluar përpara kthimit të tij në Jabllanicë.<sup>584</sup>

267. Dhoma Gjyqësore konkludoi se pas ikjes së tij, Dëshmitari 3 ishte endur fshat më fshat dhe se njerëzit kishin pasur frikë ta ndihmonin pasi kishin dëgjuar se ishte i arratisur në kërkim. Më tej Dhoma Gjyqësore konkludoi se pas arratisjes së tij, Dëshmitari 3 ishte kthyer për afërsisht 10 - 12 ditë në Jabllanicë, ku mendonte se ishte i sigurt për shkak se një Kallashnikov, që ia kishte marrë një shoku të plagosur gjatë betejës së Grabanicës, i ishte kthyer pronarit të ligjshëm. Dhoma Gjyqësore shtoi se Dëshmitari 3 kishte menduar se mbajtja e armës mund të kishte qenë shkak për trajtimin e tij të mëparshëm.<sup>585</sup>

268. Dhoma e Apelit do të shqyrtojë dëshmitë që lidhen me këtë përfundim për të përcaktuar nëse përfundimi ishte i arsyeshëm. Dhoma e Apelit konstaton se dëshmia e Dëshmitarit 3 nuk ishte plotësisht përputhëse. Fillimisht, gjatë pyetjeve kryesore të Prokurorisë, ai deklaroi se gjatë kohës që po e rihnin, i kishte thënë Lahi Brahimajt se, në rast se do ta lironin, do ta sillte armën automatike që kërkonte Lahi Brahimaj.<sup>586</sup> Gjithsesi, në dëshminë e tij të mëpasme, ai deklaroi se ndërkohë arma i ishte kthyer Lahi

<sup>581</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 119.

<sup>582</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 56.

<sup>583</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 56 (citon Dëshmitarin 3, T. 7960-7961, 7967-7968 (4 shtator 2007) (Seancë private), T. 8012 (5 shtator 2007) (Seancë private)).

<sup>584</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 56 (që citon Dëshmitarin 3, T. 7960 (4 shtator 2007) (Seancë private)).

<sup>585</sup> Aktgjykim, para. 441, 442 (që citon Dëshmitarin 3, T. 7957, 7959-7960, 7968 (4 shtator 2007) (Seancë private), T. 8003-8005, 8010-8012, 8015-8016, 8026 (5 shtator 2007) (Seancë private)).

<sup>586</sup> Dëshmitari 3, T. 7954 (4 shtator 2007) (Seancë private).

Brahimajt. Dëshmitari 3 shpjegoi se “Selim Ademi shkoi të fliste me Lahi [Brahimajn], me qëllim që unë të mos kisha më problem me të. Kështu, ata ranë dakord se tani që arma automatike ishte kthyer, nuk kishte më ndonjë problem të pazgjidhur.”<sup>587</sup> Gjatë pyetjeve nga Mbrojtja, Dëshmitari 3 deklaroi se kishte menduar që kjo çështje ishte mbyllur pasi Lahi Brahimaj e kishte siguruar Selim Ademin në lidhje me të, por “doli se nuk kishte qenë ashtu.”<sup>588</sup> Gjithashtu Mbrojtja e pyeti Dëshmitarin 3 se si e kishte siguruar armën, e cila më parë kishte qenë e një luftëtari të UÇK-së, të plagosur në betejë. Më vonë, ai kishte takuar një person i cili pretendonte se arma ishte e tij, kështu që Dëshmitari 3 ia kishte dhënë armën atij, duke qenë se personi në fjalë kishte qenë në gjendje të identifikonte tiparet dalluese të saj.<sup>589</sup>

269. Dhoma e Apelit gjykon se dëshmia e Dëshmitarit 3 mbështet përfundimin e Dhomës Gjyqësore se Dëshmitari 3 ishte kthyer në Jabllanicë për shkak se mendonte që nuk ishte më në rrezik, sepse arma i ishte kthyer pronarit të ligjshëm. Lahi Brahimaj thekson se nuk kishte dëshmi të drejtpërdrejtë se Dëshmitari 3 e dinte, përpara kthimit të tij në Jabllanicë, se arma ishte kthyer. Mirëpo Dhoma e Apelit konkludon se përfundimi i Dhomës Gjyqësore ishte i arsyeshëm, duke pasur parasysh të gjitha provat. Për më tepër, Dhoma e Apelit vëren se Dëshmitari 3 ishte në pozitë shumë të vështirë, nuk mund të gjente askënd që ta ndihmonte, dhe mendonte se nuk mund të gjente vendstrehim tjetër veç shtëpisë së Selim Ademit.<sup>590</sup> Ai dëshmoi si më poshtë gjatë pyetjeve të bëra nga Dhoma:

Vendosa të kthehesha në Jabllanicë pavarësisht rrezikut, sepse vdekjen e kisha thujse të sigurtë, por nuk kisha ku të shkoja, dhe në fshatrat e tjera, kishte shumë policë serbë. Nuk kisha asnjë mundësi në ato rrethana, nga të dy palët do të isha i vrarë. Kështu që mendova se [ata] do të më ndihmonin, dhe në një farë mënyre u detyrova të kërkoja strehë atje. Isha si të them ne mes, midis serbëve dhe shqiptarëve. Kushdo që do të më kapte i pari, do të më vriste, qoftë serbët, qoftë UÇK-ja.<sup>591</sup>

Si rrjedhojë, Dhoma e Apelit gjykon se Lahi Brahimaj nuk ka provuar se Dhoma Gjyqësore gaboi në përfundimin e saj se arsyeja e kthimit të Dëshmitarit 3 në Jabllanicë

<sup>587</sup> Dëshmitari 3, T. 7960-7961 (4 shtator 2007) (Seancë private).

<sup>588</sup> Dëshmitari 3, T. 8012 (5 shtator 2007) (Seancë private).

<sup>589</sup> Dëshmitari 3, T. 8003-8005 (5 shtator 2007) (Seancë private).

<sup>590</sup> Dëshmitari 3, T. 7959-7960, 7968 (4 shtator 2007) (Seancë private).

<sup>591</sup> Dëshmitari 3, T. 7968 (4 shtator 2007) (Seancë private).

ishte se ai mendonte që ishte i sigurt për shkak se arma i ishte kthyer të zotit. Gjithashtu Dhoma e Apelit konkludon se Lahi Brahimaj nuk mundi të provonte se nga dëshmia mund të nxirreshin përfundime të tjera të arsyeshme, që të përputheshin me pafajësinë e Lahi Brahimajt.

270. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit e hedh poshtë këtë pikë të apelit.

**D. Pretendime për Gabime në lidhje me Rrahjen e Parë të Dëshmitarit 3 (Pikat 7 dhe 8)**

**1. Pretendim për mosnxjerrje përfundimesh mbi rrahjen e parë (Pika 7)**

271. Lahi Brahimaj argumenton se Dhoma Gjyqësore përshkroi tri seri faktesh mbi të cilat e bazoi fajësinë për keqtrajtim të Dëshmitarit 3:<sup>592</sup> (a) rrahje me shkopinj bejsbolli nga persona të panjohur kur Dëshmitari 3 u soll për herë të parë në ndërtesën e shtabit të UÇK-së (“rrahja e parë”);<sup>593</sup> (b) marrje në pyetje nga disa persona, ndër të cilët Lahi Brahimaj (“marrja në pyetje”);<sup>594</sup> dhe (c) rrëmbimi dhe keqtrajtimi i tij nga Lahi Brahimaj të paktën 10 ditë më pas (“rrëmbimi”).<sup>595</sup> Lahi Brahimaj parashtroi se Dhoma Gjyqësore shkeli të drejtën e tij për një mendim të arsyetuar, duke mos përcaktuar qartë nëse synonte ta përfshinte rrahjen e parë në fajësinë e tij, përveç marrjes në pyetje dhe rrëmbimit, kur konkludoi se ishte bindur jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se ai kishte kryer trajtim mizor dhe torturim sipas Pikës 32.<sup>596</sup>

272. Në mbështetje të argumentit të tij, Lahi Brahimaj vë në dukje dy përfundime të nxjerra nga Dhoma Gjyqësore. Së pari, Lahi Brahimaj kujton se Dhoma Gjyqësore ia atribuoi rrahjen e parë disa “personave të panjohur”,<sup>597</sup> pastaj “ushtarëve të UÇK-së, apo personave të lidhur me UÇK-në”,<sup>598</sup> por më pas, erdhi në përfundimin se Lahi Brahimaj kishte kryer trajtim mizor dhe torturim sipas Pikës 32, pa përcaktuar nëse ky përfundim

<sup>592</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 120 (që citon Aktgjykimin, para. 440-442).

<sup>593</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 120.1 (që citon Aktgjykimin, para. 440).

<sup>594</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 120.2 (që citon Aktgjykimin, para. 441).

<sup>595</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 120.3 (që citon Aktgjykimin, para. 442).

<sup>596</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 121, 124, 126,

<sup>597</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 122 (që citon Aktgjykimin, para. 440).

<sup>598</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 123 (që citon Aktgjykimin, para. 447).

përfshinte rrahjen e parë.<sup>599</sup> Së dyti, Lahi Brahimaj vë në dukje se në kapitullin “Fajësia e shumëfishtë”, Dhoma Gjyqësore konkludoi se kishin ndodhur “dy incidente të sjelljes kriminale”<sup>600</sup> në lidhje me Pikën 32, por diskutoi tri seri faktesh që kishin ndodhur në ditë të ndryshme. Lahi Brahimaj vjen në përfundimin se Dhoma Gjyqësore mund të ketë pasur si qëllim ta fajësonte Lahi Brahimajn vetëm për seritë e fundit të fakteve, pra, marrjen në pyetje dhe rrëmbimin, por jo për rrahjen e parë.<sup>601</sup>

273. Prokuroria përgjigjet se Dhoma Gjyqësore shpjegoi se fajësia e Lahi Brahimajt përfshinte si rrahjen e parë, po ashtu edhe marrjen në pyetje,<sup>602</sup> që në fakt përbënin një ngjarje të vetme ku Lahi Brahimaj luante rolin drejtues dhe kryesor.<sup>603</sup> Prokuroria parashtron se argumentet e Lahi Brahimajt nuk tregojnë se përfundimi i Dhomës Gjyqësore ishte i paarsyeshëm.<sup>604</sup>

274. Dhoma e Apelit konstaton se Dhoma Gjyqësore analizoi dy seri faktesh të ndodhura pak kohë pas mbërritjes dhe ndalimit të Dëshmitarit 3 në ndërtesën e shtabit të Jabllanicës, pra, rrahja nga anëtarë të UÇK-së, apo persona të lidhur me ta<sup>605</sup> dhe marrja në pyetje, gjatë të cilës dy gra e goditën Dëshmitarin 3 në duar.<sup>606</sup> Dhoma Gjyqësore i gjykoi këto ngjarje si *incidenti i parë* i sjelljes kriminale.<sup>607</sup> Më pas, Dhoma Gjyqësore konstatoi se rrëmbimi i Dëshmitarit 3 nga Lahi Brahimaj përbënte *incidentin e dytë të sjelljes kriminale*<sup>608</sup>. Dhoma Gjyqësore konkludoi se incidenti i parë i sjelljes kriminale i shkaktoi Dëshmitarit 3 vuajtje të mëdha fizike, se keqbërësit kishin synim t’i shkaktonin atij vuajtje të tilla, se rrahjet synonin ta ndëshkonin dhe diskriminonin Dëshmitarin 3, dhe se keqtrajtimi i tij përbënte trajtim mizor dhe torturim.<sup>609</sup> Dhoma e Apelit gjykon se sa më sipër tregon synimin e qartë të Dhomës Gjyqësore për të përfshirë në përfundimin e

<sup>599</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 124 (që citon Aktgjykimin, para. 451).

<sup>600</sup> Aktgjykim, para. 481.

<sup>601</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 125.

<sup>602</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 58 (që citon Aktgjykimin, para. 445-447, 449, 490).

<sup>603</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 58 (që citon Aktgjykimin, para. 441); TA. 154-155 (Seancë Publike).

<sup>604</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 61.

<sup>605</sup> Aktgjykim, para. 445.

<sup>606</sup> Aktgjykim, para. 446.

<sup>607</sup> Aktgjykim, para. 481.

<sup>608</sup> Aktgjykim, para. 481.

<sup>609</sup> Aktgjykim, para. 447.

saj në lidhje me incidentin e parë të sjelljes kriminale, si “rrahjen e parë”, po ashtu dhe “marrjen në pyetje”, që përfshinte gjithashtu dhe rrahjet.

275. Në lidhje me incidentin e dytë të sjelljes kriminale, Dhoma Gjyqësore analizoi dëshminë e dhënë nga Dëshmitari 3<sup>610</sup> dhe erdhi në përfundimin se faktet përbënin vetëm trajtim mizor.<sup>611</sup>

276. Dhoma e Apelit mendon se Dhoma Gjyqësore identifikoi dy incidente të sjelljes kriminale që çuan në dy verdikte fajësie,<sup>612</sup> konkretisht, (a) trajtim mizor dhe torturim,<sup>613</sup> që mbulon incidentin e parë të sjelljes kriminale (“rrahja e parë” dhe “marrja në pyetje”) dhe (b) vetëm trajtim mizor, që mbulon incidentin e dytë të sjelljes kriminale (“rëmbimi”). Për më tepër, Dhoma Gjyqësore konkludoi se “roli i Brahimajt gjatë marrjes në pyetje të *Dëshmitarit 3 pas mbërritjes së tij* në objektin e Jabllanicës vërteton synimin për t’i shkaktuar vuajtje të rënda fizike me qëllim që ta ndëshkonte për mosdorëzimin e një arme dhe ta diskriminonte sepse mendohej se kishte lidhje me serbët”.<sup>614</sup> Formulimi i këtij përfundimi është një tregues tjetër se Dhoma Gjyqësore e ka përfshirë rrahjen e parë në përcaktimin e fajësisë sipas Pikës 32, duke qenë se si rrahja e parë ashtu edhe marrja në pyetje, ndodhën pas mbërritjes së Dëshmitarit 3 në oborrin me ndërtesa.

277. Si pasojë, Dhoma e Apelit gjykon që Lahi Brahimaj nuk arriti të provonte se Dhoma Gjyqësore kreu gabim ligjor, mbështetur në arsyetim të paqartë të saj, për sa i takon fajësisë së tij për keqtrajtim gjatë rrahjes së parë.<sup>615</sup>

278. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit e hedh poshtë këtë pikë të apelit.

<sup>610</sup> Aktgjykim, para. 449.

<sup>611</sup> Aktgjykim, para. 449.

<sup>612</sup> Aktgjykim, para. 481.

<sup>613</sup> Dhoma Gjyqësore e deklaroi Lahi Brahimajn fajtor për trajtim mizor dhe torturim në lidhje me incidentin e parë të sjelljes kriminale, por, pasi zbatoi ligjin për fajësi të shumëfishtë, e dënoi vetëm për torturim.

<sup>614</sup> Aktgjykim, para. 451 (theksi është shtuar).

<sup>615</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 121, 124, 126.

2. Pretendim për gabim në lidhje me përgjegjësinë e Lahi Brahimajt për rrahjen e parë  
(Pika 8)

279. Lahi Brahimaj argumenton se, në qoftë se Dhoma Gjyqësore synonte ta fajësonte për rrahjen e parë të Dëshmitarit 3, ajo nuk paraqiti arsye për vendimin e marrë dhe kreu gabime faktuale.<sup>616</sup> Lahi Brahimaj parashtroi se Dhoma Gjyqësore konkludoi se veprimet e kryera në lidhje me rrahjen e parë ishin kryer nga ushtarë të UÇK-së apo persona të lidhur me ta<sup>617</sup> dhe se, ndonëse Lahi Brahimaj e kishte sjellë Dëshmitarin 3 në kazermë, ai ishte larguar përpara se të fillonte rrahja.<sup>618</sup> Lahi Brahimaj argumenton gjithashtu se Dhoma Gjyqësore e fajësoi për kryerjen e këtyre veprimeve, dhe jo mbi bazën e pjesëmarrjes në një NPK, për planifikim, nxitje, ndihmë dhe inkurajim, sikundër pretendohet në Aktakuzë. Ai deklaroi se Aktakuza nuk pretendon se ai mbante postin e komandantit të Shtabit të Zonës Operative të Dukagjinit në periudhën përkatëse dhe se, rrjedhimisht, baza e fajësisë së dhënë nga Dhoma Gjyqësore është e paqartë.<sup>619</sup>

280. Prokuroria përgjigjet se Dhoma Gjyqësore e përshkroi sjelljen e Lahi Brahimajt gjatë kohës që Dëshmitari 3 torturohej dhe se me të drejtë gjykoj se përbënte torturim.<sup>620</sup> Për më tepër Prokuroria argumenton se faktet materiale<sup>621</sup> lidhur me sjelljen e Lahi Brahimajt ishin të përfshira në Aktakuzë dhe në Dosjen Paragjyqësore të Prokurorisë.<sup>622</sup> Prokuroria parashtroi se argumentet e Lahi Brahimajt nuk tregojnë se përfundimi i nxjerrë nga Dhoma Gjyqësore ishte i paarsyeshëm.<sup>623</sup>

<sup>616</sup> Njoftimi për Apel i Brahimajt, para. 14 (citon Aktgjykimin, para. 440-451); Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 127.

<sup>617</sup> Njoftimi për Apel i Brahimajt, para. 14.1; Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 128 (citon Aktgjykimin, para. 440).

<sup>618</sup> Njoftimi për Apel i Brahimajt, para. 14.2; Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 128 (citon Aktgjykimin, para. 440-445).

<sup>619</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 129.

<sup>620</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 60 (citon Aktgjykimin, para. 440-441).

<sup>621</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 60 (citon Aktgjykimin e Apelit *Simiq*, para. 20; Aktgjykimin e Apelit *Naletiliq dhe Martinoviq*, para. 23; Aktgjykimin e Apelit *Kvoçka e të tjerë*, para. 27; Aktgjykimin e Apelit *Kupreshkiq e të tjerë*, para. 88; Aktgjykimin e Apelit *Ntakirutimana*, para. 470; Aktgjykimin e Apelit *Semanza*, para. 85; Aktgjykimin e Apelit *Gacumbitsi*, para. 123).

<sup>622</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 60 (që citon Aktakuzën, para. 103, 105; Dosjen Paragjyqësore të Prokurorisë, para. 148-149).

<sup>623</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 61.

281. Dhoma e Apelit mendon se orvatja e Lahi Brahimajt për ta veçuar rrahjen e parë të Dëshmitarit 3 nga marrja në pyetje, që ndodhi gjatë të njëjtës periudhë të shkurtër të mbajtjes së tij, është një orvatje për të ndarë në mënyrë artificiale dy seri faktesh, që logjikisht përbënin një incident të vetëm dhe që u analizuan në mënyrë të drejtë nga Dhoma Gjyqësore si të tillë. Sikundër thuhet më lart, Dhoma e Apelit mendon se incidenti i parë i sjelljes kriminale përfshinte si rrahjen e parë ashtu edhe marrjen në pyetje më pas, ndërsa incidenti i dytë përfshinte rrëmbimin e Dëshmitarit 3 nga Lahi Brahimaj.<sup>624</sup> Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore e ka analizuar si duhet rrahjen e parë brenda një kuadri më të gjerë ngjarjesh, të cilat përfshinë ndalimin e parë nga Lahi Brahimaj të Dëshmitarit 3 dhe rolin e tij të mëvonshëm në marrjen në pyetje dhe rrahjen e këtij dëshmitari.

282. Dhoma e Apelit më tej vëren se, për incidentin e parë të sjelljes kriminale, Dhoma Gjyqësore u bazua në faktet që lidheshin me rrahjen e parë, me qëllim vërtetimin e fajësisë së Lahi Brahimajt për trajtim mizor dhe torturimin e Dëshmitarit 3. Dhoma Gjyqësore konkludoi se synimi i Lahi Brahimajt për t'i shkaktuar vuajtje të rënda fizike Dëshmitarit 3 u provua që prej momentit kur Dëshmitari 3 mbërriti në oborrin me ndërtesat dhe përfshiu të gjithë kohën që ai u mbajt aty.<sup>625</sup> Dhoma Gjyqësore konkludoi se rrahjet i shkaktuan Dëshmitarit 3 vuajtje të rënda fizike dhe se keqbërësit kishin për qëllim ti shkaktounin vuajtje të tilla, se rrahjet e Dëshmitarit 3 kishin për qëllim ta ndëshkonin se nuk kishte dorëzuar armën, si dhe ta diskriminonin mbi bazën e mendimit se ai kishte lidhje me serbet, dhe se një gjë e tillë përbënte trajtim mizor dhe torturë.<sup>626</sup> Si rrjedhojë, Dhoma e Apelit e gjykon të pabazë argumentin e Lahi Brahimajt se Dhoma Gjyqësore nuk ofroi arsye për fajësinë e tij në lidhje me rrahjen e parë të Dëshmitarit 3.

283. Për sa i takon pretendimit të Lahi Brahimajt se baza e fajësisë së tij për rrahjen e parë është e paqartë, duke qenë se Aktakuza nuk pretendon se ai mbante postin e komandantit në kohën në fjalë, Dhoma e Apelit vëren se Aktakuza e Ndryshuar për Herë të Katërt pohon se Lahi Brahimaj “kreu ose planifikoi, nxiti, apo ndihmoi dhe inkurajoi

<sup>624</sup> *Shih* nënpjesën 1, pjesa D, Kapitulli IV. më sipër.

<sup>625</sup> Aktgjykim, para. 451.

<sup>626</sup> Aktgjykim, para. 447.

kryerjen e krimeve të përshkruara”.<sup>627</sup> Dhoma e Apelit ka konkluduar tashmë se Dhoma Gjyqësore nuk gaboï kur analizoi provat në lidhje me rrahjen e parë dhe marrjen në pyetje si një incident i vetëm kriminal.<sup>628</sup> Në bazë të provave për rrahjen e parë dhe marrjen në pyetje të Dëshmitarit 3, Dhoma Gjyqësore konkludoi se “se roli i Lahi Brahimajt gjatë marrjes në pyetje të Dëshmitarit 3 pas mbërritjes së këtij të fundit në objektin e Jabllanicës vërteto[i] synimin për t’i shkaktuar vuajtje të rënda fizike me qëllim që ta ndëshkonte për mosdorëzimin e një arme dhe ta diskriminonte sepse mendohej se kishte lidhje me serbët.”<sup>629</sup> Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore u bind jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm, se Lahi Brahimaj kreu trajtimin mizor të sipërpërmendur dhe torturimin e Dëshmitarit 3 sipas Pikës 32.<sup>630</sup> Si pasojë Dhoma e Apelit gjykon se është e qartë që Dhoma Gjyqësore e fajësoi Lahi Brahimajn për kryerjen e krimeve, dhe jo mbi bazën e pjesëmarrjes në NPK, apo për planifikimin, nxitjen, apo ndihmën dhe inkurajimin e tyre, dhe se roli drejtues i Lahi Brahimajt nuk ishte as element i qenësishëm i përgjegjësisë së tij individuale penale për kryerjen e tyre, as fakt material i nevojshëm për fajësinë e tij sipas kësaj forme përgjegjësie.

284. Bazuar në sa më sipër, Dhoma e Apelit konkludon se Lahi Brahimaj nuk ka mundur të identifikojë ndonjë gabim nga ana e Dhomës Gjyqësore në fajësinë e tij për trajtim mizor dhe torturim të Dëshmitarit 3.

285. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit e hedh poshtë këtë pikë të apelit.

**E. Pretendime për Gabime në lidhje me Motivet e Lahi Brahimajt për Torturimin e Dëshmitarit 3 (Pika 9)**

286. Lahi Brahimaj parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboï në përfundimet në lidhje me fajësinë e tij për torturimin e Dëshmitarit 3. Në këtë drejtim, Lahi Brahimaj argumenton se Prokuroria nuk arriti të provonte asnjërin prej motiveve të tij për keqtrajtim, që kërkohen për fajësinë e torturimit. Ai gjithashtu pretendon se Dhoma Gjyqësore gaboï kur konkludoi se ai synonte ta diskriminonte Dëshmitarin 3 mbi bazën e “mendimit për

<sup>627</sup> Aktakuza, para. 106.

<sup>628</sup> *Shih* më sipër nënpjesën 1, pjesa D, Kapitulli IV.

<sup>629</sup> Aktgjykim, para. 451.

<sup>630</sup> Aktgjykim, para. 451.

lidhje” të këtij dëshmitari me serbët.<sup>631</sup> Lahi Brahimaj më tej pohon se Dhoma Gjyqësore shpërfilli prova lidhur me mosdorëzimin e një pushte nga Dëshmitari 3. Së fundi, Lahi Brahimaj parashtron se përfundimi i Dhomës Gjyqësore, se motivi për keqtrajtimin e Dëshmitarit 3 ishte ndëshkimi i tij për mosdorëzimin e një pushke, përbën “gabim faktual dhe /ose ligjor, sepse ky fakt material nuk përfshihet si akuzë në aktakuzë dhe sepse Lahi Brahimaj nuk mori njoftim të duhur, madje asnjë ndonjë lloj njoftimi, për një bazë të tillë alternative për fajësinë e tij”.<sup>632</sup>

287. Prokuroria përgjigjet se argumentet e Lahi Brahimajt “nuk provojnë që Dhoma [Gjyqësore] gaboi, dhe duhen hedhur poshtë.”<sup>633</sup> Prokuroria beson se motivet e Lahi Brahimajt për torturimin e Dëshmitarit 3 “janë të ndërthurura dhe se orvatja [e tij] për t’i ndarë është e pabazuar.”<sup>634</sup>

1. A arriti Prokuroria të provonte një apo më shumë elemente të torturimit

288. Lahi Brahimaj pretendon se Prokuroria “nuk arriti të provonte një apo më shumë elemente materiale të akuzës për torturim, konkretisht synimin për të siguruar informacione apo një pohim, përmes ndëshkimit, frikësimit shtrëngimit, apo diskriminimit për çfarëdo arsye.”<sup>635</sup> Prokuroria nuk jep përgjigje konkrete për këtë argument.

289. Si fillim, Dhoma e Apelit konstaton se Lahi Brahimaj nuk orvatet t’u referohet provave ku bazohet ky pretendim i tij i gjerë. Gjithashtu, nuk është e qartë nëse Lahi Brahimaj pretendon se gabimi i pretenduar është ligjor apo faktual; si rrjedhim Dhoma e Apelit nuk është e detyruar ta shqyrtojë këtë parashtrim.<sup>636</sup> Gjithsesi, për faktin se ky

<sup>631</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, 133, që i referohet Aktgjykimit, para. 451.

<sup>632</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para 131-136.

<sup>633</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 63.

<sup>634</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 63.

<sup>635</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 136.

<sup>636</sup> Dhoma e Apelit në çështjen *Kërnojelac* konstatoi si më poshtë: “Në parim, Dhoma e Apelit nuk është e detyruar të shqyrtojë parashtrimet e një pale në rast se ato nuk kanë të bëjnë me një gabim ligjor, i cili e bën të pavlefshëm vendimin apo, me një gabim faktual që shkakton dështimin e drejtësisë. Rrjedhimisht nuk ka aspak kuptim që një palë të përsërisë në apel argumente që kanë dështuar gjatë gjykimit, në rast se pala nuk provon se rrëzimi i atyre argumenteve ka rezultuar në një gabim të tillë që e përlligj ndërhyrjen e Dhomës së Apelit”. Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 15.

pretendim është i lidhur thelbësisht me pretendimet e tjera të Lahi Brahimajt, Dhoma e Apelit do ta trajtojë.

290. Jurisprudenca e Tribunalit e përcakton torturën si më poshtë:

(i) Shkaktim, përmes veprimit apo mosveprimit, i dhimbjeve apo vuajtjeve të rënda fizike apo mendore.

(ii) Veprimi ose mosveprimi duhet të jetë i qëllimshëm.

(iii) Synimi i veprimit apo mosveprimit duhet të jetë marrja e informacionit, apo e një pohimi, ose ndëshkimi, frikësimi, apo shtrëngimi i viktimës apo një personi të tretë, ose diskriminimi për çfarëdo shkakui i viktimës apo i një personi të tretë.<sup>637</sup>

291. Në rastin konkret, Dëshmitari 3 dëshmoi se, bashkë me katër apo pesë të tjerë, ai ishte përpjekur pa sukses të mbronte Grabanicën në komunën e Klinës dhe se më pas ishin tërhequr.<sup>638</sup> Kur ishte në komunën e Pejës, Dëshmitari 3 kishte hasur Lahi Brahimajn dhe Alush Agushin, i cili e kishte denoncuar Dëshmitarin 3 dhe të tjerët si tradhtarë për tërheqjen nga përpjekjet për mbrojtjen e fshatit.<sup>639</sup> Dëshmitari 3 qëndroi për një kohë të shkurtër në Jabllanicë, por pastaj u largua sepse dëgjoi nga fshatarët tek të cilët bujtke, se shtabi i UÇK-së ishte në kërkim të personave që kishin braktisur Grabanicën.<sup>640</sup> Në korrik 1998, Lahi Brahimaj erdhi të kërkonte Dëshmitarin 3 dhe më pas e shpuri në ndërtesën e shtabit të UÇK-së në Jabllanicë dhe e la Dëshmitarin 3 në një dhomë.<sup>641</sup> Disa minuta më vonë, Dëshmitari 3 u rrah nga disa persona me shkopinj bejsbolli deri sa humbi vetëdijen.<sup>642</sup> Dëshmitari 3 ndenji në atë dhomë dy net dhe tri ditë.<sup>643</sup> Lahi Brahimaj e shpuri në një moment Dëshmitarin 3 në një dhomën ngjitur, ku e mori në pyetje, duke e akuzuar se mbështeste policinë serbe dhe se mbante një arme automatike.<sup>644</sup> Lahi Brahimaj gjithashtu u tha dy grave që ishin në dhomë të

<sup>637</sup> Aktgjykimi i Apelit *Kunarac e të tjerë*, para. 142 (citon përkufizimin e torturës, përdorur nga Dhoma Gjyqësore në Aktgjykimin *Kunarac e të tjerë*, para. 497).

<sup>638</sup> Aktgjykimi, para. 439 (citon Dëshmitarin 3, T. 7916, 7922, 7993 (4 shtator 2007) (Seancë private)).

<sup>639</sup> Aktgjykimi, para. 439 (citon Dëshmitarin, T. 7922-7924, 7989, 7992 (4 shtator 2007) (Seancë private)).

<sup>640</sup> Aktgjykimi, para. 439 (citon Dëshmitarin, T. 7929-7930, 7933-7937, 7993 (4 shtator 2007) (Seancë private), T. 8006 (5 shtator 2007) (Seancë private)).

<sup>641</sup> Aktgjykimi, para. 440 (citon Dëshmitarin 3, T. 7943-7945 (4 shtator 2007) (Seancë private)).

<sup>642</sup> Aktgjykimi, para. 440 (citon Dëshmitarin 3, T. 7943, 7945-7946, 7958 (4 shtator 2007) (Seancë private), T. 8009 (5 shtator 2007) (Seancë private)).

<sup>643</sup> Aktgjykimi, para. 441 (citon Dëshmitarin 3, T. 7945, 7948 (4 shtator 2007) (Seancë private), T. 8009-8010 (5 shtator 2007) (Seancë private)).

<sup>644</sup> Aktgjykimi, para. 441 (citon Dëshmitarin 3, T. 7951-7953, 7958 (4 shtator 2007) (Seancë private)).

“praktikoheshin” me Dëshmitarin 3, të cilat pastaj e rrahën Dëshmitarin 3 me dylbi për pesë deri në dhjetë minuta.<sup>645</sup> Lahi Brahimaj gjithashtu i dha revolen e tij Dëshmitarit 3, duke i thënë të vriste veten.<sup>646</sup> Burri tjetër që ishte në dhomë e akuzoi Dëshmitarin 3 si bashkëpunëtor të serbëve, duke e kërcënuar se do t’i priste fytyrën.<sup>647</sup>

292. Dhoma Gjyqësore konkludoi se:

Sipas dëshmisë për rrahjet dhe marrjen në pyetje [...] Lahi Brahimaj e futi Dëshmitarin 3 në një dhomë në objektin e Jabllanicës. Menjëherë pas kësaj, në dhomë hynë ushtarë të UÇK-së apo persona të lidhur me UÇK-në, të pajisur me shkopinj bejsbolli, me të cilët e rrahën Dëshmitarin 3. Dëshmia përcakton gjithashtu se Dëshmitari 3 u mbajt në atë dhomë deri kur Lahi Brahimaj e çoi në një dhomë tjetër dhe e mori në pyetje Dëshmitarin 3 ndërkohë që persona të tjerë e rrihnin. Dhoma Gjyqësore gjykon se roli i Lahi Brahimajt gjatë marrjes në pyetje të Dëshmitarit 3 pas mbërritjes së këtij të fundit në objektin e Jabllanicës vërtetohet synimin për t’i shkaktuar vuajtje të rënda fizike me qëllim që ta ndëshkonte për mosdorëzimin e një arme dhe ta diskriminonte sepse mendohej se kishte lidhje me serbët. Për këto arsye, Dhoma Gjyqësore është e bindur jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se Lahi Brahimaj kreu trajtimin e lartpërmendur mizor dhe torturimin sipas Pikës 32.<sup>648</sup>

Në këtë mënyrë Dhoma Gjyqësore përcaktoi dy motive për torturimin: ndëshkim për mosdorëzim arme dhe diskriminim për shkak se mendohej që Dëshmitari 3 kishte lidhje me serbët. Dhoma e Apelit konkludon se duke pasur parasysh dëshmitë e paraqitura në gjyq, përfundimet e Dhomës Gjyqësore ishin të arsyeshme. Rrjedhimisht argumenti i Lahi Brahimajt se Prokuroria nuk mundi të provojë që ai kishte synimin e nevojshëm për fajësinë e torturimit, është i pabazuar.

293. Si rrjedhojë Dhoma e Apelit hedh poshtë argumentin e Lahi Brahimajt.

2. A gaboi Dhoma Gjyqësore në konkluzionin se Lahi Brahimaj synonte ta diskriminonte Dëshmitarin 3 për shkak se mendohej që ai kishte lidhje me serbët

294. Lahi Brahimaj parashtron se e vetmja akuzë që “mund të kishte shërbyes si bazë për një ‘synim’ në keqtrajtimin e pretenduar, dhe si pasojë, edhe si bazë për fajësinë e torturimit, ishte se Dëshmitari 3 ishte shqiptar kosovar që kishte refuzuar të luftonte për

<sup>645</sup> Aktgjykimi, para. 441 (citon Dëshmitarin 3, T. 7953-7954 (4 shtator 2007) (Seancë private)).

<sup>646</sup> Aktgjykimi, para. 441 (citon Dëshmitarin 3, T. 7954 (4 shtator 2007) (Seancë private)).

<sup>647</sup> Aktgjykimi, para. 441 (citon Dëshmitarin 3, T. 7955-7956 (4 shtator 2007) (Seancë private)).

<sup>648</sup> Aktgjykim, para. 451.

UÇK-në.”<sup>649</sup> Por, sipas Lahi Brahimajt provat nuk treguan se Dëshmitari 3 kishte refuzuar të luftonte për UÇK-në.<sup>650</sup> Lahi Brahimaj pretendon se përkundrazi Dhoma Gjyqësore duket se e ka mbështetur fajësinë e tij për torturim në mendimin për lidhje të Dëshmitarit 3 me serbët.<sup>651</sup> Lahi Brahimaj argumenton se në shfrytëzimin e një baze të tillë alternative në fajësinë për torturim, Dhoma Gjyqësore shpërfilli dëshmi që lidheshin me pushkën Kallashnikov, që Dëshmitari 3 e kishte mbajtur. Më tej, ai parashtron se “e vetmja arsye pse Dëshmitari 3 u mor në pyetje ishte që t’i kërkohej të jepte shpjegime për një pushkë Kallashnikov”.<sup>652</sup> Lahi Brahimaj deklaroi se, “asnjë Dhomë Gjyqësore e arsyeshme nuk do të kishte ardhur në përfundimin se shkaku i keqtrajtimit [të Dëshmitarit 3] ishte se mendohej që ai kishte lidhje me serbët”.<sup>653</sup>

295. Në përgjigje, Prokuroria pretendon se Dhoma Gjyqësore veprroi në mënyrë të arsyeshme kur konkludoi se Lahi Brahimaj e kishte akuzuar Dëshmitarin 3 dhe të tjerët si tradhtarë, sepse ishin larguar nga pozicionet pas përpjekjes së tyre të dështuar për mbrojtjen e Grabanicës nga forcat serbe. Prokuroria gjithashtu vë në dukje se Lahi Brahimaj e mori në pyetje Dëshmitarin 3 dhe e akuzoi për mbështetje të policisë serbe dhe për mosdorëzimin e një arme automatike.<sup>654</sup> Prokuroria shton se dy arsyet e torturimit, përkrahja për policinë serbe dhe ndëshkimi për mosdorëzimin e një arme automatike, janë të ndërthurura, duke qenë se Lahi Brahimaj “nuk do të kishte lejuar që një armë e vyer të mbahej e fshehur nga një person, të cilin ai e konsideronte përkrahës të policisë serbe kundër popullsisë shqiptare.”<sup>655</sup>

296. Lahi Brahimaj e akuzoi Dëshmitarin 3 si tradhtar dhe si bashkëpunëtor të serbëve. Aktgjykimi përshkruan qartë provat e paraqitura, të cilat çojnë tek incidenti, ku Dëshmitari 3 u mbajt për dy - tri ditë dhe u rrah keqas. Dhoma e Apelit kujton provat e administruara që lidhen konkretisht me motivin diskriminues. Në përshkrimin e takimit të tij të parë me Lahi Brahimajn pas ikjes së tij nga fshati, Dëshmitari 3 deklaroi, “[P]ërpara

<sup>649</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 131.

<sup>650</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 132.

<sup>651</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 133.

<sup>652</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 133.

<sup>653</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 134.

<sup>654</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 63.

<sup>655</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 63.

se të shkonim në Gllogjan, Lahu dhe Alushi erdhën dhe na thanë se ishim tradhtarë, anëtarë tradhtarë të LDK-së, sepse i kishim lëshuar pozicionet”.<sup>656</sup> Dëshmitari 3 vuri në dukje se Lahi Brahimaj ishte “shumë nervoz, shumë i zemëruar me ne, sepse kishim braktisur pozicionet dhe ishim tërhequr nga fshati”<sup>657</sup> dhe “na shante gjithë kohën”.<sup>658</sup> Dëshmitari 3 gjithashtu shpjegoi se pasi ishte larguar nga fshati, e kishte pasur vështirë të gjente strehim për shkak se “në Jabllanicë dihej se kushdo që do të strehonte burra nga Grabanica duhet t’i çonte në shtab, me qëllim që t’i kthenin në Grabanicë për të mbrojtur fshatin”.<sup>659</sup>

297. Dëshmitari 3 gjithashtu tregoi hollësitë e mbajtjes së tij në ndërtesën e shtabit të UÇK-së në Jabllanicë. Ai shpjegoi se Lahi Brahimaj e kishte sjellë në ndërtesën e shtabit të UÇK-së me një veturë, e kishte futur në një dhomë dhe pastaj ishte larguar.<sup>660</sup> Pas pak kohe, Dëshmitari 3 ishte rrahur me shkopinj bejsbolli deri sa kishte humbur vetëdijen.<sup>661</sup> Më pas, Dëshmitari 3 ishte çuar në një dhomë tjetër nga Lahi Brahimaj, ku Brahimaj e kishte marrë në pyetje dhe e kishte akuzuar se kishte marrë pjesë në një tubim dhe se përkrahte policinë serbe kundër popullsisë shqiptare.<sup>662</sup>

298. Personi tjetër i pranishëm në dhomë gjatë marrjes në pyetje po ashtu e akuzoi Dëshmitarin 3 për bashkëpunim me serbët, duke i thënë Dëshmitarit 3 të “[p]ranonte çfarë [kishte] bërë”.<sup>663</sup> Ai e kërcënoi Dëshmitarin 3 duke i thënë, “Ne do të ngremë flamurin dhe kur të kthehem përsëri, do të të pres fytyrën dhe pastaj do të pranosh gjithçka”.<sup>664</sup> Kjo është arsyeja që Dëshmitari 3 vendosi të arratisej.

299. Dëshmitë e pranuar nga Dhoma Gjyqësore provojnë se Lahi Brahimaj kishte shfaqur përbuzje dhe përçmim për Dëshmitarin 3 gjatë një periudhe të gjatë kohe dhe gjatë një numri incidentesh për shkak të mendimit se ai kishte lidhje me serbët. Ka

<sup>656</sup> Dëshmitari 3, T. 7923 (4 shtator 2007) (Seancë private).

<sup>657</sup> Dëshmitari 3, T. 7924 (4 shtator 2007) (Seancë private).

<sup>658</sup> Dëshmitari 3, T. 7923 (4 shtator 2007) (Seancë private).

<sup>659</sup> *Shih* Aktgjykim, para. 439; Dëshmitari 3, T. 7935 (4 shtator 2007) (Seancë private).

<sup>660</sup> Aktgjykim, para. 440 (citon Dëshmitarin 3, T. 7943-7945 (4 shtator 2007) (Seancë private)).

<sup>661</sup> Aktgjykim, para. 440 (citon Dëshmitarin 3, T. 7943, 7945-7946, 7948 (4 shtator 2007) (Seancë private), T. 8009 (5 shtator 2007) (Seancë private)).

<sup>662</sup> Dëshmitari 3, T. 7951-7952 (4 shtator 2007) (Seancë private).

<sup>663</sup> Dëshmitari 3, T. 7955 (4 shtator 2007) (Seancë private).

<sup>664</sup> Dëshmitari 3, T. 7955 (4 shtator 2007) (Seancë private).

përputhje provash që tregon se Lahi Brahimaj kishte motiv ta keqtrajtonte Dëshmitarin 3, të paktën pjesërisht, për shkak se mendonte se ai kishte bashkëpunuar me serbët. Si rrjedhojë, Dhoma e Apelit e hedh poshtë argumentin e Lahi Brahimajt se asnjë Dhome Gjyqësore e arsyeshme nuk do të kishte ardhur në përfundimin se shkak për keqtrajtimin e Dëshmitarit 3 ishte mendimi se kishte lidhje me serbët.

300. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit e hedh poshtë argumentin e Lahi Brahimajt.

### 3. A shpërfilli Dhoma Gjyqësore prova që lidhen me pushkën Kallashnikov

301. Dhoma e Apelit konstaton që në fillim se deklarata përgjithësuese e Lahi Brahimajt që Dhoma Gjyqësore “e shpërfilli dëshminë në lidhje me pushkën Kallashnikov”<sup>665</sup> bie ndesh me tekstin e qartë të Aktgjykimit. Aktgjykimi ofron dy arsye për përfundimet në lidhje me motivet për keqtrajtimin e Dëshmitarit 3 dhe fajësinë së tij rezultuese për torturim, ku një prej arsyeve është se “rrahjet e Dëshmitarit 3 synonin ta ndëshkonin për mosdorëzimin e një arme”.<sup>666</sup>

302. Lahi Brahimaj pretendon se, “Dëshmitari 3, gjatë dëshmisë së tij, shpjegoi se në fakt ai u akuzua për mbajtjen e një arme automatike të cilën nuk e kishte dorëzuar dhe pranoi se pas dorëzimit të armës, Selim Ademi kishte rënë dakord me UÇK-në, në emër të Dëshmitarit 3, se nuk kishte më çështje të pazgjidhura.” Lahi Brahimaj parashtron se kjo dëshmi tregon se Dëshmitari 3 u mor në pyetje vetëm për shkak të armës Kallashnikov.<sup>667</sup>

303. Dhoma e Apelit thekson se një Dhomë Gjyqësore “jo domosdoshmërisht i referohet dëshmisë së çdo dëshmitari dhe çdo dëshmie të administruar dhe se jo domosdoshmërisht një gjë e tillë tregon shpërfillje”.<sup>668</sup> Gjithsesi Dhoma e Apelit do t'i trajtojë argumentet e Lahi Brahimajt për këtë pikë.

304. Dëshmia së cilës i referohet Lahi Brahimaj është dëshmia e Dëshmitarit 3 për një bisedë që ai kishte pasur pas mbajtjes së tij në ndërtesën e shtabit të UÇK-së në Jabllanicë

<sup>665</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 133.

<sup>666</sup> Aktgjykim, para. 447.

<sup>667</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 133.

<sup>668</sup> Aktgjykimi *Strugar*, para. 24.

me një person të quajtur Selim Ademi, i cili kishte folur me Lahi Brahimajn për pushkën Kallashnikov. Dëshmitari 3 dëshmoi se:

Selim Ademi shkoi të fliste me Lahiuin, me qëllim që unë të mos kisha më probleme me të. Kështu që ata ranë dakord se nuk kishte më ndonjë problem të pazgjidhur tani që pushka automatike ishte kthyer.<sup>669</sup>

Dëshmitari 3 më tej dëshmoi se, pas pak kohe, Lahi Brahimaj ishte përballur me Dëshmitarin 3, e kishte quajtur “tradhtar”, dhe i kishte thënë të shkonte me të, duke i vënë një pushkë pas koke.<sup>670</sup> Kjo dëshmi tregon se, kur Dëshmitari 3 e përshkroi këtë deklaratë me fjalët se nuk do të kishte më “çështje të pazgjidhura”, në të vërtetë ai nuk “pranoi se nuk kishin mbetur më probleme të pazgjidhura”. Përkundrazi, ai vetëm përshkroi një bisedë gjatë së cilës i kishin thënë se nuk do të kishte më probleme të pazgjidhura. Përshkrimi nga Dëshmitari 3 i kësaj bisede u bë në kontekstin e shpjegimit se, pas pak kohe Lahi Brahimaj e kishte marrë përsëri, pavarësisht se Selim Ademi e kishte siguruar se nuk do ndodhte gjë. Në të vërtetë, gjatë pyetjeve nga Mbrojtja, kur u pyet nëse kthimi i pushkës e kishte zgjidhur problemin, Dëshmitari 3 u përgjigj, “Unë kështu pandeha se duhej të ndodhte, por doli se nuk ishte ashtu.”<sup>671</sup>

305. Më tej, Dhoma e Apelit nuk mendon se një dëshmi e tillë e zhvlerëson dëshminë në lidhje me komentet dhe akuzat që Lahi Brahimaj bën në lidhje me mendimin se Dëshmitari 3 ishte i implikuar me serbët. Dhoma Gjyqësore i vlerësoi të gjitha dëshmitë që lidheshin me mbajtjen e Dëshmitarit 3 në ndërtesën e shtabit të UÇK-së në Jabllanicë, ndër të cilat dëshminë në lidhje me çështjen e mendimit të lidhjeve të Dëshmitarit 3 me serbët si edhe dëshminë për problemin e pushkës Kallashnikov. Dhoma Gjyqësore konkludoi se ekzistonin dy motive për torturimin e Dëshmitarit 3: ndëshkim për mbajtjen e armës dhe diskriminim për lidhje të pretenduara me serbët.

306. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit i hedh poshtë argumentet e Lahi Brahimajt për këtë pikë.

<sup>669</sup> Dëshmitari 3, T. 7960-7961 (4 shtator 2007) (Seancë private).

<sup>670</sup> Dëshmitari 3, T. 7961 (4 shtator 2007) (Seancë private).

<sup>671</sup> Dëshmitari 3, T. 8012 (5 shtator 2007) (Seancë private).

4. A pati Lahi Brahimaj njoftim të duhur për “bazën alternative” të fajësisë së tij

307. Lahi Brahimaj pretendon se Dhoma Gjyqësore bëri gabim kur e fajësoi për torturim në përfundimin se arsyeja për keqtrajtimin e Dëshmitarit 3 ishte që ai të ndëshkohej për mosdorëzimin e një pushke Kallashnikov, për shkak se ky fakt material nuk u përmend në Aktakuzë, dhe si pasojë ai nuk pati njoftimin e duhur për këtë bazë alternative të fajësisë së tij.<sup>672</sup>

308. Prokuroria përgjigjet se dy arsyet e torturimit janë të ndërthurura dhe se orvatja e Lahi Brahimajt për t’i ndarë është e pathemeltë. Prokuroria po ashtu argumenton se Lahi Brahimaj nuk do të kishte lejuar që një armë e vyer të mbahej e fshehur prej tij nga një person që ai e konsideronte përkrahës të policisë serbe. Si rrjedhojë Prokuroria parashtroon se nuk kishte arsye që Brahimajt t’i jepej njoftim konkret në lidhje me “motivin e armës”.<sup>673</sup>

309. Dhoma e Apelit së pari konstaton se Lahi Brahimaj i shtrembëron përfundimet e Dhomës Gjyqësore kur parashtroon se Dhoma Gjyqësore e fajësoi për torturim vetëm në bazë të synimit të tij për të ndëshkuar Dëshmitarin 3 për mosdorëzimin e pushkës Kallashnikov. Dhoma Gjyqësore nuk konkludoi se torturimi u krye vetëm në bazë të një motivi, por në fakt konkludoi se ekzistonin dy motive, ndëshkimi dhe diskriminimi. Ndërkohë, Dhoma e Apelit ka lënë në fuqi vendimin e Dhomës Gjyqësore për ta fajësuar Lahi Brahimajn për torturim, si pasojë e diskriminimit të Dëshmitarit 3 për lidhjet e pretenduara të tij me serbët. Pra, çështja që shtrohet përpara Dhomës së Apelit është nëse ndëshkimi për mosdorëzimin e një arme përbën bazë të veçantë mbi të cilën u mbështet Dhoma Gjyqësore në fajësinë për torturim, apo nëse ishte “i ndërthurur” me motivin e diskriminimit. Në rast se në të vërtetë përbën bazë të veçantë, atëherë Dhoma e Apelit duhet të përcaktojë nëse Dhoma Gjyqësore gaboi ligjërisht kur u bazua në një fakt material, që normalisht duhej të ishte parashtruar në Aktakuzë.

310. Dhoma e Apelit konstaton se Lahi Brahimaj ka të drejtë në pretendimin e tij se Aktakuza nuk parashtroon ndonjë fakt të lidhur drejtpërsëdrejti me mosdorëzimin e

<sup>672</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 135.

<sup>673</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 63.

pushkës Kallashnikov nga Dëshmitari 3. Në pjesët përkatëse të Aktakuzës lexohet si vijon:

Më 13 korrik 1998 ose rreth kësaj date, Dëshmitarit SST7/03, shqiptar kosovar, i cili kishte refuzuar të luftonte për UÇK-në, iu kërkua prej Lahi Brahimajt ta shoqëronte deri në shtabin e UÇK-së në Jabllanicë. Pasi erdhën në shtabin e Jabllanicës, Dëshmitari SST7/03 u burgos bashkë me dy njerëz të tjerë prej Lahi Brahimajt. Ushtarë të UÇK-së e rrahën SST7/03 derisa humbi ndjenjat.<sup>674</sup>

Më 16 korrik 1998 ose rreth kësaj date, Dëshmitari SST7/03 u çua në një zyrë ku ishin të pranishëm Lahi Brahimaj, Idriz Balaj dhe dy ushtarë të paidentifikuar të UÇK-së. Lahi Brahimaj i ftoi ushtarët e UÇK-së që ta rrihnin Dëshmitarin SST7/03, gjë që ato e bënë duke përdorur mjete. Lahi Brahimaj dhe Idriz Balaj e inkurajuan rrahjen. Gjatë rrahjes, Idriz Balaj e akuzoi Dëshmitarin SST7/03, si spiun serb dhe e kërcënoi. Lahi Brahimaj e nxiti Dëshmitarin SST7/03 të vriste veten. Më vonë Dëshmitari SST7/03 u arratis.<sup>675</sup>

311. Dhoma e Apelit nuk e pranon qëndrimin e Prokurorisë se të dy motivet për torturimin e Dëshmitarit 3 ishin ligjërisht të ndërthurur. Dhoma Gjyqësore konkludoi se ekzistonin dy motive të ndryshme për torturim, diskriminim dhe ndëshkim. Secili motiv në vetvete, në rast se provohej, do të ishte i mjaftueshëm në mbështetje të fajësisë së torturimit. Motivi i ndëshkimit u konstatua vetëm në lidhje me mosdorëzimin e pushkës Kallashnikov dhe u trajtua nga Dhoma Gjyqësore si i veçuar ligjërisht nga motivi i diskriminimit, sikundër shihet në përfundimin e Dhomës Gjyqësore se “roli i Lahi Brahimajt gjatë marrjes në pyetje vërteton synimin [ ... ] për t'i shkaktuar vuajtje të rënda fizike Dëshmitarit 3 me qëllim që *ta ndëshkonte* për mosdorëzimin e një arme dhe *ta diskriminonte* sepse mendohej se kishte lidhje me serbët.”<sup>676</sup>

312. Dhoma e Apelit konstaton se sipas Nenit 18(4) të Statutit dhe Rregullës 47(C) të Rregullores, aktakuza duhet të paraqesë një deklaratë të përmbledhur të fakteve dhe krimet apo krimeve për të cilat akuzohet i akuzuari. Për më tepër, Nenet 21(2), 21(4)(a), dhe 21(4)(b) parashikojnë se në gjykimin e akuzave kundër tij, i akuzuari ka të drejtë për proces të drejtë, që përfshin të drejtën për t'u informuar për natyrën dhe shkakun e akuzave kundër tij dhe për të pasur kohën dhe mjetet e duhura për t'u përgatitur për mbrojtjen e tij. Dhoma e Apelit i ka interpretuar këto dispozita se kërkojnë që Prokuroria të deklarojë faktet materiale mbi të cilat mbështeten akuzat e aktakuzës, por jo provat që

<sup>674</sup> Aktakuza, para. 103.

<sup>675</sup> Aktakuza, para. 105.

<sup>676</sup> Aktgjykim, para. 451 (theksi është shtuar).

do të provojnë këto fakte.<sup>677</sup> Një fakt material “varet nga natyra e paraqitjes së çështjes nga Prokuroria”, ndonëse faktori vendimtar për përcaktimin e shkallës së kërkuar të konkretësisë është “lloji i sjelljes kriminale të akuzuar”.<sup>678</sup> Një fakt material duhet të paraqitet gjithnjë në një nivel të mjaftueshëm saktësie, me qëllim që të sigurojë njoftimin e të akuzuarit.<sup>679</sup> Për më tepër, kur një vendim “varet thelbësisht ” nga një fakt, ai fakt është fakt material që duhet parashtruar në aktakuzë për shkak se mosparaqitja e tij shkon në dëm të drejtësisë së gjyqimit dhe mundësisë së të akuzuarit për t’u vetëmbrojtur.<sup>680</sup>

313. Dhoma e Apelit mendon se motivi i ndëshkimit ishte një fakt material që lidhet me synimin kriminal të të akuzuarit, motiv që Prokurorisë i kërkohej të parashtronte në Aktakuzë. Mirëpo, Dhoma e Apelit konkludon se Prokuroria nuk e parashtroi këtë fakt në Aktakuzë dhe se as Dosja Paragjyqësore e Prokurorisë, as Dosja Gjyqësore Përfundimtare nuk e përmendin mosdorëzimin nga Dëshmitari 3 të pushkës Kallashnikov. Si pasojë, Dhoma e Apelit konkludon se Lahi Brahimajt nuk iu dha njoftimi i duhur për bazën alternative të fajësisë të tij për torturim dhe se Dhoma Gjyqësore gaboi kur e fajësoi Lahi Brahimajn për torturim mbi këtë bazë.

314. Gjithsesi, sikundër përmendet më sipër, Dhoma Gjyqësore e bazoi fajësinë e Lahi Brahimajt për torturim jo vetëm mbi motivin e ndëshkimit, por edhe të diskriminimit. Duke qenë se kjo pikë e veçantë e diskriminimit për torturë është lënë në fuqi nga Dhoma e Apelit, mbetet në fuqi edhe fajësia për torturim.

## 5. Përfundim

315. Si rrjedhojë, Dhoma e Apelit e pranon këtë pikë të apelit pjesërisht, në lidhje me argumentin se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se shkak i keqtrajtimit të Dëshmitarit 3 ishte ndëshkimi i tij për mosdorëzimin e pushkës Kallashnikov, dhe e shpalli Lahi Brahimajn fajtor për këtë arsye. Dhoma e Apelit e hedh poshtë këtë pikë të apelit në të gjithë aspektet e tjera dhe lë në fuqi fajësinë e Lahi Brahimajt për torturim

<sup>677</sup> Aktgjykim i Apelit *Kërnojelac*, para. 129-131; *Kupreshkiq e të tjerë*, para. 88.

<sup>678</sup> Aktgjykim i Apelit *Kupreshkiq e të tjerë*, para. 89.

<sup>679</sup> Aktgjykim i Apelit *Muvunyi*, para. 18.

<sup>680</sup> Aktgjykimi *Kupreshkiq e të tjerë*, para. 99, 105.

sipas Pikës 32 të Aktakuzës. Rrjedhimisht, nuk ka asnjë ndryshim në dënimin e Lahi Brahimajt.

#### **F. Apelimi i Dënimit (Pikat 10-19)**

316. Sikundër thuhet më sipër, Dhoma e Apelit nuk e ka interpretuar Pikën 1 të Apelit të Prokurorisë si kërkesë për shfuqizimin e fajësisë së Lahi Brahimajt për Pikat 28 dhe 32, dhe si rrjedhojë Lahi Brahimajt nuk do të rigjykohet në lidhje me këto dy Pika. Për më tepër, Dhoma e Apelit e ka lënë në fuqi fajësinë e Lahi Brahimajt për Pikat 28 dhe 32. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit gjykon se pikat e apelit të tij në lidhje me dënimin duhet të trajtohen në këtë Aktgjykim.

317. Në rast se Lahi Brahimajt shpallet fajtor dhe dënohet gjatë rigjykimit për pika të tjera, Dhoma Gjyqësore duhet të marrë parasysh faktin që ndërkohë ai është dënuar me gjashtë vjet burgim për Pikat 28 dhe 32.

318. Në apel, Lahi Brahimajt parashtron se Dhoma Gjyqësore bëri gabime të shumta në përcaktimin e këtij dënimi si dënimi i duhur.<sup>681</sup>

319. Ai pretendon se Dhoma Gjyqësore ka gabuar: në konkluzionin se posti që kishte mbajtur ai më parë ishte faktor rëndues (pika 10); në konkluzionin se posti i tij si anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së ishte post i lartë dhe faktor rëndues (pika 11); në konkluzionin se posti i tij i mëparshëm si Zëvendëskomandant i Zonës së Dukagjinit ishte post i lartë në UÇK dhe rrethanë rënduese (pika 12); në konkluzionin se statusi i tij pati efekt inkurajues tek ushtarët për kryerjen e krimeve (pika 13); në konkluzionin se ai kreu krime në prani të ushtarakëve me grada më të ulëta (pika 14); në konkluzionin se cënueshmëria e veçantë e Dëshmitarit 6 dhe Dëshmitarit 3 ishte faktor rëndues (pika 15); në konkluzionin se trauma fizike “që ende vuante” Dëshmitari 6 në kohën e dëshmisë ishte faktor rëndues (pika 16); në konkluzionin se Dëshmitari 3 në kohën e dëshmisë së tij ende vuante ende traumë fizike dhe mendore nga torturimi dhe trajtimi mizor (pika 17); në konkluzionin se frika e Dëshmitarit 6 kur mësoi për vdekjen e Skënder Kuqit ia shtoi atij frikën për jetën, duke qenë kështu faktor rëndues (pika 18); duke mos ushtruar

<sup>681</sup> Njoftimi për Apel i Brahimajt, para. 16-26; Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 137-180.8.

kompetencën e saj në lidhje me faktin se dënimi ishte haptazi tepër i rëndë në të gjitha rrethanat.<sup>682</sup>

320. Dhoma e Apelit tërheq vëmendjen ndaj faktit se Dhoma Gjyqësore e shpalli Lahi Brahimajn fajtor për tortura, si shkelje të ligjeve apo zakoneve të luftës, sikundër akuzohet në Pikën 28 të Aktakuzës, dhe për tortura dhe trajtim mizor, si shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës, sikundër akuzohet në Pikën 32 të Aktakuzës,<sup>683</sup> dhe e shpalli të pafajshëm për të gjitha Pikat e tjera të Aktakuzës.<sup>684</sup> Në fund Dhoma Gjyqësore e dënoi Lahi Brahimajn me një dënim të vetëm me gjashtë vjet burgim.<sup>685</sup>

### 1. Standardi i rishikimit

321. Apelimet e dënimeve, sikurse në rastin e apeleve të një aktgjykimi, janë apelime *stricto sensu*; ata kanë një natyrë korrigjuese dhe nuk janë gjykime *de novo*.<sup>686</sup> Dhoma Gjyqësore gëzon kompetencë të gjerë gjyqësore në përcaktimin e dënimit të duhur.<sup>687</sup> Si rregull, Dhoma e Apelit e rishikon një vendim vetëm në rast se Dhoma Gjyqësore ka kryer një “gabim të dukshëm” në ushtrimin e kompetencës së saj gjyqësore, apo në rast se nuk i është përmbajtur ligjit përkatës.<sup>688</sup> Është detyrë e palës që kundërshton dënimin të provojë se Dhoma Gjyqësore ka dalë jashtë kuadrit të kompetencave gjyqësore të saj në dhënien e dënimit.<sup>689</sup>

322. Për të provuar se Dhoma Gjyqësore kreu një gabim të dukshëm në ushtrimin e kompetencës së saj gjyqësore, apeluesit i kërkohet të provojë se Dhoma Gjyqësore u kushtoi rëndësi aspekteve të jashtme apo të parëndësishme, nuk u kushtoi rëndësi apo

<sup>682</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 137-180.

<sup>683</sup> Aktgjykim, para. 479-481, 504.

<sup>684</sup> Aktgjykim, para. 504.

<sup>685</sup> Aktgjykim, para. 501, 505.

<sup>686</sup> Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 734 (që citon Aktgjykimin e Apelit *Kupreshkiq e të tjerë*, para. 408; Aktgjykimin e Apelit *Galiq*, para. 393; Aktgjykimin e Apelit të Dënimit *Brallo*, para. 9).

<sup>687</sup> Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 734 (që citon Aktgjykimin e Apelit *Bllagojeviq dhe* Aktgjykimin e Apelit *Jokiq*, para. 321; Aktgjykimin e Apelit *Galiq*, para. 393); Aktgjykimi i Apelit të Dënimit *Jokiq*, para. 8.

<sup>688</sup> Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 734 (që citon Aktgjykimin e Apelit *Bllagojeviq dhe* Aktgjykimin e Apelit *Jokiq*, para. 321; Aktgjykimi i Apelit të Dënimit *Brallo*, para. 9; Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 393).

<sup>689</sup> Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 734 (që citon Aktgjykimin e Apelit *Bllagojeviq dhe* Aktgjykimin e Apelit *Jokiq*, para. 321; Aktgjykimin e Apelit *Galiq*, para. 393; Aktgjykimin e Apelit *Çelebiq*, para. 725).

rëndësinë e mjaftueshme aspekteve të rëndësishme, ka bërë një gabim të dukshëm në lidhje me faktet për të cilët ushtroi kompetencën gjyqësore, apo mori një vendim kaq të paarsyeshëm apo krejt të padrejtë sa që Dhoma e Apelit mund të dalë në përfundimin se Dhoma Gjyqësore ka dështuar në ushtrimin e duhur të kompetencës së saj gjyqësore.<sup>690</sup>

## 2. Pretendim për gabim në konkluzionin se posti i mëparshëm ishte faktor rëndues (Pika 10)

323. Lahi Brahimaj parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboi kur përcaktoi se posti që ai mbante më parë si Zëvendëskomandant i Shtabit të Zonës Operative të Dukagjinit përbënte faktor rëndues. Ai argumenton se, ndërsa roli i një të akuzuari si komandant apo epror mund të përbëjë faktor rëndues, nuk ka arsye që një post i mbajtur më parë të konsiderohet faktor rëndues.<sup>691</sup>

324. Prokuroria përgjigjet se Dhoma Gjyqësore nuk gaboi në konkluzionin se posti i mëparshëm i Lahi Brahimajt si Zëvendëskomandant ishte faktor rëndues.<sup>692</sup> Ajo argumenton se Lahi Brahimaj i shtrembëron përfundimet e nxjerra nga Dhoma Gjyqësore dhe shpërfill përfundime të tjera të rëndësishme.<sup>693</sup> Prokuroria deklaron se, ndonëse Dhoma Gjyqësore konkludoi se Lahi Brahimaj nuk ishte Zëvendëskomandant në kohën e kryerjes së shumicës së krimeve, Dhoma Gjyqësore në të njëjtën kohë konkludoi se në periudhën në fjalë ai ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, dhe i mori parasysh të dy këto konstatime në nxjerrjen e përfundimit se Lahi Brahimaj pati pozitë eprori.<sup>694</sup> Prokuroria më tej parashtron se konkluzioni i Dhomës Gjyqësore se Lahi Brahimaj “nuk ishte Zëvendëskomandant në kohën e kryerjes së shumicës së krimeve”, tregon se Dhoma Gjyqësore mori parasysh se Lahi Brahimaj kishte dijeni që *disa* krime u kryen gjatë kohës që ai ishte Zëvendëskomandant, dhe rrjedhimisht ajo nuk nxori përfundimin se posti që kishte pasur më parë përbënte faktor rëndues.<sup>695</sup> Së fundi,

<sup>690</sup> Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 735 (që citon Aktgjykimin e Apelit të Dënimit *Brallo*, para. 9; Aktgjykimin e Apelit *Galiq*, para. 394; Aktgjykimin e Apelit të Dënimit *M. Nikoliq*, para. 95; Aktgjykimin e Apelit të Dënimit *Babiq*, para. 44).

<sup>691</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 138-139.

<sup>692</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 66, 70.

<sup>693</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 67.

<sup>694</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 67.

<sup>695</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 68.

Prokuroria argumenton se Lahi Brahimaj shpërfill konkluzionin e Dhomës Gjyqësore se ai i kishte kryer krimet në prani të ushtarakëve të UÇK-së me grada më të ulëta.<sup>696</sup>

325. Në Dosjen e Kundërpërgjigjes së tij, Lahi Brahimaj nuk pajtohet me Prokurorinë se konkluzioni i Dhomës Gjyqësore që ai nuk “ishte Zëvendëskomandant në kohën e kryerjes së shumicës së krimeve” do të thotë se “Dhoma kishte dijeni se Brahimaj kishte kryer *disa* krime gjatë kohës që ishte Zëvendëskomandant”.<sup>697</sup> Ai argumenton:

[...] nuk kishte prova që ai ta kishte ushtruar ndonjëherë përgjegjësinë e Zëvendëskomandantit apo se ka qenë fizikisht i pranishëm në Jabllanicë, ku pretendohet se kanë ndodhur krimet, gjatë periudhës 12-ditore që kur Ramush Haradinaj e caktoi atë në atë post më 23 qershor, deri pas heqjes së tij prej atij posti më 5 korrik si pasojë e mungesës së tij të përsëritur nga Zona e Dukagjinit.<sup>698</sup>

326. Dhoma e Apelit konstaton se Dhoma Gjyqësore së pari mori parasysh si faktor rëndues faktin se Lahi Brahimaj mbajti poste të larta në UÇK: ai ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm dhe Zëvendëskomandant i Shtabit të Zonës Operative të Dukagjinit për një farë kohe në qershor dhe fillim të korrikut 1998, megjithëse nuk ishte Zëvendëskomandant kur u kryen shumica e krimeve.<sup>699</sup> Dhoma Gjyqësore gjithashtu mori parasysh faktin e Lahi Brahimaj i kreu krimet në prani të ushtarakëve me grada më të ulëta dhe se ishte i pranishëm kur ushtarakë të tjerë u sollën në mënyrë të ngjashme.<sup>700</sup> Mbështetur në këto prova, Dhoma Gjyqësore konkludoi se, “padyshim që kjo mund të ketë patur ndikim inkurajues ndaj ushtarëve që ata të kryenin apo të vazhdonin të kryenin krime të tilla. Eprorët duhet të jenë të parët që nuk duhet të përfshihen në kryerjen e krimeve, në mënyrë që të tjerët të mos mendojnë se një përfshirje e tillë është e lejueshme dhe se veprimi duhet imituar.”<sup>701</sup>

327. Në rast se përfundimet e Dhomës Gjyqësore shqyrtohen në tërësi, del qartë se Dhoma Gjyqësore i ka analizuar dëshminë për të përcaktuar nëse Lahi Brahimaj e shpërdori pozitën si epror. Në këtë drejtim, Dhoma e Apelit kujton se pozita e lartë në vetvete, nuk përbën faktor rëndues, mirëpo shpërdorimi i kësaj pozite konsiderohet faktor

<sup>696</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 69.

<sup>697</sup> Dosja e Kundërpërgjigjes së Brahimajt, para. 14 (theksi në origjinal).

<sup>698</sup> Dosja e Kundërpërgjigjes së Brahimajt, para. 14 (theksi në origjinal).

<sup>699</sup> Aktgjykim, para. 491.

<sup>700</sup> Aktgjykim, para. 491.

<sup>701</sup> Aktgjykim, para. 491.

rëndues.<sup>702</sup> Dhoma e Apelit është e mendimit se kur në kuadrin e dhënies së dënimit, Dhoma Gjyqësore shqyrtoi nëse Lahi Brahimaj e kishte shpërdorur pozitën si epror, asaj i lejohej të analizonte një prej posteve eprore të mëparshme të tij, në rrethana kur ai e përdori ndikimin që buronte nga një post i tillë për inkurajimin dhe miratimin e kryerjes së krimeve.<sup>703</sup>

328. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit e hedh poshtë këtë pikë të apelit.

3. Pretendim për gabim në konkluzionin se posti i Lahi Brahimajt në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së ishte post i lartë në UÇK dhe si rrjedhojë rrethanë rënduese  
(Pika 11)

329. Lahi Brahimaj parashton se Aktakuza nuk pretendon që ai kishte pozitë të lartë në UÇK apo se personat që kryen shkelje ishin vartësit e tij.<sup>704</sup> Ai gjithashtu argumenton se provat nuk mbështesin përfundimin e Dhomës Gjyqësore se ai kishte post të lartë, duke qenë se prej tyre doli që ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, përgjegjës për financat dhe jo “oficer komande që përgjigjej për stërvitjen, mbikëqyrjen apo disiplinimin e ushtarëve në terren”.<sup>705</sup> Më tej, ai parashton se Dhoma Gjyqësore nuk mori parasysh se Shtabi i Përgjithshëm ishte organizatë klandestine dhe se pak persona në Zonën e Dukagjinit kishin dijeni që ai ishte anëtar i saj.<sup>706</sup>

330. Në përgjigje, Prokuroria vë në dukje se përkundrazi, në Aktakuzë pretendohej se Lahi Brahimaj pati poste të larta.<sup>707</sup> Prokuroria argumenton se Lahi Brahimaj i ka keqkuptuar konkluzionet e Dhomës Gjyqësore dhe jurisprudencën mbi të cilën ajo është bazuar. Prokuroria pohon se konkluzionet e Dhomës Gjyqësore u bazuan në gradën e Lahi Brahimajt krahasuar me personat e pranishëm kur ai kreu krimet, që Dhomë

<sup>702</sup> *Shih* Aktgjykimin e Apelit *D. Millosheviq*, para. 302; Aktgjykimin e Apelit *Martiq*, para. 350; Aktgjykimin e Apelit *Simba*, para. 237-241, 284; Aktgjykimin e Apelit *Stakiq*, para. 411 (që citon Aktgjykimin e Apelit *Kayishema dhe Ruzindana*, para. 358-359; Aktgjykimin e Apelit të Dënimit *Babiq*, para. 80; Aktgjykimin e Apelit *Kamuhanda*, para. 347; Aktgjykimin e Apelit *Aleksovski*, para. 183; Aktgjykimin e Apelit *Ntakirutimana*, para. 563; Aktgjykimin *Kërstiq*, para. 709).

<sup>703</sup> *Shih* Aktgjykimin e Apelit *Aleksovski*, para. 183.

<sup>704</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 140-141.

<sup>705</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 142-145; *shih gjithashtu* Dosja e Kundërpërgjigjes së Brahimajt, para. 15.

<sup>706</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 146-151.

<sup>707</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 70.

Gjyqësore konkludoi se pati efekt inkurajues. Për më tepër, Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore “aludoi për faktin se kryerja nga Brahimaj e krimeve të trajtimit mizor dhe torturimit në prani të ushtarakëve më grada më të ulëta përbënte [...] shpërdorim të rangut të postit të tij”, duke shërbyer rrjedhimisht si faktor rëndues.<sup>708</sup>

331. Dhoma e Apelit gjykon se në Aktakuzë shprehet qartë se Lahi Brahimaj kishte post të lartë në UÇK dhe se personat që kryen shkelje ishin nën pushtetin e tij. Në këtë drejtim Dhoma e Apelit konstaton se Aktakuza pretendonte se gjatë gjithë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, Lahi Brahimaj ishte anëtar i UÇK-së;<sup>709</sup> drejtoi objektin e burgimit në Jabllanicë së paku prej prillit 1998 deri më 5 korrik 1998;<sup>710</sup> dhe u emërua Zëvendëskomandant i Shtabit të Zonës Operative të Dukagjinit nga 23 qershori deri më 5 korrik 1998.<sup>711</sup> Gjithashtu pretendohet se, pas heqjes nga posti i Zëvendëskomandantit, ai shërbeu si “Drejtor i Financës në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së”.<sup>712</sup> Më tej Aktakuza pretendonte se Lahi Brahimaj miratoi dhe inkurajoi sjelljen kriminale të ushtarëve të tjerë të UÇK-së, deri në mesin e shtatorit 1998, ndër të cilët edhe ushtarët e objektit të burgimit të UÇK-së në Jabllanicë dhe “të policisë ushtarake dhe personave të tjerë të cilët sulmuan dhe ndryshe keqtrajtuan civilë në Zonën Operative të Dukagjinit”.<sup>713</sup> Rrjedhimisht është i pathemeltë argumenti i Lahi Brahimajt se Aktakuza nuk pretendonte se ai mbante post të lartë në UÇK apo se personat që kryen shkelje ishin nën pushtetin e tij.

332. Dhoma e Apelit po ashtu gjykon se ka prova të shumta në mbështetje të konkluzionit të Dhomës Gjyqësore se Lahi Brahimaj “ka mbajtur poste të larta në UÇK”.<sup>714</sup> Në këtë drejtim, Dhoma e Apelit konstaton se Bislim Zyrapi, që ishte drejtor i Degës Operative,<sup>715</sup> dëshmoi se Lahi Brahimaj ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe drejtor i Degës së Financës në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së.<sup>716</sup> Bislim

<sup>708</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 73-74.

<sup>709</sup> Aktakuza, para. 12.

<sup>710</sup> Aktakuza, para. 32.

<sup>711</sup> Aktakuza, para. 12.

<sup>712</sup> Aktakuza, para. 12.

<sup>713</sup> Aktakuza, para. 12 dhe 32.

<sup>714</sup> Aktgjykimi, para. 491.

<sup>715</sup> Zyrapi, T. 3208 (23 prill 2007) (Seancë Publike).

<sup>716</sup> Zyrapi, T. 3212-3213 (23 prill 2007) (Seancë Publike).

Zyrapi gjithashtu deklaroi se, përpara se të merrte këtë post, Lahi Brahimaj kishte qenë Zëvendëskomandant i Zonës Operative të Dukagjinit,<sup>717</sup> se në mes të korrikut 1998, Lahi Brahimaj i kishte përçuar atij një urdhër nga Shtabi i Përgjithshëm për t'u kthyer në Rahovec, dhe se ata kishin shkuar në Rahovec së bashku.<sup>718</sup> Gjithashtu Jakup Krasniqi dëshmoi se, kur kishte kërkuar informacion rreth “Zonës së Dukagjinit” pas fillimit të luftimeve, personi i parë me të cilin kishte folur ishte Lahi Brahimaj, i cili ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm.<sup>719</sup> Për sa i takon sugjerimit të Lahi Brahimajt se posti i tij në Shtabin e UÇK-së nuk ishte post i lartë, sepse ai ishte “oficer shtabi” që përgjigjej për financat dhe jo “oficer komandues”,<sup>720</sup> Dhoma e Apelit vëren se dëshmitë treguan se Lahi Brahimaj nuk ishte vetëm anëtar i Degës së Financës në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së, por ishte drejtori i saj.<sup>721</sup> Bazuar në dëshmitë e mësipërme, ishte e arsyeshme që Dhoma Gjqësore të vinte në përfundimin se Lahi Brahimaj kishte pozitë eprori në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së.

333. Në mbështetje të argumentit të tij se Dhoma Gjqësore nuk mori parasysh që Shtabi i Përgjithshëm ishte organizatë klandestine dhe se pak persona në Zonën e Dukagjinit kishin dijeni se Lahi Brahimaj ishte anëtar i tij, Lahi Brahimaj i referohet Provës Materiale P141, procesverbal i një mbledhjeje pune të Shtabit të Dukagjinit më 23 qershor 1998. Dhoma e Apelit vëren se tema e përgjithshme e mbledhjes ishte organizimi i UÇK-së në një “ushtri të rregullt”.<sup>722</sup> Sipas fjalëve të Ramush Haradinajt, “metoda klandestine e [UÇK-së] dha rezultatet e saj”, duke iu referuar faktit se lufta nuk ishte pronë e asnjë grupi por “kishte të bënte me çlirimin e vendit me anë të [...] një kryengritjeje të përgjithshme”.<sup>723</sup> Dhoma e Apelit konstaton se në procesverbal është shënuar se, “Agroni” tha: “Lahiu ishte përfaqësuesi i Shtabit Qendror të Rrafshit së Dukagjinit. Ndoshta kjo mbahej e fshehtë. Shtabi ka ekzistuar qysh nga 1993 deri më

<sup>717</sup> Zyrapi, T. 3213 (23 prill 2007) (Scancë Publike).

<sup>718</sup> Zyrapi, T. 3234-3235, 3239 (23 prill 2007) (Scancë Publike).

<sup>719</sup> Krasniqi, T. 5077-5078 (30 maj 2007) (Scancë Publike).

<sup>720</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 143.

<sup>721</sup> Zyrapi, T. 3212-3213 (23 prill 2007) (Scancë Publike).

<sup>722</sup> P141 (Procesverbal me shkrim dore i mbledhjes së punës, 23 qershor 1998, mbajtur në Jabllanicë), f. 1-2.

<sup>723</sup> P141 (Procesverbal me shkrim dore i mbledhjes së punës, 23 qershor 1998, mbajtur në Jabllanicë), p. 1.

sot”.<sup>724</sup> Procesverbali po ashtu tregon se disa nga personat e pranishëm në mbledhje e njihnin Lahi Brahimajn dhe dinin se me propozim të kapitenit Tetaj, Ramush Haradinaj do të bëhej komandant kurse “Lahiu” zëvendësi i tij.<sup>725</sup> Dhoma e Apelit ka konkluduar ndërkohë se përfundimi i Dhomës Gjyqësore që Lahi Brahimaj kishte një post të lartë, ishte i arsyeshëm. Dhoma e Apelit nuk gjykon se fakti nëse UÇK-ja vepronte në mënyrë klandestine apo nëse numri i personave në zonën e Dukagjinit që e dinin se Lahi Brahimaj ishte në UÇK, janë faktorë me rëndësi për të përcaktuar nëse Lahi Brahimaj kishte post të lartë në UÇK. Rrjedhimisht Dhomës Gjyqësore nuk i kërkohej t’i shqyrtonte këta faktorë, kështu që Lahi Brahimaj nuk ka provuar ndonjë gabim nga ana e Dhomës Gjyqësore.

334. Si rrjedhojë, Dhoma e Apelit e hedh poshtë këtë pikë të apelit.

4. Pretendim për gabim në konkluzionin se posti i mëparshëm i Lahi Brahimajt si Zëvendëskomandant i Zonës së Dukagjinit ishte post i lartë në UÇK dhe rrjedhimisht rrethanë rënduese (Pika 12)

335. Lahi Brahimaj argumenton se nuk kishte të dhëna, përveç emërimit të tij zyrtar, se ai kishte ushtruar ndonjëherë përgjegjësitë e tij si Zëvendëskomandant i Zonës së Dukagjinit dhe se, në të vërtetë, kishte dëshmi për të kundërtën. Ai argumenton më tej se, në konkluzionin se ai kishte një post të lartë, Dhoma Gjyqësore nuk mori parasysh se ai e mbajti postin e Zëvendëskomandantit të Zonës së Dukagjinit për një periudhë relativisht të shkurtër.<sup>726</sup>

336. Prokuroria jep përgjigje për të dy pikat 11 dhe 12 të Apelit, dhe përgjigja e saj mund të gjendet në pjesën e mëparshme.<sup>727</sup>

337. Lahi Brahimaj citon Provën Materiale P161 në mbështetje të argumentit të tij se kishte dëshmi që kundërshtonin konkluzionin se ai kishte ushtruar detyrën si Zëvendëskomandant i Shtabit të Zonës Operative të Dukagjinit. Prova Materiale P161

<sup>724</sup> P141 (Procesverbal me shkrim dore i mbledhjes së punës, 23 qershor 1998, mbajtur në Jabllanicë), p. 6.

<sup>725</sup> P141 (Procesverbal me shkrim dore i mbledhjes së punës, 23 qershor 1998, mbajtur në Jabllanicë), p. 7.

<sup>726</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 152-154. *Shih gjithashtu* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Brahimajt, para. 14.

<sup>727</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 73-74.

është një letër qortimi e Ramush Haradinajt drejtuar “Lahi Brahimajt, Zëvendëskomandant i Shtabit Operativ të Zonës së Dukagjinit”, e cila mban datën 4 korrik 1998. Në letër lexohet:

- Pas kërkesës sonë për mbajtjen e një mbledhjeje pune që, për shkak të mungesës tënde nga zona e përgjegjësisë ku të takon të jesh, nuk u zhvillua dy herë me radhë, po të dërgojmë këtë vërejtje, duke të kërkuar që të kryesh detyrat e tua me besnikëri.
- Kërkojmë që një sjellje e tillë të mos përsëritet.<sup>728</sup>

Lahi Brahimaj u largua nga ai post të nesërmen.<sup>729</sup> Ndonëse Dhoma Gjyqësore nuk e diskutoi Proven Materiale P161 në Aktgjykimin e saj, Dhoma e Apelit gjykon se Prova Materiale P161 nuk e mbështet pretendimin e Lahi Brahimajt se ai nuk i ushtroi kurrë përgjegjësitë e tij si Zëvendëskomandant. Përkundrazi, Prova Materiale P161 tregon se (a) Lahi Brahimaj e ushtroi detyrën si Zëvendëskomandant, duke qenë se i kërkohej të merrte pjesë në një mbledhje pune në cilësinë si Zëvendëskomandant; (b) u qortua për mospjesëmarrje në mbledhje; dhe (c) iu bë thirrje nga Ramush Haradinaj të vazhdonte të kryente me besnikëri detyrat e tij si Zëvendëskomandant. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit gjykon se dëshmia që tregon se Lahi Brahimaj u qortua për mungesën e tij nga zona e përgjegjësisë dhe të nesërmen u hoq nga ai post, nuk e bën konkluzionin e Dhomës Gjyqësore të paarsyeshëm.

338. Për sa i takon argumentit të Lahi Brahimajt se Dhoma Gjyqësore nuk mori parasysh faktin se ai e kishte mbajtur këtë post për një periudhë të shkurtër, Dhoma e Apelit vëren përfundimin e Dhomës Gjyqësore se Lahi Brahimaj ishte Zëvendëskomandant i Shtabit Operativ të Dukagjinit “për një farë kohe në qershor dhe në fillim të korrikut 1998”, ndonëse nuk ishte Zëvendëskomandant kur u kryen shumica e krimeve.<sup>730</sup> Në nxjerrjen e këtij përfundimi, Dhoma Gjyqësore mori parasysh dëshminë e Rrustem Tetajt se Lahi Brahimaj u emërua Zëvendëskomandant në një mbledhje të

<sup>728</sup> P161 (Qortim nënshkruar nga Ramush Haradinaj drejtuar Lahi Brahimajt, Zëvendëskomandant i Zonës së Dukagjinit, për largimin e tij pa leje nga Zona e Përgjegjësisë dhe për mosorganizimin e një mbledhjeje, dy herë me radhë, 4 korrik 1998).

<sup>729</sup> P168 (Urdhër i nënshkruar nga Ramush Haradinaj për heqjen nga detyra të Lahi Brahimajt dhe emërimin e Nazmi Brahimajt si Zëvendëskomandant i Shtabit të Zonës Operative të Dukagjinit, 5 korrik 1998).

<sup>730</sup> Aktgjykim, para. 491.

mbajtur më 23 qershor 1998 në shtëpinë e Lahi Brahimajt dhe dëshminë e Jakup Krasniqit se Lahi Brahimaj ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm në korrik të vitit 1998.<sup>731</sup> Rrjedhimisht Dhoma e Apelit vjen në përfundimin se, në kundërshtim me argumentin e Lahi Brahimajt, Dhoma Gjyqësore pa diskutim që mori parasysh periudhën gjatë të cilës Lahi Brahimaj mbajti postin e Zëvendëskomandantit të Shtabit Operativ të Dukagjinit, si edhe natyrën e këtij posti.<sup>732</sup>

339. Për këtë arsye, Dhoma e Apelit e hedh poshtë këtë pikë të apelit.

5. Pretendim për gabim në konkluzionin se Lahi Brahimaj i inkurajoi ushtarët të kryenin krime (Pika 13)

340. Lahi Brahimaj parashton se Dhoma Gjyqësore gaboi në përfundimin e saj se “statusi” i tij kishte efekt inkurajues ndaj ushtarëve për kryerjen e krimeve, sepse provat nuk treguan që Lahi Brahimaj mbajti post komandanti gjatë kohës së kryerjes së krimeve apo se ndonjë person tjetër që mund të ketë qenë i pranishëm, kishte dijeni apo mendonte se ai mbante post komandanti. Ai gjithashtu argumenton se, në rast se Dhoma Gjyqësore synonte të konkludonte se çdo post i lartë komandues që ai kishte pasur më parë kishte bërë që ushtarët të kryenin krime, ajo nuk kishte prova për një gjë të tillë dhe se çdo përfundim i tillë do të ishte spekulim.<sup>733</sup>

341. Prokuroria përgjigjet se argumenti i Lahi Brahimajt duhet hedhur poshtë meqenëse kundërshton një përfundim në të cilin nuk mbështetet konkluzioni përfundimtar i Dhomës Gjyqësore. Prokuroria argumenton se konkluzioni që pretendohet se është nxjerrë prej Dhomës Gjyqësore se kryerja e krimeve nga Brahimaj në prani të ushtarakëve me grada më të ulëta nuk ka si të mos ketë pasur efekt inkurajues për kryerjen e krimeve nga ana e tyre, mund të shihet si shpjegim nga ana e Dhomës Gjyqësore i përfundimit të mëparshëm të saj se Lahi Brahimaj “i kreu krimet në prani të

<sup>731</sup> *Shih* Aktgjykim, para. 491, shënimi 2442.

<sup>732</sup> Aktgjykimi, para. 491.

<sup>733</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 157.

ushtarakëve të UÇK-së me grada më të ulëta dhe se ishte i pranishëm kur ushtarë të tjerë janë sjellë në mënyrë të ngjashme.”<sup>734</sup>

342. Dhoma e Apelit kujton konkluzionet e Dhomës Gjyqësore:

Dhoma Gjyqësore ushtron gjithashtu kompetencën e vetë gjyqësore në këtë aspekt, pasi Brahimaj i kreu krimet në prani të ushtarëve vartës të UÇK-së dhe ishte i pranishëm kur ushtarë të tjerë vepronin në mënyrë të ngjashme. Dhoma Gjyqësore gjykon se padyshim që kjo mund të ketë pasur ndikim nxitës ndaj ushtarëve që ata të kryenin apo të vazhdonin të kryenin krime të tilla. Eprorët duhet të jenë të parët që nuk duhet të përfshihen në kryerjen e krimeve, në mënyrë që të tjerët të mos mendojnë se një përfshirje e tillë është e lejueshme dhe se veprimi duhet imituar.<sup>735</sup>

Dhoma e Apelit ndërkohë ka konkluduar se përfundimi i Dhomës Gjyqësore se Lahi Brahimaj kishte një post të lartë, ishte i arsyeshëm. Argumenti i parashtruar nga Lahi Brahimaj është se Dhoma Gjyqësore gaboi në konkluzionin se ky fakt ishte faktor rëndues, sepse nuk ishte vërtetuar se ishin kryer krime në kohën që ai kishte post komandues. Dhoma e Apelit kujton se gjatë një periudhe në qershor dhe në fillim të korrikut 1998, Lahi Brahimaj ishte Zëvendëskomandant i Shtabit Operativ të Dukagjinit.<sup>736</sup> Krimet e kryera kundër Dëshmitarit 6 u kryen më 13-14 qershor; ai u mbajti afërsisht për katër javë dhe u lirua më 25 korrik.<sup>737</sup> Krimet kundër Dëshmitarit 3 u kryen në fillim apo në mes të korrikut gjatë një periudhe treditore. Pastaj Dëshmitari 3 u arratis; dhe pas dy ditësh, Lahi Brahimaj kreu krime të tjera kundër tij.<sup>738</sup> Mbështetur në faktin se Lahi Brahimaj ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe Zëvendëskomandant i Shtabit Operativ të Dukagjinit për një farë kohe në qershor dhe në fillim të korrikut 1998, Dhoma Gjyqësore gjykoi se, ndonëse ai nuk ishte Zëvendëskomandant kur u kryen shumica e krimeve, ai gjithsesi duhej të merrte një dënim të rënduar.<sup>739</sup> Dhoma e Apelit konstaton se Lahi Brahimaj i kreu krimet kundër Dëshmitarit 6 gjatë periudhës kur ishte zëvendëskomandant. Në lidhje me Dëshmitarin 3, disa nga krimet u kryen gjatë periudhës që kryesisht përkon me periudhën kur ishte zëvendëskomandant, ndonëse shumica e

<sup>734</sup> Përgjigjja e Prokurorisë, para. 75.

<sup>735</sup> Aktgjykimi, para. 491.

<sup>736</sup> Aktgjykim, para. 491.

<sup>737</sup> Aktgjykim, para. 382-384, 391-395.

<sup>738</sup> Aktgjykim, para. 440, 443-451.

<sup>739</sup> Aktgjykim, para. 491.

krimeve u kryen pas dhjetë ditësh. Rrjedhimisht përfundimi i Dhomës Gjyqësore ishte i arsyeshëm.

343. Si pasojë Dhoma e Apelit e hedh poshtë këtë pikë të apelit.

6. Pretendim për gabim në konkluzionin se krimet u kryen në prani të ushtarakëve me grada më të ulëta (Pika 14)

344. Lahi Brahimaj parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se ai kishte kryer krime në prani të oficerëve me grada më të ulëta. Ai argumenton se nuk kishte prova për praninë e ushtarakëve me grada më të ulëta kur u kryen krimet kundër Dëshmitarit 3 dhe Dëshmitarit 6.<sup>740</sup> Lahi Brahimaj gjithashtu argumenton se në Aktakuzë nuk pretendohet se ai kishte kryer krime në prani të ushtarakëve me grada më të ulëta.<sup>741</sup>

345. Prokuroria përgjigjet se Lahi Brahimaj i shtrembëron përfundimet e Dhomës Gjyqësore. Ajo argumenton se nga leximi i Aktgjykimit del se ushtarakë me grada më të ulëta kanë qenë të pranishëm kur Lahi Brahimaj kreu krimet kundër Dëshmitarit 3 dhe Dëshmitarit 6.<sup>742</sup>

346. Dhoma e Apelit ka konkluduar ndërkohë në pikën 11 të apelit se Aktakuza ka parashtruar si duhet se Lahi Brahimaj kishte një post të lartë në UÇK dhe se personat që kanë kryer shkelje kanë qenë nën pushtetin e tij.

347. Dhoma e Apelit ka konfirmuar përfundimin e Dhomës Gjyqësore se Lahi Brahimaj ka pasur poste të larta në UÇK. Gjithashtu Dhoma Gjyqësore konkludoi se gjatë burgimit të Dëshmitarit 3, Lahi Brahimaj e çoi atë në dhomën e tij në ndërtesën e Shtabit të UÇK-ë në Jabllanicë.<sup>743</sup> Në dhomë ishin të pranishëm dy gra dhe një burrë tjetër, që të gjithë të veshur me uniforma të zeza.<sup>744</sup> Lahi Brahimaj dhe burri tjetër kishin në mëngë emblemën “PU” (policia ushtarake).<sup>745</sup> Lahi Brahimaj e mori në pyetje

<sup>740</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 159-164.

<sup>741</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 160.

<sup>742</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 76-83.

<sup>743</sup> Aktgjykim, para. 440-441 (citon Dëshmitarin 3, T. 7951, 7958 (4 shtator 2007) (Seancë private); P914 (Fotografi në të cilën Dëshmitari 3 shënoi rrugën ishte arratisur dhe dhomën e Lahi Brahimajt).

<sup>744</sup> Aktgjykim, para. 441 (citon Dëshmitarin 3, T. 7952 (4 shtator 2007) (Seancë private)).

<sup>745</sup> Aktgjykim, para. 441 (citon Dëshmitarin 3, T. 8020 (5 shtator 2007) (Seancë private)).

Dëshmitarin 3, e akuzoi se mbështeste policinë serbe,<sup>746</sup> dhe u tha grave të “praktikoheshin” me Dëshmitarin 3, gjë që ato e bënë, duke e goditur Dëshmitarin 3 në duar për pesë apo dhjetë minuta me një dylbi.<sup>747</sup> Lahi Brahimaj pastaj i dha revolen e tij Dëshmitarit 3 dhe i tha të vriste veten.<sup>748</sup> Dëshmitari 3 e mori revolen dhe qeshi. Pastaj njëra prej grave ia mori revolen dhe ia ktheu Lahi Brahimajt.<sup>749</sup> Dëshmitari 6 dëshmoi se, ditën e dytë të qëndrimit të tij në oborrin me ndërtesa në Jabllanicë (14 qershor 1998), e kishin çuar në një dhomë në një shtëpi njëkatëshe me tulla të kuqe në mes të oborrit.<sup>750</sup> Ai u mbajti aty gjatë pjesës tjetër të kohës që qëndroi në Jabllanicë.<sup>751</sup> Dëshmitari 6 dëshmoi se Lahi dhe Nazmi Brahimaj e rrahën në këtë dhomë me grushte dhe me shkopinj bejsbolli dhe disa herë kishin qenë të pranishëm kur e rrahën të tjerët.<sup>752</sup>

348. Dhoma e Apelit është e mendimit se dëshmitë tregojnë qartë se Lahi Brahimaj ishte në krye të keqtrajtimit të Dëshmitarëve 3 dhe 6, qoftë duke i rrahur vetë, qoftë duke u ndihmuar nga të tjerët, apo duke i drejtuar veprimet e të tjerëve. Mbështetur në këtë dëshmi, si edhe në dëshmitë se Lahi Brahimaj ishte zyrtar i lartë i UÇK-së, ishte e arsyeshme që Dhoma Gjyqësore të nxirrte përfundimin se ushtarakët e UÇK-së të pranishëm kur Lahi Brahimaj kreu krimet apo që kryen krime në praninë e tij, ishin ushtarakë me grada më të ulëta se Lahi Brahimaj.

349. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit e hedh poshtë këtë pikë të apelit.

## 7. Pretendim për gabim në lidhje me cënueshmërinë e veçantë të Dëshmitarëve 3 dhe 6

### (Pika 15)

350. Lahi Brahimaj parashtroi se Dhoma Gjyqësore bëri gabim ligjor dhe faktual në përfundimin se Dëshmitari 3 dhe Dëshmitari 6 ishin veçanërisht të cënueshëm dhe se një

<sup>746</sup> Aktgjykim, para. 441 (citon Dëshmitarin 3, T. 7952-7953 (4 shtator 2007) (Seancë private)).

<sup>747</sup> Aktgjykim, para. 441 (citon Dëshmitarin 3, T. 7953-7954 (4 shtator 2007) (Seancë private)).

<sup>748</sup> Aktgjykim, para. 441 (citon Dëshmitarin 3, T. 7954 (4 shtator 2007) (Seancë private)).

<sup>749</sup> Aktgjykim, para. 441 (citon Dëshmitarin 3, T. 7954-7955 (4 shtator 2007) (Seancë private)).

<sup>750</sup> Dëshmitari 6, T. 5204-5205, 5216 (1 qershor 2007) (Seancë e hapur), T. 5316, 5324 (4 qershor 2007) (Seancë e hapur); P332 (Fotografi e oborrit me ndërtesa në Jabllanicë).

<sup>751</sup> Dëshmitari 6, T. 5205, 5213, 5216 (1 qershor 2007) (Seancë Publike), T. 5316-5317, 5325, 5347 (4 qershor 2007) (Seancë Publike).

<sup>752</sup> Dëshmitari 6, T. 5205, 5208-5209, 5213, 5216, 5219-5221 (1 qershor 2007) (Seancë Publike), T. 5316-5317, 5325, 5347, 5372-5373 (4 qershor 2007) (Seancë Publike).

cënueshmëri e tillë përbënte faktor rëndues.<sup>753</sup> Lahi Brahimaj argumenton se Dëshmitari 3 dhe Dëshmitari 6 ishin që të dy me prejardhje shqiptare, meshkuj, të armatosur në të kaluarën, dhe se kur ishin në kazermë i kishin vizituar anëtarë të familjes dhe fshatarë që e dinin se ndodheshin aty. Lahi Brahimaj gjithashtu vë në dukje se Dëshmitari 3 ishte luftëtar që kishte luftuar më parë për UÇK-në. Për këto arsye, ai parashton se “cënueshmëria” e tyre ishte “tejet e kufizuar” dhe se ata bënë pjesë në një “kategori shumë të ndryshme nga ajo e viktimave të cënueshme” në çështjet e cituara në Aktgjykim, të tillë si *Kunarac e të tjerë*, ku gratë dhe vajzat nën moshën 18 ishin përdhunuar.<sup>754</sup> Lahi Brahimaj gjithashtu vë në dukje se ai nuk ishte shpallur fajtor për krimin e burgosjes.<sup>755</sup>

351. Prokuroria përgjigjet se Lahi Brahimaj nuk ka arritur të tregojë që asnjë Dhomë Gjyqësore e arsyeshme nuk do të kishte nxjerrë përfundimin se këta burra të burgosur dhe të çarmatosur ishin veçanërisht të cënueshëm në kohën e kryerjes së krimeve.<sup>756</sup>

352. Dhoma e Apelit konstaton se Dhoma Gjyqësore e mori parasysh cënueshmërinë e Dëshmitarit 3 dhe Dëshmitarit 6 kur vlerësoi peshën e veprave penale, dhe jo si faktor rëndues. Dhoma Gjyqësore shqyrtoi cënueshmërinë e veçantë të dëshmitarëve të mbajtur në izolim, duke deklaruar se “Ata ishin jo vetëm të privuar nga liria, por edhe të mbajtur në kushte të tilla, që të ishin tërësisht në mëshirën e atyre që i mbanin në Jabllanicë”.<sup>757</sup> Dhoma Gjyqësore më tej erdhi në përfundimin se “gjendja e rrezikuar e viktimave dhe traumat fizike dhe mendore të përjetuara prej tyre” ishin “faktorë që përbëjnë rrezikshmërinë e veprës penale dhe tërësinë e sjelljes në këtë çështje”.<sup>758</sup> Rrjedhimisht, argumenti i Lahi Brahimajt se Dhoma Gjyqësore e konsideroi faktor rëndues, pasqyron një interpretim të pasaktë të Aktgjykimit.

353. Si rrjedhojë, Dhoma e Apelit e hedh poshtë këtë pikë të apelit.

<sup>753</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 165; Njoftimi për Apel i Brahimajt, para. 21.

<sup>754</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 166.

<sup>755</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 167.

<sup>756</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 84-85.

<sup>757</sup> Aktgjykimi, para. 492 (citimet e brendshme janë hequr).

<sup>758</sup> Aktgjykimi, para. 493.

8. Pretendim për gabim në konkluzionin se Dëshmitari 3 dhe Dëshmitari 6 ende vuanin pasoja fizike në kohën e dhënies së dëshmive të tyre (Pikat 16 dhe 17)

354. Lahi Brahimaj parashtroi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur erdhi në përfundim se Dëshmitari 3 dhe Dëshmitari 6 ende vuanin traumë fizike dhe mendore në kohën e dhënies së dëshmive të tyre dhe se një traumë e tillë përbënte faktor rëndues.<sup>759</sup> Lahi Brahimaj argumenton se “ndonëse Dhoma Gjyqësore konstatoi se Dëshmitari 6 dëshmoi për dhimbje të përhershme në të gjithë trupin dhe paaftësi për kryerjen e punëve fizike, provat nuk e mbështetën deponimin e tij”.<sup>760</sup> Ai pretendon se i vetmi dëmtim fizik i konstatuar nga mjeku që e ekzaminoi Dëshmitarin 6 menjëherë pas largimit nga Jabllanica ishte një kyç dore i thyer që ishte shëruar dhe që nuk kishte nevojë për mjekim. Për më tepër, radiografia nuk u paraqit asnjëherë si provë.<sup>761</sup> Lahi Brahimaj gjithashtu mbron pikëpamjen se nuk kishte prova që Dëshmitari 6 merrte ndonjë mjekim në kohën e lëndimeve të tij, duke përfshirë edhe vitin 2007 kur dëshmoi para Dhomës Gjyqësore.<sup>762</sup> Së fundi, Lahi Brahimaj vë në dukje se nuk u parashtuan prova të pavarura mjekësore që të vërtetonin dhimbje apo vuajtje të vazhdueshme fizike apo psikologjike të Dëshmitarit 6.<sup>763</sup> Lahi Brahimaj po ashtu përsërit kundërshtimin e tij ndaj besueshmërisë së Dëshmitarit 6.<sup>764</sup>

355. Në lidhje me Dëshmitarin 6, Prokuroria përgjigjet se argumenti i Lahi Brahimajt nuk është gjë tjetër veçse një sulm i vazhduar kundër përfundimit të Dhomës Gjyqësore se Dëshmitari 6 ishte i besueshëm; mirëpo, sipas Prokurorisë, Lahi Brahimaj nuk ka paraqitur arsye të mjaftueshme për të vënë në dyshim vlerësimin e besueshmërisë nga Dhoma Gjyqësore.<sup>765</sup> Për sa i takon Dëshmitarit 3, Prokuroria përgjigjet se, ndonëse Dëshmitari 3 nuk deklaroi shprehimisht se vazhdonte të vuante nga dhimbjet fizike dhe trauma mendore si pasoja të trajtimit mizor, Dhoma Gjyqësore kishte të drejtë të nxirrte

<sup>759</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para 172-174.

<sup>760</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 168.

<sup>761</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 169.

<sup>762</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 170.

<sup>763</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para 168-171.

<sup>764</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 168.

<sup>765</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 86-87.

konkluzionin e një ndikimi afatgjatë, duke pasur parasysh natyrën dhe shkallën e rrahjeve dhe torturave.<sup>766</sup>

356. Dhoma Gjyqësore shqyrtoi “traumën fizike dhe mendore të pësuar dhe ende të përjetuar nga të dy dëshmitarët.<sup>767</sup> Në adoptimin e një përjasjeje të tillë të gjerë, Dhoma Gjyqësore mori parasysh pasojat fizike afatgjata të rrahjeve dhe traumën e vazhdueshme mendore. Ky përfundim është brenda kuadrit të kompetencës gjyqësore të Dhomës Gjyqësore. Si rrjedhojë, Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore nuk gaboi në cilësimin e “cënueshmërisë së viktimave dhe traumës fizike dhe mendore të vuajtur prej tyre” si faktorë që anonin nga rrezikshmëria e veprave penale.<sup>768</sup>

357. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit i hedh poshtë këto pika të apelit.

9. Pretendim për gabime në konkluzionin se frika për jetën e Dëshmitarit 6 u shtua kur mësoi për vdekjen e Skënder Kuqit, duke qenë rrjedhimisht faktor rëndues (Pika 18)

358. Lahi Brahimaj argumenton se Dhoma Gjyqësore bëri gabim faktual dhe ligjor kur konkludoi se frika e Dëshmitarit 6 për jetën e tij u shtua kur mësoi për vdekjen e Skënder Kuqit, duke qenë rrjedhimisht faktor rëndues.<sup>769</sup> Së pari, Lahi Brahimaj vë në dukje se ai nuk ishte bërë përgjegjës për keqtrajtim të Skënder Kuqit dhe si rrjedhim nuk duhej t'i jepej dënim më i madh për këtë arsye.<sup>770</sup> Së dyti, ai parashtron se Dhoma Gjyqësore nuk dëgjoi dëshmi se pasi mësoi për vdekjen e Skënder Kuqit, Dëshmitari 6 filloi të ketë frikë për jetën e tij.<sup>771</sup> Së treti, sipas Lahi Brahimajt, “nuk duket” se Dhoma Gjyqësore e mori parasysh faktin se, në kohën që Dëshmitari 6 mësoi për vdekjen e Skënder Kuqit, ai ishte i lirë të lëvizte nëpër lëndinën jashtë kazermës (ku njeriu mund të shihte përreth deri në disa mijëra metra), të shëtiste nëpër oborr, të lante pjatat, dhe nuk u arratis, ndonëse e kishte mundësinë ta bënte këtë gjë.<sup>772</sup>

<sup>766</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 88-90.

<sup>767</sup> Aktgjykim, para. 492.

<sup>768</sup> Aktgjykim, para. 493. Dhoma e Apelit konstaton se Lahi Brahimaj e ngre këtë gabim si një “faktor rëndues” të marrë gabimisht parasysh dhe jo si një faktor që anon nga rrezikshmëria e veprës penale.

<sup>769</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 175-179.

<sup>770</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 176.

<sup>771</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 177.

<sup>772</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 178 (citimet e brendshme janë hequr).

359. Prokuroria përgjigjet se, ndonëse Dëshmitari 6 nuk dëshmoi se frika që kishte për jetën iu shtua kur mësoi se një bashkëburgosur ishte vrarë, ishte gjithsesi e arsyeshme që Dhoma Gjyqësore të nxirrte si përfundim një fakt të tillë, bazuar në provat e disponueshme.<sup>773</sup> Prokuroria pohon se Dëshmitari 6 u mbajt për katër javë, gjatë të cilave ai u rrah dhe u shkelma vazhdimisht, ndonjëherë deri sa humbte ndjenjat. Gjithashtu, Prokuroria vuri në dukje se Dëshmitari 6 dëshmoi se Skënder Kuqi ishte rrahur në të njëjtën ditë që ishte rrahur edhe ai.<sup>774</sup>

360. Dhoma Gjyqësore gjykoi si më poshtë:

Dhoma Gjyqësore ka marrë parasysh gjendjen veçanërisht të rrezikuar të Dëshmitarit 3 dhe Dëshmitarit 6 kur ishin të izoluar. Ata ishin jo vetëm të privuar nga liria, por edhe të mbajtur në kushte të tilla, që ata të ishin tërësisht në mëshirën e atyre që i mbanin në Jabllanicë. Së fundi, Dhoma Gjyqësore ka marrë parasysh traumën fizike dhe mendore të pësuar dhe ende të përjetuar nga të dy viktimat. Dëshmitari 6 dëshmoi se pa rrahjen e Skënder Kuqit dhe më pas mësoi se ai ishte dërguar për mjekim në Gillogjan ku vdiq. Duke mësuar për fatin e këtij të burgosuri tjetër, në një kohë kur ai vetë ishte i burgosur dhe i keqtrajtuar, Dëshmitari 6 duhet të ketë patur frikë edhe më të madhe për jetën e tij. [...]<sup>775</sup>

Dhoma Gjyqësore ka arritur në përfundimin se Lahi Brahimaj duhet të shpallet fajtor për dy rastet e torturës dhe një rast të trajtimit mizor. Dhoma Gjyqësore ka marrë parasysh se sa të rënda ishin këto krime në vetvete si dhe faktin se Lahi Brahimaj, i cili ka patur poste të larta në UÇK, mori pjesë drejtpërdrejtë në kryerjen e tyre. Dhoma Gjyqësore ka marrë parasysh gjithashtu gjendjen e rrezikuar të viktimave dhe traumat fizike dhe mendore të përjetuara prej tyre. Të gjitha këta faktorë përbëjnë rrezikshmërinë e veprës penale dhe tërësinë e sjelljes në këtë çështje.<sup>776</sup>

361. Dhoma e Apelit konstaton se, ndryshe nga argumenti i Lahi Brahimajt, në të vërtetë Dhoma Gjyqësore e mori parasysh faktin se Dëshmitari 6 kishte një farë lirie brenda oborrit me ndërtesa në Jabllanicë dhe se nuk u orvat të arratisëj.<sup>777</sup> Dhoma Gjyqësore kujton konkretisht dëshminë e Dëshmitarit 6 se ai nuk u orvat të arratisëj sepse “nuk donte të rrezikohej”.<sup>778</sup> Rrjedhimisht Lahi Brahimaj bën gabim kur pretendon se Dhoma Gjyqësore nuk e mori parasysh këtë dëshmi. Për më tepër, Dhoma e Apelit kujton se Dëshmitari 6 ishte i burgosur për katër javë dhe u rrah keqazi nga Lahi Brahimaj

<sup>773</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 91-92.

<sup>774</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 92.

<sup>775</sup> Aktgjykimi, para. 492 (citimet e brendshme janë hequr).

<sup>776</sup> Aktgjykim, para. 493.

<sup>777</sup> Aktgjykim, para. 383.

<sup>778</sup> Aktgjykim, para. 383 (citon Dëshmitarin 6, T. 5243 (1 qershor 2007) (Seancë Publike), T. 5349 (4 qershor 2007) (Seancë Publike)).

personalisht dhe nga të tjerë, që Dhoma Gjyqësore konkludoi se përbënte trajtim mizor dhe torturim.<sup>779</sup> Dhoma e Apelit e hedh poshtë sugjerimin e Lahi Brahimajt se një person në rrethana të tilla nuk frikësohej për jetën e tij sepse gëzonte një farë lirie lëvizjeje në oborrin me ndërtesa dhe nuk u orvat të arratisëj.

362. Në lidhje me argumentin e Lahi Brahimajt se dënimi i tij nuk duhej të ndikohej nga vrasja e Skënder Kuqit, sepse ai nuk ishte fajtor për këtë, Dhoma e Apelit konstaton se Skënder Kuqi u vra nga ushtarë të UÇK-së gjatë kohës që mbahej në oborrin me ndërtesa në Jabllanicë.<sup>780</sup> Dhoma Gjyqësore nuk mori parasysh vrasjen e Skënder Kuqit në përcaktimin e rrezikshmërisë së veprave penale të Lahi Brahimajt, por mori parasysh frikën e shtuar të Dëshmitarit 6 kur dëgjoi për vdekjen e Skënder Kuqit në rrethana shumë të ngjashme me të vetat. Për shkak të rolit të Lahi Brahimajt në oborrin me ndërtesa në Jabllanicë dhe pjesëmarrjes së tij aktive në rrahjet e atjeshme, ishte e arsyeshme që Dhoma Gjyqësore të nxirrte përfundimin se vdekja e Skënder Kuqit bëri që të shtohej frika e Dëshmitarit 6 se mund të pësonte të njëjtin fat.

363. Dhoma e Apelit pranon se nuk kishte dëshmi të drejtpërdrejta se frika e Dëshmitarit 6 u shtua kur mësoi për vdekjen e Skënder Kuqit. Gjithsesi, duke i shqyrtuar provat dhe rrethanat në tërësi, Dhoma e Apelit konkludon se përfundimi i Dhomës Gjyqësore në këtë drejtim ishte i arsyeshëm.

364. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit e hedh poshtë këtë pikë të apelit.

10. Pretendim për gabim të Dhomës Gjyqësore në ushtrimin jo të duhur të kompetencës së saj gjyqësore duke marrë parasysh se dënimi i dhënë ishte haptazi i tepruar në të gjitha rrethanat (Pika 19)

365. Lahi Brahimaj parashtroi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur nuk e ushtroi si duhet kompetencën e saj gjyqësore, duke marrë parasysh se dënimi i dhënë ishte haptazi i tepruar në rrethanat e çështjes së tij.<sup>781</sup> Ai rendit tetë nënpika të apelit.

<sup>779</sup> Aktgjykim, para. 395.

<sup>780</sup> Aktgjykim, para. 433-435.

<sup>781</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 180-180.8.

366. Prokuroria përgjigjet se Lahi Brahimaj nuk provon se vendimi i Dhomës Gjyqësore në lidhje me dënimin ishte i tillë që asnjë Dhomë Gjyqësore e arsyeshme nuk do ta kishte dhënë.<sup>782</sup> Prokuroria më tej argumenton se kjo pikë përmban pretendime që ose janë të përsëritura, ose nuk lidhen me çështjen.<sup>783</sup>

367. Në nënpikën 19.1, Lahi Brahimaj argumenton se torturat dhe trajtimi mizor për të cilët u shpall fajtor, nuk ishin as sistematike as të përhapura gjerësisht.<sup>784</sup> Dhoma e Apelit konstaton se Lahi Brahimaj u shpall fajtor në lidhje me dy pika për shkelje të ligjeve apo zakoneve të luftës sipas Nenit 3 të Statutit, por u shpall i pafajshëm në lidhje me të gjitha pikat për krime kundër njerëzimit sipas Nenit 5 të Statutit.<sup>785</sup> Duket se Lahi Brahimaj argumenton që atij duhet t'i jepet dënim më i lehtë, sepse u shpall i pafajshëm për krime kundër njerëzimit. Mirëpo Dhoma e Apelit kujton konkluzionin e vet se:

ligji nuk bën dallim midis peshës së një krimi kundër njerëzimit dhe të një krimi lufte. Dhoma e Apelit gjykon se nuk ka ekziston bazë për një dallim të tillë në Statut apo në Rregulloren e Tribunalit Ndërkombëtar, të hartuar në përputhje me të drejtën zakonore ndërkombëtare; dënimet e sanksionuara janë po ashtu të njëjta, niveli i tyre përcaktohet për çdo rast konkret duke iu referuar rrethanave të çështjes.<sup>786</sup>

Si rrjedhojë, pretendimi i Lahi Brahimajt se duhet t'i jepet një dënim më i lehtë sepse ai u dënua për shkelje të ligjeve apo zakoneve të luftës, dhe jo për krime kundër njerëzimit, është i pasaktë nga pikëpamja ligjore. Si rezultat, kjo nënpikë e apelit hidhet poshtë.

368. Në nënpikën 19.2, Lahi Brahimaj pohon se ai ka të njëjtën përkatësi etnike me Dëshmitarët 3 dhe 6.<sup>787</sup> Dhoma e Apelit e hedh poshtë menjëherë këtë nënpikë të apelit, bazuar në faktin se është argument i pashtjelluar apo pretendim i gabuar.<sup>788</sup>

369. Nën nënpikën 19.3, Lahi Brahimaj parashtron se Dëshmitari 3 dhe 6 ishin meshkuj dhe ishin ose të armatosur, ose kishin marrë pjesë në luftime. Më tej, ai parashtron se Dëshmitari 6 kishte një armë zjarri pa leje dhe se Dëshmitari 3 ishte

<sup>782</sup> Përgjigjja e Prokurorisë, para. 94.

<sup>783</sup> Përgjigjja e Prokurorisë, para. 94.

<sup>784</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 180.1.

<sup>785</sup> Aktgjykimi, para. 504.

<sup>786</sup> Aktgjykimi i Apelit të Dënimet *Tadiq*, para. 69.

<sup>787</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 180.2.

<sup>788</sup> Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 26; Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 297.

luftëtar që kishte luftuar për UÇK-në dhe që kishte një pushkë Kallashnikov.<sup>789</sup> Kjo nënpikë e apelit është hedhur poshtë ndërkohë në pikën 15 më sipër.

370. Nën nënpikën 19.4, Lahi Brahimaj parashtron se Dhoma Gjyqësore nuk konkludoi se ai ishte përgjegjës për ngritjen apo përdorimin e kazermës në të cilën u mbajtën Dëshmitari 3 dhe 6.<sup>790</sup> Dhoma e Apelit konkludon se kjo nënpikë e apelit është argument i pashtjelluar ose pretendim i gabuar.<sup>791</sup> Rrjedhimisht kjo nënpikë e apelit hidhet poshtë menjëherë.

371. Në nënpikën 19.5, Lahi Brahimaj parashtron se Dhoma Gjyqësore nuk konkludoi se ai kishte ndonjë rol komandues në kazermë.<sup>792</sup> Dhoma e Apelit e ka trajtuar tashmë aspektin e masës së pushtetit që Lahi Brahimaj kishte në Jabllanicë sipas pikave 11, 12, dhe 13, të cilat janë hedhur poshtë. Për më tepër, Dhoma e Apelit konstaton se kjo nënpikë e apelit është argument i pashtjelluar ose pretendim i gabuar.<sup>793</sup> Rrjedhimisht kjo nënpikë e apelit hidhet poshtë menjëherë.

372. Në nënpikën 19.6, Lahi Brahimaj parashtron se kishte arsye për mbajtjen apo marrjen në pyetje të personave në kazermë: U konstatua se Dëshmitari 6 mbante një armë zjarri pa leje, ndërsa Dëshmitari 3 kishte dorëzuar një pushkë Kallashnikov që i përkiste një bashkëfshatari.<sup>794</sup> Dhoma e Apelit e hedh poshtë menjëherë këtë nënpikë të apelit mbështetur në faktin se është argument i pashtjelluar ose pretendim i gabuar.<sup>795</sup>

373. Në nënpikën 19.7, Lahi Brahimaj argumenton se Dëshmitarët 3 dhe 6 nuk pretenduan se Lahi Brahimaj u kishte shkaktuar atyre lëndime fizike, me përjashtim të mavijosjeve.<sup>796</sup> Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore konkludoi se Lahi Brahimaj personalisht mori pjesë në torturimin dhe trajtimin mizor të Dëshmitarëve 3 dhe 6;<sup>797</sup> për më tepër, është e qartë se Dhoma Gjyqësore e mori këtë parasysh kur përcaktoi

<sup>789</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 180.3.

<sup>790</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 180.4.

<sup>791</sup> Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 26; Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 297.

<sup>792</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 180.5.

<sup>793</sup> Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 26; Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 297.

<sup>794</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 180.6.

<sup>795</sup> Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 26; Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 297.

<sup>796</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 180.7.

<sup>797</sup> Aktgjykimi, para. 395, 451.

rrezikshmërinë e veprave penale të Lahi Brahimajt.<sup>798</sup> Rrjedhimisht nuk është provuar ndonjë gabim, dhe kjo nënpikë e apelit hidhet poshtë.

374. Në nënpikën 19.8, Lahi Brahimaj argumenton se as Dëshmitari 3, as Dëshmitari 6 nuk ishin veçanërisht të cënueshëm për shkak se mbaheshin të ndaluar.<sup>799</sup> Familja e Dëshmitarit 6 dhe bashkëfshatarët e tij kishin dijeni se ai ishte në kazermë dhe u lejuan ta vizitonin, ndërsa familja e Dëshmitarit 3 kishte dijeni se ai ishte në kazermë dhe ndërhyri për të.<sup>800</sup> Dhoma e Apelit tashmë e ka trajtuar dhe hedhur poshtë këtë argument në pikën 15. Rrjedhimisht kjo nënpikë e apelit hidhet poshtë.

375. Bazuar në sa më sipër, Dhoma e Apelit nxjerr përfundimin se Lahi Brahimaj nuk mundi të provonte që Dhoma Gjyqësore nuk e ushtroi si duhet kompetencën e saj gjyqësore duke i dhënë atij një dënim që ishte haptazi i tepruar në të gjitha rrethanat.

376. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit e hedh poshtë këtë pikë të apelit.

---

<sup>798</sup> Aktgjykimi, para. 492-493.

<sup>799</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 180.8.

<sup>800</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt, para. 180.8.

## V. VENDIM

377. Për arsytet e lartpërmendura, **DHOMA E APELIT**,

**BAZUAR NË** Nenin 25 të Statutit dhe Rregullat 117 dhe 118 të Rregullores,

**DUKE MARRË PARASYSH** parashtrimet përkatëse me shkrim të palëve dhe argumentet e paraqitura prej tyre në seancën e apelit më 28 tetor 2009;

Në lidhje me apelin e Prokurorisë,

**MIRATON** Pikën 1 të Apelit, me përjashtim të mospajtimit prej Gjykatësit Robinson, dhe **HEDH POSHTË** vendimin e Dhomës Gjyqësore : (a) që shpalli të pafajshëm Ramush Haradinajn dhe Idriz Balajn për pjesëmarrje në një ndërmarrje të përbashkët kriminale për kryerjen e krimeve në shtabin dhe burgun e UÇK-së në Jabllanicë në lidhje me Pikat 24, 26, 28, 30, 32, dhe 34 të Aktakuzës; (b) që shpalli të pafajshëm Lahi Brahimajn për pjesëmarrje në një ndërmarrje të përbashkët kriminale për kryerjen e krimeve në shtabin dhe burgun e UÇK-së në Jabllanicë në lidhje me Pikat 24, 26, 30, dhe 34 të Aktakuzës; (c) që shpalli të pafajshëm Ramush Haradinajn, Idriz Balajn, dhe Lahi Brahimajn për përgjegjësi individuale penale në lidhje me Pikat 24 dhe 34 të Aktakuzës; dhe (d) që shpalli të pafajshëm Lahi Brahimajn për përgjegjësi individuale penale në lidhje me Pikën 26 të Aktakuzës, dhe **URDHËRON** që Ramush Haradinaj, Idriz Balaj, dhe Lahi Brahimaj të rigjykoohen në lidhje me këto pika;

**HEDH POSHTË** Pikën 2 të Apelit të Prokurorisë;

**MIRATON**, pjesërisht, dhe **HEDH POSHTË**, pjesërisht, Pikën 3 të Apelit të Prokurorisë dhe **LË NË FUQI** pafajësinë e Idriz Balajt në lidhje me Pikën 37;

Në lidhje me apelin e Lahi Brahimajt,

**HEDH POSHTË** Pikat 1-8 të Apelit të Lahi Brahimajt;

**MIRATON**, pjesërisht, dhe **HEDH POSHTË**, pjesërisht, Pikën 9 të Apelit të Lahi Brahimajt dhe **LË NË FUQI** fajësinë e Lahi Brahimajt në lidhje me Pikën 28;

**HEDH POSHTË** Pikat 10 -19 të Lahi Brahimajt;

**LË NË FUQI** dënimin e Lahi Brahimajt; dhe

**BAZUAR NË** Rregullën 64 dhe Rregullën 107 të Rregullores së Procedurës dhe Provave,

**URDHËRON** marrjen në paraburgim të Ramush Haradinajt, Idriz Balajt, dhe Lahi Brahimajt dhe **UDHËZON** Komandantin e Njësisë së Paraburgimit të Kombeve të Bashkuara në Hagë t'i mbajë ata në paraburgim deri në një urdhër tjetër.

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht, teksti në anglisht ka përparësi.

Gjykatës Patrick Robinson, Kryetar

Gjykatës Fausto Pocar

Gjykatës Liu Daqun

Gjykatës Andréia Vaz

Gjykatës Theodor Meron

Gjykatësi Patrick Robinson bashkëngjijt arsyetimin e tij pjesërisht mospajtues.

Sot, më 19 korrik 2010  
Në Hagë  
Holandë

**Vula e Tribunalit**

## VI. ARSYETIM PJESËRISHT MOSPAJTUES I GJYKATËSIT PATRICK ROBINSON

### A. Hyrje

1. Përfundimet e Shumicës në lidhje me pikën 1 të Apelit të Prokurorisë vënë në pikëpyetje kufijtë e funksioneve të gjykimit dhe të apelit. Kur Dhoma e Apelit bën gabim, sikundër parashtroj se ka bërë në këtë çështje, me gjithë respektim tim për të, komprometohet rëndë marrëdhënia midis dy funksioneve, përmbushja e duhur nga Tribunali e misionit të tij për gjykimin e personave për shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare.

2. Në të gjitha sistemet ligjore, organet e gjykimit dhe të apelit kanë rolet dhe kompetencat e tyre përkatëse. Në veçanti, ka kufi në lidhje me fushëveprimin e mundshëm të një organi apeli. Rregullat themelore të shumicës së sistemeve ligjore, të cilat kufizojnë funksionin e apelit, janë të mirënjohura dhe janë theksuar vazhdimisht në vendimet e Dhomës së Apelit: apeli nuk është rigjykim;<sup>1</sup> Dhomave Gjyqësore u është akorduar përparësi deri në një masë të caktuar përse i përket vërtetimit të fakteve, sidomos, kur është fjala për përcaktimin e besueshmërisë së dëshmitarëve, meqenëse ajo ka epërsinë e vëzhgimit të sjelljes së dëshmitarëve në gjyq;<sup>2</sup> vetëm fakti se Dhoma e Apelit do ta kishte ushtruar ndryshe kompetencën e saj gjyqësore, nuk përbën arsye të mjaftueshme për shfuqizimin e ushtrimit të kësaj kompetence nga Dhoma Gjyqësore, me kusht që Dhoma Gjyqësore ta ketë ushtruar si duhet këtë kompetencë;<sup>3</sup> Dhomës

<sup>1</sup>Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq*, para. 352; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 734; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 326; Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 393; Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq e të tjerë*, para. 407-408.

<sup>2</sup> Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq e të tjerë*, para. 32; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 491; Aktgjykimi i Apelit *Furunxhija*, para. 37; Aktgjykimi i Apelit *Ntakirutimana*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Niyitegeka*, para. 95.

<sup>3</sup> *Shih Prokurori k. S. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-99-37-AR73, IT-01-50-AR73, dhe IT-01-51-AR73, Arsyet për Vendimin e Apelit të Ndërkohshëm të Prokurorisë të Refuzimit për të Urdhëruar Bashkimin e Çështjeve, 18 prill 2002 (Vendimi “*Millosheviq* i 18 prillit 2002”), para. 4 (“Kur një apel parashtrohet si rrjedhojë e një vendimi të Dhomës Gjyqësore gjatë ushtrimit të kompetencës së saj gjyqësore, çështja në atë apel nuk është nëse vendimi ka qenë i saktë, në kuptimin që Dhoma e Apelit pajtohet me atë vendim, por nëse Dhoma Gjyqësore ka ushtruar me korrektesë kompetencën e saj gjyqësore në marrjen e një vendimi të tillë. Në qoftë se Dhoma Gjyqësore e ushtron me korrektesë kompetencën e saj gjyqësore, vendimi i saj nuk

Gjyqësore i duhet dhënë një farë përparësie në çështje që lidhen me administrimin e gjykimit.<sup>4</sup>

Është e lehtë të formulohet pyetja në këtë apel, sepse është pyetje e thjeshtë: sa mundësi duhet t'i ofrojë Dhoma Gjyqësore një pale për paraqitjen e një dëshmitari? Në rast se Dhoma Gjyqësore i ofron një pale vetëm një apo dy mundësi për paraqitjen e një dëshmitari, a ka vepruar në mënyrë të papërshtatshme, duke pasur parasysh detyrën e saj statutore për garantimin e një gjykimi të drejtë dhe të shpejtë? A e ka shkelur kompetencën e saj gjyqësore në administrimin e gjykimit? A duhet ta shtyjë çështjen e një pale katër, pesë, apo 50 herë, që t'i japë mundësi asaj pale të paraqesë një dëshmitar? Çështja më e rëndësishme është roli që duhet të luajë Dhoma e Apelit në shqyrtimin e një pike të apelit sipas të cilës Dhoma Gjyqësore, që në të vërtetë i ka dhënë mundësi një pale të paraqesë një dëshmitar, nuk ka bërë sa duhet për të mundësuar praninë e atij dëshmitari.

4. Konkluzioni i Shumicës është se Dhoma Gjyqësore gaboi kur “nuk mori masat e nevojshme kundër frikësimit të dëshmitarëve që përshkoi procesin gjyqësor, dhe në veçanti nuk ndihmoi Prokurorinë në kërkesat e saj për të siguruar dëshminë e Kabashit dhe dëshmitarit tjetër” dhe se për shkak të “rëndësisë së mundshme të këtyre dëshmitarëve për çështjen e Prokurorisë, [...] në kuadrin e kësaj çështjeje, gabimi minoi ndershmërinë e procesit që garanton Statuti dhe Rregullorja, dhe rezultoi në dështimin e

---

preket në apel, edhe pse vetë Dhoma e Apelit mund ta kishte ushtruar ndryshe kompetencën e saj gjyqësore. Kjo është themelore për çdo vendim të marrë, mbështetur në kompetencën gjyqësore. Vetëm në rast se provohet gabim në ushtrimin e kompetencës gjyqësore, Dhoma e Apelit mund të ushtrojë kompetencën e vet gjyqësore në vend të kompetencës gjyqësore të Dhomës Gjyqësore”). *Shih gjithashtu Prokurori k. Momçillo Krajishnikut*, Çështja Nr. IT-00-39-AR73.1, Vendim mbi Apelin e Ndërkohshëm të Vendimit për Mocionin e dytë të Mbrojtjes për Shtyrje, 25 prill 2005 (“Vendimi *Krajishnik* i 25 prillit 2005”), para. 7; *Prokurori k. S. Millosheviqit*, Çështja Nr. IT-02-54-AR73.7, Vendim mbi Apelin e Ndërkohshëm të Vendimit të Dhomës Gjyqësore për Caktimin e Avokatit të Mbrojtjes, 1 nëntor 2004, para. 9; *Prokurori k. Vojisllav Sheshelit*, Lënda Nr. IT-03-67-AR73.3, Vendim mbi Apelin e Vendimit të Dhomës Gjyqësore për Caktimin e Avokatit, 20 tetor 2006, para. 7.

<sup>4</sup> *Prokurori k. Radovan Karaxhiqit*, Çështja Nr. IT-95-5/18-AR73.5, Vendim mbi Apelin e Radovan Karaxhiqit të Vendimit për Fillimin e Gjykimit, 13 tetor 2009, para. 6 (“Vendimi *Karaxhiq* i 13 tetorit 2009”); *Prokurori k. Vojisllav Sheshelit*, Çështja Nr. IT-03-67-AR73.8, Vendim mbi Apelin e Prokurorisë të Urdhrit të Dhomës Gjyqësore për Rifillimin e Procesit, 16 shtator 2008 (“Vendimi *Sheshel* i 16 shtatorit 2008”), para. 3; Vendimi *Krajishnik* i 25 prillit 2005, para. 7; *Prokurorja k. S. Millosheviqit*, Çështja Nr. IT-02-54-AR73.6, Vendim mbi Apelin e Ndërkohshëm nga *Amici Curiae* të Urdhrit të Dhomës Gjyqësore në lidhje me Paraqitjen dhe Përgatitjen e Çështjes nga Mbrojtja, 20 janar 2004 (“Vendimi *Millosheviq* i 20 janarit 2004”), para. 16; Aktgjykimi *Çelebiqi*, para. 291-293.

drejtësisë”.<sup>5</sup> Mirëpo duhet vënë në dukje se Dhoma Gjyqësore e zgjati afatin e Prokurorisë tri herë, për t’i dhënë Prokurorisë më shumë kohë për marrjen e dëshmive të këtyre dëshmitarëve dhe ishte e hapur për mundësinë e miratimit të një zgjatjeje tjetër afati, në qoftë se provohej ndryshim rrënjësor në rrethanat e çështjes. Së pari megjithëse fillimisht Dhoma Gjyqësore caktoi 8 nëntorin 2007 si datën e fundit për paraqitjen e çështjes nga Prokuroria,<sup>6</sup> më 31 tetor 2007 Dhoma Gjyqësore e zgjati çështjen e Prokurorisë me tetë ditë, deri më 16 nëntor 2007, për t’i mundësuar Prokurorisë marrjen e dëshmisë së Kabashit dhe të dëshmitarit tjetër me anë të videokonferencës në fillim të po asaj jave.<sup>7</sup> Së dyti, më 15 nëntor 2007, Dhoma Gjyqësore e miratoi kërkesën e Prokurorisë për një zgjatje katërditore të çështjes së saj<sup>8</sup> për t’i mundësuar të dëgjonte dëshminë e Kabashit me anë të videokonferencës më 20 nëntor 2007.<sup>9</sup> Në miratimin e kësaj zgjatjeje afati Dhoma Gjyqësore ishte e vetëdijshme ndaj faktit se Kabashi, sipas fjalëve të saj, ishte “dëshmitar i rëndësishëm okular për krimet për të cilat akuzon aktakuza”.<sup>10</sup> Dhoma Gjyqësore gjithashtu vuri në dukje se:

[...] më 31 tetor 2007, ajo bëri të ditur se priste që Prokuroria ta mbyllte çështjen e saj më 16 nëntor 2007. Mirëpo Prokuroria ka provuar se i ka bërë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për marrjen e dëshmisë së Z. Kabashi brenda kësaj date, dhe për shkak të rrethanave jashtë kontrollit të Prokurorisë, një gjë e tillë nuk u bë e mundur. Rrjedhimisht Dhoma vendosi t’ia zgjasë afatin [...] Prokurorisë për përfundimin e çështjes së saj me qëllimin e vetëm për të dëgjuar dëshminë e Z. Kabashi më 20 nëntor 2007.<sup>11</sup>

Së treti, më 20 nëntor 2007, Dhoma Gjyqësore i lejoi Prokurorisë edhe një zgjatje prej shtatë ditësh për paraqitjen e çështjes së saj deri më 27 nëntor 2007, me qëllim që të dëgjonte dëshminë e dëshmitarit tjetër, duke marrë parasys argumentin e Prokurorisë “se ajo i kishte bërë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për marrjen e dëshmisë së [dëshmitarit tjetër] brenda 16 nëntorit, por se ishte e pamundur për arsye që nuk vareshin prej saj.”<sup>12</sup> Në dhënien e këtij vendimi, Dhoma Gjyqësore shqyrtoi edhe “rëndësinë e pritshme të

<sup>5</sup> Mendimi i Shumicës, para. 49.

<sup>6</sup> T. 9347-9348, 15 tetor 2007 (Seancë Publike), T. 10798 (15 nëntor 2007) (Seancë Publike).

<sup>7</sup> T. 9984-9985, 31 tetor 2007 (Seancë Publike).

<sup>8</sup> *Shih Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-T, Kërkesa e Prokurorisë për të Dëgjuar Shefqet Kabashin me Videolidhje të martën, 20 nëntor 2007, 14 nëntor 2007.

<sup>9</sup> T. 10893 (15 nëntor 2007) (Seancë Publike), T. 10954 (20 nëntor 2007) (Seancë Publike).

<sup>10</sup> T. 10120 (1 nëntor 2007) (Seancë Publike).

<sup>11</sup> T. 10955 (20 nëntor 2007) (Seancë Publike).

<sup>12</sup> T. 10955 (20 nëntor 2007) (Seancë Publike).

dëshmisë për çështjen e Prokurorisë” dhe “vështirësitë që Prokuroria kishte për marrjen e dëshmisë së tij”.<sup>13</sup> Për më tepër, sikundër shpjegohet me hollësi më poshtë, pasi Kabashi refuzoi të dëshmonte me videolidhje gjatë seancës së 20 nëntorit 2007, Dhoma Gjyqësore vendosi se do të shqyrtonte kërkesën e Prokurorisë për një zgjatje tjetër afati për të dëgjuar dëshminë e Kabashit, në rast se Prokuroria do të provonte se kishte ndodhur një ndryshim rrënjësor në rrethanat e çështjes.<sup>14</sup> Duke marrë parasysh nivelin e dëshmuar të përpjekjeve të Dhomës Gjyqësore për të mundësuar praninë e këtyre dëshmitarëve, është vështirë të kuptohet se si mund të mendohet se Dhoma Gjyqësore nuk e kreu detyrën e saj për ta ndihmuar Prokurorinë në marrjen e provave të saj.

5. Kur problemet në apel lidhen me administrimin e gjykimit, sikundër ndodh në këtë rast, Dhoma e Apelit duhet t’i japë Dhomën Gjyqësore përparësi në një masë të arsyeshme. Sikurse pranohet në praktikën gjyqësore, dhënia e përparësisë bazohet në pranimin nga Dhoma e Apelit “se Dhoma Gjyqësore është organikisht në dijeni të sjelljes së përditshme të palëve dhe kërkesave praktike të çështjes”.<sup>15</sup> Është për të ardhur keq që në Arsyetimin e Shumicës ky standard rishqyrtimi është shpërfillur. Logjika e standardit është se Dhoma Gjyqësore përgjigjet për administrimin e gjykimit që zhvillon, dhe është krejtësisht e arsyeshme që një organ apeli t’u japë përparësi mendimeve të Dhomave Gjyqësore për probleme që lidhen me administrimin e përditshëm të çështjes, sigurisht nëse Dhoma nuk e ka shpërdorur kompetencën e saj gjykuese.

6. Në rastin konkret, Dhoma Gjyqësore ia zgjati afatin Prokurorisë për paraqitjen e çështjes së saj, jo një, jo dy, por tri herë, dhe ishte e hapur për t’ia zgjatur sërish në rast se Prokuroria do të kishte provuar ndryshim të madh të rrethanave. Ajo veproi kështu sepse donte t’i jepte Prokurorisë sa më shumë kohë që të ishte e mundur, për të mundësuar praninë e atyre dëshmitarëve të rëndësishëm. Dhoma Gjyqësore veproi kështu edhe për faktin se ishte e vetëdijshme për atmosferën e përgjithshme të frikësimeve dhe

<sup>13</sup> T. 10956 (20 nëntor 2007) (Seancë Publike).

<sup>14</sup> *Shih* Kabashi, T. 10961 (20 nëntor 2007) (Seancë Publike); T. 10977-10979 (26 nëntor 2007) (Seancë Publike).

<sup>15</sup> *Prokurori k. Zdravko Tolimirit e të tjerëve*, Çështja Nr. IT-04-80-AR73.1, Vendim mbi Apelin e Ndërkohshëm të Radivoje Miletiqit *k. Vendimit të Dhomës Gjyqësore për Bashkimin e të Akuzuarve*, 27 janar 2006, para. 4; *Prokurori k. S. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-AR73.7, Vendim mbi Apelin e Ndërkohshëm të Vendimit të Dhomës Gjyqësore për Caktimin e Avokatit të Mbrojtjes, 1 nëntor 2004, para. 9.

kërcënimeve, që vetë Dhoma Gjyqësore e pranoi se ishte e gjithëpranishme. Në rast se nuk do të kishte qenë mirëkuptuese ndaj vështirësive të përjetuara nga Prokuroria për mundësimin e pranisë së këtyre dëshmitarëve, në kuadër të atmosferës së përgjithshme të frikësimeve dhe kërcënimeve, atëherë mund të shtrohej pyetja nëse kishte shpërdorur kompetencën e saj gjyqësore, duke pasur parasysh detyrën e saj për garantimin e një gjykimi të shpejtë dhe për të ndihmuar një palë në marrjen e dëshmive të dëshmitarëve të saj në kuadrin e paraqitjes së çështjes nga ana e saj. Mirëpo në fakt Dhoma Gjyqësore miratoi zgjatje afati dhe pastaj, pas pamundësisë së Kabashit për të qenë i pranishëm në konferencën me videolidhje, e zgjati edhe një herë afatin, dhe së fundi, e zgjati edhe një herë të tretë kur dëshmitari tjetër nuk erdhi në konferencën me videolidhje. Për më tepër, Dhoma Gjyqësore bëri të ditur se ishte e hapur ndaj mundësisë për zgjatje të mëtejshme të afatit, në rast se Prokuroria do të provonte çfarë kërkohej. Atëherë si mund të argumentohet në këto rrethana se Dhoma Gjyqësore “nuk mori masat e nevojshme kundër frikësimit të dëshmitarëve që përshkoi procesin gjyqësor, dhe në veçanti nuk ndihmoi Prokurorinë në kërkesat e saj për të siguruar dëshminë e Kabashit dhe dëshmitarit tjetër”<sup>16</sup>

7. Problemi i numrit të zgjatjeve të afateve, një, dy, apo njëqind herë, apo pezullimi ose shtyrja e seancave janë aspekte të administrimit të hollësishëm të përditshëm të çështjes për të cilat vendos më së miri Dhoma Gjyqësore duke u bazuar në të gjitha rrethana përkatëse. Për këto aspekte nuk mund të vendosë Dhoma e Apelit. Unë do ta kisha zgjatur afatin më shumë se tri herë, apo do ta kisha shtyrë për më vonë ose pezulluar procedimin, dhe të njëjtën gjë mund të kishte bërë edhe Shumica, por kjo nuk ka lidhje me problemin. Sepse, nuk është detyra e apelit të përcaktojë nëse Dhoma Gjyqësore ka miratuar zgjatje të mjaftueshme afatesh, në rast se nuk ka një tregues të qartë për shpërdorim të kompetencës gjyqësore prej Dhomës Gjyqësore. Në rast se do të vepronim kështu, thjesht do të ushtronim kompetencën tonë gjyqësore në vend të kompetencës gjyqësore të Dhomës Gjyqësore, pa pasur arsytet e duhura.

---

<sup>16</sup> Mendimi i Shumicës, para. 49.

8. Është fakt i pranuar se vetëm kur provohet gabim i dukshëm i Dhomës Gjyqësore në ushtrimin e kompetencës së saj gjyqësore, Dhoma e Apelit mund të ushtrojë kompetencën e saj gjyqësore në vend të kompetencës së ushtruar nga Dhoma Gjyqësore.<sup>17</sup> Rrjedhimisht Dhoma e Apelit e shfuqizon ushtrimin e kompetencës gjyqësore të Dhomës Gjyqësore vetëm kur konkludon se një ushtrim i tillë: (a) është bazuar në një interpretim të pasaktë të ligjit në fuqi, që për këtë rast nuk vlen; (b) është bazuar në një përfundim faktual qartësisht të pasaktë, që gjithashtu në këtë rast nuk vlen; ose (c) është kaq i padrejtë apo i paarsyeshëm sa që përbën shkelje të kompetencës gjyqësore të Dhomës Gjyqësore.<sup>18</sup> Në gjykimin tim faktori i fundit do të ishte kriteri i vlefshëm në lidhje me këtë çështje. Mirëpo në Arsyetimin e Shumicës nuk tregohet ndonjë vendim i padrejtë ose i paarsyeshëm i Dhomës Gjyqësore.

9. Gabimi i vënë në dukje nga Shumica, se Dhoma Gjyqësore “nuk mori masat e nevojshme kundër frikësimit të dëshmitarëve që përshkoi procesin gjyqësor, dhe në veçanti nuk ndihmoi Prokurorinë në kërkesat e saj për të siguruar dëshminë e Kabashit dhe dëshmitarit tjetër”, nuk përbën aspak gabim, sepse Dhoma Gjyqësore, duke e zgatur tri herë afatin dhe, për më tepër, duke qenë e gatshme të shqyrtonte kërkesën e Prokurorisë për zgjatje të mëtejshme afati për të dëgjuar dëshminë e Kabashit pasi kjo e fundit të provonte se kishte ndodhur një ndryshim rrënjësor i rrethanave, mbajti qëndrim krejtësisht të drejtë dhe të arsyeshëm në ato rrethana, sikundër tregon analiza e mëposhtme.

## **B. Vendimet e Kundërshtuara të Dhomës Gjyqësore**

10. Për të qenë sa më i plotë, po i përmbledh shkurtimisht argumentet e Prokurorisë, ndonëse janë të përmbledhura në Arsyetimin e Shumicës.

<sup>17</sup> *Shih* më sipër Arsyetim Pjesërisht Mospajtuës, poshtëshënimet 3-4; *shih gjithashtu* Vendimi *Krajishnik* i 25 prillit 2005, para. 7.

<sup>18</sup> *Shih* Vendimi *Karaxhiq* i 13 tetorit 2009, para. 6; Vendimi *Sheshel* i 16 shtatorit 2008, para. 3; Vendimi *Krajishnik* i 25 prillit 2005, para. 7.

## 1. Vendimi i 31 tetorit 2007

11. Prokuroria argumenton se Vendimi i 31 tetorit 2007, në të cilin Dhoma Gjyqësore bëri të ditur se e kishte shqyrtuar kohën që mbetet në kuadër të 125 orëve të caktuara Prokurorisë për paraqitjen e çështjes nga ana e saj, dhe se priste që Prokuroria ta mbyllte çështjen e saj më 16 nëntor 2006, tregon ngurtësinë e Dhomës Gjyqësore në mosndryshimin e afatit kohor që i kishte caktuar Prokurorisë për paraqitjen e çështjes së saj, e privoi Prokurorinë prej marrjes së dëshmisë së Kabashit dhe të dëshmitarit tjetër.<sup>19</sup> Për ironi, në këtë Vendim, të cilin Prokuroria e sjell si shembull ilustrues të “gabimit të Dhomës Gjyqësore në parapëlqimin për një gjykim të shpejtë në vend të një gjykimi të drejtë”.<sup>20</sup> Në fakt Dhoma Gjyqësore e zgjati afatin për paraqitjen e çështjes prej Prokurorisë. Sikundër shpjegohet më sipër, në vendimin e saj të 31 tetorit, 2007, Dhoma Gjyqësore e shtyu datën përfundimtare të paraqitjes së çështjes nga Prokuroria nga 8 nëntori 2007 më 16 nëntor 2007. Për më tepër, pas vendimit të 31 tetorit 2007, Dhoma Gjyqësore ia zgjati Prokurorisë afatin edhe dy herë të tjera për marrjen e dëshminë së Kabashit dhe të dëshmitarit tjetër.<sup>21</sup> Gjithashtu Dhoma Gjyqësore bëri të ditur se ishte e hapur ndaj mundësisë për zgjatje të mëtejshme të afatit për të dëgjuar dëshminë e Kabashit në rast se Prokuroria do të provonte ndryshim të madh të rrethanave të çështjes. Rrjedhimisht ndryshe nga sa pretendon Prokuroria, këto zgjatje afatesh miratuar nga Dhoma Gjyqësore dhe gatishmëria e Dhomës për një zgjatur tjetër afati, pasi të provohej çfarë kërkohej, tregojnë se Dhoma Gjyqësore i kushtoi vëmendjen e duhur shqyrtimit të rëndësisë së marrjes së dëshmisë së Kabashit dhe dëshmitarit tjetër dhe se ishte e hapur për grafikun kohor të procesit gjyqësor, për mundësimin e dhënies së dëshmive.

## 2. Vendimi i 15 nëntorit 2007

12. Në trajtimin e argumentit të Prokurorisë, se Dhoma Gjyqësore “duke qenë e fiksuar pas trysnisë së kohës”, nuk pranoi të dëgjonte dëshminë e dëshmitarit tjetër më 15 nëntor 2007 me videolidhje duke vazhduar punën pas orës 19:00, ose duke punuar të nesërmen, Shumica e karakterizon vendimin e 15 nëntorit 2007 si “shëmbëlltyrë” të faktit

<sup>19</sup> *Shih* Arsyetimi i Shumicës, para. 20.

<sup>20</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 17.

<sup>21</sup> *Shih* më sipër Arsyetim Pjesërisht Mospajtues, para. 4.

se Dhoma Gjyqësore nuk bëri përpjekjet që do të kishin rezultuar në marrjen e dëshmisë prej dëshmitarit tjetër. Në këtë drejtim, Shumica deklaroi se:

Dhoma Gjyqësore u informua se dëshmitari tjetër [...] do të kishte qenë në dispozicion për të dëshmuar me videolidhje rreth orës 18:30 pasdite. Mirëpo ndonëse ishte e vetëdijshme për mosgatishmërinë e dëshmitarit tjetër për të dëshmuar dhe rëndësinë e mundshme të kësaj dëshmie për çështjen e Prokurorisë, Dhoma Gjyqësore e vonoi ndjeshëm dhënien e dëshmisë së tij për arsye logjistike, objektivistike më pak të rëndësishme.<sup>22</sup>

Më tej, vihet në dukje përfundimi i Dhomës Gjyqësore se:

jo vetëm që është e enjte rreth orës 19:00, por gjithashtu edhe 125 orë që kur Prokuroria filloi me paraqitjen e çështjes së saj. Nuk ka kurrfarë mundësie që të zhvillojmë seancë të premtën ose të hënën. [...] E marta [...] është e rezervuar për një dëshmitar tjetër [por edhe sikur dëshmitari tjetër] të mund të dëshmonte, ekziston mundësi e arsyeshme që të mos arrijmë më tej se ai nuk do t'u përgjigjet pyetjeve. Ka edhe një mundësi tjetër, që ai të fillojë t'u përgjigjet pyetjeve. dhe pastaj, sigurisht, çfarë hapash të ndërmarrim kur nuk ka më kohë.<sup>23</sup>

Shumica më tej konkludon:

Gjuha dhe qëndrimi i Dhomës Gjyqësore tregojnë qartë se ajo u dha përparësi faktorëve logjistikë dhe numrit të orëve që i ishin caktuar Prokurorisë për paraqitjen e çështjes prej saj, në vend të faktorit shumë më të rëndësishëm të marrjes së dëshmisë së një dëshmitari potencialisht të rëndësishëm, i cili më së fundi ishte në dispozicion për të dëshmuar.<sup>24</sup>

13. Së pari, në kundërshtim me pretendimin e Shumicës, në Vendimin e saj të 15 nëntorit 2007, Dhoma Gjyqësore asnjëherë nuk deklaroi me siguri se dëshmitari tjetër “do të kishte qenë në dispozicion të dëshmonte me videolidhje rreth orës 18:30”. N1 fakt ajo deklaroi se:

nga informacioni më i fundit që kemi në [...] prej orës 18:30, [dëshmitari tjetër] do të jetë në dispozicion për t'u marrë në pyetje nëpërmes videolidhjes, ndonëse ende nuk është konfirmuar plotësisht.<sup>25</sup>

Rrjedhimisht, për mendimin tim nuk ishte e qartë nëse Dhoma Gjyqësore do ta kishte marrë dëshminë e dëshmitarit tjetër, po të kishte vazhduar punën edhe pas orës 19:00. Për më tepër, konstatoj se Prokuroria nuk i kërkoi asnjëherë Dhomës Gjyqësore të vazhdonte punën pas orës 19:00, më 15 nëntor 2007 apo ditën e nesërme, në përshtatje të mbërritjes më vonësë të dëshmitarit tjetër në vendin ku do zhvillohej videokonferenca. Në rast se

<sup>22</sup> Mendimi i Shumicës, para. 43.

<sup>23</sup> *Po aty*.

<sup>24</sup> *Po aty*.

<sup>25</sup> T. 10876, 15 *Shih* nëntor 2007 (Seancë private).

Prokuroria do të gjykonte se një masë e tillë të ishte e dobishme, ishte detyrë e saj ti kërkonte Dhomës Gjyqësore një gjë të tillë. Për mendimin tim, argumenti i Prokurorisë duhej rrëzuar duke u bazuar vetëm në këtë arsye, meqenëse është konkluduar se një palë nuk mund të mbajë heshtje për një çështje gjatë gjykimit dhe t'i kthehet asaj në apel për të kërkuar gjykim *de novo*.<sup>26</sup> Për më tepër, siç është shpjeguar me herët, më 20 nëntor 2007, Dhoma Gjyqësore e shtyu afatin e çështjes së Prokurorisë deri më 27 nëntor 2007, me qëllim për të dëgjuar dëshminë e dëshmitarit tjetër.<sup>27</sup> Në rrethana të tilla, nuk mund të pajtohem me përfundimin se “Dhoma Gjyqësore e vonoi ndjeshëm” dhënien e dëshmisë së dëshmitarit tjetër, apo u dha përparësi “faktorëve logjistikë” dhe “numrit të orëve që i ishin caktuar Prokurorisë për paraqitjen e çështjes”, përkundrajt marrjes së dëshmisë prej dëshmitarit tjetër.

14. Dy komente mund të bëhen në lidhje me përfundimin e Shumicës se “gjuha dhe qëndrimi i Dhomës Gjyqësore tregojnë qartë se ajo u dha më shumë përparësi faktorëve logjistikë dhe numrit të orëve që i ishin caktuar Prokurorisë për paraqitjen e çështjes, në vend të faktorit shumë më të rëndësishëm të marrjes së dëshmisë së një dëshmitari potencialisht të rëndësishëm, i cili ishte më së fundi ishte në dispozicion për të dëshmuar”.<sup>28</sup> Së pari, faktikisht ky përfundim është i pasaktë, meqenëse pretendimi i përparësisë rrëzohet qartësisht prej masave të ndërmarra nga Dhoma Gjyqësore duke e zgjatur jo një, as dy, por tri herë afatin e paraqitjes së çështjes nga Prokuroria, për t'i dhënë mundësi marrjen e dëshmive, dhe duke qenë e hapur për një zgjatje tjetër të afatit, në rast se Prokuroria provonte se ndryshim të madh të rrethanave të çështjes. Dhe, është e qartë se ajo veprroi kështu, sepse ishte mirëkuptuese ndaj vështirësive të Prokurorisë për mundësimin e pranisë së dëshmitarëve për të cilët vetë Dhoma Gjyqësore pranoi, se ishin të rëndësishëm për çështjen e Prokurorisë.

15. Por, kritika më e rëndësishme që mund t'i bëhet këtij përfundimi është se u ka dhënë një strukturë hierarkike të drejtave për një gjykim të drejtë, që nuk bazohet në

<sup>26</sup> Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 55; *Prokurorja k. Zlatko Aleksovskit*, Çështja Nr. IT-95-14/1-AR73, Vendim mbi Apelin e Prokurorisë për Pranueshmërinë e Provave, 16 shkurt 1999, para. 18-19; Aktgjykimi i Apelit *Kambanda*, para. 44-48.

<sup>27</sup> *Shih* më sipër Arsyetim Pjesërisht Mospajtuës, para. 4.

<sup>28</sup> Mendimi i Shumicës, para. 43.

interpretimin dhe zbatimin e duhur të Statutit. Në paragrafin 4 të Neni 21 të Statutit përcaktohen shprehimisht të drejtat e të akuzuarit. Statuti natyrisht nuk përcakton shprehimisht të drejtat e Prokurorisë. Ky fakt është befasues, meqenëse Neni 21(4) frymëzohet nga përjasja e pasqyruar në Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Konventës Ndërkombëtare të të Drejtave Civile dhe Politike, ku gjithashtu nuk ekziston dispozitë shprehimisht për të drejtat e Prokurorisë. Gjithsesi, kjo nuk do të thotë se Prokuroria nuk ka të drejta. Në paragrafin 1 të Neni 20 të Statutit parashtrohet, “Dhomat Gjyqësore garantojnë gjykim të drejtë dhe të shpejtë dhe një zhvillim të procesit në përputhje me rregulloren e procedurës dhe të provave, duke respektuar plotësisht të drejtat e të akuzuarve dhe duke i kushtuar vëmendjen e duhur mbrojtjes së viktimave dhe të dëshmitarëve”. Detyra e Dhomës Gjyqësore sipas këtij Neni për garantimin e një gjykimi të drejtë dhe të shpejtë, është e një natyre të përgjithshme në kuptimin se kjo vlen si për Prokurorinë, po edhe për Mbrojtjen. Nga kjo detyrë del se interesat e Prokurorisë duhen mbrojtur nga Dhoma Gjyqësore, dhe rrjedhimisht Prokuroria ka të drejtë të ngjashme me të drejtën e të Akuzuarit na bazë të Nenit 21(4)(e) të Statutit për të siguruar praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve.

16. Mirëpo në paragrafin 1 të Nenit 20 të Statutit, ka një kushtëzim ndaj kësaj të drejte. Është një e drejtë që gëzohet “duke respektuar plotësisht të drejtat e të akuzuarve”. Domethënia është mjaft e qartë: Dhoma Gjyqësore nuk mund t’i japë Prokurorisë ndihmë për mundësimin e pranisë së dëshmitarëve në atë masë sa të rezultojë në respektimin jo të plotë të të drejtave të të akuzuarit. Në rase se, për shembull, ndihma e dhënë shkon deri në atë masë sa që ndërhyrë padrejtësisht në të drejtën e të akuzuarit sipas Nenit 21(4)(c) të Statutit për t’u gjykuar pa vonesa të tepruara, atëherë Dhoma Gjyqësore është në shkelje të detyrës së saj statutore.

17. Për shkak të detyrimit që ka Prokuroria për të provuar fajësinë e të akuzuarit jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm, pozita e Prokurorisë në shumë aspekte është e ndryshme nga ajo e të akuzuarit. Rrjedhimisht Prokuroria ka detyra të cilat Mbrojtja nuk i ka, kurse Mbrojtja ka të drejta, të cilat Prokuroria nuk i ka. E analizuar si duhet, marrëdhënia midis Prokurorisë dhe Mbrojtjes nuk është simetrike; ajo është asimetrike për shkak të detyrimit të lartpërmendur.

18. Kjo analizë mbështet përfundimin e mëposhtëm: përderisa, sipas Nenit 20 të Statutit, në interes të drejtësisë, Prokuroria ka të drejtë të ndihmohet nga Dhoma Gjyqësore për të siguruar praninë e dëshmitarëve në paraqitjen e çështjes së saj, kjo e drejtë nuk mund të zbatohet në mënyrë të tillë që të cënojë padrejtësisht të drejtat e të akuzuarit, të përcaktuara në paragrafin 4 të Nenit 21 të Statutit, ndër të cilat e drejta për t'u gjykuar pa vonesa të tepruara. Kjo ndodh sepse çdo e drejtë e Prokurorisë për drejtësi, sipas Nenit 20 të Statutit, duhet të zbatohet “duke respektuar plotësisht të drejtat e të akuzuarve” në bazë të Nenit 21(4) të Statutit. Si pasojë është e pasaktë të deklarohet, sikundër bën Shumica, se “faktori i marrjes së dëshmisë së një dëshmitari potencialisht të rëndësishëm, i cili më në fund ishte në dispozicion për të dëshmuar” është “shumë më i rëndësishëm” se sa administrimi i kohës nga ana e Dhomës Gjyqësore për garantimin e një gjykimi të shpejtë apo një gjykimi pa vonesa të tepruara. Pra është e qartë se Dhoma Gjyqësore ka kryer detyrat e saj statute, dhe rrjedhimisht veprimi si duhej masat që mori për administrimin e kohës, në mbrojtje të të drejtës së të akuzuarve për t'u gjykuar pa vonesa të tepruara, në bazë Nenit 21(4)(c) të Statutit. Vlen të theksohet fakti që Dhoma Gjyqësore nuk i shpërfilli të drejtat e Prokurorisë për një gjykim të drejtë sipas Nenit 20(1) të Statutit. Ajo tregoi ndjeshmërinë e duhur ndaj këtyre të drejtave, jo vetëm duke miratuar tri zgjatje afati Prokurorisë, dhe gjithashtu duke qenë e hapur ndaj mundësisë për një zgjatje tjetër, në rast se Prokuroria do të provonte ndryshim rrënjësor të rrethanave të çështjes.

19. Gjithashtu më vjen shumë keq për përdorimin e emërimit “faktorë logjistikë”, që ka një tingëllim përçmues” kur, në të vërtetë interpretimi dhe zbatimi i duhur i Statutit, tregojnë se shqetësimi për kohën dhe faktorët që ndikojnë në kohëzgjatjen e çështjes së një pale nuk janë më pak të rëndësishëm se sa shqetësimi për elemente të tjerë të të drejtave për një gjykim të drejtë.

### 3. Vendimi i 20 nëntorit 2007

20. Prokuroria argumenton se më 20 nëntor 2007, data kur Dhoma Gjyqësore ia mbylli çështjen, me përjashtim të zgjatjes së pazakontë afatit deri më 27 nëntor 2007 për të dëgjuar dëshminë e dëshmitarit tjetër, Dhoma Gjyqësore gabo i nuk hetoi mundësinë

e dhënies së dëshmisë prej Kabashit në të ardhmen, pas konsultimit të tij me avokatin, që ishte caktuar për t'i dhënë ndihmë juridike në lidhje me një proces të mundshëm kundër tij në Shtetet e Bashkuara për shpërfillje të gjykatës.<sup>29</sup> Shumica pajtohet, duke arritur në përfundimin se “pas seancës me videolidhje së datës 20 nëntor 2007 gjatë të cilës ai dhe avokati i tij në mënyrë të ngatërruar dhe të paqartë refuzuan të flisnin, mbeti e hapur mundësia që Kabashi të dëshmonte në rrethana të tjera” dhe se, “Dhoma Gjyqësore vendosi të mos këmbëngulte në përpjekjet për të dëgjuar dëshminë e tij j”.<sup>30</sup> Mirëpo në dhënien e Vendimit të 20 nëntorit 2007, Dhoma Gjyqësore gjykoi qartësisht se si Z. Karnavas, po ashtu dhe vetë Dhoma Gjyqësore, e kishin informuar Kabashin për pasojat e mosdhënies së dëshmisë dhe se gjithsesi Kabashi kishte konfirmuar se, “nuk do t'i përgjigjej asnjë pyetjeje që do t'i bëhej si dëshmitar” në atë çështje. Më tej, Dhoma Gjyqësore vendosi se do të shqyrtonte një kërkesë të Prokurorisë për një zgjatje tjetër afati për të dëgjuar dëshminë e Kabashit, me kusht që Prokuroria të provonte se kishte ndodhur ndryshim rrënjësor i rrethanave të çështjes.<sup>31</sup>

21. Si rrjedhojë, në kundërshtim me pretendimin e Prokurorisë, Dhoma Gjyqësore shqyrtoi me kujdes gjasat e dëshmisë së Kabashit pasi të konsultohej me avokatin e tij, përpara se Dhoma Gjyqësore të mbyllte çështjen e Prokurorisë. Ishte pjesë e ushtrimit të arsyeshëm të kompetencës gjyqësore të Dhomës Gjyqësore kur, pas shqyrtimit të refuzimit të vazhdueshëm të Kabashit për të dëshmuar, ajo refuzoi t'ia zgjaste afatin Prokurorisë për marrjen e dëshmisë prej Kabashit, në mungesë të një ndryshimi rrënjësor të rrethanave. Dhoma Gjyqësore asnjëherë nuk e përjashtoi mundësinë për të dëgjuar dëshminë e Kabashit në të ardhmen. Në fakt ajo adoptoi një përjasje elastike, duke përmbytur detyrimin e saj për ti mundësuar Prokurorisë kohë të mjaftueshme për paraqitjen e çështjes së saj përmes dëshmitarëve të saj dhe për një gjykimi të shpejtë. Gjithashtu, në kundërshtim me mendimin e Shumicës, refuzimi i vendosur i Kabashit për të mos iu përgjigjur asnjë pyetjeje që i bëhej për çështjen, nuk ishte as i paqartë, as i mjegullt, dhe sigurisht nuk linte vend për sugjerimin se ai ishte i gatshëm të dëshmonte

<sup>29</sup> *Shih* Mendimi i Shumicës, para. 24.

<sup>30</sup> *Shih* Mendimi i Shumicës, para. 41.

<sup>31</sup> *Shih* Kabashi, T. 10961 (20 nëntor 2007) (Seancë Publike); T. 10977-10979 (26 nëntor 2007) (Seancë Publike).

në rrethana të tjera. Rrjedhimisht përfundimi i Shumicës së Dhoma Gjyqësore gaboi në dhënien e vendimit të 20 nëntorit 2007 nuk mbështetet nga provat e administruara.

#### 4. Vendimi i 26 nëntorit 2007 në lidhje me Kabashin dhe Vendimi i 5 dhjetorit 2007

22. Prokuroria parashtron se, duke refuzuar mocionin e saj të 23 nëntorit 2007 për zgjatjen e afatit të çështjes së saj për marrjen e dëshmisë së Kabashit, Dhoma Gjyqësore shpërfilli argumentin e Prokurorisë për gjasën e marrjes së dëshmisë prej Kabashit, në rast se ai do të informohej për nisjen e procesit kundër tij për mosbindje ndaj gjykatës, si pasojë e refuzimit për të dëshmuar.<sup>32</sup> Në kundërshtim me parashtrimin e Prokurorisë, sikundër shpjegohet më lart gjatë seancës së 20 nëntorit 2007, Dhoma Gjyqësore e shqyrtoi me kujdes këtë argument të Prokurorisë përpara se të vinte në përfundim se, për shkak të refuzimit të Kabashit për të dëshmuar, Dhoma Gjyqësore do ta zgjaste afatin e çështjes së Prokurorisë për të dëgjuar dëshminë e tij, vetëm në rast se Prokuroria provonte “ndryshim rrënjësor të rrethanave”. Meqenëse Prokuroria nuk provoi ndryshim rrethanash, Dhoma Gjyqësore ishte e përligjur në rrëzimin e mocionit të Prokurorisë të 23 nëntorit 2007. Për të njëjtat arsye, Dhoma Gjyqësore ishte po ashtu e përligjur në rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë për lejimin e apelimit të këtij vendimi, me Vendimin e saj të 5 dhjetorit 2007.

23. Për më tepër, është i pabazë pretendimi i Prokurorisë se, në seancën e 26 nëntorit 2007, Dhoma Gjyqësore shfaqti “ngut për mbylljen e procedimit të çështjes prej Prokurorisë dhe përfundimin e gjykimi” kur deklaroi se me sa duket Prokuroria “nuk i ka kushtuar vëmendje udhëzimit të Dhomës Gjyqësore” dhënë në seancën e 20 nëntorit 2007 dhe se, Prokuroria kishte tejkalluar kufirin prej 125 orët që iu caktua në fillim të procesit gjyqësor<sup>33</sup>. Interpretimi i Shumicës për këtë koment është se “Dhoma Gjyqësore zgjodhi respektimin e afateve kohore në vend që të ndihmonte Prokurorinë në kapërcimin e orvatjeve të frikësimit të dëshmitarëve”.<sup>34</sup> Mirëpo për mendimin tim, është në kompetencën e Dhomës Gjyqësore që t’i kujtonte Prokurorisë se, sipas vendimit të saj në

<sup>32</sup> *Shih* Mendimi i Shumicës, para. 26.

<sup>33</sup> *Shih* Mendimi i Shumicës, para. 26.

<sup>34</sup> Mendimi i Shumicës, para. 41.

seancën e 20 nëntorit 2007, ajo do të miratonte kërkesë për zgjatjen e afatit të paraqitjes së çështjes nga Prokuroria për të dëgjuar dëshminë e Kabashit, vetëm në rast se Prokuroria do të provonte ndryshim rrënjësor, si edhe t'i vinte në dukje Prokurorisë se e kishte kaluar kufirin kohor që i ishte caktuar nga Dhoma Gjyqësore për paraqitjen e çështjes së saj. Në vend të ngutit për mbylljen e çështjes së Prokurorisë, vendimi i Dhomës Gjyqësore tregoi qëndrimin e saj elastik në lidhje me paraqitjen nga Prokuroria të çështjes së saj, duke lënë të hapur mundësinë e zgjatjes edhe një herë të afatit të Prokurorisë për paraqitjen e çështjes së saj, për marrjen e dëshmisë së Kabashit, në rast se provonte që Kabashi kishte ndryshuar mendje dhe se në të vërtetë ishte i gatshëm të dëshmonte.

5. Vendimi i 26 nëntorit 2007 në lidhje me dëshmitarin tjetër dhe Urdhri i 30 nëntorit 2007 për Caktim Date

24. Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi në mbylljen e çështjes së saj në lidhje me dëshmitarin tjetër gjatë seancës së 26 nëntorit 2007, pa i dhënë Prokurorisë kohë shtesë për marrje informacioni rreth gjendjes së tij shëndetësore dhe për shqyrtimin e mundësinë së marrjes së dëshmisë së tij.<sup>35</sup> Më tej Prokuroria argumenton se Urdhri i 30 nëntorit 2007 për caktimin e datës, me anë të së cilit Dhoma Gjyqësore bëri të ditur se Prokuroria e kishte përfunduar paraqitjen e provave të saj dhe rrjedhimisht çështja mbyllet, tregon “ngutje të paarsyeshme për të marrë vendim” prej Dhomës Gjyqësore, duke pasur parasysh se dy dëshmitarët kyç të Prokurorisë ende nuk kishin dëshmuar.<sup>36</sup>

Bazuar në këto argumente, Shumica vjen në përfundim se:

duke qenë në dijeni se frikësimi i dëshmitarëve po kërcënonte ndershmërinë e procesit gjyqësor, një Dhomë e arsyeshme Gjyqësore do të kishte urdhëruar, *proprio motu*, shtyrjen ose pezullimin e procesit për një kohë të arsyeshme për t'i mundësuar Prokurorisë mbledhjen e informacionit lidhur me gjendjen shëndetësore të dëshmitarit tjetër dhe për të gjetur mundësinë e marrjes së dëshmisë së tij pas daljes nga spitali.<sup>37</sup>

25. Prokuroria nuk ka përmendur ndonjë kërkesë të saj për kohë shtesë drejtuar Dhomës Gjyqësore gjatë apo pas seancës së 26 nëntorit 2007, për të marrë informacion

<sup>35</sup> *Shih* Mendimi i Shumicës para. 28.

<sup>36</sup> *Shih* Mendimi i Shumicës, para. 20.

<sup>37</sup> Mendimi i Shumicës, para. 45.

rreth gjendjes shëndetësore të dëshmitarit tjetër, apo për marrjen e dëshmisë së dëshmitarit tjetër. Në këto rrethana, nuk mund të pajtohem me mendimin e Shumicës se Dhoma Gjyqësore kishte për detyrë të urdhëronte shtyrjen apo pezullimin e procesit, duke mos pasur një kërkesë nga Prokuroria për këtë qëllim. Përkundrazi, në rast se Prokuroria e gjykonte me vend një masë të tillë, ishte detyrë e saj t'ia kërkonte Dhomës Gjyqësore këtë gjë.

26. Nuk është e qartë pse në një sistem ballafaques dhe të vënë në lëvizje prej palëve, Dhoma Gjyqësore duhet të marrë përsipër të ndjekë një mënyrë procedimi që nuk propozohet nga asnjë prej palëve. Nuk është se gjykimi vazhdoi pa palën e interesuar, Prokurorinë, që t'i paraqiste argumente Dhomës për miratimin e masave konkrete për marrjen e dëshmimeve të dëshmitarëve. Prokuroria e bëri këtë vazhdimisht, por asnjëherë nuk kërkoi shtyrjen apo pezullimin e gjykimit. Në rast se Prokuroria do t'i kishte paraqitur një parashtrim të tillë Dhomës Gjyqësore, atëherë, të akuzuarve u duhej dhënë e drejta e kundërshtimit të çdo kërkesë për shtyrje apo pezullim. Si rrjedhojë, efekti përfundimtar i lejimit të apelimit të Prokurorisë mbi këtë bazë të re është që një të akuzuari, shpallur i pafajshëm në procesin gjyqësor, tani i anulohet pafajësia në lidhje me një pikë për të cilën nuk i është dhënë asnjë mundësi ta kundërshtojë gjatë gjykimit. Vetëm në këtë bazë, ky argument, i ngritur për herë të parë nga Prokuroria gjatë apelit, duhet hedhur poshtë. Sigurisht Dhoma e Apelit mund të shqyrtojë një pikë që nuk u ngrit në gjykim, por për mendimin tim, ajo duhet të tregohet jashtëzakonisht e kujdesshme në rast se pika e ngritur ndikon negativisht në të drejtat e një të akuzuari, i cili është shpallur i pafajshëm në gjykim.

27. Statuti i Tribunalit është kritikuar në disa raste për dhënien e të drejtës së apelimit Prokurorisë.<sup>38</sup> Një e drejtë e tillë nuk ekziston në shumë juridiksione shtetërore, sepse

<sup>38</sup> *Shih, p.sh.*, Mark C. Fleming, *Appellate Review in the International Criminal Tribunals*, 37 Tex. Int'l L. J. 111, 127, 141 (2002) (mbështet faktin se Neni 25 i Statutit e lejon Prokurorinë të apelojë shpallje pafajësie për vetëm për aspekte të ligjit dhe të ligjit të zbatuar, por që kritikon faktin se Neni 25 e lejon Prokurorinë të apelojë aspekte faktuale, sepse kjo "nuk përputhet me qëllimet e rishqyrtimit në apel"); John Laughland, *The Anomalies of the International Criminal Tribunal Are Legion. This is Not Victors' Justice in the Former Yugoslavia – In Fact, It is No Justice At All*, Times (MB), 17 qershor 1999; Michael P. Scharf, *A Critique of the Yugoslav War Crimes Tribunal*, 25 Denv. J. Intl L. & Poly 305, 307 (1997);

shihet si një shkelje e parimit *non bis in idem*. Ndoshta, duke marrë parasysh peshën e krimeve të proceduara penalisht nga Tribunali dhe të rrethanave absolutisht të tmerrshme dhe të llahtarshme që lidhen me kryerjen e tyre, mund të argumentohet se dhënia e të drejtës së apelit Prokurorisë është disi e përligjur. Mirëpo Dhoma e Apelit duhet të ketë një arsye të qartë dhe të padiskutueshme për shfuqizimin e pafajësisë. Në veçanti, kur Prokuroria apelon kundër një verdikti pafajësie, dhe apeli shqyrton arsyeshmërinë e ushtrimit të kompetencës gjyqësore së një Dhome Gjyqësore, sikundër bën në këtë rast, Dhoma e Apelit duhet të jetë tejet e kujdesshme në konstatimin e një gabimi në ushtrimin e kësaj kompetence, meqenëse bëhet fjalë për lirinë e një personi të shpallur i pafajshëm, madje edhe më shumë e kujdesshme, kur pasoja e rishikimit nga Dhoma e Apelit është baras me zëvendësimin e kompetencës së Dhomës Gjyqësore me kompetencën e saj gjykuese.

28. Së fundi, është i pasaktë sugjerimi i Shumicës, se Dhoma Gjyqësore nuk kishte dijeni për frikësimin e dëshmitarit. Në të vërtetë, vetë Dhoma Gjyqësore iu referua atmosferës së përgjithshme të frikësimit dhe kërcënimit të dëshmitarëve në Aktgjykim,<sup>39</sup> ndërsa masat që ajo mori për zgjatjen e afatit të Prokurorisë për paraqitjen e çështjes së saj jo një, as dy, por tri herë, duhen parë si mënyra që zgjodhi ajo në përgjigje të këtyre rrethanave.

## 6. Vendimi i 21 dhjetorit 2007

29. Prokuroria pretendon se Dhoma Gjyqësore gaboi kur nuk mori parasysh kërkesën e saj për rihapjen e çështjes së saj, pasi një gjykatës i një gjykate qarku në Shtetet e Bashkuara vuri në dukje se, në rast se Dhoma Gjyqësore do të caktonte një datë për të dëgjuar dëshminë e Kabashit, “kishte shumë të ngjarë që gjykatësi do të lëshonte një urdhër që do ta detyronte Shefqet Kabashin të dëshmonte atë ditë”.<sup>40</sup> Shumica pajtohet, duke thënë se vendimi i Dhomës Gjyqësore “në mënyrë të pajustificueshme nuk mori në konsideratë një urdhër të një gjykatësi të një gjykate qarku të Shteteve të Bashkuara ku

---

Michele N. Morosin, *Double Jeopardy and International Law: Obstacles to Formulating a General Principle*, 64 Nordic J. Int'l L. 261, 267, 269 (1995).

<sup>39</sup> *Shih* Aktgjykimi, para. 22.

<sup>40</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 32 (citimet e brendshme janë hequr).

thuhej se nëse çështja do të rihapej dhe do të caktohej data e dëshmisë së Kabashit, ‘kishte shumë të ngjarë’ që ai të nxirrte një urdhër që do ta detyruar Kabashin të dëshmonte atë ditë’.<sup>41</sup> Shumica arrin në përfundim se ai vendim “nuk mori parasysh faktin që vetë prania fizike e Kabashit në Shtetet e Bashkuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e ekspozonte atë ndaj dënimeve për shpërfillje të gjykatës të përcaktuara nga gjykatat federale të Shteteve të Bashkuara, përfshirë burgimin, në rast se do të refuzonte të dëshmonte’.<sup>42</sup>

30. Mirëpo duhet kujtuar se, në mosmiratimin e Mocionit të Prokurorisë së datës 17 dhjetor, 2007, Dhoma Gjyqësore gjykoi se:

në Vendimin e saj të 26 nëntorit 1997, Dhoma Gjyqësore hodhi poshtë kërkesën e Prokurorisë për zgjatjen afatit të procedimit të çështjes prej saj, duke qenë se bazohej thjesht në shpresën se kontaktet e mëtejshme midis Z. Kabashi dhe avokatit të tij, gjatë të cilave Z. Kabashi do të informohej në lidhje rrethanat e tij ligjore, do t’ia ndryshonin mendjen në lidhje me mosdhënien e dëshmisë. Mirëpo Z.Kabashi ka përsëritu disa herë se nuk ishte i gatshëm të dëshmonte. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore nuk mundi të konstatoi ndonjë ndryshim rrethanash që do të përlligjte zgjatjen e afatit për këtë çështje. Gjithashtu në lidhje me këtë Kërkesë, është e qartë se Z. Kabashi përsëri nuk është i gatshëm të dëshmojë dhe nuk i ka dhënë Prokurorisë asnjë arsye të besojë se kjo situatë do të ndryshojë.<sup>43</sup>

Dhoma Gjyqësore më tej konstatoi se:

Z. Kabashi ishte i detyruar të dëshmonte në procesin gjyqësor *Haradinaj e të tjerë* që në momentin që u thirr për herë të parë si dëshmitar. Ai ka deklaruar vazhdimisht se nuk është i gatshëm të dëshmojë dhe, sipas informacionit që disponon Dhoma Gjyqësore, ai sërish nuk është i gatshëm. Gjithashtu Z. Kabashi u akuzua për shpërfillje ndaj Tribunalit, si pasojë e refuzimit të tij për të dëshmuar më 5 qershor 2007, dhe kundër tij do të nisë procesi për shpërfillje pas arrestimit dhe transferimit të tij në Hagë.<sup>44</sup>

Bazuar në sa më sipër, Dhoma Gjyqësore erdhi në përfundimin se “thjesht mundësia e nisjes së procesit për shpërfillje në një gjykatë shtetërore nuk përbën një rrethanë të re të një natyre të tillë që do të përlligjte rihapjen e çështjes *Haradinaj e të tjerë*’.<sup>45</sup>

<sup>41</sup> Mendimi i Shumicës, para. 42.

<sup>42</sup> Mendimi i Shumicës, para. 42.

<sup>43</sup> Vendimi i 21 dhjetorit 2007, para. 6.

<sup>44</sup> Vendimi i 21 dhjetorit 2007, para. 7.

<sup>45</sup> Vendimi i 21 dhjetorit 2007, para. 7.

31. Si pasojë Vendimi i 21 dhjetorit 2007 u bazua në konkluzionin e Dhomës Gjyqësore, mbështetur në provat që dispononte, se Kabashi përsëri nuk ishte i gatshëm të dëshmonte, pavarësisht se mund të procedohej për shpërfillje prej Tribunalit, apo prej një gjykate qarku në Shtetet e Bashkuara. Duke qenë se Kabashi vazhdimisht kishte bërë të ditur se nuk do të dëshmonte në Tribunal edhe në se akuzohej për shpërfillje, dhe se më mirë shkonte në burg se të dëshmonte, ishte e arsyeshme që Dhoma Gjyqësore të vinte në përfundimin se Prokuroria nuk kishte provuar ekzistencën e rrethanave të reja, që do të përligjnin rihapjen e çështjes. Në seancën e 5 qershorit 2007, pasi Kryegjykatësi e informoi për pasojat e refuzimit për të dëshmuar, Kabashi deklaroi:

Unë nuk mund të flas për gjërat që më kërkoni të flas pas gjithë çfarë ka ndodhur. Në rast se doni të më detyroni, të më çoni në burg, do të shkoj në burg. [...] Unë nuk jam në gjendje të dëshmoj. Nuk mundem, shumë shkurt, nuk mundem, nuk mundem, jo se më detyron njeri dhe jo sepse kam frikë nga njeri. Në rast se si gjykatës, ju më detyroni ta bëj këtë, mund t'ju them se nuk jam në gjendje. Ju mund të merrni vendimin që dëshironi, por unë po ju kërkoi juve dhe Prokurorisë të më lironi, të më lini të kthehem përsëri në Kosovë, të shoh fëmijët e mi. Në rast se doni të më fusni në burg, unë nuk kam çfarë të bëj.<sup>46</sup>

Më tej, në seancën e 20 nëntorit 2007, pasi ndaj ishte ngritur aktakuzë për shpërfillje ndaj Tribunalit, Kabashi vuri në dukje se përsëri nuk ishte i gatshëm të dëshmonte.<sup>47</sup> Dhoma Gjyqësore e ushtroi si duhet kompetencën e saj gjyqësore kur konkludoi se nuk do ta zgjaste afatin e çështjes së Prokurorisë për marrjen e dëshmisë së Kabashit në rast se Prokuroria nuk provonte se kishte ndodhur ndryshim rrënjësor i rrethanave. Në mungesë të provave se Kabashi mund të ndryshonte mendje, Dhoma Gjyqësore kishte kompetencë të vendoste që të mos e rihapte çështjen e Prokurorisë.

### C. Përfundim

32. Në përfundim, me gjithë respektin që kam, nuk pajtohem me Mendimin e Shumicës për arsyet e mëposhtme. Së pari, provat tregojnë se Dhoma Gjyqësore ishte e vetëdijshme për rëndësinë e dëshmimeve të të dy dëshmitarëve për çështjen e Prokurorisë si edhe për atmosferën e përgjithshme të frikësimit dhe kërcënimit të dëshmitarëve, dhe ajo tregoi mirëkuptimin e duhur ndaj këtyre shqetësimeve të Prokurorisë duke e zgjatur afatin

<sup>46</sup> Kabashi, T. 5441-5443 (5 qershor 2007) (Seancë Publike).

<sup>47</sup> Kabashi, T. 10936, 10958 (20 nëntor 2007) (Seancë Publike).

e çështjes jo një, as dy, por tri herë, dhe la të hapur mundësinë e një zgjatjeje tjetër, në rast se Prokuroria do të provonte ndryshim rrënjësor të rrethanave. Në të vërtetë, qëndrimi i adoptuar prej Shumicës në apel ishte nëse Dhoma Gjyqësore mund të kishte bërë më shumë për ta ndihmuar Prokurorinë në mundësimin e pranisë së dëshmitarëve, në një kohë kur duhej hetuar nëse, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat, çfarë bëri Dhoma ishte e arsyeshme. Së dyti, nga pikëpamja ligjore dhe parimore Mendimi i Shumicës nuk bën gjë tjetër veçse zëvendëson kompetencën gjyqësore ushtruar nga Dhoma Gjyqësore me kompetencën gjyqësore të Dhomës së Apelit, që është i mundshëm vetëm kur provohet një gabim i dukshëm i Dhomës Gjyqësore. Asnjë gabim nuk është provuar, sepse Dhoma Gjyqësore iu përgjigj shqetësimeve të Prokurorisë duke ia zgatur afatin tri herë, për t'i mundësuar marrjen e dëshmimeve të atyre dëshmitarëve dhe duke lënë të hapur mundësinë e një zgjatjeje tjetër afati, pasi Prokuroria të provonte se kishte ndodhur ndryshim rrënjësor i rrethanave. Mënyra e veprimit të Dhomës Gjyqësore ka një standard bazë. Në rast se niveli i veprimeve të saj bie poshtë këtij standardi, atëherë kemi shpërdorim të kompetencës gjyqësore. Nëse ajo i përmbahet këtij standardi, si në rastin konkret nëpërmjet disa zgjatjeve të afatit dhe lënies së hapur të mundësisë së një zgjatjeje tjetër pasi të provohet çfarë kërkohet, vendimi nëse duhen miratuar zgjatje të tjera të këtij afati ka të bëjë me mikroadministrimin gjyqësor, në lidhje me të cilin Dhoma e Apelit duhet ti japë përparësi gjykimit të Dhomës Gjyqësore. Ky aspekt është më mirë t'i lihet Dhomës Gjyqësore në përputhje me parimin e përgjithshëm sipas të cilit për sa i takon administrimit të problemeve që kanë të bëjnë me gjykimin i jepet përparësi gjykimit të një Dhome Gjyqësore, për arsyet e shprehura mjaft qartë në çështjen *Millosheviq*.<sup>48</sup> Mendimi i Shumicës përbën tejkalim kompetence prej Dhomës së Apelit duke shkaktuar zëvendësimin e funksionit të apelit me atë të gjykimit. Ky është precedent i rrezikshëm, në dëm të përmbushjes së duhur nga Tribunali të mandatit të tij për të gjykimin e individëve për shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare. Së treti, duke i dhënë përparësi të drejtës së Prokurorisë për paraqitjen e çështjes së saj përmes dëshmitarëve të saj, ndaj të drejtës së të akuzuarve për një gjykim të shpejtë, Shumica ka interpretuar gabim lidhjen midis Neneve 20 dhe 21 të Statutit, duke injoruar plotësisht

<sup>48</sup> *Shih më sipër* Arsytimi Pjesërisht Mospajtues, poshtëshënimi 3, që citon Vendimin *Millosheviq* të 18 prillit 2002, para. 4.

faktin që të drejtat e paraqitura në Nenin 20 duhen zbatuar “duke respektuar plotësisht të drejtat e të akuzuarve” sipas Nenit 21(4).

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht, ku teksti në anglisht ka përparësi.

Përpiluar sot, më 19 korrik 2010  
Në Hagë  
Holandë

---

Gjykatësi Patrick Robinson

### **Vula e Tribunalit**

## VII. SHTOJCA I: HISTORIA PROCEDURALE

1. Më 3 prill 2008, Dhoma Gjyqësore I nxori aktgjykimin e saj, në të cilin shpalli të pafajshëm Ramush Haradinajn dhe Idriz Balajn për të gjitha pikat në Aktakuzë, dhe Lahi Brahimajn fajtor vetëm për pikat 28 dhe 32.<sup>1</sup> Prokuroria dhe Lahi Brahimaj apeluan Aktgjykimin.

### A. Përbërja e Dhomës së Apelit

2. Më 6 maj 2008, Kryetari i Tribunalit caktoi në Dhomën e Apelit Gjykatësit e mëposhtëm në këtë çështje: Gjykatësin Fausto Pocar, Kryegjykatës dhe Gjykatës Paraapelues; Gjykatësin Mohamed Shahabuddeen, Gjykatësen Andrézia Vaz, Gjykatësin Liu Daqun, dhe Gjykatësin Theodor Meron.<sup>2</sup>

3. Më 9 shkurt 2009, Kryetari i Tribunalit caktoi Gjykatësin Patrick Robinson që të zëvendësonte Gjykatësin Shahabuddeen. Gjykatësi Robinson u caktua Kryegjykatës kurse Gjykatësi Fausto Pocar vazhdoi të ishte Gjykatës Paraapelues.<sup>3</sup>

### B. Dosjet e Apelit

#### 1. Apeli i Prokurorisë

4. Më 2 maj 2008, Prokuroria dorëzoi Njoftimin e saj për Apel së bashku me Shtojcën konfidenciale bashkëlidhur Njoftimit për Apel.<sup>4</sup> Më 16 korrik 2008, Prokuroria dorëzoi Dosjen e saj konfidenciale të Apelit.<sup>5</sup> Prokuroria dorëzoi versionin publik të redaktuar dhe Listën e Burimeve të Cituara më 17 korrik 2008.<sup>6</sup> Atë ditë, Prokuroria

<sup>1</sup> Aktgjykim, para. 502-504.

<sup>2</sup> Urdhër për Caktimin e Gjykatësve në një Çështje në Dhomën e Apelit dhe Për Caktimin e Gjykatësit Paraapelues, 6 maj 2008.

<sup>3</sup> Urdhër për Zëvendësimin e një Gjykatësi në një Çështje në Dhomën e Apelit, 9 shkurt 2009.

<sup>4</sup> Njoftimi për Apel i Prokurorisë; Shtojca Konfidenciale e Njoftimit për Apel të Prokurorisë.

<sup>5</sup> Dosja e Apelit të Prokurorisë (Konfidenciale).

<sup>6</sup> Njoftim për Dorëzimin e Versionit Publik të Redaktuar të Dosjes së Apelit të Prokurorisë, 17 korrik 2008; Lista e Burimeve të Cituara për Dosjen e Apelit të Prokurorisë, 17 korrik 2008.

gjithashtu dorëzoi një shtojcë të Dosjes konfidenciale të Apelit për të korrigjuar një gabim administrativ.<sup>7</sup>

5. Më 25 gusht 2008, Idriz Balaj dhe Ramush Haradinaj dorëzuan përgjigjet e tyre konfidenciale ndaj Dosjes së Apelit të Prokurorisë.<sup>8</sup> Në të njëjtën ditë, Lahi Brahimaj iu bashkua Dosjes së Përgjigjes së Ramush Haradinajt.<sup>9</sup> Idriz Balaj dhe Ramush Haradinaj dorëzuan gjithashtu versionet publike të përgjigjeve të tyre.<sup>10</sup> Më 29 gusht 2008, Idriz Balaj dorëzoi korrigjimin e Dosjes së Përgjigjes së tij për ndreqjen e një gabimi shtypi.<sup>11</sup>

## 2. Apeli i Lahi Brahimajt

6. Lahi Brahimaj dorëzoi Njoftimin e tij për Apel më 5 maj 2008<sup>12</sup> dhe Dosjen e tij të Apelit më 21 korrik 2008.<sup>13</sup> Më 1 shtator 2008, Prokuroria dorëzoi konfidencialisht Përgjigjen e saj konfidenciale ndaj Dosjes së Apelit të Lahi Brahimajt.<sup>14</sup> Po atë ditë, ajo dorëzoi edhe versionin publik të përgjigjes së saj.<sup>15</sup> Lahi Brahimaj dorëzoi Kundërpërgjigjen e tij ndaj Përgjigjes së Prokurorisë më 15 shtator 2008.<sup>16</sup>

## C. Avokatët e Prokurorisë dhe të Mbrojtjes

7. Prokuroria përfaqësohet nga Z. Peter Kremer, Z. Marwan Dalal dhe Zj. Elena Martin Salgado. Ramush Haradinaj përfaqësohet nga Z. Ben Emmerson dhe Z. Rodney Dixon. Idriz Balaj përfaqësohet nga Z. Gregor Guy-Smith dhe Zj. Colleen Rohan. Lahi Brahimaj përfaqësohet nga Z. Richard Harvey dhe Z. Paul Troop.

<sup>7</sup> Shtojcë e Dosjes Konfidenciale të Apelit të Prokurorisë e datës 16 korrik 2008, 17 korrik 2008.

<sup>8</sup> Dosja e Përgjigjes se Balajt (Konfidenciale); Dosja e Përgjigjes së Haradinajt (Konfidenciale).

<sup>9</sup> Dosja e Përgjigjes së Brahimajt.

<sup>10</sup> Dosja e Përgjigjes së Haradinajt, 25 gusht 2008; Dosja e Përgjigjes se Balajt, 29 gusht 2008.

<sup>11</sup> Korrigjim i Përgjigjes së Idriz Balajt ndaj Dosjes së Apelit të Prokurorisë, 29 gusht 2008.

<sup>12</sup> Njoftim për Apel i Brahimajt.

<sup>13</sup> Dosja e Apelit të Brahimajt.

<sup>14</sup> Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë (Konfidenciale).

<sup>15</sup> Njoftim për Dorëzimin e Versionit Publik të Redaktuar të Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Dosjes së Apelit në Emër të Lahi Brahimajt, 1 shtator 2008.

<sup>16</sup> Dosja e Kundërpërgjigjes së Brahimajt.

#### **D. Konferencat mbi Gjendjen**

8. Në përputhje me Rregullën 65 bis, Konferencat mbi Gjendjen u mbajtën më 22 gusht 2008, 24 nëntor 2008, dhe 11 mars 2009.<sup>17</sup>

#### **E. Transferimi i Idriz Balajt**

9. Më 3 prill 2008, Dhoma Gjyqësore urdhëroi kthimin e Idriz Balajt në Kosovë, ku kishte qenë duke kryer një dënim me 13 vjet burgim, në kohën kur u akuzua nga Tribunali.<sup>18</sup>

#### **F. Lirimi i Përkohshëm i Lahi Brahimajt**

10. Më 25 maj 2009, Lahi Brahimaj u lirua përkohësisht.<sup>19</sup>

#### **G. Seanca e Apelit**

11. Seanca e Apelit mbi thelbin e arsyeve të apelimeve u mbajt më 28 tetor 2009.<sup>20</sup>

---

<sup>17</sup> Urdhër për Caktim Date i 9 korrikut 2008; TA. 1-4 (22 gusht 2008) Urdhër për Caktim Date i 12 nëntorit 2008; TA. 5-10 (24 nëntor 2008); Urdhër për Caktim Date i 3 marsit 2009; TA. 11-15 (11 mars 2009).

<sup>18</sup> Urdhër për Transferimin e Idriz Balajt (Konfidencial).

<sup>19</sup> Vendim mbi Kërkesën e Lahi Brahimajt për Lirim të Përkohshëm.

<sup>20</sup> TA. 16-164 (28 tetor 2009).

## VIII. SHTOJCA II: FJALORI

### A. Lista e Vendimeve të Tribunalit dhe të Tjera

#### 1. TPNJ

#### **ALEKSOVSKI**

*Prokurori k. Zllatko Aleksovskit*, Lënda Nr. IT-95-14/1-AR73, Vendim mbi Apelin e Prokurorisë për Pranueshmërinë e Provave, 16 shkurt 1999

*Prokurori k. Zllatko Aleksovskit*, Lënda Nr. IT-95-14/1-A, Aktgjykim, 24 mars 2000 (“Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*”)

#### **BABIQ**

*Prokurori k. Milan Babiqit*, Lënda Nr. IT-03-72-A, Aktgjykimi i Apelit për Dënimin, 18 korrik 2005 (“Aktgjykimi i Apelit *Babiq* për Dënimin”)

#### **BLLAGOJEVIQ DHE JOKIQ**

*Prokurori k. Vidoje Bllagojeviqit dhe Dragan Jokiqit*, Lënda Nr. IT-02-60-A, Aktgjykim, 9 maj 2007 (“Aktgjykimi i Apelit *Bllagojeviq dhe Jokiq*”)

#### **BLLASHKIQ**

*Prokurori k.. Tihomir Bllashkiqit*, Lënda Nr. IT-95-14-T, Aktgjykim, 3 mars 2000 (“Aktgjykimi *Bllashkiq*”)

*Prokurori k.. Tihomir Bllashkiqit*, Lënda Nr. IT-95-14-A, Aktgjykim, 29 korrik 2004 (“Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*”)

#### **BOSHKOSKI DHE TARÇULLOVSKI**

*Prokurori k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçullovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-A, Aktgjykim, 19 maj 2010 (“Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*”)

#### **BRALLO**

*Prokurori k. Miroslav Brallos*, Lënda Nr. IT-95-17-A, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Mosmarrje në Konsideratë të Dëshmime dhe mbi Kërkesën e Apeluesit për t'u Përgjigjur Argumenteve Gojore të Prokurorisë, 5 mars 2007

*Prokurori k. Miroslav Brallos*, Lënda Nr. IT-95-17-A, Aktgjykimi i Apelit për Dënimin, 2 prill 2007 (“Aktgjykimi i Apelit *Brallo* për Dënimin”)

## **BËRGJANIN**

*Prokurori k. Radosllav Bërgjaninit*, Lënda Nr. IT-99-36-A, Aktgjykim, 3 prill 2007 (“Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*”)

## **ÇELEBIQI**

*Prokurori k. Zejnil Delaliqit, Zdravko Muciqit, me pseudonimin “Pavo”, Hazim Deliqit dhe Esad Llanxhos, me pseudonimin “Zenga”,* Lënda Nr. IT-96-21-T, Aktgjykim, 16 nëntor 1998 (“Aktgjykimi *Çelebiqi*”)

*Prokurori k. Zejnil Delaliqit, Zdravko Muciqit, me pseudonimin “Pavo”, Hazim Deliqit dhe Esad Llanxhos, me pseudonimin “Zenga”,* Lënda Nr. IT-96-21-A, 20 shkurt 2001 (“Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*”)

## **FURUNXHIIJA**

*Prokurori k. Anto Furunxhisë*, Lënda Nr. IT-95-17/1-A, Aktgjykim, 21 korrik 2000 (“Aktgjykimi i Apelit *Furunxhija*”)

## **GALIQ**

*Prokurori k. Stanislav Galiqit*, Lënda Nr. IT-98-29-AR73, Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Leje për Apel, 14 dhjetor 2001

*Prokurori k. Stanislav Galiqit*, Lënda Nr. IT-98-29-AR73.2, Vendim mbi Apelin e Përkohshëm lidhur me Fregullën 92bis(C), 7 qershor 2002

*Prokurori k. Stanislav Galiqit*, Lënda Nr. IT-98-29-A, Aktgjykim, 30 nëntor 2006 (“Aktgjykimi i Apelit *Galiq*”)

**HAXHIHASANOVIQ DHE KUBURA**

*Prokurori k. Enver Haxhihasanoviqit dhe Amir Kuburës, Lënda Nr. IT-01-47-A, Aktgjykim, 22 prill 2008 (“Aktgjykimi i Apelit Haxhihasanoviq dhe Kubura”)*

**HALILOVIQ**

*Prokurori k. Sefer Haliloviqit, Lënda Nr. IT-01-48-A, Aktgjykim, 16 tetor 2007 (“Aktgjykimi i Apelit Haliloviq”)*

**HARADINAJ dhe të tjerët**

*Prokurori k. Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt, Lënda Nr. IT-04-84-PT, Urdhër për Publikimin e Memorandumit dhe për Intervistat me një Burim dhe Dëshmitar të Prokurorisë, 13 dhjetor 2006 (“Vendimi i 13 dhjetorit 2006”)*

*Prokurori k. Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt, Lënda Nr. IT-04-84-T, Vendim mbi Mocionin për Videolidhje (Dëshmitari 30), 14 shtator 2007*

*Prokurori k. Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt, Lënda Nr. IT-04-84-T, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Urdhërparaqitje për të Dëshmuar për Dëshmitarin 25, 30 tetor 2007*

*Prokurori k. Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt, Lënda Nr. IT-04-84-T, T. 9984-9986 (31 tetor 2007) (seancë publike) (“Vendimi i 31 tetorit 2007”)*

*Prokurori k. Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt, Lënda Nr. IT-04-84-T, Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për të Shtuar Dy Dëshmitarë në Listën e Saj të Dëshmitarëve dhe për të Zëvendësuar një Dëshmitar me një Tjetër, 1 nëntor 2007*

*Prokurori k. Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt, Lënda Nr. IT-04-84-T, T. 10876 (15 nëntor 2007) (seancë private) (“Vendimi i 15 nëntor 2007”)*

*Prokurori k. Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt*, Lënda Nr. IT-04-84-T, T. 10935-10936, 10956 (20 nëntor 2007) (seancë publike) (“Vendimi i 20 nëntorit 2007”)

*Prokurori k. Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt*, Lënda Nr. IT-04-84-T, T. 10975-10978 (“Vendim i 26 nëntorit 2007 lidhur me dëshmitarin tjetër”)

*Prokurori k. Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt*, Lënda Nr. IT-04-84-T, T. 10977-10979 (“Vendim i 26 nëntorit 2007 lidhur me Kabashin”)

*Prokurori k. Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt*, Lënda Nr. IT-04-84-T, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin si Prova të Pesë Deklaratave të Dëshmive të Dorës së Dytë prej Dëshmitarit 1 sipas Rregullës 92 *quarter* së bashku me Shtojcën Konfidenciale, 28 nëntor 2007

*Prokurori k. Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt*, Lënda Nr. IT-04-84-T, Urdhër për Caktim Date për Dorëzimin e Dosjeve Përfundimtare dhe për Argumentet Përmbyllëse, 30 nëntor 2007 (“Urdhër për Caktim Date i 30 nëntorit 2007”)

*Prokurori k. Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt*, Lënda Nr. IT-04-84-T, Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Leje për Apel ndaj Vendimit të Dhomës Gjyqësore në lidhje me Shefqet Kabashin, 5 dhjetor 2007 (“Vendim i 5 dhjetorit 2007”)

*Prokurori k. Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt*, Lënda Nr. IT-04-84-T, Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Rihapjen e Procedimit të Çështjes së Saj për Dëgjimin e Dëshmisë së Shefqet Kabashit dhe për Përfaqësim Juridik të Autoriteteve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, 21 dhjetor 2007 (“Vendim i 21 dhjetorit 2007”)

*Prokurori k. Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt*, Lënda Nr. IT-04-84-T, Aktgjykim, 3 prill 2008 (“Aktgjykim”)

*Prokurori k. Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt*, Lënda Nr. IT-04-84-T, Urdhër për Transferimin e Idriz Balajt (Konfidencial), 3 prill 2008 (“Urdhër për Transferimin e Idriz Balajt”)

*Prokurori k. Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt*, Lënda Nr. IT-04-84-A, Urdhër për Caktimin e Gjykatësve në një Çështje para Dhomës së Apelit dhe për Caktimin e Gjykatësit Paraapelues, 6 maj 2008 (“Urdhër për Caktimin e Gjykatësve në një Çështje para Dhomës së Apelit dhe për Caktimin e Gjykatësit Paraapelues”)

*Prokurori k. Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt*, Lënda Nr. IT-04-84-A, Urdhër për Caktim Date, 9 korrik 2008 (“Urdhër për Caktim Date i 9 korrikut 2008”)

*Prokurori k. Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt*, Lënda Nr. IT-04-84-A, Urdhër për Caktim Date, 12 nëntor 2008 (“Urdhër për Caktim Date i 12 nëntorit 2008”)

*Prokurori k. Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt*, Lënda Nr. IT-04-84-A, Urdhër për Zëvendësimin e një Gjykatësi në një Çështje para Dhomës së Apelit, 9 shkurt 2009 (“Urdhër për Zëvendësimin e një Gjykatësi në një Çështje para Dhomës së Apelit”)

*Prokurori k. Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt*, Lënda Nr. IT-04-84-A, Urdhër për Caktim Date, 3 mars 2009 (“Urdhër për Caktim Date i 3 marsit 2009”)

*Prokurori k. Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt*, Lënda Nr. IT-04-84-A, Vendim mbi Kërkesën e Lahi Brahimajt për Lirim të Përkohshëm, 27 maj 2009 (“Vendim mbi Kërkesën e Lahi Brahimajt për Lirim të Përkohshëm”)

## **JOKIQ**

*Prokurori k. Miodrag Jokiqit*, Lënda Nr. IT-01-42/1-A, Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit, 30 gusht 2005 (“Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit *Jokiq*”)

## **KARAXHIQ**

*Prokurori k. Radovan Karaxhiqit*, Lënda Nr. IT-95-5/18-AR73.5, Vendim mbi Apelin e Radovan Karaxhiqit ndaj Vendimit për Fillimin e Procesit Gjyqësor, 13 tetor 2009 (“Vendim *Karaxhiq* i 13 tetorit 2009”)

### **KORDIQ DHE ÇERKEZ**

*Prokurori k. Dario Kordiqit dhe Mario Çerkezit*, Lënda Nr. IT-95-14/2-A, Aktgjykim, 17 dhjetor 2004 (“Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*”)

### **KRAJISHNIK**

*Prokurori k. Momçillo Krajishnikut*, Lënda Nr. IT-00-39-A, Aktgjykim, 17 mars 2009 (“Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*”)

*Prokurori k. Momçillo Krajishnikut*, Lënda Nr. IT-00-39-AR73.1, Vendim për Apel të Ndërkohshëm ndaj Vendimit lidhur me Mocionin e Dytë të Mbrojtjes për Shtyrje të Procesit Gjyqësor, 25 prill 2005 (“Vendim *Krajishnik* i 25 prillit 2005”)

### **KËRNOJELAC**

*Prokurori k. Millorad Kërnojelacit*, Lënda Nr. IT-97-25-A, Aktgjykim, 17 shtator 2003 (“Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*”)

### **KËRSTIQ**

*Prokurori k. Radisllav Kërstiqit*, Lënda Nr. IT-98-33-T, Aktgjykim, 2 gusht 2001 (“Aktgjykimi *Kërstiq*”)

*Prokurori k. Radisllav Kërstiqit*, Lënda Nr. IT-98-33-A, Aktgjykim, 19 prill 2004 (“Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*”)

### **KUNARAC dhe të tjerët**

*Prokurori k. Dragolub Kunaracit, Radomir Kovaçit dhe Zoran Vukoviqit*, Lënda Nr. IT-96-23-T dhe IT-96-23/1-T, Vendim mbi Mocionin për Shpalljen e Pafajësisë, 3 korrik 2000

*Prokurori k. Dragolub Kunaracit, Radomir Kovaçit dhe Zoran Vukoviqit, Lënda Nr IT-96-23 dhe IT-96-23/1-T Aktgjykim, 22 shkurt 2002 (“Aktgjykimi Kunarac dhe të tjerët”)*

*Prokurori k. Dragolub Kunaracit, Radomir Kovaçit dhe Zoran Vukoviqit, Lënda Nr IT-96-23 dhe IT-96-23/1-A Aktgjykim, 12 qershor 2002 (“Aktgjykimi i Apelit Kunarac dhe të tjerët”)*

### **KUPRESHKIQ dhe të tjerët**

*Prokurori k. Zoran Kupreshkiqit, Mirjan Kupreshkiqit, Vllatko Kupreshkiqit, Drago Josipoviqit, dhe Vladimir Shantiqit, Lënda Nr. IT-95-16-A, Aktgjykimi i Apelit, 23 tetor 2001 (“Aktgjykimi i Apelit Kupreshkiq dhe të tjerët”)*

### **KVOÇKA dhe të tjerët**

*Prokurori k. Miroslav Kvoçkës, Mllagjo Radiqit, Zoran Zhigiqit, dhe Dragolub Përcaqit, Lënda Nr. IT-98-30/1-A, Aktgjykim, 28 shkurt 2005 (“Aktgjykimi i Apelit Kvoçka dhe të tjerët”)*

### **LIMAJ dhe të tjerët**

*Prokurori k. Fatmir Limajt, Haradin Balës dhe Isak Musliut, Lënda Nr. IT-03-66-A, 27 shtator 2007 (“Aktgjykimi i Apelit Limaj dhe të tjerët”)*

### **MARTIQ**

*Prokurori k. Millan Martiqit, Lënda Nr. IT-95-11-A, Aktgjykim, 8 tetor 2008 (“Aktgjykimi i Apelit Martiq”)*

### **D. MILLOSHEVIQ**

*Prokurori k. Dragomir Millosheviqit, Lënda Nr. IT-98-29/1-A, Aktgjykim, 12 nëntor 2009 (“Aktgjykimi i Apelit D. Millosheviq”)*

### **S. MILLOSHEVIQ**

*Prokurori k. Sllobodan Millosheviqit, Lënda Nr. IT-99-37-AR73, IT-01-50-AR73, dhe IT-01-51-AR73, Arsye për Vendimin mbi Apelin e Ndërkohshëm të Prokurorisë të*

Mospranimit të Propozimit për Bashkimin e Çështjeve, 18 prill 2002 (“Vendimi *Milloseviq* i 18 prillit 2002”)

*Prokurori k. Slobodan Milloseviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-AR73.6, Vendimi mbi Apelin e Ndërkohshëm të *Amici Curiae* Ndaj Urdhrit të Dhomës Gjyqësore lidhur me Paraqitjen dhe Përgatitjen e Çështjes së Mbrojtjes, 20 janar 2004 (“Vendimi *Milloseviq* i 20 janarit 2004”)

*Prokurori k. Slobodan Milloseviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-AR73.7, Vendim mbi Apelin e Ndërkohshëm ndaj Vendimit të Dhomës Gjyqësore për Caktimin e Avokatit të Mbrojtjes, 1 nëntor 2004

### **MILLUTINOVIQ dhe të tjerët**

*Prokurori k. Millan Millutinoviqit, Nikolla Shainoviqit, Dragolub Ojdaniqit, Nebojsa Pavkoviqit, Vladimir Llazareviqit dhe Sreten Llukiqit*, Lënda Nr. IT-05-87-T, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave sipas Rregullës 92 *quater*, 16 shkurt 2007

### **MËRKSHIQ DHE SHLIVANÇANIN**

*Prokurori k. Mile Mërkshiqit dhe Veselin Shlivançaninit*, Lënda Nr. IT-95-13/1-A, Aktgjykim, 5 maj 2009 (“Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*”)

### **NALETILIQ DHE MARTINOVIQ**

*Prokurori k. Mlladen Naletiliqit, i njohur edhe si “Tuta” dhe Vinko Martinoviqit, i njohur edhe si “Shtella”*, Lënda Nr. IT-98-34-A, Aktgjykim, 3 maj 2006 (“Aktgjykimi i Apelit *Naletiliq dhe Martinoviq*”)

### **M. NIKOLIQ**

*Prokurori k. Momir Nikoliqit*, Lënda Nr. IT-02-60/1-A, Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit, 8 mars 2006 (“Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit të *M. Nikoliqit*”)

### **ORIQ**

*Prokurori k. Naser Oriqit*, Lënda Nr. IT-03-68-A, Aktgjykim, 3 korrik 2008  
 (“Aktgjykimi i Apelit Oriq”)

### **PËRLIQ dhe të tjerët**

*Prokurori k. Jadranko Përliqit, Bruno Stojiqit, Slobodan Pralakit, Milivoj Petkoviqit, Valentin Qoriqit dhe Berisllav Pushiqit*, Lënda Nr. IT-04-74-AR73.4, Vendim mbi Apelin e Prokurorisë ndaj Vendimit të Dhomës Gjyqësore për Shkurtimin e Afatit për Procedimin e Çështjes së Prokurorisë, 6 shkurt 2007

*Prokurori k. Jadranko Përliqit, Bruno Stojiqit, Slobodan Pralakit, Milivoj Petkoviqit, Valentin Qoriqit dhe Berisllav Pushiqit*, Lënda Nr. IT-04-74-AR73.6, Vendim mbi Apelin ndaj Vendimit për Pranimin si Provë të Procesverbalit të Marrjes në Pyetje të Jadranko Përliqit, 23 nëntor 2007

### **SHESHEL**

*Prokurori k. Vojisllav Sheshelit*, Lënda Nr. IT-03-67-AR73.3, Vendim mbi Apelin ndaj Vendimit të Dhomës Gjyqësore për Caktimin e Avokatit të Mbrojtjes, 20 tetor 2006

*Prokurori k. Vojisllav Sheshelit*, Lënda Nr. IT-03-67-AR73.8, Vendim mbi Apelin e Prokurorisë ndaj Urdhrit të Dhomës Gjyqësore për Rinisjen e Procesit Gjyqësor, 16 shtator 2008 (“Vendimi Sheshel i 16 shtatorit 2008”)

### **SIMIQ**

*Prokurori k. Bllagoje Simiqit*, Lënda Nr. IT-95-9-A, Aktgjykim, 28 nëntor 2006  
 (“Aktgjykimi i Apelit Simiq”)

### **STAKIQ**

*Prokurori k. Millomir Stakiqit*, Lënda Nr. IT-97-24-A, Aktgjykim, 22 mars 2006  
 (“Aktgjykimi i Apelit Stakiq”)

**STRUGAR**

*Prokurori k. Pavle Strugarit*, Lënda Nr. IT-01-42-A, Aktgjykim, 17 korrik 2008  
 (“Aktgjykimi i Apelit *Strugar*”)

**TADIQ**

*Prokurori k. Dushko Tadiqit, i njohur edhe si “Dule”*, Lënda Nr. IT-94-1-T, Vendim mbi  
 Mocionin e Mbrojtjes për Dëshmi të Dorës së Dytë, 5 gusht 1996

*Prokurori k. Dushko Tadiqit*, Lënda Nr. IT-94-1-A, Aktgjykim, 15 korrik 1999  
 (“Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*”)

*Prokurori k. Dushko Tadiqit*, Lënda Nr. IT-94-1-A dhe IT-94-1-Abis, Aktgjykimi i  
 Apelimit të Dënimit, 26 janar 2000 (“Aktgjykimi *Tadiq* i Apelimit të Dënimit”)

**TOLIMIR dhe të tjerët.**

*Prokurori k. Zdravko Tolimirit, Radivoje Miletiqit dhe Millan Gveros*, Lënda Nr. IT-04-  
 80-AR73.1, Vendim mbi Apelin e Ndërkohshëm të Radivoje Miletiqit ndaj Vendimit të  
 Dhomës Gjyqësore për Bashkimin e Çështjeve, 27 janar 2006

**VASILEVIQ**

*Prokurori k. Mitar Vasileviqit*, Lënda Nr. IT-98-32-A, Aktgjykim, 25 shkurt 2004  
 (“Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*”)

2. TPNR**GACUMBITSI**

*Sylvestre Gacumbitsi k. Prokurores*, Lënda Nr. ICTR-2001-64-A, Aktgjykim, 7 korrik  
 2006 (“Aktgjykimi i Apelit *Gacumbitsi*”)

**KAMBANDA**

*Jean Kambanda k. Prokurores*, Lënda Nr. ICTR-97-23-A, Aktgjykim, 19 tetor 2000 (“Aktgjykimi i Apelit *Kambanda*”)

### **KAMUHANDA**

*Jean de Dieu Kamuhanda k. Prokurores*, Lënda Nr. ICTR-00-54A-A, Aktgjykim, 19 shtator 2005 (“Aktgjykimi i Apelit *Kamahunda*”)

### **KARERA**

*François Karera k. Prokurores*, Lënda Nr. ICTR-01-74-A, Aktgjykim, 2 shkurt 2009 (“Aktgjykimi i Apelit *Karera*”)

### **KAYISHEMA AND RUZINDANA**

*Prokurori k. Clément Kayishema dhe Obed Ruzindana*, Lënda Nr. ICTR-95-1-A, Aktgjykim (Arsyet), 1 qershor 2001 (“Aktgjykimi i Apelit *Kayishema dhe Ruzindana*”)

### **MUVUNYI**

*Tharcisse Muvunyi k. Prokurores*, Lënda Nr. ICTR-2000-55A-A, Aktgjykim, 29 gusht 2008 (“Aktgjykimi i Apelit *Muvunyi*”)

### **NCHAMIHIGO**

*Siméon Nchamihigo k. Prokurores*, Lënda Nr. ICTR-2001-63-A, Aktgjykim, 18 mars 2010 (“Aktgjykimi i Apelit *Nchamihigo*”)

### **NDINDABAHIZI**

*Prokurori k. Emmanuel Ndindabahizi*, Lënda Nr. ICTR-01-71-A, Aktgjykim, 16 janar 2007 (“Aktgjykimi i Apelit *Ndindabahizi*”)

### **NIYITEGEKA**

*Eliézer Niyitegeka k. Prokurores*, Lënda Nr. ICTR-96-14-A, Aktgjykimi, 9 korrik 2004 (“Aktgjykimi i Apelit *Niyitegeka*”)

**NSHOGOZA**

*Léonidas Nshogoza k. Prokurores*, Lënda Nr. ICTR-07-91-A, Aktgjykim, 15 mars 2010, (“Aktgjykimi i Apelit *Nshogoza*”)

**NTAGERURA dhe të tjerët**

*Prokurori k. André Ntagerura, Emmanuel Bagambiki dhe Samuel Imanishimwe*, Lënda Nr. ICTR-96-46-A, Aktgjykim, 7 korrik 2006 (“Aktgjykimi i Apelit *Ntagerura dhe të tjerët*”)

**NTAKIRUTIMANA**

*Prokurori k. Elizaphan Ntakirutimana dhe Gérard Ntakirutimana*, Lënda Nr. ICTR-96-10-A dhe ICTR-96-17-A, Aktgjykim, 13 dhjetor 2004 (“Aktgjykimi i Apelit *Ntakirutimana*”)

**SEMANZA**

*Laurent Semanza k. Prokurores*, Lënda Nr. ICTR-97-20-A, Aktgjykim, 20 maj 2005 (“Aktgjykimi i Apelit *Semanza*”)

**SIMBA**

*Aloys Simba k. Prokurores*, Lënda Nr. ICTR-01-76-A, Aktgjykim, 27 nëntor 2007 (“Aktgjykimi i Apelit *Simba*”)

**ZIGIRANYIRAZO**

*Protais Zigiranyirazo k. Prokurores*, Lënda Nr. ICTR-01-73-A, Aktgjykim, 16 nëntor 2009 (“Aktgjykimi i Apelit *Zigiranyirazo*”)

3. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut

**Van de Hurk v. The Netherlands**

*Van de Hurk v. The Netherlands*, 19 prill 1994, § 61, Series A no. 288

#### 4. Të tjera

##### **Protokolli Shtesë II**

Protokolli Shtesë i Konventave të Gjenevës të datës 12 gusht 1949, lidhur me Mbrojtjen e Viktimave të Konfliktëve të Armatosura Jondërkombëtare (Protokolli II) 8 qershor 1977, 1125 U.N.T.S. 609

##### **Karta Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe Popujve**

Karta Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe Popujve, miratuar më 27 qershor 1981, OAU Doc. CAB/LEG/67/3 rev.5, hyrë në fuqi më 21 tetor 1986

##### **Neni i Përbashkët 3**

Neni i Përbashkët 3 i Konventave të Gjenevës I deri në IV

##### **ICCPR**

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, miratuar dhe hapur për nënshkrim, ratifikim dhe anëtarësim me anë të Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme 2200A (XXI) të datës 16 dhjetor 1966, 993 U.N.T.S. 3, hyrë në fuqi më 3 janar 1976

##### **Konventa Ndëramerikane për të Drejtat e Njeriut**

Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut, miratuar në Konferencën Speciale Ndëramerikane për të Drejtat e Njeriut, San José, Kosta Rikë, 22 nëntor 1969, 1144 U.N.T.S. 123, hyrë në fuqi më 18 korrik 1978

##### **Konventa e Tretë e Gjenevës**

Konventa e Gjenevës (III) e datës 12 gusht 1949, 75 U.N.T.S. 135, Lidhur me Trajtimin e Pengjeve të Luftës,

##### **Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut**

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, miratuar dhe shpallur me anë të Rezolutës 217 A (III) të Asamblesë së Përgjithshme të datës 10 dhjetor 1948

## **B. Lista e Shkurtimeve**

Sipas Rregullës 2(B) të Rregullores, gjinia mashkullore përfshin edhe femëroren, si dhe njëjësi shumësin, dhe anasjelltas.

### **Aktakuzë**

*Prokurori k. Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt*, Lënda Nr. IT-04-84-T, Aktakuza e Ndryshuar për Herë të Katërt, 16 tetor 2007

### **Aktgjykim**

*Prokurori k. Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt*, Lënda Nr. IT-04-84-T, Aktgjykim, 3 prill 2008

### **Dosja e Apelit të Brahimajt**

*Prokurori k. Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt*, Lënda Nr. IT-04-84-A, Dosja e Apelit në Emër të Lahi Brahimajt, 21 korrik 2008

### **Dosja e Apelit të Prokurorisë**

*Prokurori k. Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt*, Lënda Nr. IT-04-84-A, Dosja e Apelit të Prokurorisë, 16 korrik 2008 (konfidenciale) (versioni publik i redaktuar: 17 korrik 2008)

### **Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Brahimajt**

*Prokurori k. Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt*, Lënda Nr. IT-04-84-T, Dosja Gjyqësore Përfundimtare në Emër të Lahi Brahimajt, 14 janar 2008 (konfidenciale) (versioni publik i redaktuar: 22 janar 2008)

### **Dosja e Kundërpërgjigjes së Brahimajt**

*Prokurori k. Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt*, Lënda Nr. IT-04-84-A, Dosja e Kundërpërgjigjes në Emër të Lahi Brahimajt, 15 shtator 2008

**Dosja Paragjyqësore e Prokurorisë**

*Prokurori k. Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt, Lënda Nr. IT-04-84-PT, Dosja Paragjyqësore e Prokurorisë me Shtojcat Konfidenciale, 29 janar 2007*

**Dosja e Përgjigjes së Balajt**

*Prokurori k. Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt, Lënda Nr. IT-04-84-A, Përgjigje e Idriz Balajt ndaj Dosjes së Apelit të Prokurorisë, 25 gusht 2008 (konfidenciale)*

**Dosja e Përgjigjes së Brahimajt**

*Prokurori k. Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt, IT-04-84-A, Bashkim me Përgjigjen e Ramush Haradinajt ndaj Dosjes së Apelit të Prokurorisë, 25 gusht 2008.*

**Dosja e Përgjigjes së Haradinajt**

*Prokurori k. Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt, IT-04-84-A, Dosja e Përgjigjes në Emër të Ramush Haradinajt, 25 gusht 2008 (konfidenciale)*

**Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë**

*Prokurori k. Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt, Lënda Nr. IT-04-84-A, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Dosjes së Apelit të Lahi Brahimajt, 1 shtator 2008 (konfidenciale) (versioni publik i redaktuar: 1 shtator 2008)*

**Dhoma Gjyqësore**

Dhoma Gjyqësore I

**Kodi Penal i RSFJ-së**

Miratuar më 28 shtator 1976 nga Kuvendi i RSFJ-së gjatë Sesionit të Këshillit Federal, shpallur me dekret të Presidentit të Republikës më 28 shtator 1976, botuar në Fletoren zyrtare të RSFJ-së Nr. 44 të datës 8 tetor 1976, hyrë në fuqi më 1 korrik 1977

**NPK**

Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale

**Njoftim për Apel i Brahimajt**

*Prokurori k. Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt*, Lënda Nr. IT-04-84-A,  
Njoftim për Apel në Emër të të Akuzuarit të Tretë Lahi Brahimajt, 5 maj 2008

**Njoftim për Apel i Prokurorisë**

*Prokurori k. Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt*, Lënda Nr. IT-04-84-A,  
Njoftimi për Apel i Prokurorisë, 2 maj 2008 (publik me shtojcën konfidenciale)

**P**

Nënkupton “Prokurorinë” për identifikimin e provave materiale

**Prokuroria**

Zyra e Prokurorit

**Rregullorja**

Rregullorja e Procedurës dhe e Provave të Tribunalit

**RSFJ**

Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë

**Statuti**

Statuti i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, themeluar nga Rezoluta e Këshillit të Sigurimit 827, miratuar nga S/RES 827 (1993), ndryshuar nga S/RES 1166 (1998), S/RES 1329 (2000), S/RES 1411 (2002), S/RES 1431 (2002), S/RES 1481 (2003), S/RES 1597 (2005), S/RES 1660 (2006), S/RES 1837 (2008)

**Shqiponjat e Zeza**

Njësi e UÇK-së që vepronte anembanë zonës së Dukagjinit si Njësi e Posaçme e Ndërhyrjes

**T**

Transkripti i seancave në këtë çështje

**TA.**

Faqe nga transkripti i seancave të apelit në këtë çështje.

**TPNR**

Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Gjenocid dhe Shkelje të Tjera të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e Ruandës dhe Qytetarëve të Ruandës Përgjegjës për Gjenocid dhe Shkelje të Tjera të Kryera në Territorin e Shteteve Fqinje midis 1 janarit 1994 dhe 31 dhjetorit 1994

**UÇK**

Ushtria Çlirimtare e Kosovës

**Udhëzim Praktik mbi Kushtet Formale për Apelim të Aktgjykimit**

Udhëzim Praktik mbi Kushtet Formale për Apelim të Aktgjykimit (IT/201) i datës 7 mars 2002